

## SHENIM HYRES

Bashkëpunimi me gazetën KOHA JONE, mund të konsiderohet më jetëgjati në shtypin shqiptar. Sipas arkivit tim, fillon që më 1996 (në fakt që më 1993-94, por dorëshkrimet dhe materialet e ruajtura në një kompjuter tjetër kanë humbur) dhe shkrimi i fundit shënohet me 2018. Bashkëpunimi intensiv është deri në vitin 2004. Gjithsej janë ruajtur 49 shkrime, me 114 faqe word.

Po ashtu, është gazeta e pare dhe ndoshta e vetme ku shkrimet e mia u kushtohen terësisht problemeve politike dhe shoqërore në vend dhe përbënin një zë të fuqishëm në shtypin e shkruar shqiptar. Analizat politike për krizën e zgjatur pas 1996 nuk kishin thjesht guxim, por dhe thellësi mendimin dhe trajtimi i problemeve bëhej në një frymë më globale. Pa frikë mund të them se përbënin një shkollë për gazetarinë e atyre viteve. Kjo ishte arsyeja që në çdo veprimtari në rang vendi apo dhe ndërkomëbtare në lidhje me shtypin unë isha i pranishëm dhe i ngarkuar për të foluar.

## ΕΙΣΑΓΩΓΗ

Η συνεργασία μου με την εφημερίδα KOHA JONE μπορεί να θεωρηθεί η μακροβιότερη στον αλβανικό τύπο. Με βάση το αρχείο μου ξεκινάει από το 1996 (στην ουσία από το 1993-94, αλλά τα χειρόγραφα και τα αρχεία στον πρώτο υπολογιστή έχουν εξαφανιστεί) και το τελευταίο άρθρο δημοσιεύτηκε το 2018. Σώθηκαν συνολικά 49 άρθρα σε 114 σελίδες word.

Επίσης είναι η πρώτη εφημερίδα και ίσως η μόνη από τον αλβανικό τύπο, στην οποία σχεδόν όλη η αρθρογραφία μου είναι αφιερωμένη στα πολιτικά, κοινωνικά και οικονομικά προβλήματα της Αλβανίας και τα άρθρα μου αποτελούσαν μια ισχυρή φωνή στον αλβανικό έντυπο τύπο. Οι πολιτικές αναλύσεις για την παρατεταμένη κρίση μετά το 1996 δεν διακρίνονταν απλώς για την τόλμη, αλλά και βάθος σκευής και η προσέγγιση των θεμάτων γινόταν σε πλαίσιο διεθνών συσχετισμών. Αφοβα μπορεί να χαρακτηριστούν μια σχολή στη δημοσιογραφία εκείνης της περιόδου. Είναι αυτός ο λόγος ώστε σε κάθε εκδήλωση σχετική με τη δημοσιογραφία, στο εσωτερικό της χώρας ή σε διεθνές επίπεδο, ήμουν προσκεκλημένος επίσημος ομιλητής.

# ***PËRMBAJTJA***

- 1. Partia e Melos, Kalë troje për PD-në**  
15.06.1996 faq. 6.
- 2. Para kongresit të PS-së (24-25 gusht) Berisha me dorëza Makbethi kundër PS-së e Nanos (26 Maji mund të konvertohet në 20 tetor)**  
11.08.1996 faq. 7.
- 3. Kongresi i dytë I PS-së, më shumë një humbje e Berishës se një fitore e Nanos.**  
28.08.1996 faq. 10.
- 4. Një opozitë e fragmetnarizuar**  
**08.10.1996** faq.11
- 5. Zgjedhjet e 20 Tetorit, shpresa dhe zhgënjimi bashkë!**  
12.10.1996 faq. 12.
- 6. Puralizmi në shqiperi do te rikrijohet nga PD-ja (“Hojet e mjaltit” nuk janë të pafundme)**  
30.10.1996 u botua faq. 15.
- 7. Kush do ta korrigjojë tripushtetin e PD-së në shtetin e degraduar për shkak të politizimit të tij, fajdeve, korrupsionit, kriminalitetit, largimi nga vendi?!**  
5.11.1996/ 17 .11.1996 faq. 17
- 8. Zgjedhjet e parakohshme të paralajmeruara nga Perendimorët nuk kanë vlerë pa zgjidhur krizën institucionale të shtetit. (PD: Blloko rrugë elidh këmbët e veta)**  
5.12.96/07.12.1996 faq. 19.
- 9. Berisha, opozita serbe, SHBA dhe Kosova**  
13.12.1996 faq. 21.
- 10. Firmat piramidale, mashtrim që po prodhon tragjedi**  
21.12.1996 faq. 23.
- 11. Piramidat, laku që po i merr frymën Berishës**  
07.01.1997 faq. 24.
- 12. Berisha vetëm si qytetar i thjeshtë mund të vizitojë Greqinë**  
12.01.97/14.01.97 faq. 26.
- 13. Piramidat rranë, Berisha kërkon të shpetojë nga zemerata popullore**

- 19.01.1997 faq. 28.
- 14. Berisha që të shpetojë kokën, merr në qafë shqiptarët. Pse hesht Perendimi?**  
10.02.1997/14/02/97 faq. 31.
- 15. Rrethi i rrezikshëm vicioz i krizës së shtetit**  
28.03.1997/31.03.1997 faq. 33.
- 16. “Tradhetia” e 9 Marsit**  
14.04.1997/16.04.97 faq. 35.
- 17. Trashëgimtari i kurrores mbreterore, asi në mengë i Berishës për mbijetese politike. (Presidenti kufizon politikën)**  
20.04.1997/23.04.97 faq. 37.
- 18. Marrëveshja e 9 Marsit, fillimi dhe fundi i rolit të Komiteteve të Shpetimit Publik**  
26.04.1997 faq. 39.
- 19. Fokusi manipulator i Berishës për zgjedhjet e qershorit**  
30.04.1997/02.05.1997 faq. 42.
- 20. Ose Komitete dhe Levizje, ose Berishë dhe dhunë**  
/13.05.1997 faq. 44.
- 21. Perendimi: Çfare të bëjme me Shqiperine?! Dhe lojrat e Berishes për të fituar pushtet**  
28.05.97 faq. 45.
- 22. Zgjedhjet e 29 qershorit , si mundësi për të ndërtuar shtetin dhe jo për të marrë pushtetin**  
19.06.1997 faq. 47.
- 23. Sfidat e ringritjes së shtetit (Shqiperia në prag të një ideali të ri)**  
/19.08.1997 faq. 49.
- 24. Precedentet “e trashëguara “ dhe reflektimi i tyre në situata aktuale**  
25.08.1997 faq. 52.
- 25. Çfarë synohet me harresën dhe fajesimin e Levizjes Popullore për Demokraci?**  
17.09.1997 faq. 54.
- 26. Përgenjeshtrim**  
31.10.1997 faq. 56.
- 27. Përvjetori i parë i nëntë Marsit, vërteton kompromisin politik kundër shtetit**  
04.03.1998 faq. 57.

- 28. Pushteti, kjo tepsi me thela mishi**  
09.07.1998/ 14.07.1998 faq. 59.
- 29. TROJKA ne Tiranë: Paqja që rrezikon perpektivën e shtetit**  
20.09.1998 faq. 64.
- 30. Oktapodi i krizës shqiptare, Perendimi – rajoni dhe terrorizmi**  
21.09.1998/23.09.1998 faq. 67.
- 31. Riciklimi i krizës dhe nëvoja e kultivimit të shoqërisë civile**  
09.10.1998/11.10.1998 faq. 70.
- 32. Arsyet për të mos qenë historik takimi Majko-Berisha**  
27.12.1998/29.12.1998 faq. 72
- 33. Kuvendi Popullor viktime e falsifikatoreve të propozimeve per në këshillin kombëtar të RTV-së**  
28.12.1988 faq. 74
- 34. Doreheqja e Nanos nga kreu i Partisë lëvizje politike apo dalje nga politika?!**  
21.01.1999 faq. 75.
- 35. Pakti për rendin Majko-Berisha, strategji e Berishes për të ardhur në pushtet**  
10.02.1999 faq. 77
- 36. Zgjedhjet locale të 1 Tetorit treguan serish përplasje antivlerash dhe aspak ballafaqim vlerash.**  
Java e parë e tetorit 2000 faq. 79.
- 37. Rregjistrimi i popullsisë dhe problemi historik i Minoritetit Etnik Grek**  
12.04. 2001 faq. 81.
- 38. Paternalizmi nacionalist për të drejtat e minoriteti një rrezik për të ardhmën evropiane të Shqipërisë.**  
Artikulli i përket periudhës prill 2001. Eshtë botur dhe në gazeta të tjera  
faq. 83.
- 39. Deformim i paprecedent i realitetit politik në mazhorancë**  
12.11.2001/17.11.2001 faq. 86.
- 40. Nanua hedh ne KPD dorashkën, por nuk e ngre askush...**  
07.12.2001 faq. 89.
- 41. KPD-ja e Partisë Socialiste, të gjithë kundër të gjithëve dhe epersia e sulmuar e NANOS (PS- një mjegull e ndriçuar)**

- 14/12/2001 faq. 92.
- 42. Kundër N. Gaxojannis, apo kundër helenizmit!?**  
8.12.2002/10.12.2002 faq. 95.
- 43. Pronësia mbi tokën dhe politika neotmaniste**  
15.01.2003/ 17.01.2003 faq. 98
- 44. Përplasja quhet Rama, apo përplasja kërkon Ramën.**  
(Prishja e marrëveshjes së 5 prillit 2002 dhe përplasja për E. RAMEN  
26.01.2003 faq. 101
- 45. Rikthimi i epokës së Migjenit dhe mungesa e revoltës!**  
13.02.2003/16.02.2003 faq. 103
- 46. Medjat: ingranazh i makinës së pushtetit dhe ombrella mbrojtëse të korrupsionit e krimit (Medjat,- mjet konfirmimi i një shoqërie që mohon vetvetën.)**  
30.06.2003/02.07.2003 faq. 105.
- 47. Realiteti i krizës dhe qëllimi i opozitës për të marrë pushtetin**  
27.02.2004/28.02.2004 faq. 108.
- 48. Pse i duhet kthyer “periudhës barbare”?**  
/08.03.2004 faq. 111
- 49. Në varrimin e Kacifas nuk kishte asgjë antishqiptare në Bularat**  
13 Nentor, 2018 faq. 112
50. Fund faq. 114

**Nga Panajot Barka**  
**Partia e Melos, Kalë troje për PD-në**  
 15.06.1996

# Partia e Melos, Kalë troje për PD



Politikisht, mbështetja që përqafo PD-ja, në përfaqësimin për të krijuar pothuajse artificialisht pluripartizmin e parlamentit të vet; nga përkrahja e partisë së Melos, është më e rëndësishme se çdo përkrahje tjetër e partive të vogla.

Kjo përcaktohet nga fakti se PBDNJ-si si një parti e minoritetit grek, ka një status të veçantë dhe që mirret në konsideratë si e tillë. Nga ana tjetër është një parti që në kushtet konkrete krijon korridorët e komunikimit me Athinën.

Në këto zgjedhje u duk qartë se Partia e Melos, e cila fitoi rol nën përbërjes së Greqisë, do të shërbejë si një kalë troje për PD-në, me qëllim që t'i shpëtojë vota opozitës atje ku vet PD-ja do ta kishte të vështirë. Në logjikën e zgjedhjeve të drejta e të barabarta një formulë e tillë do të ishte e pranueshme. Mirëpo rrjedha e ngjarjeve e ktheu

te filluar si shprehje pakënaqësie ndaj qëndrimeve të tyre politike shumë kohë para zgjedhjeve. Eshë kjo arsyeja që PBDNJ-si pranoi pa asnjë kundërshtim t'i numëronin votat në minoritet, njerëzit e PD-së, duke vënë në dyshim për herë të parë besueshmërinë e tyre në numërimin e votave. Një akt i tillë si dhe pozicionimin e pas 26 Majit të PDNJ-së dhe të Omonias ku njëri udhëheqës i binte gozhdës e tjetri padokoi, ku njëri deklaronte, tjetri ç' deklaronte dhe një tretë përgjëjësitorite, e la minoritetin pa identitet politik.

Nuhatja politike e minoritetit i përshkon atij mesazhin se nuk duhet të rrijë në krahun e dhunës të demokracisë së pasojat e këtij dhunimi do t'i vuajë pari ai - si minoritet. Ai nuk do të pranojë "përkëmbje" e pushtetit duke vuajtur përditë vështrimin përhuazës të vëllezërve shqiptarë ashtu siç po ndodh këtë ditë. Një qen-

drim i tillë do ta çonte atë në vetëzolim, pra në një largim nga aspirata e tij për t'u integruar në shoqërimin shqiptarë veçanërisht duke kontribuar direkt për çështjen e demokracisë. Kjo bëhet më dominuese për faktin e vendosjes së saj në Jug të Shqipërisë, ku më së një herë tregoi se nuk e do udhëheqjen e Berishës.

Minoriteti grek s' do të pranojë të respektojë një qëndrim pasiv dhe njëkohësisht komprometues me shkatërratë e krizës, edhe pse fatkeqësisht këtë e kërkon, sipas shrypit grek, edhe Athina.

Në këto momente Greqia duket se nuk i merr parasysh këto raporte marrëdhëniesh dhe i kundërvihet në fakt vullnetit të brendshëm të asaj pjese të popullsisë që më 1994 e inkurajoi kundër Berishës, për të përkrahur më 1996 PD-në.

**PANAJOT BARKA**

**PROMEMORIE drejtuar: Departamentit të Shtetit të SHBA, Bashkimit Evropia,**

# Para kongresit të PS-së (24-25 gusht) Berisha me doreza Makbethi kundër PS-së e Nanos (26 Maji mund të konvertohet në 20 tetor)

11.08.1996



PD-ja, duke shfrytëzuar pushtetin e pa respektuar nga te tjeret, qe ajo i dha vetes edhe ne situaten e re politike parazgjedhore, kerkon rolin e lojtarit qe drejton lojen dhe jo rolin e lojtarit te barabarte ne fushe. Taktikat e perdoruara jane mese te njohura:- befasia, dokesimi dhe inaktivizimi politik i kundershtrart dhe taktika e faktit te kryer.

Ndonese «rezultative» deri me sot keto taktika, situata e

precipituar ne vend pas zgjedhjeve te 26 Majit krijon korridore teper te ngushta per efektivitetin e tyre ne zgjedhjet e 20 Tetorit. Duhet nenvizuar gjithashtu se ajo per te cilen ka me shume nevojë PD-ja sot eshte rikuperimi i figures se vet politike ne standarte te pranueshme demokratike. Nga ana tjetere, ne deklarata te shume liderve te saj konstatohet hapur fakti se PD-ja nuk ka demtuar vetem veten, por ajo eshte pergjegjesja kryesore edhe per kredibilitetin demokratik te humbur te vendit. Pra thelbi i pushtetit qe posedon PD-ja eshte shprehje e nje krize te karakterit te dyfisht, te cilen vetem ne shfaqje duket se e perjeton opozita.

Faktori baze per riparimin e kesaj situate mbetet nje fitore e mundshme ne zgedhjet e Tetorit. Mirpo nje fitore me mjete demokratike eshte e pamundshme per PD-ne, ashtu si dhe nje humbje me diference minimale. Ndersa, nje fitore me mjetet e 26 Majit konkretisht ne neutralizimin final te kredibilitetit te brendshem dhe te jashtem politik ta saj. Dhe PD-ja e di mire cdo te thote kjo. Nga ana tjetere edhe po te doje ajo te riperdore mjetet e Pirosh dhe dorashkat e Makbethit, do te korre jo humbje por disfate te pariparueshme.

Eshte kjo arsyeja qe ne arsenalin e taktikave te vjetra te saj, PD-ja ka bere nje diferencim serioz. Pa hequr dore nga befasia dhe taktika e faktit te kryer, ajo i meshon fort tani neutralizimit te kundershtrert politik. Me AD-ne dhe PSD-ne, apo dhe me PDD-ne, PD-ja duket se ka ezauruar gjithë arsenalin e mundshem dhe tani operon me tabut e idealizmit objektiv, qe, nga qe nuk do te egzistojne ne mendjen e PD-se, beson se dhe per te tjeret nuk egzistojne.

Keshtu qe ne kete aspekt objekt kryesor mbetet PS-ja, operacioni ndaj se ciles eshte shumeplanesh, me interesa afirmative per PD-ne dhe udheheqesin e saj Berishen, dhe neutralizuese apo dhe kontrolluese mbi PS-ne.

Fakt eshte qe makina propagandistike e PD-se, mirret shume me zhvillimet e brendshme ne PS. Kjo nuk synon ate qe deklarohet se PD-ja kerkon reformimin e PS-se, (qe PD-ja e ben per afirmimin e «vlerave» te veta Demokratike), por synon ne

mjegullimin e metejshe te perespektives se PS-se, ne fragmentarizimin e jetes politike te saj dhe te partive te tjera, ne grupe individesh dhe persoanalititesh politike, te cilet per asnje cast te mos gjejne kohe te mirren me qellimin politik te nje organizimi partiak, por me sharrime te ndersjellta karrigesh dhe pjedestalesh. Po ashtu arsenal i propagandistik i Berishes kerkon me kete rast te denigroje dhe te izoloje njerez, te cilet nuk iu binden vullnetit te tij. Ata akuzohen per faje politike, si precedenti i burgosjes per motive politike te Fatos Nanos, te cilat ne fakt rendojne karrieren e shkurter politike te vet Berishes. (Ata duhet te vuajne tani patetizmin e treguar ne nje moment fillestar per te fituar besimin e tij)

Ne operacionin e PD-se ndaj PS-se vihet re se si mirret ne mbrojtje nje grup dhe si denigrohet e sulmohet nje grup tjetër në këtë parti. Qellimi ketu, mesa duket, nuk eshte vetem diversioni, por edhe perpjekeja pe te ruajtur te paprekur brenda ne PS ate kategori njerezish qe, edhe sipas Nanos, me ndergjegje apo jo, kane cuar uje ne mullirin e PD-se. Eshte kjo nje nga arsyet e konfrontimeve te ashpra te mjeteve informative te PD-se me udheheqesin e burgosur te socialisteve Fatos Nano.

Logjikisht eshte e pranueshme qe F. Nano te mos pajtohet me disfatat e perseritura ne betejat politike te partise, ne kushtet e fitoreve teper te sigurta, te cilat ne fund te fundit nuk perfaqesonin thjesht fitore politike te PS-se, por te gjithe opozites dhe sigurisht te demokracise dhe te te gjithe vendit.

Po ashtu, eshte e logjikshme qe Ai si kryetar, te kerkoje ne nje prag kongresi te Partise reformim real te Partise ne ide dhe ne njerez, por jo reforma qe në fakt nuk prishin statuskuon ne parti te cilin Ai e quan «kenetor». Ai qe, si politikan ka manifestuar vazhdimisht ide reformatore ne politike dhe ne mentalitetin e realitetit te ri te shoqerise shqiptare, kuptohet qe si kryetar i partise, i liruar sigurisht ne periudhen midis dy kongreseve, apo dhe menjehere pas kongresit te Gushtit, nuk do te mund te bashkepuoje me njerez dhe qendrimet, te cilat ose shquhen per perulje politike, ose per bashkepunim kuintash, ose per paaftesi per te marre pergjegjesi politike. Ky reformim duhet bere vertet ne Kongresin e Partise, por opinioni duhet te pergatitet paraprakisht per te marre vendime te tilla, te cilat do te jete teper e veshtire te realizohen pas Kongresit.

PD-ja e sulmon Nanon edhe per nje dicka tjetër. Kushdo e kupton qe PS-ja po te mos e kishte te zgjidhur problemin e kryetarit, do te ishte percare mes ambicjeve te pretendeteve me ide dhe origjine te ndryshme. PD-ja e di qe Nano eshte i pazevendueshem brenda ne PS. Per kete arsye ajo kerkon ose t'i pengojte perpjekjet e tij per reformimin real te PS-se, ose t'i banalizoje keto perpjekje ne lufte individesh e klanesh, ose te shnderroje dialogun e Nanos me kryesine e PS-se, ne nje konflikt ku njera pale, (e patjeter Nanua) te abandonojte Partine.

Qe Nanua nuk eshte nje aventurier politik, por politikan i pergjegjshem, refarmator dhe i pjekur, kjo dihet. Ai e pranon sfiden dhe bistrurine. Perderisa ka vendosur te flas, ai di shume gjera dhe perderisa kryesia nuk respektoi propozimin e tij per ta pergatitur Kongresin njerez jasht kryesise por me funksione te larta ne Parti, kjo do te thote se Ai do t' i hapi letrat e tij ne Kongres, i bindur se edhe pa qene i pranishem, pikepamjet e tij do te fitojne. Problemi shtrohet nese ata qe nuk do te fitojne cdo te bejne. Do te disiplinohen, do te reflektojne brenda kuadrit te njohur demokratik apo do te rebelohen? Ne rast se po, sa e madhe do te jete carja dhe a do te ndikojte ne peshen e PS-se? Keto e te tjera jane pyetje qe do marrin pergjigje pas disa ditesh. Rendesi ka qe themimet e mundshme ne PS nuk duhen pare me panik. Ato jane fenomene te natyrshme. Ne kete plan, nje grimcim i PS mund te perbeje material per materien e nje force politike te qendres drejt se ciles aspiron elektorati Shqiptar e qe me sa duket per kongretizimin e saj jane te domosdoshme si kuadri dhe aksioni politik, ashtu dhe figurat politike. Por



per aspektin imediat ajo qe ka rendesi eshte se PD-ja, persa i perket elektoratit, nuk duhet te shpresoje shume nga zhvillimet ne PS, se elektorati, sido qe te veje puna, do t' i mbetet opozites.

Por rrethi i Berishes e sulmon Nanon edhe per faktin se ne rend te dites rishtrohet lirimi i tij. Lirimi i tij mund te realizohet nga gjykata e Strasburgut, por edhe nga vet Berisha, prandaj eshte i domosdoshem shkaterrimi i pedestalit te tij. Berisha mund ta liroje per dy arsye. Ne qoftese zhvillimet ne PS do te shkojne ne linjen e kenaqshme per te, atehere rezulton se Nanua do te jete i pafuqishem ne krye te Partise se tij, ose lehtesisht i «lexueshem» nga Berisha. Nga ana tjeter Berishes i duhet te rikuperoje me shume se vet PD-ne figuren e vet politike. Keshtu, ai mund t'i paraprije Strasburgut per te lare duart nga nje mekat politik te cilin, dhe pas 26 Majit ia rifokusuan si per t'i thene se demokracine e deklararon por nuk e zbaton. Perpjekja titane e gazetes «ALBANIA», per te shfajesuar Berishen nga burgimi i Nanos, nuk presupozon komente.

Megjithate zhvillimet ne PS kane rendesi te madhe ne zhvillimet politike te vendit si ne aspektin imediat dhe ne ate te perspektives. Ne aspektin imediat ato duhen pare ne mundesine qe ka PS-ja per te koordinuar aksionin politik me pjesen tjeter te opozites. Kjo per momentin ka rendesi primare per frenimin e Berishes ne ndermarrjen e veprimeve qe nuk respektojne as propozimet e Institucioneve Perendimore e as ato te opozites. Berisha me sa duket eshte i gatshem te perseris fenomenin e Princit VID per Shqiperine, por opozita para se to behet bashkefajtores, duhet ta ndaloje ate.

18.08.1996

Panajot Barka

Nga panajot Barka

## **Kongresi i dytë i PS-së, më shumë një humbje e Berishës se një fitore e Nanos.**

28.08.1996

Kongresi i dytë i PS-se justifikoi shpresën e optimisteve se pluralizmi në Shqipëri, konsolidohet hapi pas hapi duke sfiduar diversionet dhe imponimet që partitë të shnderrohen në egzistencë formale të mekanizmave që zoterojnë pushtet dhe perpiqen ta mbajnë atë me mentalitë moniste e totalitariste.

Evenimen tjetër që shenoi tubimi i socialistëve shqiptarë është se tregoi se egzistenca politike e individit apo e një grupi të caktuar nuk mund të evidentohen vetëm duke u shkeputur e duke krijuar formacione të reja politike (semundje foshnjore e pluralizmit shqiptar) me synim që çdonjeri të bëhet kryetar. Por një egzistencë e tillë mund të evidentohet duke u perpjekur për të afirmuar bindjet e tua politike brenda grupimit politik që të shpreh duke menjanuar kompleksin e të qenit superior. Tregoi gjithashtu se «Kutite» në spektrin politik shqiptar janë të percaktuara nga çdo pikepamje dhe «kapercimet» janë të veshitura.

Në kongresin e PS-se, Fatos Nano nuk fitoi se u zgjodhë kryetar. Fitorja e tij lidhet me faktin se ka pjekurine e politikanit që jo vetëm ndjen peshën e nevojës për veprim politik por që di ta inicojë e ta kurrëzojë atë me sukses duke operuar thellë por pa shkaktuar dhimbje të mëdha që mund të kapërcejnë kufirin e lejueshmë të një rezonance politike. Në këtë sens ai e shkallmoi izolimin e burgut. Mbajtja e tij akoma në qeli provon se prangavenësit e tij nuk mund ta kuptojnë se kështu nuk i bëjnë demnjëri Fatos Nano, por politikës dhe demokracisë shqiptare që ka nevojë për të, jo thjesht në kuptimin e nevojës për kontributin e çdo njeriu. Në këtë aspekt, falja dhe e denimit është e lavdërueshme, por mbajtja në burg si kundërshtar politik përben dhunim të interesave të vendit.

Vija e Nanos, ashtu si pritej, fitoi në Kongres. Kjo vijë kishte dy plane: Se pari nevojën e reformimit të dokumentave dhe se dyti zgjedhjen e stafit për realizimin praktik të këtij reformimi. Në aspektin kohor reformimi i programit dhe i statutit zune kohën më të shkurtër, gjë që tregon se përbente domosdoshmëri për të gjithë. Kjo ka një rëndësi shumë të madhe. Përzgjedhja e stafit që «djersiu» kongresin duke vërtetuar edhe një herë se nuk ishin idetë që nuk e lënë PS-në të dilte nga rrethi vizioz i fitoreve që përfundonin në humbje, por njëzërit në krye të saj. Një situatë e tillë pas kongresit krijon premisa për një opozitë të hapur brenda në PS. Kjo, kuptohet, është në të mirë të saj deri atëherë që kjo opozitë do të mbajë mirë parasysh mesazhin e Nanos se s' duhet të mbijetojë duke gjuajtur gabimet e mundshme të udhëheqjes, (për t' i zënë vendin), por duke u perpjekur për të afirmuar me mirë vlerat politike të partisë.

Nga ana tjetër, punimet e kongresit të PS-se evidentuan gjithashtu semundjen e vjetër të politikaneve shqiptarë. Kjo u shpreh në «Sinqeritetin e tepruar» që do të thotë gadishmëri permanente për të kthyer në kundërshtar dhe armik njeriun e të njëjtave ideale, për shkak se dikur mendimet nuk u pajtuan. Dhe në emër të kesaj njeriu tend nuk i ha mishin për t' i lenë kokat, por i ha mishin dhe kokat ia bluan. Në kongres u fol ,madje nga eksponent i PS-se , për «antimerkanizmin, antinatioizmin dhe antievropianizmin» e F. Nanos, apo dhe sensin «negativ» të Nanos në momente të caktuara, ndaj disa emrave të njohura në PS. Diskutanti la të kuptohet se këto u janë servirur edhe diplomateve të huaj në kontaktet e shumta që ai kishte nga pozicioni në parti. Pas kesaj merren me mend rezervat e Perëndimit për kryeministrin e mundshëm

te ardhshem dhe qendrimet ndaj Opozites, sidomos ne kohen para zgjedhjeve te pergjithshme.

Sigurisht ajo qe ka me shume rendesi eshte se PS arriti te ruaje ekulibret perfundimtare aq te brishta per shoqerine shqiptare por aq te domosdoshme per jeten politike. Nje merite te madhe ne menjanimin e percarjes dhe te ikjes nga PS-ja ndihmuan goditjet e vazhdueshme te PD-se dhe e shtypit opozitar. Kjo beri qe askush te mos guxojte ta ktheje rrebelimin ne ikje, pasi cdo ikje do te shoqerohej me damken «njeriu i Berishes».

Megjithate, humbesi i madh pas kongresit te PS nuk jane kundersharet e Nanos brenda ne PS, por Berisha dhe PD-ja

Ne nje kendveshtrim te caktuar PS-ja ishte objekt veprimi, por me kahje te kunderta, si per Berishen ashtu dhe per Nanon. Nuk eshte e vertete se Berisha harxhoi kaq shume energji ndaj PS-se se s' kishte me se te mirrej, se donte te mbante gjalle antikommunizmin dhe entuziazmin e pasuesve te tij. Nuk eshte e vertete gjithashtu se gjithte ato energji te tij synonin te harxhonin sa me shume kohe deri ne zgjedhjet lokale apo te terhiqnin vemendjen nga puci elektoral i 26 Majit, apo qofte dhe nga kolapsi politik e ekonomik qe po futet vendi. Synimi ishte me i larget. Ai ka bazen tek mentaliteti i te qenit vetem, apo vetem mbi vasalët. Dhe kjo mund te arrihej vetem duke copezuar PS, partine me elektoratin me te madh ne vend. Tani Ai e di qe ketij elektorati eshte e veshtire t'i vjedhesh prap votat, dhe pushteti do te dorezohet apo do te mirret ne baze te ketyre votave. Ne kete kontekst Berisha ne historine e pluralizmit shqiptar do te mbetet udheheqesi politik qe fitoren e pushtetit nuk e llogariste me ballafaqimin e alternativave politike, ekonomike e qeverisese, por me shkaterimin e kundershhtarit, duke perdorur pushtetin.

Megjithate ndonese ne pozita krejt te pabarabarta Nanua e fitoi betejten me Berishen ne lidhjen me te ardhmen e PS-se. Fatos Nano pervijoi me kete rast dhe nje vlere pak te spikatur te ish udheheqjes se PS-s. Mohimi nga delegatet e kongresit i leximit te mesazhit te Berishes drejtuar atyre, tregoi edhe nje here se ata ne menyre unanime jane kunder Berishes. Fatos Nanua u mesoi se per te fituar nuk mjafton te jesh kundra, por dhe te ndeshesh ballas dhe ashper me te.

Berisha vertet u mund ne perpjekje per te fituar ne PS, (percarje, udheheqes, kontrolletj) Fjala e tij e ashper disa ore pas kongresit te PS-se ishte nje manifestim i hapur i humbjes. Por megjithate ai dhe udheheqja tjeter e PD-se duket se nuk i dorezojne armet. Po ne fjalimin e tij ne aktivin e PD-se u duk qart se, me shume se strategjia per te fituar zgjedhjet lokale, u percaktua strategjia e re kunder PS-se. Tani qe reformimi programor i PS-se u arrit drejtimet e luftes kunder PS do te jene Individet udheheqes te gjithte te «pareformuarit», «antikombetarizmi» i PS-se dhe hapja e dyerve per te «thithur» FRESSH-in

Ky eshte perfundimi qe del nga reagimi i pare i stafit te PD-se, per kundershhtarin te cilin edhe do ta mund deri ne shkaterrim, por edhe e do qe te kete mese te mirret kur i duhet per te «shtrenguar rradhet»

28.08.1996

Partitë politike dhe zgjedhjet lokale të 20 tetorit

# Një opozitë e fragmentuar

Në Nëntor të 1994, opozita nuk diti ç'te bënte me fitoren që i dha populli në referendum për kushtetutën, ndërsa PD-ja filloi përgatitjet për të provuar se nuk ishte e gatshme për të dorëzuar pushtetin. Me 26 Maj të '96 opozita dhe demokracia në vend do të provojë sfidën berishiane ndërsa bota do të konfirmojë se shkëlqimi i demokracisë së shitur nga pushteti i Berishës nuk ishte prej floriri, por i bakërt. Kjo histori e trishtueshme politike e bën 20 Tetorin të perceptohet si një moment të ngarkaur me shumë përgjegjësi politike. Barra i bie përsëri ta mbajë opozita. Një fitore e opozitës dihet që do t'i hapë rrugën shpresës "për një rrjedhë logjike" të instalimit të pro-

ceseve demokratike në vend me ribërjen e zgjedhjeve të përgjithshme në një afat sa më të shkurtër. Pra zgjedhjet e 20 Tetorit dhe mënyra e zhvillimit të tyre, përbejnë piksepër një test për aftësinë e Shqipërisë në rrugën e demokracisë dhe për marrëdhëniet e saj me Perëndimin. Janë njëkohësisht dhe një test për vet opozitën, sidomos për atë socialiste. Rezultati i zgjedhjeve do të tregojë sa dhe si e kapërceu krizën që pasoi pas zgjedhjeve të 26 Majit. Do të tregojë gjithashtu sa e aftë është ajo për ta marrë dhe të mbajë pushtetin. Vonësa e saj dhe jo vetëm e PS, për të deklaruar pjesëmarrjen në zgjedhje tregoi edhe një herë se ajo, opozita, lojën e vet politike e zih-

villon shpesh nën kushtet e strategjisë së PD-së. Por nga ana tjetër i dha asaj mundësinë të tërheqë me shumë vëmendjen e Institucioneve perëndimore për procese zgjedhore në Shqipëri, kujdes që për nga numri i vëzhguesve dhe analiza e situatës politike në vend nga forumet ndërkombëtare, përbën një rekord që ja kalon ndoshta dhe Bosnjes. Në këto zgjedhje opozita ndryshe nga ato të 26 majit, nuk përbën një front unik. Fronti tanimë ka një lidhje të brendshme të shprehur në strategjinë e përgjithshme, të gjithë kundër antishetit dhe nuk ka një koordinim organik ashtu si para zgjedhjeve të 26 majit e sidomos pas çuqit elektoral. Duket gjithashtu qartë se opozita nuk mund

të përballojë me efektivitet gjigantin propagandistik, televizionin shtetëror. Po ashtu mungesa e fondeve i hoqi me sa duket asaj mundësinë e përdorimit të një propagande vizualo-aplikative në terren ose dhe të metodave të tjera që do të mund të kompensonin qoftë televizionin qoftë dhe makinën shtetërore që përsëri është e tëra në funksion të propagandës së PD-së. Po ashtu opozita, dhe veçanërisht ajo socialiste, në përpjekje për ta çtensionuar politikisht fushatën elektorale, me qëllim për t'i hequr armën e përdorimit të mjeteve të forcës dhe frikës nga ana e PD-së, duket se kaloi në ekstremin tjetër. Ajo jo vetëm nuk tregon

P. BARKA  
(Vijon në faqe 24)

(Vijon nga faqja 7)  
aftësi për t'i mbyllur korridorët e lëvizjeve të paligjshme të PD-së, por shfaqet shumë më e tërhequr dhe pasive se elektorati i vet, aq sa me të drejtë shtrohet pyetja: Kush është më i friksuar nga presioni i berishianëve, udhëheqja politike e opozitës apo elektorati i saj? Po ashtu opozita nuk arriti të shfrytëzojë avantazhin që krijoi presioni ndërkombëtar lidhur me ndërtimin e komisioneve elektorale. Sipas formulës së aprovuar, nënkryetari në komisionet e çdo niveli duhet të jetë nga opozita parlamentare. Komisioni qëndror i zgjedhjeve në udhëzimin përkatës konsideron opozitë partinë që vjen e dyta në zgjedhjet lokale të 1992. Kjo do të thotë që në komisionet e niveleve rreth, bashki, komunë ku PD-ja erdhi e dyta në zgjedhjet e

minione, përveç kryetarit ose sekretarit që e fiton si pozitë nga zgjedhjet parlamentare, (pra si përfaqësues të qeverisë) edhe nënkryetarin si përfaqësues të opozitës, por të opozitës në pushtetin lokal. Kjo kuptohet i krijon, bashkë me prapësitë e tjera që projekton KQZ, predispozitat për manipulimet e mundshme. Nga ana e vet PD, pavarësisht se në dukje superiore, e nisi dhe po e vazhdon fushatën me shumë fragmentarizëm, e njëkohësisht shfaqet shumë anemike. Nga njëra anë kuptohet që njerëzit e saj të ndershëm nuk e shijuan fitoren e shfaqur si kokë e përgjakur mbi sininë e argjentë në tavolinën e humbjes. Po ashtu ajo nuk mundi të kënaqi brenda disa muajve premtimet individuale të manipulatorëve të vegjël në të gjitha strukturat e proceseve zgjedhore, gjë që nuk i siguron lehtë kontigjent të ri për 20 Tetorin. Nga ana tjetër, ajo tentoi të drejtojë opozitën drejt bojkotimit të zgjedhjeve për të qenë kështu fitues i vetëm në një ndeshje me një lojtar, veten. Madje bojkotimin e mundshëm të procesit zgjedhor nga ana e opozitës, si pasojë e intolerancës dhe e manipulimeve të mundshme të PD-së, PD-ja tentoi ta përdorë si profecinë e Kasandrës për të justifikuar imitimin e 26 majit nga ana e saj.

P. BARKA

## **Nga Panajot Barka**

### **Zgjedhjet e 20 Tetorit, shpresa dhe zhgënjimi bashkë!**

12.10.1996

Me 20 tetor populli shqiptar ftohet ne kutite e votimit jo ne nje procedure te thjeshte zgjedhor per te tria nivelet e pushtetit lokal, por per te marre pjese ne nje proces me te gjere politik qe lidhet me vete ardhmerine e proceseve demokratike ne vend, me faktin se kush dhe si do te drejtoje Shqiperine dhe mandej, do ta drejtoje apo da ta sundoje. Ne nje kuader te tille, do te ishte absurditet te mendoje se ne Shqiperi lufta politike zhvillohet midis se djathtes dhe se majtes. Kjo lufte politike eshte zhvendosur tanime ne nje perpjekje te pabarabarte midis pushtetit dhe nevojës per vendosjen e institucioneve demokratike, pa te cilat as qe mund te mendohet si pluralizmi, ashtu dhe liria e votës.

Nen kete kendveshtrim opozita nuk thirret ne skenen politike dhe nuk perkrahet nga pjesa dermuese e popullit per ta ardhur ne pushtet, por pikerisht si shprehje e aspiratave per instalimin e ketyre institucioneve demokratike.

Ne harkun kohor prej jo me shume se 24 muaj populli ftohet tani per te treten here rradhazi ne kutite e votimit, te cilet ne Shqiperi kane marre pikerisht kuptimin e mesiperm ku dhe dueli midis popullit dhe pushtetit aktual ka arritur ne kufij ku shpresa dhe zhgënjimi jane shume prane njera tjetres, vecse pasojat nga mbijetesa e cdonjeres prej tyre, mund te jene nesor ne kahje krejt te kunderta.

Ne Nentor te 1994 opozita nuk diti c' te bente me fitoren qe i dha populli ne referendumin per kushtetuten, ndersa PD-ja filloi pergatitjet per te provuar se nuk ishte e gatshme per te dorezuar pushtetin. Me 26 Maj te 96 opozita dhe demokracia ne vend do te provonin sfiden berishiane ndersa bota do te konfirmoje se shkelqimi i demokracise se shitur nga pushteti i Berishes nuk ishte prej floriri por i bakert.

Kjo histori e tristhueshme politike e ben 20 Tetorin te perceptohet si nje moment te ngarkuar me shume pergjegjesi politike. Bara i bie perseri ta mbajë opozita. Nje fitore e opozites dihet qe do t'i hap rrugen shpreses «per nje rjedhe logjike» te instalimit te proceseve demokratike ne vend me riberjen e zgjedhjeve te pergjithshme ne nje afat sa me te shkurter. Pra zgjedhjet e 20 Tetorit dhe menyra e zhvillimit te tyre, perbejne pikesepari nje test deciziv per aftesine e Shqiperise ne rrugen e demokracise dhe per marredhenjet e saj me perendimin.

Jane njekohesisht dhe nje test per vet opoziten, sidomos per ate socialiste Rezultati i zgjedhjeve do te tregojë sa dhe si e kaperceu krizen qe pasoi pas zgjedhjeve te 26 Majit. Do te tregojë gjithashtu sa e afte eshte ajo per ta marre dhe te mbaje pushtetin .

Vonesa e saj, dhe jo vetem e PS-se, per te deklaruar pjesemarrjen ne zgjedhje tregoi edhe nje here se ajo, opozita, lojen e vet politike e zhvillon shpesh nen kushtet e strategjise se PD se. Por nga ana tjetër i dha asaj mundesine te terheq me shume vemendjen e institucioneve perendimore per procese zgjedhore ne Shqiperi, kujdes qe per nga numri i vezhguesve dhe analiza e situates politike ne vend nga forumet nderkombetare, perben nje rekord qe ia kalon ndoshta dhe Bosnjes.

Ne keto zgjedhje opozita ndryshe nga ato te 26 majit, nuk perben nje front unik. Fronti tanime ka nje lidhje te brendshme te shprehur ne strategjine e pergjithshme,- te gjithe kunder antishtetit dhe nuk ka nje koordinim organik ashtu si para zgjedhjeve te 26 majit e sidomos pas pucit elektoral. Duket gjithashtu qarte se opozita nuk mund te perballoje me efektivitet gjigandin propagandistik ,-televizionin shteteror. Po ashtu mungesa e

fonteve i hoqi me sa duket asaj mundesine e perdorimit te nje propagante vizualo-aplikative ne terren ose dhe te metodave te tjera qe do te mund te kompensonin qofte televizionin qofte dhe makinen shteterore qe perseri eshte e tera ne funksion te propagandes se PD-se

Po ashtu opozita, dhe vecanarisht ajo socialiste, ne perpjekje per ta ctensionuar politikisht fushaten elektorale, me qellim per t'i hequr armen e perdorimit te mjeteve te forces dhe frikes nga ana e PD-se, duket se kaloi ne ekstremin tjeter. Ajo jo vetem nuk tregon aftesi per t'i mbyllytur korridorret e levizjeve te paligjshme te PD-se, por shfaqet shume me e terhequr dhe pasive se elektorati i vet, aq sa me te drejt shtrohet pyetja: Kush eshte me i frikesuar nga presioni i Berishianeve, udheheqja politike e opozites apo elektorati i saj?

Po ashtu opozita nuk arriti te shfrytezoje avantazhin qe krijoi presioni nderkombetar lidhur me ndertimin e komisioneve elektorale. Sipas formules se aprovuar, nenkryetari ne komisionet e cdo niveli duhet te jete nga opozita parlamentare. Komisioni qendror i zgjedhjeve ne udheshimin perkates konsideron opozite partine qe vjen e dyta ne zgjedhjet lokale te 1992. Kjo do te thote qe ne komisionet e niveleve rreth, bashki, komune ku PD-ja erdhi e dyta ne zgjedhjet e 1992-shit, te kete ne keto komisione, pervec kryetarit dhe sekretarit qe e fiton si pozite nga zgjedhjet parlamentare, (pra si perfaqesues te qeverise) edhe nenkryetarin si perfaqesues te opozites, por te opozites ne pushtetin lokal. Kjo kuptohet i krijon, bashke me prapesite e tjera qe projekton KQZ, predispozitat per manipulimet e mundshme.

Nga ana e vet PD-ja, pavaresisht se ne dukje superiore, e nisi dhe po e vazhdon fushaten me shume fragmentarizem, e njekohesisht shfaqet shume anemike. Nga njera ane kuptohet qe njerezit e saj te ndershem nuk e shijuan fitoren e shfaqur si koke e pergjakur mbi sinine e argjente ne tavolinen e humbjes. Po ashtu ajo nuk mundi te kenaqi brenda disa muajve premtimet indivuduale te manipulatoreve te vegjel ne te gjitha strukturat e proceseve zgjedhore, gje qe nuk i siguron lehtë kontigjent te ri per 20 Tetorin.

Nga ana tjeter ajo tentoi te çonte opoziten drejt bojkotimit te zgjedhjeve per te gene keshtu fitues i vetem ne nje ndeshje me nje lojtar, veten. Madje bojkotimin e mundshem te procesit zgjedhor nga ana e opozites, si pasojë e intolerances dhe e manipulimeve te mundshme te PD-se, PD-ja tentoi ta perdore si profecine e Kasandres per te justifikuar imitimin e 26 majit nga ana e saj. Kjo taktike zgjati deri ne momentin kur u hoq nga fronti i fushates elektorale Gjongecaj, per t'u zevendesuar nga Berisha e Shehu.

Dhe kjo periudhe lidhet kuptohet me udhetimin e Shehut ne SHBA, marredheniet me ta dhe qendrimi i tyre i patolerueshem ne lidhje me zgjedhjet e 26 majit, duket se e djegin shume presidentin tone.

Largimi nga fushata i Berishes per kohen qe Shehu ishte ne SHBA, lidhet me ate qe Ai synoi t'i tregonte SHBA-s se Ai si President di t'i respektoje rregullat e lojes demokratike duke qendruar asnjanes ne fushaten zgjedhore, mjaft qe Shtepia e bardhe te ndryshonte qendrimin ndaj tij. Mirepo kur e pa qe Shtepia e Bardhe nuk lidh me kontrata personale por ve si kusht respektimin e te drejtave te njeriut dhe demokracise ne pergjithesi, Ai, Berisha, vuri perseri ne funksion te PD-se gjithë makinen shteterore, duke harruar se ajo u perket gjithë shqiptareve nen logjiken se nje fitore e mundshme do te justifikojë 26 Majin dhe alibine politike te PD-se.

Rishfaqja e Berishes ne fushaten elektorale, lidhet dhe me faktin se brenda rradheve te PD-se filloi te ngrinte krye ideja se Berisha i braktisi te gjithë dhe mendon vetem per vete. Ne qarqe te ndryshme filoi te qarkullonte skema e vjeter qe Berisha do t' i ler te lira keto zgjedhje ku sigurisht do t'i fitoje opozita, me qellim qe te fitoje besimin e

perendimit. Ne vijim te lere kete parlament deri ne rizgjedhjen e tij President i Republikes e me pas, andej nga fundi i pranveres se 97 te shpall zgjedhje te parakohshme. Kjo logjik lidhet dhe me fjalet e perhapura per sherin brenda udheheqjes se larte te PD -se, bazuar kjo edhe ne diasa shkrime opozitare ndaj qeverise se PD-se ne gazeten ALBANIA (!) madje dhe ndaj vet Meksit i cili bashke me Arbnorin shume pak aktivizohen me fushaten.

Mirepo qendrimi i pandryshueshem i SHBA-s, vendosmeria e Perendimit per te vezhguar e monitorizuar zgjedhjet, i mbushen medjen e tij se vetem fitorja ne 20 Tetor mund t'i garantoje, per nje kohe me te gjate se humbja, qendrimin ne pushtet atij dhe partise se tij. Kjo , pavaresisht se verteton qe PD-ja ia ka me hile demokracise, d.m.th mendon vetem per vete, e nderlikon akoma me shume situaten parazgjedhore ne vend. Nga njera ane perpjekja per te penguar vezhgimin e huaj dhe vendas, tregon gadishmerine e PD-se per te manipuluar serish rezultatin si te vetmen alternative qe fitorja te anoje per te. Nga ana tjeter duket se populli duhet te gjeje kurajon per te perballuar ate uragan propagandistik mbytes te PD-se te kryesuar nga Berisha dhe e ndihmuar nga truket televizive, qe synon te krijojë edhe nje here iluzionin se PD-ja e ka ne xhep fitoren. Kjo krijon si mundesine per manipulim ashtu dhe indiferencen e votuesve per pjesemarrjen ne votim. Nje logjik e tille e kthen ne detyrim patriotik si pjesemarrjen ne votime, ashtu dhe mbrojtjen e votes se lire, patriotizem qe ne rradhe te pare duhet ta frymezoje dhe ta udheheq opozita.

P BARKA

## **Nga Panajot Barka**

### **Puralizmi në shqiperi do te rikrijohet nga PD-ja ("Hojet e mjalit" nuk janë të pafundme)**

/30.10.1996

Partia Demokratike me 20 tetor vertetoi edhe nje here se ç' thote dhe ç' do ajo do te behet ne Shqiperi. Tani eshte e qarte dhe formula qe e ben logjiken moniste te PD-se mentalitet politik te shoqerise Shqiptare.- Perballja e te gjitha institucioneve dhe forcave te tjera politike me binomin PD + shteti. Keshtu qe ajo qe ka më shume rendesi eshte te vihen re disa deformime konceptuale mbi shoqerine demokratike me pasoja teper te renda per te ardhmen e vet demokracise ne Shqiperi.

*Se pari : pozita-opozita,- dy vija paralele*

Alternativa e majte, e djathte ne Shqiperi po degjeneron ne nje fanatizim absurd politik, - ne dhe ata-, ku te dyja palet jane rreshtuar perballe njera tjetres ne menyre paralele. Baza ideologjike e se djathtes mbeti antikommunizmi dhe i se majtes perpjekja per te shpetuar nga etiketa e komunizmit qe i ngjiti e djathta. Kjo ben që pas pese vjet procesesh demokratike niveli i evoluimit te jete prap ai i vitit 1991, me te vetmin ndryshim se PD-ja e shfrytezon antikomunizmin e vet per te shmangur akuzen kryesore ndaj vetes, -perpjekjen per te instaluar nje neodiktature ne vend.

*Se dyti : Deformimi i elektoratit.*

PD eshte e vertete se nuk perdori armen e antikomunizmit per të krijuar bazen e vet te qendrushme elektorale. Madje ajo u divorcua shume shpejt nga ajo shtrese shoqerore qe e perjetoi diktaturen si drame te rende. Ajo e kuptoi qe antikomunizmi nuk prodhonte elektorat. Keshtu qe PD perdori metoden e suxhukut me arra dhe me mjalit per te krijuar nje elektorat te qendrushem, ku arrat e qeruara jane anetaret e PD-se, helli eshte vet PD-ja ndersa ena e madhe me mjalit ku zhytet helli per tu ntrashur me mjalit, eshte shteti i kontrolluar plotesisht nga PD-ja e qeveria e vet. Ne kete fushate elektorale u duk qarte se armata e elektoratit te PD-se perbehet nga zyrtaret e te gjitha rangjeve. Madje dhe ndarrja e detyrave ne fushate ishte bere pak a shume ne funksion te te ardhurave qe prodhon vendi i punes.

Ndersa me elektoratin e PS-se po ndodh nje fenomen i kundert. Ky elektorat, qe per arsye te ndryshme vazhdon te jete me i kompaktesuar, duket se u lodh duke besuar se vota e tij eshte e lire dhe e i abandonoi zgjedhjet, pasi nga ana tjetere filloi te dyshoje se udheheqja e tij jo vetem po semuret nga kompleksi i inferioritetit, por dhe skermoqet nga mungesa e unitetit. Kuptohet qe ata qe e perkrahnin PS-ne apo dhe opoziten ne pergjithesi nga pozitat e teorise se suxhukut me arra dhe mjalit prej kohesh jane para dyerve te PD -se. Kjo u duk qarte edhe ne gadishmerine pragmatiste te deklaratave per t'u dukur apo dhe te sherbimeve qe kategoria e tille e elektoratit dikur opozitar i ofronte PD-se.

Mirepo shnderrimi i marredhenjeve te shtetit me indivindin ne marredhenje interesash personale e ve ne pikpyetje te madhe vet funksionin e tij si shtet ligjor. Zgjedhjet e 20 tetorit te cilat dhe nga vet natyra treguan se madhesia e elektoratit te PD-se do te varet nga produktiviteti i marredhenjeve te interesit privat. Rreziku i kanoset keshtu dhe vet PD-se. Ne gjirin e saj jane te hapura kontradiktat midis atyre qe e krijuan dhe perfituan idealizmin e tyre dhe atyre qe e gjeten te gatshem Partinë dhe perfituan vila luksoze dhe pasuri. Por edhe «hojet e mjalit» PD-ja s'i ka te pafundme.



Se treti Morali i ketyre zgjedhjeve.

E verteta eshte se PD-ja perpunoi nje propagande ku nenvizohej qarte dhe hapur se e moralshme eshte n.q.s 100 % e votave shkojne per PD-ne. Nqs voton per PD-ne nderohesh, ne rast te kundert turperohesh. Ky moral nuk perfshiu vetem indivindin por rajone te tera madje te gjithë vendin. Provokimi ishte ne shume raste i hapur. «Qyteti yt nuk duhet te mbetet jasht kuadrit demokratik te vendit» theksonin ne kete fushate elektorale udheheqesit e larte te partise dhe te shetitit te PD-se. Niveli kulturor i individit apo dhe i grupit si kolektiv ishte ne vartesi te votes pro apo kunder PD-se. Dhe kultura politike kishte si sistem referimi voten ndaj PD-se, e cila konsiderohet si vet demokracia ne vend. Madje u arrit deri atje sa te thuhet vota pro PD-se eshte vote per çeshtjen kombetare. Po ashtu krahas idese se demokracia arrihet vetem me PD-ne, ndersa partite e tjera jane, ose per garniture, ose per te qene objekt «luftë», u fol me intisitet per programe inegzistente te krahasuara. Kulmi i kesaj logjike u arrit kur kandidatet e PD-se i thoshnin elektoratit se, votoni ne, se pas nesh eshte qeveria, kurse pas kundershareve askushi. Po shteti (!!).

Ndërkohë morali i opozites ishte: te marrim pjese apo jo ne zgjedhje, te bashkuar apo vec e vec, do ta pengojme PD-ne te vjedhi apo jo, e ka apo e humbi besimin elektorati dhe a do ta marri guximin te votoje.

Rezultati i ketij morali, bashke me moralin e votes se manipuluar te 26 Majit solli ne pamje te pare pjesemarrjen e pakte ne votime, me te voglen e pare ndonjehere ne Shqiperi, dhe fitoren e PD-se ne kushtet e abstenimit masiv

Se katerti : Pluralizmi do te rikrijohet nen «udheheqjen» e PD-se.

Zgjedhjet lokale ne vend konfirmuan disa nga boshtet me remineshence adekuate te shtetit monist. Psh centralizmi demokratik. Pushteti qendror pas 26 Majit kontrolohet ne masen mbi 90 % nga PD -ja . Pushteti lokal pas 20 tetorit po ashtu. Pushteti lokal, ne baze te premtimeve te PD-se do te jete efektiv se pas tij qendron qeveriq demokratike,. Pra eshte i centralizuar jo vetem se eshte ne duart e PD -se por mekanizmi i funksionimit te tij eshte i unifikuar. Se dyti PD-ja edhe pse siguroi, sipas saj , 90 % te dy pushteteve qendror e lokal, ajo synon te fitoje gjithcka qe votohet ne masen 100% (!).

Ne arenen nderkombetare po kumtohet qarte se e majta shqiptare eshte e papranueshme ne kundershitim me te djathten qe eshte e mirepritur.

Dhe se fundi. Vete PD-ja, qe sipas shtypit te vet, dhe eksonenteve me te larte te saj, i di te gjitha, na thtote se disa Parti opozitare jane inegzistente, disa veprojne ne kuadrin e mundesise dhe te idese, ndersa disa te tjera do te shkaterrohen, do te copetohen do te krijohen te tjera te reja, te pranueshme nga ajo vete. Parti te pozites dihet qe veprojne si rrypa te vet transmesioni.

E vetmja gje qe nuk dihet eshte sa e ndritur do te jete kjo demokraci e re.

Parashikimi i ardhur nga historia nuk eshte fort i kendshem. Problemi shtrohet te mos kemi kalim nga nje ekstrem ne ekstremin tjetër se kjo nuk do te jete vetem ne dem te PD-se por te te gjithë asaj gjeje qe ajo pretendon se po ngre Demokracise.

P. BARKA

(Ubotua me 30 ose 31 10.1996 ne gazeten KOHA JONE me disa shkurtime te vogla)

## **Nga Panajot Barka**

### **Kush do ta korrigojë tripushtetin e PD-së në shtetin e degraduar për shkak të politizimit të tij, fajdeve, korrupsionit, kriminalitetit, largimi nga vendi?!**

5.11.1996/ 17 .11.1996

Problemi që shtrohet tani para partise në pushtet është: Kush do ta korrigojë ate në veteqeverisjen e vet. Praktika katervjecare e pushtetit të PD-se tregoi se nuk pranonte «korrigjime», nga opozita duke e shndërruar rolin e kesaj të fundit në një funksion de jure. Në keto raporte nuk ndikoi në sensin pozitiv as egzistenca në duart e opozites të gjysmes të pakten të pushteti lokal.

Pas 27 Tetorit, në aspektin politik, unifikimit të shtetit me partinë në pushtet i shtohet dhe administrimi i plote i pushtetit legjislativ, ekzekutiv dhe atij lokal, si edhe menjanimi pothuaj edhe de jure i opozites. Kjo do të thote se pluralizmi politik në Shqipëri pësoi një goditje serioze në aplikimin e funksionit praktik politik. Pra thelbi është se opozita nuk mund të luaj rolin e vet në kushtet e krijuara.

Pushtetin e PD-se nuk mund t'i bëjë oponente as faktori tjetër shumë i rëndësishëm në kushtet e pluralizmit politik. -Organizatat dhe organizmat jo qeveritare dhe shoqëria civile. Ato ose funksionojnë formalisht, ose nuk kanë forcën e duhur imponuese, ose nuk egzistojnë fare. Marrim si shembull sindikatat. Faktikisht ato zoterojnë kryesisht sektorin shtetëror të punës. Sektori privat i punës jo vetëm që është i zhvilluar fare pak por edhe problemet e mundshme nuk arrijnë të prekin relatat me shtetin, sepse shteti as ka menduar dhe as mund t'u ofrojë mbrojtje ose përkrahje. Në këtë kuader sindikatat, njëra nga të cilat është lidhur me fije direkte me Partinë në pushtet, kanë aq pak njerez dhe janë aq të frikësuar për vendin e punës, qoftë si anetare të PD-se, qoftë si kundërshtarë, sa që edhe në një përpjekje për një grevë para do kohësh për gjene me të domosdoshëm,- buken, nuk ngacmoi pothuaj fare qeverinë dhe pushtetin e PD-se.

Në kushte të tilla është i paimagjinueshëm kundërveprimi i organizmave të tjere, të cilat me shumë duhet të themë se nuk egzistojnë se sa nuk veprojnë.

Fuqinë për të «korrigjuar» tripushtetin e PD-se e ka «humbur» edhe pushteti i katert, - shtypi. Kjo ndodh pikësepari se ky tripushtet i njësuar në siglën e PD-se mund të ushtrojë presion shumëplanësh mbi shtypin për të zbutur sa më shumë forcën e tij goditëse.

Se dyti,- hermetizimi i pushtetit para shtypit e bën të pafektshëm rolin e tij të fundit. Shteti gjatë gjithë kesaj periudhe jo vetëm që me intiferentizmin e tij për të reaguar ndaj atyre që shkruan shtypi, e ka injoruar ate, por i ka mbyllur pothuaj të gjitha portat e komunikimit me shtypin dhe gjykimin e punëve të tij nga shtypi. Marrim një shembull. Sa kohë shtypi, dhe si pasojë dhe qytetari i thjeshtë nuk e di ç'behët me financat e shtetit e vet, me shkallën e shfrytësimit të ndihmave të jashtme dhe sekretet e tjera të këtyre financave?

Se treti, mos lejimi nga ana e shtetit të funksionimit të medjave elektronike private, e minimizon akoma me shumë mundësinë e vëzhgimit në thellësi të «punëve të shtetit».

Se katërti, aplikimi i taksave dhe i cmimeve të larta të lendeve të para për medjat e shkruara i ka detyruar ato në një fare mase, ose të falimentojnë, ose të jenë shpesh më dore të shtrire. Pra pa ate pavarësi që i duhet këtij pushteti përherë në oponente.

Por problemi shtrohet, si i ka punet PD-ja ne ekonomi qe ne fakt konfirmon suksesin apo deshtimin e nje sistemi qeverises? Ne dukje duket se ka lindur me «kemishe» aq sa shpesh duket si sukses i vertet i PD-se realizimi «pa dhimbje i reformave ekonomike». Ne fakt duhet thene se ekonomia shqiptare e pas viteve 90' paraqet nje fizionimi krejt origjinale. Kjo ekonomi perfaqesohet nga rritja e normave te konsumit, te cilat faktikisht nuk kane asnje lidhje me rritjen e brendshme te prodhimit. Ato jane norma fiktive dhe e kane burimin tek puna e mese 400 mije emigranteve. Te ardhurat e tyre prej 300 milion dollaresh ne vit, perbejne «grandin» me serioz per Shqiperine e vogel, «klasa punetore» e se ciles nuk i kalonte te 400 mije vetet para vitit 1990. Ky «grand» e shpeton qeverine e PD-se nga cdo «kokecarje» per qytetaret e vet dhe i krijon avantazhe asaj per te realizuar cdo «reforme». Por faktori prodhues ekonomik vepron jasht Shqiperise. Ne Shqiperi realizohet, nepermjet gjeografise amorfe te qoskave, vetem konsumi i mallrave te ardhura po nga jashte, gje qe presupozon rikthimin i ketyre parave po andej nga erdhen dhe krijimin ne vend te nje shoqerie parazitare konsumi. Qeveria e PD-se megjthate ka bere nderhyrjen e vet duke e politizuar sistemin e tregetise qe realizon kete konsum, nepermjet krijimit te lehtesirave, ne tarifa, taksa, zhdoganime, per njerezit e vet per te perfituar prej tyre sherbime politike.

Shoqeria parazitare e konsumit behet dhe me e gjere po to kemi parasysh funksionimin e shoqerive piramidale te fajdeve, si dhe rruget e tjera te paligjshme te perfitimit te parave pa shume djerse, por me shume rrezik. Shikoni, rruget, kafenete, dyqanet, pazaret jane plot me njerez, si ne asnje vend te botes. E po ashtu si ne asnje vend te botes, rruget qe te cojne ne menyre te ligjshem apo te paligjshem jashte vendit, jane plot, madje me nje tendence rritjeje.

Pikerisht, veprimi i faktorit ekonomik prodhues kryesisht jasht vendit, politizimi i aspektit te brendshem ekonomik, stimulimi i fajdezizmit, ne vend te investimit, kompromentimi i burimeve ekonomike me rruge te paligjshem fitimesh qe cojne ne rritjen e kriminalitetit dhe «terrorit ndaj shtetit», si dhe tendenca ne rritje e kerkeses per t'u larguar nga vendi, tregojne se vet shteti ka degraduar ne nje parazitizem.

Po ashtu kjo qeveri si perfaqesuese e shtetit, pavaresisht nga resurset financiare ne formen e granteve, per shume zera te sektorit shteteror, ka veshtiresi pothuaj te pakapercyeshme persa i perket deficitit te buxhetit te shtetit, deficit I cili do te rendohet edhe më ne te ardhmen kur funksionimi i shtetit te PD-se do te tentojë te shkeputet nga «sistemi nderkombetar i ushqimit», si FMN-ja, Banga Boterore etj.

Kjo do te thote se pavaresisht se PD-ja, menjanoi ne menyre totalitare faktoret oponente qe presupozon pluralizmi, shteti i krijuar prej saj ka krijuar aq shume plage te renda, sa qe nuk ka nevojë per oponente tjeter. Totalitarizmi thjeshte sa mund t' i zgjasi jeten.

5.11.1996 FUND U botua me 17 .11.1996, ne numrin e se dieles gaz. «Koha jone»

## Nga Panajot Barka

### Zgjedhjet e parakohshme të paralajmeruara nga Perendimorët nuk kanë vlerë pa zgjidhur krizën institucionale të shtetit.

(PD: Blloko rrugë e lidh këmbët e veta)

5.12.96/07.12.1996



Nenkuptimi nga ana e z. Coffey i domosdoshmerise se zhvillimit te zgjedhjeve te reja te parakohshme parlamentare ne Shqiperi (ndryshe nga deklarimi i hapur ne distancen e dhjete diteve nga kolegu i tij Wirth), nxorri ne pah panikun ne kambin e Berishes lidhur me kete ceshje. Tregoi gjithashtu se shmangja e zgjedhjeve te reja perben preokupimin kryesor te PD-se ne planin e brendshem dhe te jashtem. Megjithate,

energji e harxhuara prej Berishës kanë filluar të japin rezultatin e kundert.

Ne planin nderkombetar qendrimi i prere i SHBA-se jo vetem e nervozon Berishen por i ben te mendueshem dhe «aleatet» e mundshem, konjunkturalë apo dhe te perkohshem te Berishes. Koordinimi i qendrimit amerikan me qeverine italiane, psh, e ben Athinen te hezitueshme ne marredhenjet e muajit te mjaltit me Tiranen, pasi mund te pengoje ne gjetjen e nje gjuhe te perbashket me Romen ne zbatimin e politikese Komunitetit Evropian ne Balkan ku Greqia me te drejte kerkon te luaje rolin e violines se pare. Nga ana tjeter problemet e brendshme te Greqise dhe acarimet me Turqine ku dhe Gjermania (e cila mendohet si perkrahese e Greqise pas zgjedhjes se Simitisit si kryeminister) i kerkoj te ulet ne bisedime me Turqine dhe presionet amerikane lidhur me flurimet e avioneve ushtarake greke mbi Qipro, kuptohet qe i hoqen zellin e madh te Athines ndaj Berishes. Le te mos harrojme gjithashtu friken e deritanishem të Berishes ndaj ndikimit te Lobit Grek mbi Shtepine e Bardhe, qe do te thote se vecanarisht Athina nuk mund te kete imunitet absolut ndaj ketij ndikimi, edhe ne lidhje me Shqiperine.

Po ashtu zelli i Gjermanise per t'i qendruar prane Berishes duket se po venitet. Arsyeja e do qe Gjermania ta kete vene re fundin e shpejte te Berishes. Po ashtu mundet qe interesat globale gjermane te mos kerkojne qe ajo te bie ndesh me SHBA-n ne nje vend si Shqiperia ku demokracia ecen ne kahun negativ dhe roli i saj ne Ballkan, pas pavaresise qe fitoi nga Tirana problemi i Kosoves, (ai ecen ne shtigjet qe hap Amerika) eshte i pa peshe.

Shkeputja e kartes se Kosoves nga duart e Berishes dhe vrapimi i tij pas hijes se Rugoves, tregon jo vetem zvogelimin politik te presidentit te Tiranës ne arenen nderkombetare, por dhe nje humbje ne planin e brendshem. Ai nuk mund te luaj me problemimin e Kosoves per te shmangur, si deri me sot krizen e brendshme.

Ne aspektin e brendshem Berisha ne manine e tij autarkike deri ne kufij e anektodes, duket se arriti nje sukses ne «shpartallimin» e opozites, ose qofte ne imponimin e strategjise se tij asaj. Mirepo, pa arritur te shijoje mire frytet e kasaj fitoreje-bumerang me veprim ta ngadalshem, u shfaq ne gjirin e vet nje opozite e karakterit te vecante. Rritja galopante e inflacionit dhe e deficitit buxhetor, imponimi i politikese financiare nga piramidat e fajdeve (le te mos harrojme se keto piramida teper

te renda i kane themelet mbi kurrizet e njerezve qe presin fijen e drites nga kulmet e tyre), imazhi se ketu drejton nje mafia e instaluar ne shtet, degradimi i prodhimit dhe i infrastruktures, nuk i ndalon dot as policia, as SHIKU, as dekretet per dekorimet e Pishtareve te demokracise as deklaratat per demokraci. Si katalizator i pershpejtimet te veprimit te tyre tani duket se do te veproje sindikata e Azemit, e cila jo vetem qe shfaqet si kunderveprim brenda llojit, pra dhembin se tepermi se gjenden lehte pikat e shumta te dobeta tyre, por edhe se kane si frymezues nje njeri qe di qofte dhe me shembullin personal te ngjalle kurajon civile te revoltes, aq shume te perdhosur ne shoqerine tone.

Te gjitha keto cojne domosdoshmerisht drej kushtit me numer tre, te mbrasht per Berishen, ne zgjedhje te reja. Ky proces tregon se i ktheu ne hapa te bindura vicklat e hedhura nga obori berishian per te mos zbatuar formulen treplaneshe te se ardhmes politike shqiptare. Mirepo zgjedhjet e reja jane te pavlefshme pa zgjidhjen e krizes konstitucionale te shtetit qe montoj vet Ai. Fakt eshte qe veprimi i shtetit pa kushtetute jo vetem qe eshte deformuar por edhe eshte ngushtuar se tepermi. Kete boshlllek nga pikepamja juridike e zgjidh aprovimi i kushtetutes qe me se fundi hyri ne rendin e dites.

Mendimi amerikan se rruga e PD-se per aprovimin e kushtetutes ne parlament eshte pa krye tregon se amerikanet e njohin mire mentalitetin politik te PD-se dhe e kuptojne rrezikun se PD-ja me kete rruge do te konstitucionalizojte krizen politike te demokracise ne vend. Por dhe nje referendum, ne kushtet e mungeses se nje mirekuptimi midis pozites dhe opozites eshte i pavlere. Kjo sepse dihet qe pozita ne cdo rast nuk do te leshoje pe opozites dhe konsensusi politik eshte i veshtire. Ne nje rast te tille nje referendum i dyte do te sjelle perplasjen politike te 1994. Kushtetuata nuk do te aprovohet dhe stanjacioni politik do te riciklohet. Kjo presupozon si zgjidhje rrugen e referendumit per dy variante projektkushtetute te aprovuara nga tryeza e rumbullaket e partive politike ose nga pozita dhe opozita vec e vec. Nje formule e tille i jep kuptim dhe referendumit dhe çtensionon situaten politike ne vend dhe pershpejton procedurat.

Mirepo praktika qeverisese 5 vjecare e vendit nga nje njeri i vetem solli pikepyetje serioze edhe per natyren e shtetit. Kjo praktike vertetoi se njeshi duhet te kontrollohet nga populli dhe jo nga parlamenti. Kjo do te thote se natyra e shtetit te imitoj natyren e shume shteteve perendimore ku shteti te jete republike parlamentare me president te zgjedhur nga populli.

Kjo mund te perbeje nje pike me vete e referendumit per kushtetuten, ne te cilen kuptohet mund te futen dhe propozime te shprehura me pare.

E verteta eshte se nje rruge e tille do te hase ne kundershkrimin e hapur te PD-se. E para se ajo i trembet nje ballafaqimi te ri me voten e popullit (por edhe mospranimi tregon sa i fallsifikuar eshte 90 perqindshi i arritur ne Maj dhe ne Tetor) Se dyti ajo nuk pranon formulen me president te zgjedhur nga populli se ve ne diskutim absolut karrigen e zotit Berisha .

Keshtu qe pavaresisht per rrugen qe duhet zgjedhur per kete ceshtje, eshte PD-ja ajo qe shkakton peshjellim. Nga njera ane ajo shfaqet me disa propozime dhe nuk ndermerr veprime kongrete, kur dihet sa i rrufeshem eshte Berisha ne veprime qe i interesojne, nga ana tjeter vazhdon luften per atrofizimin e opozites, vecanarisht te PS-se. PD-ja i ka hyre me zell te madh atrofizimit te Partise me te madhe opozitare duke i yshtur te gjitha kunder kryetarit te burgosur Nano. Pra PD-ja kerkon kohe me shprese se nga njera ane baltovina ku eshte futur mund te thahet duke qene dimer, dhe nga ana tjeter se, qe te ndermarre hapa per shkallen e dyte dhe te trete nuk duhet te egzistojne perpara jo vetem parti por dhe njerez te burgosur me reputacion politik te brendshem dhe te jashtem

Gjirokaster me 5.12.96 (U botua dy dite me vone ) PANAJOT BARKA

Nga Panajot Barka

## **Berisha, opozita serbe, SHBA dhe Kosova**

13.12.1996

Perkrahja çuderisht e fuqishme nga ana e Tiranës zyrtare të opozitës serbe, në zhvillimet e fundit në fqinjin verior të Shqipërisë dhe perpjekja për të ingranuar në të Kosovën, tregojnë edhe një herë dëshirën e politikës së qeverisë së Tiranës për ta distancuar veten nga çdo ngjashmëri me manipulues zgjedhës dhe për t'u integruar sado pak në zhvillimet e reja të mundshme në Ballkan. Tregojnë njëkohësisht distancimin nga Prishtina gjë që ve në dyshim sinqeritetin e Tiranës për të perkrahur kaq nxehtësisht opozitën serbe .

Në zellin e vet kundër Milloshovicit Tirana zyrtare kërkon vendin e kampionit dhe besojmë se nuk është e vështirë për të konstatuar këto angazhim të politikës së Tiranës. Fakt është që përveç propagandës së ngjeshur në favor të opozitës Serbe, para pak ditësh një lajm i papergenjestruar nga Beogradi i një stacioni televiziv të huaj, bëri faktore «mafjen Shqiptare» për furnezimin me të holla të opozitës në Serbi. Dy ditë më vonë vete gazeta Albania duke iu referuar burimeve nga Beogradi bente të njëjten gjë, me të vetmin ndryshim që i bashkangjiste qeverisë Shqiptare dhe Shtetet e Bashkuara. (Se sa i vertete është njoftimi i gazetës «Albania» për rolin e SHBA, kjo është një punë tjetër, kur dihet botërisht që marrëveshja e Dejtonit ishte një rezultante e komunikimit perfekt midis Millosheviçit dhe Shtepisë së Bardhë ashtu si dhe marrëveshja Rugova-Millosheviç)

Ky zell i Tiranës nga ana tjetër duket hapur se nuk gjen dakort pjesën kryesore të udhëheqjes politike të Kosovës.

Në numrin e së dieles të gazetës «Rilindja demokratike», Mehmet Elezi, dora që mban penën e presidentit Berisha, duke e parë problemin e Kosovës nën prizmin e zhvillimeve të fundit shkruante ndër të tjera: «Në qoftë se studentët e Beogradit dhe tani edhe ata të Podgoricës e të Voivodines, janë vënë në balle të revoltave paqësore, studentët e në përgjithësi shqiptarët e Kosovës kanë dyfish arsye për levizje të ngjashme, energjike, massive, demokratike. Kane dyfish arsye, sepse shqiptarët janë dyfish të shtypur, dyfish të vrarë, dyfish pa të ardhme..» Dhe më poshtë zoti Elezi u tregoi Shqiptarëve të Kosovës se ata duhet të shkojnë dhe me tej se edhe nën pushtetin e mundshëm të opozitës fati i tyre zor se do të ndryshojë. «Deklaratat e Draskovicit dhe e bashkëpunetoreve të tij, thotë autori i këtij shkrimi tepër të gjatë, nuk kanë qenë me joshese se deklarata ultranacionaliste e pushtetit të sotëm serb»

Te njëjten gjë duket se kumtoi dhe presidenti Berisha në Lisbonë kur nxorri në skenë, sipas medjes zyrtare, një sllogan të ripërdorur në vitin 1993, se për çështjen e Kosovës do të përgjigjemi si një komb i vetëm. Te njëjten mendim kanë dhe disa parti po në Kosovë, si psh Partia Parlamentare e Kosovës e cila kërkon aplikimin e konstitucionimit të parlamentit të Kosovës, gjë që do të thotë edhe sipas Fehmi Aganit të LDK një provokim të ri të pushtetit Serb. Inspirues i kesaj ideje, të perpjekjeve për konstitucionimin e parlamentit të Kosovës, është z. Adem Demaci, i ftuar paradokohesh i presidentit Berisha.

Vet presidenti Berisha, në konferencën e fundit për shtyp përdori një term disi të padëshfrueshëm për marrëdhënjet me Kosovën. «Marrëdhënjet midis Prishtinës dhe Tiranës, tha, janë më të mira», dhe jo pa dëshje iu referua dy varianteve të zgjedhjes së problemit të Kosovës «opsioni» i mjeteve paqësore dhe «opsioni i luftës».

Vete ai deklarohet pro opsionit te pare, por fakti qe ai i referohet dhe opsionit tjeter te ben te dyshosh qe edhe ky variant eshte shtruar per diskutim.

Mirepo nga ana e vet qeveria ne mergim e Kosoves me deklaraten e saj te fundit duket se e ndan shapin nga sheqeri. Ne, thote deklarata, do perkrahim ato forca qe do te zgjidhin problemet tona. Dhe njekohesisht nuk ndermerr asnje hap per levizje protestash.

Ajo qe bie njekohesisht ne sy eshte fakti qe pikerisht tani, kur Tirana i ka ftohur vezet me SHBA-ne dhe zhvillimet ne Serbi moren nje kthese te papritur, Ibrahim Rugova, merr garanci maksimaliste nga autoritete te larta amerikane per vendosmeri ne zgjidhjen e problemit te Kosoves

Kjo kuptohet shtron pa hezitim disa pyetje: Ne emer te interesave te kujt, perderisa jo te Kosoves, Tirana do «te ndeshkoje» Milloshovicin? Mos valle kjo eshte nje sherbim ndaj tjeter kujt qe kerkon te nxjerre nga loja ne Ballkan SHBA, dhe Tiranës i jipet nje mundesi per te fituar nga njera ane perkrahje politike dhe ekonomike dhe nga ana tjeter nje shans per t'u «hakamarre» ndaj SHBA-ve?

Mos valle e gjithë kjo behet qe kur situata e brendshme te gjendet ne nje moment pa rruged dalje, politika e Tiranës te drejtohet pikerisht ne Kosove?

Kuptohet, qe askush se beson, qe Berisha dhe te gjithë ata qe perbejne sot Tiranen zyrtare nuk jane kaq te gatshem por as te zote, qe per interesa te caktuara te nje grupi njerezish, apo partish, te flijohen vet interesat e paqes ne Kosove, ne vet Shqiperine dhe ne rajonin me te gjere.

13.12.1996

## **Nga Panajot Barka**

### **Firmat piramidale, mashtrim që po prodhon tragjedi**

21.12.1996

Kompanite e fajdeve ne vend ose vete quhen te fuqishme dhe serioze ose i quajne te tilla sidomos medja shtetore. Fakt eshte se interesimi i shtetit per disa nga keto kompani shkon deri atje sa te krijon pershtypjen se qe ketej e tutje veprimi ekonomik i qeverise do te zhvillohet nen hijen e tyre.

Por sa teverteta jane epitetet qe u vihen.

Vetem ne nje aspekt ato jane te fuqishme. Ne aspektin se vjelin nga klientela e tyre miliona para te thata ne dite, gje qe asnje ndermarrje ekonomike ne bote nuk ka nje mundesi te tille fatlume te «fitoje» kaq para duke leshuar vetem fatura.

Nga ky veprim varet dhe serioziteti i tyre. A mund te quhen keto serioze. Kuptohet qe jo, perderisa pesha e tyre varet nga parate e qindar mijra njerezve te derdhura ne to. Ato s' kane kapital te tyre ne formen e mirefillt te pastert.

Serioziteti i tyre kuptohet qe varet me se shumti nga garancia qe japin ata tek klientela e tyre, ne nje kohe qe kuptohet, qe nqs, ato jane piramidale te pastra funksionojne me parimin e thjeshte qe te fundit u japin para te pareve. Nqs te fundit pakesohen ose nuk shterohen, atehere fitimi i te pareve nderpritet, dhe kapitali i klienteve te fundit vihet ne pikepyetje. Pra serioziteti i tyre varet nga gadishmeria e njerezve per te depozituar parate e tyre ne keto kompani.

Disa kompani ne Shqiperi si VEFA, Kamberi, Silva e ndonje tjeter, pretendojne se jane shnderruar ne fondacione bamirese ne saj te aftesive te tyre investuese. Por le te marrin nje shembull, duke bere nje prerje kohore per nje vit. VEFA pretendon se ka nje klientele prej 100 mije vetesh, te cileve u jep para me 8 % ne muaj. Po ta zeme qe mesatarisht cdo klient ka depozituar tek VEFA 5 mije dollare, i bie qe VEFA te kete siguruar nje kapital prej 500 milion dollare, per te cilat duhet te ktheje ne formen e fajdeve, ose te interesit 480 milion dollare ne vit. VEFA pretendon se investimi perben te ardhurat baze te saj per funksionimin si institucion bamires. Pra le ta zeme se VEFA investom ne kete vit 20 % te parave te mbledhura, qe perben 100 milion dollare. Dihet qe koha e realizimit te investimit dhe e perfitimit te vleres se investimit deri ne dhenien e fitimit nuk mund te zbres nen nje vit. Automatikisht vlere e investimit eshte rritur ne 200 milion dollare. (per shkak te interesit). Atehere del qe masa e fitimit nga venia ne prodhim te investimit duhet te jete mbi 200%, qe te mund te perballoje rritjen ne progresion gjeometrik te vleres se vet investimit deri ne shrytezim, per shkak te interesit dhe nje pjese tjeter te interesave, gje qe as dhe teorikisht nuk mund te ndodh. Keshtu qe po te pranohet logika se VEFA apo cdo kombani tjeter vetefinancohen, ne kushtet e permendura me lart, per te mbyllur deficitin prej 100 milion dollaresh, do te duhet nje klientele e re prej 20 mije vetesh me depozitime 5 mije dollareshe dhe pa interesa per nje vit. Po per interesat e 100 mije te tjereve ku do te gjenden parate.

Kjo do te thote se nqs pranohet ideja se parate ne keto kombani jane te pastra, atehere, ato jane borxhleshat me te medha ne bote



## **Nga Panajot Barka**

### **Piramidat, laku që po i merr frymën Berishës**

07.01.1997

Pas zgjedhjeve të 26 majit, u duk qarte se për Partinë Demokratike dhe për presidentin Berisha, që e drejton atë si forcë politike dhe si qeveri, mundësia e vazhdimit të mbajtjes së pushtetit për një kohë sa më të gjatë, do të kishte dy alternative: ose të nxiste shqiptarë drejt perëndimit për të siguruar jetesën, ose të luante kartën e nacionalizmit, (ku kuptohet se me shumë produktivitet është karta e Kosovës). Kjo sepse për qeverinë e tij kishin marrë fund ndihmat humanitare, grantet, kreditë me kushte lehtësuese. Dhe kishte ardhur koha e qeveritareve të majme, të korupsionit e të gjitha formave të trafikut të njerezve, të armeve, të narkotikeve, të vlerave antike të krimit të organizuar dhe të mafies shqiptare.

Pra në rrethana të tilla njerezit e thjeshtë për të siguruar jetesën apo për të qenë dhe me të sigurtë, por dhe për të shpallur zhgënjimin e idealeve, janë të detyruar të rikapen nga ideja e «eksodeve».

Por nuk ndodhi kështu, edhe pse alarmet e dhena nga Greqia dhe Italia nuk ishin fort pa gje. Eksodet e pritshme i shmangen FAJDET, lulezimi i të cilëve pas Majit dhe Qershorit ishte maramendes. Njerezit ashtu siç harruan idealet demokratike, harruan dhe vjedhësit e votave dhe qeverinë dhe qeveritaret. Gjithë boshllëqet, gropat dhe plagët filluan t'i mbushin fajdet. Në shoqërinë shqiptare dhe në politiken e brendshme zuri vend gjendja BUNACE (si paralajmërim shterngate).

Qeveria edhe pse e dinte se kjo zgjidhje ishte siçdo zgjidhje që sjellin barbarët jo vetëm që ferkonte duart, por u vuri atyre në dispozicion bankat. Ose me sakt i la që t' i shkatërojnë ato, nuk kontrollon nga ç' stepa vinin ato para, cili ishte roli i qindra firmave majmu, i dyqaneve luksoze, i shoqërive jo rentabel, etj.

Çdo ditë që po kalon vërtetohet se fajdet nuk janë thjesht piramida të thjeshta të mbështetura në xhepat e njerezve. Prapa tyre fshihen dhe të tjera që i bëjnë me të rëndë keto piramida. -Pastrimi i parave të pista apo dhe prania e parave për të ushtruar politike apo dhe orientim politik.

Mirepo tani fillimi i fundit të fenomenit të fajdeve po shoqërohet me një sërë fenomenesh tepër shqetësuese si për shtetin edhe për pjesëtarët e tij.

Fajdete po i shpërblejnë me se fundi njerezit e thjeshtë me lote, dëshpërim dhe që në momentet e para me revolte ndaj kreut të shtetit, të cilit edhe pse i kerkojnë ndihmë, në fakt po i kerkojnë llogari.

Fenomeni i fajdeve nxorri jashtë përdorimit rolin e bankave të shtetit. Ky fakt u bashkëngjitet fenomeneve të tjera financiare si deficiti buxhetor, rritja e inflacionit, etj, e që të gjitha së bashku ia bëjnë të pamundur qeverisë të mendojë për buxhetin e vitit të ardhshëm. Kjo flet qarte se treguesi baze i veprimit të një qeverie, financat, janë në pike të hallit, e që të kujtojnë vitet 90-91.

Fenomeni i fajdeve, bashkë me fenomenet politike në vend, si monokolori i parlamentit, i bën të jenë me të rezervuara institucionet financiare ndërkombëtare në marrëdhënjet me Shqipërinë. Nga ana tjetër i bën tepër skeptike dhe ngurues investitorët e huaj që të vijne në Shqipëri.

Eshtë po ashtu e sigurt se shkatërrimi i sistemit të fajdeve dhe mënyra e dyshimte e pastërtisë së tyre, do të shoqërohet me një shpërthim të ri të kriminalitetit dhe të pasigurisë në vend.

Pikerisht ne keto momente vihet re nje levizje e shtetit. Tani shteti nga njera ane u ben thirrje njerezve qe t'i cojne parate ne banka. Nga ana tjeter, ne shtypin e kontrolluar prej tij vihet re nje sulm frontal ndaj disa kompanive huamarrese, dhe perkrahje e gjithanashme ndaj disa te tjerave. Firmat qe gezojne kete status jane VEFA, Gjallica, Kamberi, Silva e donje tjeter. Presidenti i VEFA-s Alimuca zevendesoi ne ekranin e televizionit presidentin e Republikes, ndersa veprimtaria e VEFE-s gjithë veprimtarine e mundshem te qeverise Demokratike (?) Nje propagande e tille e shfrenuar nuk ben gje tjeter vecse paralajmeron se ose VEFA nuk eshte nje gigant i tille, ose Alimuca dhe kompanite e tjera qe gezojne kete perkrahje nuk i kane punet mire.

Megjithate ajo qe duhet shenuar eshte se mbeshtetja tek fenomeni i huamarrjes, per ta perdorur si valvule shkarkimi i pakenaqesive popullore pas zgjedhjeve te 26 Majit nuk funksionoi. Keshtu qe ajo po kthehet ne një bombe koha e shperthimit te seciles ka ar dhe pritet te parashikohet dhe permasat shkaterruese.

Shihet pra qarte qe se brendshmi rrethi po i ngushtohet Berishes dhe PD-se. Se jashtmi ky rreth e ka shkeputur Berishen si nga roli i te qenit nje president demokrat ne vendin e vet, ashtu dhe nga ndonje rol i mundshem ndermjetes. Drejt ketij synimi, Berisha po riperdore tani karten e Kosoves. Ai ngulmon per cudi qe t'i bashkengjise opozites serbe Kosoven kunder Milloshevicit. Ne kete perpjekje Berisha, dhe kur themi Berisha nenkuptojme Tiranen zyrtare, ngaterron kerkesat e opozites serbe per konfirmimin e rezultatit te zgjedhjeve lokale me deshiren e tij per permbyshjen e Milloshevicit, dhe harron qendrimet pothuaj te njejta te pozites dhe te opozites serbe ndaj problemit te Kosoves. Demonstratat ne Beograd tregojne se ne ish Jugoslavine e Milloshevicit mbliksen edhe nje here interesa politike qe ia kalojne shume shtetit te Berishes. Megjithate, Ai kerkon ta perdore Kosoven si karte «uniteti i te gjithë kombit» per te harruar problemet e tjera te brendshme dhe te behet «i rendesishem ne rajon», me sa duket vetem duke ndihmuar te tretet perplasja kaq e madhe dhe kaq e dukshem me Rugoven nuk ka, mendoj, ndonje arsytim tjete. Kjo do te thote se singeriteti i Berishes ne kete qendrim ndaj Kosoves, nuk eshte i vertet. Mirepo ate qe arriti deri tani eshte percarja e politikaneve kosovare.

Opozita, per çudi hesht. Ne rastin e fenomenit te fajdeve tregohet thellesisht passive dhe e trembur. Me sa duket nga kostoja politike e çastit dhe nuk investon politikisht per te ardhmen duke mbrojtur me mjete te tjera interesat e dhjetra mijrave huadhenesve, kur dihet fundi i nje procesi te tille. Ne kete menyre, duke pritur pasivisht fundin e sigurt tragjik të piramidave, opozita ben lojen e tokës së djegur te PD-se kur pranon te shkaterrohet struktura financiare e shtetit te cilin pretendon ta drejtoje se afermi. Hesht dhe per problemin e Kosoves duke i lene gjithë terrenin nen kembet e kalit te Berishes.

Mirepo kjo s' do te thote se nese opozita mund te rri e terhequr, qofte edhe e trembur nga propaganda per antishqiptarizem e Berishes, PD-ja qe shaloi nje kale, te mos zbresi perjete nga kali, qofte dhe ajo-PD, me brum «verior». Profecia e thene se po hipi ne kale maloku,-veriori,- nuk zbret po nuk vra me sa duket ka kohen tani. Edhe pse opozita nuk ka as fuqine e qs vrullin per te sulmuar, sulmi eshte i pavlefshem. Vetvrasja eshte me prane .

P. BARKA

# Nga Panajot Barka

## Berisha vetëm si qytetar I thjeshtë mund të vizitojë Greqinë

12.01.97/14.01.97



Burime te mirëinformuara nga Athina konfirmojne deri tani lajmin e dhene nga ministrin i Jashtem Tritan Shehu ne prag te vitit te ri, per viziten e mundshme te presidentit Berisha ne Athine. Keshtu Athina zyrtare edhe nje here, ashtu si para zgjedhjeve te 26 Majit, kerkon, me sa duket, t'u krijoje terren te pershtatshem perpjekjeve te stermundishme te Tiranës per ta care bllokaden diplomatike te krijuar pas zgjedhjeve te 26 Majit.

Mirepo, ndersa presidenti shqiptar pritet, sipas burimeve nga Athina, te vizitoje Greqine, nje nga te dy shtetet me gjitone te pa vizituar deri tani, nuk ka si te mos te bie ne sy se data e vizites, megjithte kembunguljen e Tiranës, eshte spostuar pertej Prillit, - ne Maj. Nga pikepamja e rruges diplomatike qe ndjek nje vizite e nivelit te tille, afati duket optimal, por... Athina nuk duket e predispozuar, si ne Majin e kaluar, per te mbeshetur Berishen, kur avioni qeveritar grek mori me nxitim nga lartesite e Lacit ish ministrin e Jashtem Sereqi per ne Athine «per te nenshkruar marreveshjen per legalizimin e refugjateve»...

Caktimi i Majit, per realizimin e vizites, lidhet po ashtu me muajin Prill, muaj qe Berishes i duhet te rinovojë mandatin e tij. Por ky akt, edhe pse duket i thjesht, apo dhe mund te thjeshtohet nga Ai dhe strukturat ligjore qe ai drejton, nuk eshte i tille.

Parlamenti shqiptar, ose i PD-se, (i papershendetur deri tani pothuaj nga asnje institucion shtetor i huaj), sipas Rezolutes se Asamblese se Keshillit te Evropes te 28 Qershorit te vitit te kaluar, nuk mund te marre asnje vendim te rendesishem pa tryezen e rumballaket te partive politike Shqiptare. Nje tavoline te tille Berisha e kaloi me «sukses» kur caktoi procedurat e zgjedhjeve lokale. Pervoja e atehershme i imponon tani harresen per kete tavoline Partish. Mirepo ai eshte i ndergjegjshem se po e harroi opozita funksionimin e kesaj tavoline, nuk mund ta harroje Keshili i Evropes anetare i te cilit eshte edhe Greqia.

Por me mire se vet opozita dhe Keshili i Evropes kete fakt e ka parasysh vet Berisha, i cili kohet e fundit duket se del ne publik per t'i thene opozites kthehu ne Parlament.

Berisha e di gjithashtu se zgjedhja e presidentit te republikes lidhet pazgjidhshmerisht me kushtetuten, e cila jo vetem qe paraqet te njejta veshtiresi per t'u hartuar dhe per t'u aprovuar, por mund te parashikoje zgjedhjen e presidentit drejtperse drejti nga populli, gje qe doa ta beje ate te djersije shume.

Se fundi, ashtu si po zhvillohen ngjarjet ne Shqiperi, ku çdo gje eshte nen pushtetin e kompanive te fajdeve ne falimentim, Maji eshte shume larg dhe shume i pararashikueshem.

Burime, po nga Athina vertetojne edhe ne nje aspekt tjetër mungesen e gadishmerise se pales greke per te perkrahur si edhe me pare, Berishen dhe vetem

Berishen. Vizita e Berishes ne Athine ne funksion te permiresimit te marredhenieve midis dy vendeve mund te lidhet me kushte te tilla sic garancite per lirim e Nanos si nje borxh i vonuar i qeverise se majte greke ndaj mikut te A. Pandreut dhe opozites shqiptare ne pergjithesi, (kuptohet, nqs F. Nano nuk lirohet me shpejt). Vet deklarata e ministrit te Jashtem Grek Pangallos ne takimin me kryeterin e OMONIA-s, Llabovitiadhi, ne ditene e parafundit te 1996-s, pikerisht ne kohene e marrjes se vendimit per viziten e Berishes ne Athine, tha se permiresimi i metejshem i marredhenjeve midis dy vendeve kalon permes respektimit te te drejtave te njeriut ne pergjithesi, sherben si tregues i qarte i ketij predispozicioni te Athines ndaj vizites se Berishes ne Greqi.

Vizita e Berishes pikerisht ne Athine kuptohet se nuk ka rendesi vetem se çahet bllokada diplomatike ndaj Tiranes, por se dihet roli i Greqise ne zhvillimet e brendeshme politike shqiptare sidomos me faktorin emigrant te paligjeruar.

Ne kete kontekst, muaji Maj i vizites se mundshem te Berishes ne Athine, shenon, sipas projekt-dekretit te Presidentit grek Stefanopullos, fillimin e procesit te legalizimit te emigranteve shqiptare ne Greqi. Kuptohet qe entuziazmi i dhjetra mijrave shqiptare ne Greqi do te perbente suksesin me te madh te vizites se pritshem te Berishes, ndoshta dhe te gjithe karrieres se tij presidenciale. Kete tregoi dhe kryeartikulli i «RD-se», menjehere pasi u be i njohur projekt dekreti i presidentit grek Stefanopullos. Mirepo emigrantet ne Greqi e pane me skepticizem kete projekt-dekret, me kushte, sipas tyre, jo garantuese per ta. Ata i kerkojne Berishes, qe te pakten tani, (mire deri tani s'ka bere gje) te beje dicka per ta qe dergojne per Shqiperine me shume se 300 milion dollare çdo vit .

Gjithashtu, per cudine e te gjitheve procedura deri ne aprovimin dhe zbatimin e projekt-dekretit, u nderprene nga nje vale e re debimesh te tyre nga Greqia, vale se ciles askush nuk i do permasat dhe shkallezimin politik te disa viteve me pare. Tirana zyrtare akoma s' ka mbajtur ndonje qendrim ndaj rishfaqjes se ketij fenomeni. E kjo heshtje, nqs do te vazhdoje dhe me gjate, ashtu si ne rastin kur Greqia do te kembengule qe te permbush detyrimet e veta ndaj Bashkimit Evropian, ne lidhje me emigrantet te paligjshem, pa ndryshuar dekretin, kjo tregon me se miri se vizita e Berishes ne Athine behet me shume per t'i sherbyer vetes se tij, dhe si e tille do te jete teper e veshtire. E deri atehere Athina mund te kujtohet prap per ndonje te drejte te Minoritetit Etnik Grek ne Shqiperi. Pangallos pervec se i tha Llabovitiadhit se e «ka ne mendje vazhdimisht Minoritetin», kur foli se permiresimi i marredhenjeve me Shqiperine varet nga respektimi i te drejtave te njeriut ne pergjithesi ne Shqiperi, tha dhe per te drejtat e Minoritetit Etnik Grek ne vecanti.

12.01.97 P.Barka U botua dy dite me vone me 14.01.97

## **Nga Panajot Barka**

### **Piramidat rranë, Berisha kërkon të shpetojë nga zëmerata popullore**

19.01.1997

Rruga e fajdeve dhe fundi i tyre katastrofik për me shume se një të tretën e familjeve shqiptare, vertetuan edhe njëherë se baza e drejtimit të shtetit nga qeveria e PD-se, -ishin mjetet rrethana. Për qytetaret e këtij shteti ajo nuk ka menduar se si të krijojë premisat e një zhvillimi perspektive, por për të shtyrë kohën me mjete të tipit :- opium - që të udhëheqin në rrugën e një «lumturie» fiktive.. Tani që luku i fajdeve po reshqet në qafën e saj prej dhjamt të venë edhe prej fajdeve, qeveria kërkon të shpetojë veten, ose t'i shmanget përgjegjësisë dhe fundit të vet të pashmangshëm.

Masat e shpallura nga presidenti Berisha nuk kanë si objekt mbrojtjeje aq shumë njerezit e thjeshtë, sa vet këto firma misterioze. Arsyeja e do që kjo bëhet se lehtësirat që u krijoi pushteti dhe shteti i Berishes këtyre firmave gjatë 3-4 vjeteve të egzistencës së tyre nuk mund të shpërblejnë kontributin e tyre ndaj pushtetit të Berishes. Kuptohet këtu nuk bëhet fjale për mbështetjen financiare në të dy fushatat elektorale, madje as për «kontributin e fajdeve» në sponstimin e vëmendjes së popullit nga problemet të mbrehta ekonomike dhe politike.

Gjithashtu Berisha duke pranuar të marrë përsipër gjithë baren e pasojave të fajdeve mbi ekonomitë e mijra fatkeqeve, Ai e ka shumë të lehtë të mbulojë shkallen e përlyerjes së shtetit në këte mesele. Por mund ta përdorë këte kartë për të «forcuar» unitetin e udhëheqjes, nëpërmjet kerbacit pasi ndonjë syresh mund të këte lidhje gjaku apo farefisnie me fajdetë.

Shmang gjithashtu shfaqjen masive të parazitizimit në vend të shkaktuar nga etja për fitime përrallore të njerezve të thjeshtë nëpërmjet interesave të larta të firmave rantjere. (Megjithatë këte fenomen vazhdon ta ushqejë akoma televizioni shqiptar kur në ditët e falimentimit të firmave rantjere, reklamoni me të madhe lojrat e tjera të fatit.)

Asimilon në maksimum efektet negative sidomos në ekonomi, nga eksportimi, me menyra nga me të ndryshme të valutes, jashtë vendit, dhe krijon mundësi të përdorë thelen e mbetur nga kokoshi fajde, për mbylljen e ndonjë vrime në shoshen e shprishur të finacave të shtetit.

Çfarë tha Berisha kongretisht. Se rreth një milion shqiptarë do të marrin jo vetëm interesat por dhe qindarkën e fundit. Po si? Vet gazeta Albania flet për një shifer astronomik parash të grumbulluara nga firmat rantjere që mund të arrijnë në shtatë miliardë dollarë. Mirëpo Berisha bllokoi një 250 milion. Ku do t' i gjeje ai të tjerat për t'ua kthyer dhëtrami rrave njerez që mbeten jo vetëm pa shtëpi, por dhe pa asnjë grosh për të blerë ilaçe për t' u qetesuar?

Kur Berisha thotë që ata mund të bashkohën e të behen aksionerë në këto firma, ai tregon edhe një herë se me shumë i dhimbsen firmat rantjere se sa viktimat e tyre. E para. Shumë prej tyre nuk kanë as dhjetë mijë dollarë pasuri të patundeshëm. Por edhe ato që kanë, pasuria e tyre jo vetëm që është e pakte, por dhe fiktive, dhe ka për të «iflancuar» aq shumë sa viktimat aksionerë do të mund të marrin nga një cope xham, nga nonjë karrike, nga një arke me makaronë, apo kripe .

Se dyti këto aksione kuptohet që do të «hollohen» akoma me shumë se bonot e privatizimit apo edhe letrat me vlerë që sipas shtetit ishin treguesit e shpërblimit të dhjetrave vite pune të njerezve për pesëdhjetë vjet. Pra sa për të blerë disa buke dhe aq.

Kur Berisha thote qe strukturat qeveritare dhe shteterore t' u krijojne privilegje per investime, licensa dhe kreditime per veprimtari private, Ai jo vetem tallet me ta por provokon nje shoqeri te tere. Tallet se egziston te pakten, pervoja negative e shtreses se ish te perndjekurve politik. Provokon gjithë shoqerine se shkel te drejten e barazise midis anetareve te se njejtës shoqeri. Kjo do te thote se njerezit qe nuk jane te perndjekur politik, dhe tani viktima te fajdeve duhet te presin ndonje fatkeqesi, larg qofte, per te perfituar, qofte dhe verbalisht, ndomje «privilegj» (!)

Mirepo, presidenti yne i nderuar ne zgjdhjet e tij Aleksandrike, vuri disa kushte. Te krijohet edhe nje komision qeveritar, pervec atij ekstraparlamentar, dhe te gjitha do te shkojne mbare po qe se ato jane thjeshte piramidale.

Por a mund te quhet e pafajshme qeveria kur per tre vjet rradhazi dhe sidomos vitin e fundit, shikonte se si kompanite e fajdeve po paralizonin, ekonomine e vendit, tregetine, bujqesine; se njerezit braktisen gjithcka duke besuar tek fitimi magjik i fajdeve?

Si shpjegohet qe qeveria duke mos i licensuar, i la keto kompani te vepronin jashte sistemit tatimor fiskal, ne nje kohe qe fuqia e tyre ekonomike kishte filluar te konkuronte financat e vet shtetit?. Ne c' vend te botes, ku funksionon ne elementet fillestare shteti, u lejuaka nje kompani, nje fondacion, apo nje shoqeri te mos tregoje burimet e veta te fitimit dhe te jete kaq e pakontrolluar ne transaksionet bankare?

Si shpjegohet qe ne nje kohe qe TVSH- e famshme aplikohet ne cdo lloj veprimtari qe lidhet me transaksione parash, madje dhe ne sherbimin telefonik, ne shoqerite siguruese etj dhe bejne perjashtim bankat, kur dihet nga praktika boterore, qe te pakten deri ne 15% te fitimit nga interesi i mbetet bankes, dhe kush e bente deri tani ligjin ne bankat shqiptare?

Si shpjegohet qe kjo qeveri ishte kaq e papergjegjshme ne lejimin e eksportimit te valutave ne forma nga me te ndryshme, nga keto kompani, kur dihet, sidomos ne stade te tilla zhvillimi, cdo qeveri e pergjegjeshme, aplikon nje politike teper shtrenguese ne te kunderten? Qeveria jone, per cudi, jo vetem qe lejoi te shkeleshin ligjet e veta ne kete drejtim, por me medjen shteterore u bente reklame ketyre kompanive per «investimet» e tyre jashte vendit, ne nje kohe qe u bene thirrje te huqjve te investojne ne Shqiperi?

Eshte mese e qarte qe qeveria e PD-se shtynte keshtu ditet e pashpresa, dhe njekohesisht njerezit konkret qe perbejne nocionin abstrakt te shtetit dhe te qeverise mirrinin, per hir te nje tolerance reciproke, shkelqim ekonomik nga pasuria perrallore e ketyre kompanive, te cilat thithnin ne formen e fitimit neto sakrificat, mundin dhe gjakun e dhjetra mijra njerezve. Fakti qe makina e shtetit disa i glorifikonte si shpetimtare dhe disa i sulmonte dhe u impononte dhe falimneton tregon edhe nje here se keto fontacione, ashtu si ne njerezit, partite politike, shtypi, duhej t' i sherbejne partise shtet, perndryshe...

Megjithate, a mund te sigurojne keto kompani interesa kaq te larta nga funksionimi i sistemeve thjesht piramidale, apo dhe nga investimet e tyre?

Per cudine e te gjithëve, qeveria qe me mire se kushdo tjetër e kishte per detyre te mbronte njerezit e thjeshte nga pasojat shkaterrimtare te ketyre sistemeve, perpiqej te mbante veten larg tyre, ndersa kur pa qe zemerimi popullor do te shkarkohej mbi te, nderhyri. (!) Por ku konsiston kjo nderhyrje?

Se pari. Kjo do te thote se presidenti yne i nderuar kerkon te kumtoje, nepermjet gojes gjuheprere te Sudes, te ndonje ministri zedridhur, te medjes se vet, te komisionit ekstraparlamentar, (qepergenjeshtron me ngut gazetate qe flasin per sisteme jo thjesht piramidale) e te mjeteve te tjera, se ato sisteme jane thjeshte piramidale. Kjo do te thote se qeveria ka frike nga nje transparence reale mbi keto sisteme. Ka frike pike se pari se mund te vertetohet teza e opozites se prapa ketyre sistemeve eshte vet ajo, dhe se dyti

se mos zbulohet se bamiresia» e tyre bazohet tek pastrimi i parave te pista, (ndryshe si te shpjegohet toleranca fiskale e shtetit mbi to?)

Se dyti Qeveria bllokoi, sipas Berishes veprimtarine e kompanive rentjere, si shprehje e garancise ndaj kapitaleve te klienteve(!).

Kjo s' do kollauze. Qeveria u tremb nga zemerimi dhe vetedija e popullit te prere ne bese dhe me kete levizje se pari, kerkon te fashit dhe te c'tensionoje revolten e njerezve nepermjet metodese se zvarritjes se zgjidhjes se problemit ,aq me teper kur dihet se rezultatet e cdo kontrolli do te dalin teper vone, kur plaga te kete zene pak kore. Nga ana tjetere ajo eshte e bindur se parate e bllokuara jane disa here me pak se parate qe duhen shperndare tek qytetaret. Ashtu sic eshte e bindur se dokumentacioni qe tregon marrjen e huave nga klientet jo vetem nuk ka baze ligjore por eshte dhe fare i thjeshte per t' u fallsifikuar. Eshte gjithashtu e qarte se shtetit do t'i duhet te ngreje nje sistem gjyqesore te sternadhe per te perballuar dhjetra mijra gjyqe. Kjo do te thote qe njerezit te vecohen serish, te hyjne ne nje beteje me shoq-shoqin per te fituar neper gjyqe e ato cikerime parash do te mbeten neper dhembet e shumta te kesaj makine te sternadhe gjyqesore. Keshtu njerezit do te harrojne serrishmi qeverine si shkaktaren kryesore te kesaj gjendjeje.

Por nuk eshte cudi qe keto para te blokuara te sherbejne edhe si nje mjet i mire per «te forcuar» unitetin, kete here jo lart, por ne rradhet e partise, qe do te thote qe «drejtesia» t'i shperndaje me rekomandim per njerezit me merita te cmuara.

Po ashtu, qeveria, me qellim kryesor zbutjen e revoltese popullore, mund te tendoje t'i «rase brenda» boset e fajdeve. Pastaj, donje qe mund te guxoje e te hap gojen, mund «te pesoje dhe ndonje infarkt te zemres». Ndonje mund te aratiset. Te tjere mund dhe te denohen, me gjobe, ose maksimum me kater vjet heqje te lirise , aq sa e parashikon ligji (!), e me pas mund te veproje institucioni i faljes.E te gjitha keto behen qe te mund te shmanget revolta popullore ndaj qeverise.

Se fundi: Qeveria guxon ne keto momente kritike te investoje per zgjatjen e krizes, pergjegjese per te cilen, nga cdo pikepamje eshte vet ajo, duke manifestuar keshtu edhe nje here koncepte moniste se cdo gje ka te drejte ta gatuaje dhe ta zgjidh vetem ajo. Me kete mentalitet kerkon t' i imponohet opozites te ngrohet ne diell kur dihet qe ne sistemet pluraliste krizat e renda ekonomike dhe institucionale, si kjo qe po kalon Shqiperia, zgjidhen me ndryshime politike. Kjo gje perben nje ekskluzivitet i opozites. Ajo nuk perfiton politikisht, ajo vepron politikisht. Partia ne pushtet ne raste te tilla mat forcat ne kutite e votimit dhe jo me nxjerjen e policise ne rruge.

19.01.97

P Barka

## **Nga Panajot Barka**

### **Berisha që të shpetojë kokën, merr në qafë shqiptarët. Pse hesht Perendimi?**

10.02.1997/14/02/97

Zhvillimet e fundit në Shqipëri, ndoshta pa dashjen e askujt, nxorren në skenë një simbol të ri, -Preshin. E kjo nuk perben një rastesi, por shprehjeje e nivelit ekonomik të popullit të marrë peng nga rrenimi i skemave ekonomike që mbeshteteshin tek informaliteti, fajdet, trafikun i shumellojshëm dhe pastrami i parave të pista, si dhe I nivelit politik të shtetit të uzurpuar nga frymezuesit e kesaj gjendjeje amerikanolatine në vend.

E ndersa deshperimi ekonomik i qindra mijrave shqiptare, mbart në vetvete aktin e deshperimit politik të disa mujave më parë, kur po këtyre njërezve iu vodhën votat, zhvillimet e fundit u paraprinë politikaneve, duke krijuar një precedent të rrezikshëm jo vetëm për vendin por dhe për rajonin në përgjithësi.

Ndaj këtyre zhvillimeve Perendimi tregohet tepër i ndjeshëm, madje dhe mjaft i shqetësuar. Por qëndrimi i mbajtur nga Evropa e sidomos nga vendet fqinje, që në një masë të madhe përcaktojnë qëndrimin Evropian ndaj Shqipërisë, duket se nuk e ka kuptuar ndryshimin e raporteve politike, ekonomike, e shoqërore të Tiranës zyrtare, brenda vendit në krahasim me disa vite më parë. Heshtja dhe akoma me keq tendencat e shfaqura për të dhënë zgjidhje duke ndihmuar pushtetin e Berishes, duke e konsideruar atë akoma faktor stabiliteti brenda vendit dhe me gjere në rajon, e komplikon me shumë gjendjen.

Evropa duhet ta kuptojë se që të mbahet në këmbë pushteti i Berishes, duhet t' i sigurojë atij në formën e kështit të pakten 3 miliardë dollarë, pa marrë parasysh rrenimin se afërmi dhe të kompanisë Vefa-Holding. Shuma në fjalë kuptohet që është e kripur dhe për xhepat e Evropës. Edhe sikur kjo çudi të ndodhte, Evropa nuk mund të rikuperojë demin që pesoi autoriteti i Berishes kur në mënyrë të perseritur gjakosi popullin, opozitën, gazetaret, duke vetdemaskuar kështu perfundimisht hipokrizinë dhe demagogjinë e vet demokratike. Nga ana tjetër, ai nuk ka asnjë mundësi që nga pozitën e fajtorit të mund të ofrojë një zgjidhje vendit që po humbet bastin e së ardhmes. Shkalla e pavlefshmerisë së rolit të Berishes duket edhe më qartë kur ai edhe pse zbrazi perfundimisht xhepat e buxhetit duke paguar mercenarë për të shtypur revoltën popullore, masat e veta represive edhe pse kaq të egra janë të paefektshme.

Kështu që, çdo përpjekje e Perendimit për të mbështetur Berishën në segmentin e fundit inercial që Atij i mbeti në pushtet, e çon në një rrugë të vetme shpëtimi për të por të rrezikshëm për vendin dhe rajonin në përgjithësi, -në rrugën rithirrjes në skenë të rezikut ndaj kombit duke destabilizuar ai vet Kosovën. Berisha duket se e kishte nuhatur me kohë fundin e tij në krye të shqiptarëve brenda shtetit Shqiptar dhe, për shumë kohë i që kthyer «rebelimit» të Kosovës, për të fituar të drejtat e veta përmes një politike maksimaliste. E nëse udhëheqja zyrtare e Kosovës në momentin e parë pranoi të përcaktojë, për të mos iu bindur vullnetit të Berishes, kjo nuk do të thotë se mënyrat për të arritur destabilizimin e një rajoni tepër tendosur sic është Kosova, u sosen dhe se në një moment të dytë nuk mund të jenë të efektshme.

Kjo do të thotë që perkrahja që Evropa i jep Berishes, edhe me heshtje, apo dhe duke besuar për ringjalljen nga vdekja klinike e pushtetit të tij, edhe nëse behet kjo për të fituar kohë për të perballuar një eksod të mundshëm të permasave të 1991-92, apo për



hir te interesave gjeopolitike ne lidhje direkte apo me te tretet, çon ne gangrenizimin e metejshem te situates se brendshme ne Shqiperi dhe njekohesisht ne mundesine e shperthimit te Kosoves, si rrugesgjidhje e vetme per Berishen. Kjo do te thote qe fqinjet pervecse do tu duhet te perballojne nje eksod te pashmangshem te shqiptareve, do t'u duhet te mendojne se paku edhe per nje dyndje te Shqiptareve te Kosoves, ne vendet e lira te Shqiperise apo dhe ne vendet tetjera Jugore apo Perendimore.

Keshtu qe Evropa para se te hesht, apo dhe te shpresoje akoma tek Berisha duhet te pakten te ndihmoje te clirohet opozita nga makthi ku e ka futur pushteti i Berishes, t'i jap asaj mundesi emancipuese me qellim qe t'i ofrohet vendit nje zgjidhje e re politike si hapi i pare i çtensionimit te situates ne vend dhe sigurimit te stabilitetit te rajonit me gjere.

Gjirokaster10.02.97 (u botua keter dite me vone) P Barka

## **Nga Panajot Barka**

### **Rrethi i rrezikshëm vicioz i krizës së shtetit**

28.03.1997/31.03.1997

Kriza që ka mberthyer vendin i ngjan një rrethi vicioz ku çdo perpjekje e shtetit për ta prerë në një segment shkaktonte lindjen e dhjetra rrateve të tjera vicioze. Zgjerimi i fushës së veprimit të këtyre rrateve nuk kercenon vetëm qeverinë dhe pushtetin e Berishes, por dhe vetë strukturat ekonomike, politike dhe shoqërore të vendit dhe riciklimin e krizës për të ardhmen.

Një situatë e tillë provon në fakt inegzistencën e shtetit të PD-së dhe dekombozimin e vet deri në atë shkallë sa nuk është në gjendje të aplikojë as dhe mjete totalitariste aq të pelqyeshme deri tani, për të mbajtur në këmbë ngrehinën e këtij pushteti.

Parlamenti nuk mund të marrë asnjë vendim, ose është ndergjegjesuar se i vetmi vendim që mund të ketë vlerë për të është aprovimi dhe de jure i pavlefshmerisë së tij dhe të qeverisë së miratuar prej tij.

Qeveria jo vetëm që nuk mund të egzekutojë asnjë vendim, nuk mund të zbatojë asnjë ligj, por nuk është në gjendje të mbrojë nga poshterimmi maksimal i rruges, numrin dy të saj dhe numrin një të diplomacisë Shqiptare. Ajo nuk guxon të shkarkojë asnjë ministër, pasi e di mirë që është e fajshme e tërë. Faji kolektiv i qeverisë nuk lejon tani që t'i iki asnjë pjesëtar se pas kësaj do të vijë menjehere shkërkmoqja e saj.

Brenda fajit kolektiv është përfshirë dhe vet Presidenti. Ai si arkitekt i gjithë kësaj rrenojë ka shumë detyra për të kryer.

Se pari duhet të zgjidhë duart nga faji kolektiv. D.mth, duhet të provojë para obortareve të vet se nuk është i perlyer në sistemin e fajdeve. Mirepo është e vertetë se obortaret e tij pranojnë me perulje të krehne në çdo moment geshthenjat e Presidentit nga zjarri, por nuk mund të pranojnë që të mbyten ata për të shpetuar AI.

Se dyti . Ai duhet medoemos të provojë se firmat rentjere janë piramida të thjeshta. Vertetimi i të kundertes, dmth, i asaj që vet presidenti la të kuptohet në konferencën e vet të fundit për shtyp, se disa pjesë «fare të vogla» parash të pista, vinin në Shqipëri, kjo do të çojë në përfundimin se vet Presidenti jo vetëm që është pjesëtar direkt apo indirekt i pilafit fajde, por dhe i mekanizmit të pastrimit të parave të pista në Shqipëri. Pra Berisha dhe strukturat e shtetit që ai krijoi duhet t'i shpëtojnë etiketimit «vend i kancerizuar nga pastrimi i parave të pista»

Se treti. Ai duhet të vertetojë se dhuna dhe shkatërrimi nuk janë produkt i sistemit të vet të drejtimit dhe i vullnetit të tij. Me këto mënyra fshihen njëzëri në hierarkinë e pushtetit që duan të zhdukin gjurmët për gjithçka që kanë bërë, duke shfrytëzuar pushtetin. Kështu Ai kërkon të shmang veten nga përgjësia absolute e vendosjes së faktit të gjendjes së jashtëzakonshme.

E keqja e kësaj logjike qëndron në faktin se formulat e akuzës janë aq të konsumuara aq sa dhe fabula e strucit nuk ka më vlerë.

Se katërti. Berisha duhet të gjejë zgjidhje sado të perkohshme për të shpetuar veten me shpresën klasike *Deus est machina* (!).

Një nga këto zgjidhje është «puthja me Vefën» dhe me ndonjë kompani simotër të saj. Por edhe kjo zgjidhje, si edhe zgjidhja e emetimit të parave pa vlerë, përben puthjen e vdekjes. Kreditimi i këtyre firmave kuptohet nuk i sherben një qëllimi të mbajtjes gjalle të prodhimit në vend që do të sjelli ripërteritjen e vlerave të humbura nga tragjedia e fajdeve, por është një kreditim për të zgjatur sadopak rrenien e tyre, pasi rrenia e tyre në të njëjtën kohë me ato që falimentuan atëherë vala goditese e të

zhgenjyerve me ndihmen e shtetit do te qe e tille saqe ata s' do te mund t' i shpetonin as elikoptere. Por kjo do te thelloje dhe me shume gropen e zeze tek buxheti i shtetit, pra do te conte dhe me tej vdekjen klinike te qeverise, dhe nuk dihet nese dhe llogarite personale mund ta shpetonin kete lloj kaccer akut te rrezimit te qeverive.

Por Berisha, mbi te gjitha, per te zgjatur sadopak inegzistencen e pushtetit te vet, i duhet te siguroje hegjemonine e zakonshme mbi Partine dhe strukturat e tjera te pushtetit e te shtetit.

Kete vetem duket se e arriti. Nje pjese nga parlamentaret e tij para pak ditesh, ndoshta edhe per t'u treguar te devotshem ndaj tij, kerkuan me ngulm vendosjen e gjndjes se jashtezakonshem. Ai i zmbropsi duke lene te kuptohet se do te shperndante parlamentin, dhe ata heshten. Berisha jo vetem qe siguroi sundimin mbi ta, por doli si «luftetar, sipas propagandistev te vet, i ruajtjes se demokracise ne vend». Po ashtu ai duke lene te kuptohet se nuk ka gje me qeverine, siguroi dhe perkrahjen e saj per te dale mbi kedo dhe mbi cdo gje. E megjithate edhe ky unitet eshte formal por dhe shume i rrezikshem. Formal se te zgjedhurit e PD-se qe gjithë keto dite provuan se «sa shume i do populli» dhe per ke voti ai realisht, kane mbi vete dhe kerccenimin e Berishes, pra jane thjesht marioneta. I rrezikshem se te gjitha pushtetet tani dhe de jure i ka Njeshi, nje njeshi qe per hir te «nderit te vet» ben hi cdo gje.

(U botua me 31.01,97. P Barka 28.01.97

Nga Panajot Barka

## **“Tradhetia” e 9 Marsit**

14.04.1997/16.04.97

Pas Nentorit te 1994, fundi i vitit 1996 dhe fillimi 1997, solli per politiken e opozites shqiptare nje rast te paperseritshem per ndryshime politike ne vend dhe ne kushtet e nje diktature sado te eger. Pra qe ne fillim duhet saktësuar se situata permbyesë e regjimit te Berishes nuk ishte produkt i drejtperdrejte i veprimit politik te Opozites. Perkundrazi, ishte rezultat i shperthimit popullor kunder ketij regjimi. Opozita e cila per hir te kosos politike te momentit, nuk e ngriti zerin ne kohe per te paralajmëruar rreziqet qe mbartnin per kursimet e pakta te njerezve te thjeshte, te ashtuquajtura piramida, nuk arriti te ingranohet me zemerimin popullor si ne momentin kur kjo levizje pati karakter ekonomik, ashtu dhe ateherë kur kjo levizje mori karakter te theksuar politik kunder regjimi te Berishes.

Kuptohet ne paaftesine e opozites per te adoptuar formen o e re te luftes politike ne vend ndikoi dukshem dhe vet Berisha. Ne kete plan Berisha, duke e trembur opoziten me akuza per veprime antikushtetuese dhe destabilizuese, por edhe duke ushtruar ndaj saj dhune, apo duke tenduar per ta bere bashkefajtores here per krizen, e here per rebelimin popullor; ia arriti qellimit per ta mbajtur opoziten larg kesaj levizjeje popullore, e cila pati dhe nje karakteristik te vecante persa i perkete gjeografise se zhvillimit.

Ne kete menyre Berisha kujtoi se do ta kishte me te lehte per te shtypur levizjen popullore kunder tij me front te rregullt ushtarak dhe me gjakosje se brendshmi nepermjet strukturave te sherbimeve sekrete, policise dhe ithtareve te zjarre te PD-se, por edhe duke u perpjekur ta shnderronte konfliktin midis tij dhe popullit ne konflikt midis Veriut dhe Jugut.

Ajo qe ndodhi me kete perplasje tregoi se strukturat e shtetit te Berishes u shemben sikur te ishin ngritur mbi rreren e Sahares. Kur Berisha u bind se me keto rruge, fundi i tij ishte i pashmangshem zgjedhi dy rruge të tjera qe ne pamjen e pare kondradiktore, por qe i sherbenin njera tjetres. Me forcat te instaluar rreth vetes ai nisi djegjet dhe shakterrimet per te humbur gjurnat e nje shteti te korruptuar, por edhe per t'u lene pasardhesve politike toke te djegur.

Nga ana tjetër, per te frenuar vrullin e popullit kryengrites qe po i avitej Tiranes Berisha u kujtua se ajo qe i mbeti me shumice ishte pushteti i tepert i PD-se. Nga ky pushtet Berisha mbajti aq sa desh dhe pjesen tjetër ia hodhi opozites me nje formule absurd, ate të "pajtimit kombetar". Cudeterisht opozita e tavolines se 9 Marsit, e kafshoi kete karem. Ajo u ul ne tavolinen e bisedimeve e papergatitur, pa vene kushtet e veta ne bisedime me Berishen, e qe duhet te ishin kerkesat e popullit ndaj shkaktarit kryesor te krizes. U duk qart se opozita pranoi Berishen te kryesoje nga pozita e fajtorit "pajtimin" me shpresen e zhvillimit te zgjedhjeve te reja e bindur se eshte shume afer pushtetit, dhe harroi se pushteti eshte i vlefshem ne nje shtet demokratik, shtet qe ne fakt e kontrollon Berisha. Ajo nuk u ul ne tavolinen e bisedimeve si administruese e Levizjes Popullore per Demokraci, por u perdore nga Berisha si mjet fillimisht per ta ndalur e me pas per ta shuar kete Levizje

Keshtu Berisha duke i dhene rol opozites nen kontrollin e vet rifitoi rol per vete, jo vetem ne masen e nxjerjes nga valixhja e mergimtarit te plackave por dhe ne ate te bllokimit te veprimit te Qeverise se Pajtimit Kombetar.

Opozita nuk e kuptoi se ia mbylli pergjysem deren popullit kryengrites, dhe beri lojen e Berishes, duke e lene realisht palen kryesore te zhvillimeve politike ne vend jashte qendrave ku mirreshin vendime. Me nje qendrim te tille dhe me preteksin e respektimit te institucioneve, (opozita shume shpejt harroi se kriza e pergjithshme ne vend eshte produkt e ketyre institucioneve) ajo, dekurajoi dhe Perendimin ne qendrimin e vet per ta injoruar Berishen. Njekohesisht ajo nuk ndoqi shembullin e personaliteteve perendimore per t'i njohur si pale ne bisedime Komitetet e Shpetimit Publik. Keshtu Levizja per Demokraci, per shkak te qendrimit te mefshte te partive politike opozitare, as nuk arriti qe objektivin e vet politik te shprehur qart dhe me force t'ia delegoje opozites e as po administrohet kjo Levizje si shprehje e vullnetit politik popullor per te minimizur te pakten aktivitetin e strukturave te Sali Berishes.

Kjo Levizje po mbetet tani per nje kohe te gjate pa veprim politik, ose duke ripertipur te njejtin qendrim, ne nje kohe qe dihet fati i levizjeve te tilla kur s' kane veprim, dhe nen goditjen e Berishes. Partite politike edhe dy here kur u shtrenguan te bashkohen ne nje dokumend zyrtar me Levizjen Popullore per Demokraci, veprimi i tyre mbeti deri atje dhe nuk arriti deri ne tavolinen e Partive.

Nje situatë e tille e sfumoi levizjen politike te brendshme dhe cdo gje pritet tani nga jashte. Politikanet Shqiptare levizin ne kryeqytet Perendimore per te kalkuluar formulat politike. Lajmet per Shqiperine vijne nga Perendimi. Populli del dhe pret me duartrokite dhe ovacione personalitete nga Perendimi.

Por ajo qe shihet qart eshte se Perendimi eshte veshtire te ndikohet dhe te ndryshoje vendimet qe merr. Fakt domethenes takimi i Prodit me Berishen. Edhe pse mbi tridhjet mije veta ne Vlore qe aq shume ua ka nevojen Prodi per te ardhmen e qeverise se vet, i kerkuan atij qe te mos takohet me Berishen, ai u takua.

Kjo ne nje fare menyre do te thote se Perendimi nuk do te marre me te mire kete apo ate Parti Politike Shqiptare per t'i dorezuar pushtetin. Precedenti Berisha e ben ate me te kujdesshem ne marrjen e masave per te vendosur baza te shendosha te nje shteti demokratik dhe kete gje duhet ta kene mire parasysh mire partite politike Shqiptare. Cilesi per zhvillimin e ketyre zgjedhjeve dihet se eshte veprimi paraprak disa javor i forcave nderkombetare te cilat dihet pse kane ardhur. Opozita nepermjet qeverise per te frenuar Berishen nga ndomnje mashtrim me te rrezikshem se ai i 26 Majit dhe Berisha per te futur perendimin ne terrenin e vet. Ai eshte i vetem tani qe ve ne dyshim zgjedhjet dhe per kete fajeson egzistencen e Komiteteve te Shpetimit. Komitetet e Shpetimit kane filluar ta deshifrojne kete qendrim te Berishes dhe shprehin shqetesimin se strukturat e tij do te provokojne forcat nderkombetare qe te akuzohen Komitetet te cilat vazhdon t'i kete frike .... 14.04 97 P BARKA

U botua dy dite me vone

## **Nga Panajot Barka**

### **Trashegimtari i kurrores mbreterore, asi në mengë i Berishës për mbijetese politike. (Presidenti kufizon politikën)**

20.04.1997/32.04.97

Midis shume objeksioneve qe degjohen kohet e fundit per te ardhmen e Shqiperise eshte dhe objeksioni ne forme kercenimi: “eshte shansi juaj i fundit”

Kuptohet, behet fjale per ristartimin e shtetit shqiptar. Arsyet per nje nje formulim te tille per perspektiven e ketij shteti duhen kerkuar tek historia e tij e ceket dhe e ricikluar shpesh ne nivelin i riberjes dhe formen e qeverisjes se tij, nga angazhimi shumeplanesh dhe per nje kohe teper e gjate e Perendimit me Shqiperine, (le te mos harrojme se vetem rrogat e paqeruajtesve ne Shqiperi i kushtojne Perendimit rreth gjashtembedhjete milion dollare ne muaj), por dhe nga rreziku i perhapjes se nje semundjeje te tille ne rajonin me te gjere.

Perndimi, gjithashtu, e ben tanime kete vleresim nga pozita dhe relata krejt te tjera me Shqiperine dhe shqiptaret. Nga pozitat kur populli si ne Veri dhe ne Jug eshte i armatosur, kur partite politike i perballojne me pasivitet dhe paaftesi sfidat e shkaktuara nga regjimi i Berishes dhe kur veprimi i tyre politik mbisundohet nga pasioni, kur Sali Berisha kerkon ta mbaje peng te delireve te veta manjake kete vend duke asgjesuar dhe ate pak veteveprim te brendshem politik

Ne keto kushte Perendimi rimerr per te zbatuar ne Shqiperi nje nga formulat me rezultative per riberjen e shtetit, ate te nje forme te moderuar te nje protektoriatit, ku inisiativa per instalimin e elementeve te tij e ka marre vete faktori Shqiptar dhe shpesh per interesa te kunderta. Elemente te tille jane p.sh prania e forcave shumekombeshe.

Eshte shprehur gjithashtu qarte edhe me pare ne shtypin shqiptar se ne kushtet e egzistences formale te presidentit shqiptar, kete rol e luan zoti Vranicki (çudeterisht i bie te jete nga anet e Vidit). Ndersa rolin e nje krymenistri e luan tani ambasadori italian Foresti. (Une nuk te siguroj vajtjen ne Vlore, i tha, pikerisht nga pozita te tilla, Foresti Vranickit para pak ditesh) Kuptohet kopetencat e tij do te shtohen kur forcat shumekombeshe nen drejtimin e Italise ne Shqiperi do te shfaqin hapur dhe ne praktik misonin e tyre qe nuk eshte aspak shperndarja e ndihmave por me shume riorganizimi i strukturave te rendit dhe te mbrojtjes deri dhe ne realizimin e zgjedhjeve ne Shqiperi. Eshte e qarte se zgjidhja e ketij lemshi te ngateruar fillon me zgjedhjet. Ne kete kendveshtrim, parakushtet per realizimin e tyre, megjithate, nuk kane te bejne aq shume me ligjin elektoral, me carmatosjen e popullit dhe ane te tjera teknike. Ato lidhen me probleme te tilla serioze si: kush dhe cila do te jete permbajtja e opozites se ardheshme politike. Mos valle pas zgjedhjeve do te kemi te njejta fenomene si ne tri zgjedhjet e fundit parlamentareme? Cilet do te jene individet qe do te perfaqesojne majat e shtetit e te politikës Shqiptare?

Cudeterisht dy veta qe afirmohen jane njekeohesisht dhe dy persona me reputacion te kufizuar ne popull per ate qe prafaqesojne. Nga njera ane eshte Leka Zogu. Zoti Zogu erdhi ne Shqiperi per te afirmuar kurroren mbreterore si trashegimtar i saj. Mirepo duhet vene re se Ai erdhi ne Shqiperi i pasuar nga nje grup njerez qe perfaqesojne organizma te rendesishem boterore, te cilet bejne dy pyetje “ A e doni Mbretin, a perfaqeson ai unitetin e shqiptareve ?”

Ndoshta se ndodh keshtu, z. Zogu ia arriti qellimit t’i imponoje realitetit politik shqiptar, rishqyrtimin e formes se qeverisjes ne vend. Duhet shenuar fakti qe Ai,

ndryshe nga te gjithë politikanet shqiptare del ne popull. Kete sfide e pranojne dhe parti politike per te cilat menyra e percaktuar ne paketen kushtetuese per qeverisjen e shtetit i kenaq plotesisht. Zoti Zogu po ashtu eshte i pranishem ne ambiente politike dhe publike si trashegimtar i Kurrores mbreterore dhe harrohet se nje kurrore e tille ne Shqiperi nuk egzistonte por u vetshpall ne vitin 1928, harrohet qe vet kushtetuta "mbretnore" e quan te pavlefshme mbreterine kur mbreti largohet nga vendi per disa dite dhe jo per vite te tera, qe nuk jane c'vleresuar akte te tjera juridike qe nuk e njohin mbretin. Per te vetmen gje qe s' u interesua publikisht Leka Zogu, eshte pasuar ne "trashegimi" te tij, qe populli thote se arrin nje te treten e Shqiperise.

E ndersa Partite politike e pranojne Mbretin per te treguar se jane tolerante dhe se aspirojne per nje demokraci te kulluar, ai qe ferkon duart me pranine e trashegimtarit te mbretit eshte Sali Mberisha. Mbreti, pavaresisht se eshte me i gjate se Ai, pavaresisht se vjen nga Perendimi, eshte nje kundertshtar me i dobet per Berishen. Loja me kerkesen per formen e qeverisjes se shtetit hap per Berishen mundesi jo vetem qe te shmang vemendjen nga vetja dhe zgjedhjet, por se ne nje ballafaqim te mundshem ai do te perfaqesoje palen e Republikes Parlamentare qe eshte e sigurt qe fiton.

Berisha pas suksesit te arritur per t'u rifutur ne lojen politike shqiptare, pas deshtimit te kryngritjes popullore per ta permbysur, shpreson se duke manifestuar dhunen e pushtetit qe akoma zoteron te mbetet per momentin pjese e lojes per pushtet. Nga ana tjeter duke i njohur sa te pakapexyeshme jane veshtiresite per cdo qeveri te ardhshme shpreson te kthehet shume shpejt ne krye te puneve te shtetit shqiptar

Kete ide Berishes ia ngroh dhe fakti se kundertshtaret e tij politik nga njera ane, lane trashegimtarin e Mbretit te luaj ne nje nivel te tille politik. Pra Berishen e lane pa kundertshtare. Po ashtu kundertshtaret real te tij, te cilet i pati frike per vdekje ne karrieren e vet politike, vihen perballe, nga ndermjetesit nderkombetar per krizen shqiptare, me kryeushtare te bindur te Berishes, per te diskutuar probleme te dores se dyte, te tilla si, data e zgjedhjeve, apo dhe forma e ligjit elektoral.

20 04.1997 P B A R K A U botua dy dite me vone

Nga Panajot Barka

## **Marrëveshja e 9 Marsit, fillimi dhe fundi i rolit të Komiteteve të Shpetimit Publik**

26.04.1997

Çdo dite që i largohemi 9 Marsit tregojnë me se miri se si strukturat e shteti të PD-se, Presidenca, Parlamenti, Gjykatat, prokuroria, Sherbimet sekrete, RTV-ja, po kapercen situatën e fajit dhe të krimit mbi Shqipërinë dhe shqiptarët dhe tani jo vetëm që kërkojnë të mbeten pjesë e lojës politike në Shqipëri por dhe t'i imponohen asaj. Berisha tregon tani se e ka bindje se zgjedhjet e parakohshme i takojnë serish atij. Në këtë revansh tri janë tani për tani strukturat që e pengojnë dhe duhet t'i shang. Menjanimi nga vezhgimi i zgjedhjeve të OSBE-s, aprovimi i një ligji mazhoritar që i krijon mundësi me të mëdha për të perseritur 26 majin dhe menjanimi i Komiteteve të Shpetimit Publik si faktor i vetëm i brendshëm që krijon garanci për zgjedhje të lira dhe demokratike.

Ndërsa për dy të parat, ose është në hapat e para, ose ka ngecur keq, për ceshtjen e Komiteteve ka arritur disa avantazhe. Gjenarali Forlati, duke respektuar dhe ligjin e Parlamentit të Berishes, nuk i njeh për një bashkëpunim zyrtar. Rezuluta e Këshillit të Evropës, sipas RTV-se, kërkon të shpallen të paligjshëm, ministrat e opozitës në qeverinë Fino, rasti me ekstrem Vukaj, bëjnë sikur këto komitete i takojnë një botë tjetër, vetë Finua flet për kontributin e tyre fillestar dhe për shkrirjen e tyre të plote me funksionimin e pushtetit lokal. Partitë Politike nga frika se mos shqetesohet Berisha u afrohen aq sa për të mos qene as larg e as afër.

Duket se të gjithë këta faktore ose nuk e kanë kuptuar rolin dhe misionin e këtyre komiteteve, ose i tremben ose i neglizhojnë pa ditur pse.

Se pari. Levizje Popullore për Demokraci, u la pak a shumë jetimë, përse i përket rolit udhëheqës. Për shumë kohë ajo mbeti, me kuptimin absolut të fjalës, popullore, pa një qender udhëheqës dhe përpunues të qëllimeve të veta politike. Një realitet i tillë bëri që disa here kryengritja ose të binte në kurthin e pushtetit që inicoi armatosjen e popullit dhe shkatërrimet për të humbur gjurmët e korupsionit dhe krimit.

Se dyti kjo levizje në dukje mbeti në kuadrin e spontanitetit. Ajo nuk u bë pjesë integrale e luftës politike të partive, në një kohë që këto parti e kishin provuar se ishin të pafuqishme për ta rrezuar Berishën. Nga ana tjetër energjitë e kryengritjes u harxhuan me se shumti për të shkatërruar ato mekanizma të pushtetit të Berishes, që ishin instaluar në gjirin e popullit si SHIK-u dhe që vepronin në mënyrë vdekjeprurëse.

Madje populli kryngrites ishte pothuaj vazhdimisht në mbrojtje të sulmeve të vazhdueshme dhe të shumëllojshme të Berishes dhe fare pak kishte menduar për të sulmuar. Kjo u duk me qartë kur vet Berisha humbi shansin për ta shndërruar kontradikën midis tij dhe popullit, në lufte civile midis popullit dhe ushtrisë dhe forcave të tjera të dhunës dhe kerkoi ta paraqiste këtë kryengritje si përplasje midis Veriut dhe Jugut. Megjithatë kryengritja shkoi vetëm drejt Tiranës në mënyrë të vetvetëshme, por gjithmonë të ndergjegjshëm dhe gjithmonë për të shkatërruar bazën e se keqes të një shteti të ndërtuar simos me keq. Ky proces u ndërpre me nëntë Mars.

Se treti. Duhet precizuar dhe kuptuar qartë se kjo kryengritje shpërtheu pasi të gjitha mjetet e tjera për korrigjuar shtetin dhe pushtetin totalitarist të partisë së Berishes dhe për t'i hapur rrugën proceseve të verteta demokratike ishin konsumuar totalisht dhe ishin të paefektshme. Kryengritja duke synuar drejt rrezimit të simbolit të kesaj diktature, nxorri jashtë përdorimit jo institucionet e shtetit si të tilla, por funksionaret,



nepunesit dhe punonjesit e tjere te inkriminuar, te korruptuar dhe te paligjshem te ketyre institucioneve dhe mekanizmave shteteror. Nje levizje e tille popullore e percaktuar nga vet ai si Levizje Popullore per Demokraci perkufizon mbi te gjitha ligjshmerine e tyre,- Ato shprehin ne menyre direkte vullnetin e popullit, si autoritet kryesor qe legjitimon egzistencen e nje shteti. Qe ketu percaktohet dhe misioni dhe koha per realizimin e ketij misioni ne te ardhmen.

Nen kete status, keto komitete duhet te mbushin boshlllekun e krijuar nga inegzistenca e shtetit dhe e pushtetit me dy menyra. Ose te ndihmojne ne rifunksionimin dhe ringritjen e ketyre strukturave me njerez qe gezojne mbi te gjitha konsensusin e ketyre Komiteteve dhe tavolinave te partive politike, ku keto komitete jane pale, ose te marrin persiper dhe te drejtojne pjese te tij. Po ashtu te dy keto menyra mund te alternohen dhe te jene me te frytshme, ashtu sic ndodhi me Vloren me Tepelenen, Permetin apo dhe ne rrethe te tjera. Ne kete rol te komiteteve askush nuk mund te ve ne dyshim se u respektua ligji, arsyeja dhe bashkepunimi me qeverine dhe se ne kete proces ishte e pranishem dhe PD-ja, apo njerez me te vertet patriote te saj.

Ky status percakton dhe kohen e funksionimit dhe te egzistences se tyre. Dhe kjo kohe lidhet me krijimin e garanciv te plota per vendosjen dhe funksionimin e nje shteti me te vertet demokratik. Nje qendrim i tille i Komiteteve eshte percaktuar qarte qe ne mbledhjen e tyre te pare unifikuese ne Gjirokaster me 11 Mars 1997. Nje gje e tille presupozon dhe pjesemmarjen e tyre te drejtperdrejt si ne procesin e ristrukturimit te shtetit ne te gjitha nivelet e tij dhe jo ne baze rrethesh, ashtu dhe me perfaqesimin e tyre ne strukturat e zgjedhura apo dhe te emeruara te shtetit. Ky proces fillon zyrtarisht me zgjedhjet parlamentare ku keto komitete perbejne bazen e garancise se zhvillimi te tyre ne menyre demokratike

Realizimi i ketij misioni presupuzon para se te gjithash dhe nje organizim te persosur. Komitetet eshte e vertete se dy dite me vone se marreveshja e 9 marsit, institucionalizuan dhe ata Komitetin Kombetar te Shpetimit Publik si shprehje adekuate e Levizjes Popullore per Demokraci. Ky forum percaktoi qarte dhe strategjine e tij, ku pervec kerkeses per doreheqjen pa kushte te Sali Berishes, percaktuan dhe akset kryesore te misonit historik per politiken Shqiptare te permendura me lart. Mirepo organizimi mbeti ne nivelin fillestar dhe koha tregoi se Komiteti Kombetar i Shpetimit Publik duhet t'u pergjigjet sfidave te reja me nje organizim me te persosur dhe veprimtari me aktive.

Kjo kerkon qe Komiteti Kombetar qe funksion ne takime te rregullta ne Kuvendin e Vlores, duhet te ftoje ne gjirin e vet intelektual te zot specialist te fushave te ndryshme dhe me reputacion ne popull.. Une mendoj se eshte ne nderin e ketyre intelektualeve qe te mos presin ftesa por te vrapojne drejt Vlores, me qellim te ngrihet nje Qender e Perpunimit te Mendimi Politik dhe Strategjise se kryengritjes popullore e mbetur ne mes te udhes. Mbi kete baze Komiteti Kombetar i Shpetimit Publik te zgjedh nje kryesi permanente dhe nje kryetar per te drejtuar ne menyre efikase ne cdo ore, por dhe per te vepruar ne menyre te organizuar, e per t'u perfaqesuar. Po ashtu te ngrihen seksione pune ne lidhje me cdo strukture shteterore e pushtetore, kuptohe jo per t'i dubluar, e aq me pak per t'i zevendesuar ato, por per te ndihmuar ne ristrukturimin dhe rifunksionimin e tyre, me statusin qe ky forum KKSHP, te jete pale ne te gjitha nivelet e marrjes se vendimeve. Kuptohet qe do te ishin te mirepritura ne nje rol te tille edhe partite politike me perfaqesuesit e tyre, me kusht qe kjo strategji si produkt e kryengritjes popullore, te shtrohet ne tavolinen e bisedimeve dhe te zbatohet.

Nje organizim i tille eshte ekuptueshme qe risjelle mbi baza te drejta dhe te shendosha te gjitha raportet e ketij forumi me popullin, me partite politike, me Qeverine e Pajtimit Kombetar, me organizmat nderkombetar dhe forcat shumekombeshe. Kjo

eshte dhe menyra me e mire per krijimin e garancive qe ristartimi i shtetit shqiptar te mos ricikloj gamimet e se shkuares ,por dhe ndihmon ne pershpejtimin e proceseve duke bere ta paeftkshem rolin e Berishes

P. Barka Gjirokaste 26.04.97

# Fokusi manipulator I Berishës per zgjedhjet e qershorit

30.04.1997/02.05.1997



Konstandja e dinakerise dhe intriges politike te stafit te Sali Berishes ne zhvillimet e fundit ne Shqiperi moren vlera te reja negative dhe te rrezikshem. Me 9 Mars ai foli per mbizoterimin mbi ligjin dhe parimet partiake te moralit, te shprehur sipas tij, ne formulen e “pajtitimit kombetar”. Mirepo ky moral vetem sa u shitej “dialoguesve” ne ate tavoline. Kjo per arsyen e thjeshte se kompromisi u arrit mbi baza krejt te pabarabarta. Berisha mbajti per llogari te vet dhe te PD-se Presidencen, Parlamentin, Prokurorine, Gjykatat, pushtetin e zgjedhur dhe te emeruar lokal, policine, sherbimet sekrete, dhe i la opozites disa ministra dhe kryeministrin te cilin eshte i gatshem ta sfidoje edhe per nje polic civil.

Morali i Berishes me 9 mars per fryme mirekutpimi mbaroi kur gjithë kjo makine ka filluar pak nga pak te

vihet ne levizje ne sherbim te PD-se dhe te Berishes; kur Berisha, PD-ja dhe segmentet e pushtetit te tyre u ribene intolerante dhe konsensusin e frymes se pajtimit e identifikojne me te njejtin interes pragmatist te pushtetit te tyre politik

Strategjia e metejshme e Berishes eshte tani mese i lexueshme. Ai kerkon te provoje per opinionini e brendshem dhe te jashtem se ne fund te fundit faji per deshtimin e zgjedhjeve te Qershorit nuk i perket Atij, por te tjereve, pavaresisht se eshte pikerisht ai qe saboton gjithcka.

Se pari. Berisha kerkon te percaje opoziten dhe te minimizoje rolin e saj. Per kete, duke shfrytezuat te gjitha strukturat ne dore te tij, si Presidencen, Parlamentin dhe Televizionin, Ai ia arriti deri ne nje fare mese t’ i heq ish opozites inisiativen, ose ta bllokoje ate. Berisha duke shfrytezuat pikerisht kete situatë si dhe tolerancën tej cdo kufiri te lejueshem te ish opozites, kerkon ta paraqes ate, vecanarisht Partine Socialiste, si “te pandryshueshme, staliniste komuniste, organizatore te revoltës te deshtuar te armatosur per permbysjen me dhune te pushtetit te dale nga vota e lire” etj. Heshtja e partive politike ndaj revanshit te tille te Berishes, duke i konsideruar ato, nje cmenduri dhe perpjekjeja e partive me te vogla per te kerkuar vetem nga Partia Socialiste te marre inisiativen per cdo gje, eshte ne favor te Berishes. Po ashtu situata e akuzave te ndersjellta midis partive te kampit kunder Berishes, shpesh dhe ne linjen e e tij, i vjen pershtat taktikes Berishiane.

Se dyti. Ai sulmon Komitetet e Shtetit Publik. Kete sulm nuk e ben vetem nga fakti se ato i prishen gjumin dhe delirin e tij pushtetor. Ai shkon me larg. Duke i sulmuar

ato tenton te mbaje larg tyre dhe partite, dmth to krijoje nje pakenaqesi reciproke me synim qe partite te humbasin deri ne zgjedhje mbeshtetjen e ketyre komiteteve, pra dhe te vet popullit, vecanarisht ne Jug.

Duke shfrytezuar ne kete lufte medjen shteterore elektronike, e cila eshte e vetmja qe shikohet dhe degjohet dhe ne Veri, kerkon te krijoje ketu imazhin e nje Jugu qe eshte kunder veriut dhe demokracise ne vend. Po ashtu, duke shpresuar se do te krijoje nje sistem te tille procesi zgjedhor qe mund te manipuloje si me 26 maj, komitetet do te perbejne pangesen kryesore. Edhe po te ndodh e kunderta, akuzat e tanishme kunder komiteteve, ai do t'i shrytezoje ne procesin zgjedhor per te justifikuar humbjen katastrofike te PD-se dhe keshtu te rrembeje flamurin e mosnjohjes se tyre. Ketij qellimi i sherben dhe kembulja

se treti, perzhvillimin e zgjedhjeve me nje ligj te paster mazhoritar. Kjo kembengulje lidhet njekohesisht me nje kurth qe pergatit Berisha ndaj qeverise me qellim edhe tellimin e metejshe me insiatives per veprime politike ne vend por dhe te distances midis tij dhe Finos . Berisha, duke mos dhene konsensusin per nje ligj proporcional, do ta detyroje qeverine ta coje ne parlament. Sipas ministrit Ngjela, mosaprovimi i ligjit con ne doreheqjen e qeverise dhe nje veprim i tille konsiderohet si nje presion ndaj Berishes dhe strukturave te tij. Mirepo parlamenti do te aprovoje ligjin pa marre parasysh pretendimet e qeverise per disa “nene” te tij, pra do te aprovoje nje ligj mazhoritar me nenin e gjenocidit dhe te pastertise se figurave brenda. Ne kete rast cdo reagim i asaj “pjesezes” se Parlamentit te kontrolluar nga kundertshtaret e Berishes, apo dhe i qeverise, dhe aq me teper kerkesa per doreheqjen e saj, ben me faj vete qeverine dhe partite kundertshtare te Berishes

Pra, me nje ligj te tille ne dore Berisha tregon se pari, se eshte Ai qe vendos akoma per gjithcka, Se dyti, heq qafe partite e vogla per te qene PD-ja sa me e pranishem ne opozite Se treti, duke hequr qafe komitetet, te kete mundesi qe me manipulime qofte dhe te vogla ne zona elektorale te sistemit mazhoritar, te mund te nxjerre me shume deputete, se sa me te nejta manipulime apo dhe me te medha, ne kuadrin e nje ligj proporcional.

Por Ai mendon dhe ndryshe. Duke qene se eshte i sigurt se PD-ja me nje ligj mazhoritar, nuk do te gjeje kandidate per t'i derguar qe te “te levizin lirisht”, ne popull, te akuzoje per kete Komitetet, se s' mund te akuzoje popullin, dhe t'i nenshtrohet keshtu “rruges se bojkotit”, apo te pakenaqrut dhe mosnjohjes se rezultateve.

Pra problemi shtrohet i qarte, ndersa Berisha mendon te hyje nga dritarja, kur populli e nxorri nga dera, partite kundertshtare te tij, duhet te mendojne per te parandaluar ligesine e tij qe te veproje, si para ashtu dhe pas zgjedhjeve.

P Barka Gjrokaster 30.04.97

# Ose Komitete dhe Levizje, ose Berishë dhe dhunë

/13.05.1997

Koha Jonë 8

Politikë

E Martë 13 Maj 1997

## Ose komitete dhe Lëvizje, ose Berishë dhe dhunë

Berisha tregon tani se e ka bindje se zgjedhjet e parakohësime i takojnë sërish atij. Në këtë revansh tri janë tani për tani strukturat që e pengojnë: Menjanimi nga vëzhgimi i zgjedhjeve të OSBE-së, aprovimi i një ligji mazhoritar që i krijon mundësi më të mëdha për të përsëritur 26 majin dhe menjanimi i Komiteteve të Shpëtimit Publik, si faktor i vetëm i brendshëm që krijon garancë për zgjedhje të lira dhe demokratike.

Ndërsa për dy të parat, ose është në hapat e para ose ka ngecur Req, për çështjen e komiteteve ka arritur disa avancime. Gjeneral Foriati, duke respektuar dhe ligjin e parlamentit të Berishës, nuk i njeh për një bashkëpunim zyrtar. Rezoluta e Këshillit të Evropës sipas RTV-së, kërkon të shpallen të paligjshëm, ministrat e opozitës, në qeverinë Fino, rast më ekstrem Vukaj, bëjnë sikur këto komitete i takojnë një bote tjetër, vetë Fino flet për kontributin e tyre fillestar dhe për shkrijnjen e tyre të plotë me funksionimin

***Në Kontrastin e partive politike për zgjedhjet parlamentare, është vendosur edhe shpërdarja e Komiteteve të Shpëtimit Kombëtar. Ky vendim është marrë pa lejen e komiteteve, pa i pyetur këto, dhe nga forca politike që as i kanë ndërtuar dhe as mund t'i rrezojnë Komitetet. Ku e moren këtë të drejtë forcat politike, ende nuk është e qartë. Ndërkohë nuk është e qartë pse kërkohet të shpërdajen Komitetet e Shpëtimit popullor, ndërkohë kur shteti popërsos strukturat e përcarjes dhe të krimit në popull, sidomos në Jug të vendit. Më datën 16 Maj Komitetet e Shpëtimit Kombëtar do të mbledhen në Vlorë për të diskutuar rreth programit të tyre të mëtejshëm.***

e pushtetit lokal. Partitë politike nga frika se mos shqetësohet Berisha, vendosin që këto komitete të shpërdahen.

Ndërkohë institucionet politike europiane veshtrajnë nga komitetet, madje kanë gatitur një ftesë për të Europë. Duket se jo të gjithë kanë kuptuar mirë rolin dhe misionin e këtyre komiteteve, disa edhe tremben pa ditur pse. Kjo u shkaktoi për arsye se:

Së pari, Lëvizja Popullore për Demokraci, u la jetimë, përse i përket rolit udhëheqës të forcave politike. Kjo bëri që disa herë kryengritja të binte në kurthin e pushtetit që ini-

shqiptare të përmendura më lart. Mirëpo organizimi mbetur në nivelin fillestar dhe koha tregoi se komiteti kombëtar i shpëtimit publik duhet t'u përgjigjet sfida të reja me një organizim më të përsosur dhe veprimitari më aktive.

Kjo kërkon që komiteti kombëtar që funksionon në takime të rregullta në Kuvendin e vlorës, duhet të ftojë në gjirin e vet intelektualë të zot, specialistë të fushave të ndryshme dhe me reputacion në popull. Është në nderim e këtyre intelektualëve që të mos presin ftesa por të vrapojnë drejt Vlorës, me qëllim të ngrihet një Qendër e Përpunimit të Mendimit Politik dhe Strategjikë së kryengritjes popullore e mbetur në mes të udhës. Një organizim i tillë, është e kuptueshme që risjell mbi baza të drejta dhe të shëndosha të gjitha raportet e këtyre forumit me popullin, me partitë politike, me Qeverinë e Parlamentit Kombëtar, me organizmat ndërkombëtarë dhe forcat shumëkombëshe.

Qëndrimi i Komiteteve është përcaktuar qartë që në mbledhjen e tyre të parë unifikuese në Gjirokastrë më 11 Mars 1997. Këtu presupozohet pjesëmarrje e komiteteve, dhe jo vetëm në bazë rrethesh, në strukturat e zgjedhura apo dhe të emëruara të shtetit. Ky proces fillon zyrtarisht me zgjedhjet parlamentare, ku këto komitete përbëjnë bazën e garancisë së zhvillimit të tyre në mënyrë demokratike.

Realizimi i këtij misioni presupozon para së gjithash dhe një organizim të përsosur. Komitetet dy ditë më vonë se marrëveshja e 9 Marsit, institucionalizuan Komitetin Kombëtar të Shpëtimit Publik si shprehje adekuate e Lëvizjes Popullore për Demokraci. Ky forum përcaktoi qartë dhe strategjinë e tij, ku përveç kërkesës për dorëheqjen pa kushte të Sali Berishës, për-caktuan dhe asist kryesore të misionit historik për politiken

PANAJOT BARKA

Kavajë: mshërrinë omicidat në haza

## **Nga Panajot Barka**

### **Perendimi: Çfare te bejme me Shqiperine?! Dhe lojrat e Berishes per te fituar pushtet**

28.05.97

Gjate gjithë kesaj kohe, ne qendrimin e vet ne favor te mbajtjes me cdo kusht te pushtetit, Berisha midis te tjerave, perfitoi shume edhe nga koncepti i konsensusit qe mediatoret evropiane serviren per arritjen e marreveshjeve politike midis partive. Baza e ketij koncepti ishte zbatimi i formulave te perspektives se vendit dhe te shtetit nga politika dhe politikane te çliruar nga ngarkesat dhe praktikat e se kaluares. Ne kete kuader duhet kuptuar dhe perpjekja e partnereve te huaj per krizen Shqiptare, per t'u drejtuar partive politike, pa i ndare ato ne fajtoresh dhe jo fajtoresh per shkaterrimin e shtetit shqiptar.

Tolerancen e treguar ne kete drejtim nga partite e frontit kunder Berishes, Ai e shfrytëzoi per te ruajtur pozitat e veta ne emer te Partise Demokratike. Pushteti i mbetur ne dore te tij, sidomos ai legjislativ, sherbimet sekrete dhe policia, u perdoren per te sabotuar Qeverine e Pajtimin Kombetar ne te dy detyrat kryesore te saj: ne rivendosjen e rendit dhe ne organizimin e zgjedhjeve. Nje qendrim i tille ruajtje ne gjendjen e kaosit dhe te mosbesimit dhe i detyroi partneret nderkombetare t'i rikthehen dilemes. C'te bejme me Shqiperine. Te zhvillojme zgjedhjet dhe pastaj te punohet per rivendosjen e rendit, d.m.th, per rindertimin e shtetit, apo te ecim ne rrugen e kundert, d.m.th te rivendosim rendin dhe pastaj te mendojme per zhvillimin e demokracise. Nje dileme e tille coi dhe ne shtyrjen per nje moment pas zgjedhjeve te vendimit te vendeve donatore per Shqiperine.

Por cila ishte rruga e ndjekur prej tij dhe ku kerkon te arrij?

Pasi ia arriti qellimit qe te ishte pale vetem me partite dhe jo me popullin, Ai filloi te mendoje per rolin e vet si figure qendrore te Shqiptareve. Per kete pranoi ne fillim si partner te vetem djalin e ish mbretit te veteshpallur, por pa asnje shans per te fituar Megjithate takimet e tij te para ne popull televizioni i Berishes i lustrroi dhe krijoi pershtypjen dhe vet Lekes se mund te konkuronte. Mirepo sapo Berisha tentoi dhe doli ne popull vet televizioni i tij vuri re dhe gurin me te vogel qe rra mbi makinën e Lekes. (!!), ndersa takimet e tij dhe ne fshatra te zakonshme jane madheshtore, sipas TV.

Por dalja e tij ne popull kishte dhe hile te tjera. E para Ben per vete testimin ne popull se sa i pranueshem eshte. Nga ana tjeter kerkon t'i tregojte botes nepermjet TV-se se si vetem Ai Sali Berisha, eshte i pranueshem nga populli, megjithese e di shume mire qe edhe shume nga ata qe nuk e duan shkojne atje per te pare ndoshta ku fshihet gjithë ajo prapesia e tij. Se dyti, duke e mbajtur gjithë partite e frontit kunder tij te mbyllura ne bisedime te pafund, kerkoi t'i nervozojte ato dhe t'i corientoje, sidomos ne qendrimet ndaj perendimit. Madje, duke i detyruar te ndryshojne disa here dhe qendrimet e veta lidhur me zgjedhjet, tenton t'i kompromentoje me jo seriozitetin e vet, synon t'i tregojte popullit paaftesine e opozites per ta "mposhtur" ate, pra dhe paaftesine qeverisese te saj.

Se treti. Por ajo qe eshte me kryesore eshte se me keto pengesa Ai krijon distance kohore ne komunikimin e partive te opozites me popullin. Keshtu Berisha duke shfrytëzuar kete boshllek komunikimi synon qe vektorin e urejtjes popullore ndaj tij ta ktheje dhe ne vektore pakenaqesie ndaj partive kundershtrare te tij. Kerkon pra te

fragmetarizojë gjithnjë e më shumë frontin e deritanishëm unik kundër tij, si brenda popullit, ashtu dhe midis partive.

Se katërti Taktika e lojës së tij mbetet gjithashtu aplikimi i metodave përjashtuese të partive politike nga proceset politike, qoftë dhe ato zgjedhore. Megjithatë ajo që i intereson më shumë janë përdorimi i taktikave përjashtuese të popullit nga votimi. Kjo do të thotë se kur numri i votuesve të PD-së sado i paket, mbetet i pandryshueshëm, atëherë, sa më pak votues në zgjedhje aq më e lartë përbindja e PD-së. Kjo është arsyeja që votuesit e opozitës Berisha kërkon t' i largojë nga vendi nga frika e pasigurisë, t' i vrastë, t' i terrorizojë, e t' i tremb që të mos shkojnë në votime.

Berisha megjithatë harxhoi shumë energji për t' u mbajtur në skenën politike shqiptare. E keqja është se Partitë politike, ndryshe nga populli, nuk besojnë se Ai me kohë ka vënë piken finale të karrierës Presidenciale dhe kërkojnë akoma ngaranci të shumëfishta. Përndimori gjithashtu e kuptoi se keto garanci egzistojnë brenda vendit, tek vet Partitë dhe tek populli, ndaj nuk duan ta injorojnë këto vend duke zbatuar formulë zgjedhëse të aplikuar në Palestinë e gjetke dhe nuk është aspak e vërtetë se me qëndrimet e tij të fundit i hap rrugë Berishes. Dalja në ringun elektoral të socialistëve dhe deshtimi i ri i forcave të dhunës kundër popullit, si dhe mitingjet me vetveten të Berishes dhe të udhëheqësve të PD-së, vërtetojnë me se miri këto fund.

Karta e fundit me të cilën luan tani Berisha është mos abrogimi i Ligjit të Gjendjes së Jashtëzakonshme, egzistencën e të cilit e lidh me egzistencën e Komitetëve të Shpëtimit Publik.

Mirëpo deshtimi i provës gjenerale mbi Komitetet, në fakt kundër popullit, (me provokimet e ditëve të fundit të forcave të besuara të tij në jug, në Cerik, Elbasan e gjetke,) i dhënë Presidentit dhe klanit të tij një mesazh të mirë, ashtu si dhe opozitës, së mjetet e tij të dhunës ku mbështetet një pushtet diktatorial, janë të pafuqishme, të pakta dhe të deshtuara. Në këto aspekt ky ligj, që doli në fakt për të mbrojtur Pushtetin e PD-së dhe jo rëndin kushtetues, në kushtet e mungesës së forcave dhe mjeteve për t' u zbatuar, nuk ka asnjë vlerë praktike. Kështu që në kushtet e mungesës së vullnetit të Parlamentit të PD-së për ta abroguar atë, i mbetet qeverisë së Finos, e cila duke shfrytëzuar vendimin e parlamentit të datës 13 Maj, për të administruar ajo procesin zgjedhor, ka të drejtë të nxjerrë disa akte normative e vendime përkatëse që ta bëjnë dhe juridikisht të pavlerë këto ligj. Po ashtu duke shfrytëzuar kompetencat e veta dhe hapësirat që i lejon ky vendim i parlamentit, si dhe tavolinën e Partive, Qeveria t' u tregojë vendin Presidentit që shkel kompetencat e veta duke vënë në shërbim të PD-së atributet e shtetit, shërbimin Informativ dhe hollësitë e tjera që pengojnë procesin zgjedhor.

Një masë e tillë do t' i krijojë hapësira opozitës për të treguar edhe një herë nepërmjet mitingjeve paraelektorale se shumica që hesht pro PD-së dhe Berishes nuk egziston më.

Panajot Barka 28.05.97

Nga Panajot Barka

## **Zgjedhjet e 29 qershorit , si mundësi për të ndërtuar shtetin dhe jo për të marrë pushtetin**

19.06.1997

Eshte fakt që në vendin tonë vlerat intelektuale dhe insticionet paraprirese të mbarëvajtjes së demokracisë dhe zhvillimit shoqëror janë thyer në mes nga pesha e pushtetit të mbipolizuar dhe nga agresioni i korupsionit. Paradokse të tilla ku rektori i universitetit behet leva kryesore për manipulimin e zgjedhjeve të 26 Majit 1996, apo kur universitetet shfrytëzohen për përfitime politike partiake dhe behen prone e njëzë për rruges, kur dijet dhe diplomat blihen me para, vetëm në Shqipëri po ndodh.

Eshte pikërisht ky fakt që në të gjitha zhvillimet mujve të fundit në vend, e vecanarisht në Jug, pjesëmarrja në masë e intelektualëve dhe vecanarisht e insticioneve të dijes e të kultures u vetperjashtuan duke e lënë, së bashku me forcat politike, revoltën popullore të shndërrohet në një kryengritje kaotike me vlera vetëm mohuese ndaj regjimit të Berishes.

Fakt është gjithashtu se fenomeni i pasivitetit të forcave intelektuale vihet re edhe në zhvillimet politike që lidhen me zgjedhjet e 29 Qershorit. Kjo ndodh edhe për arsye se partitë politike, ashtu dhe forcat intelektuale i shikojnë me shumë këto zgjedhje si mundësi për të marrë pushtetin dhe jo si një piknisje për të ndërtuar shtetin dhe institucionet e tij. Çarja e frontit të partive kundër Berishes si fenomen antishtet, është një tregues domothenes për garën e partive drejt pushtetit. Ato pak interesohen për një bashkëpunim konstruktiv për të përcaktuar formulën qeverisëse e cila do të marrë persiper hedhjen e kolonave të shtetit demokratik, politikën e jashtme të tij, mënyrën e rivendosjes së rendit etj. Aq e theksuar është kjo midis gjeneraleve dhe kolonëve të shumtë të ushtrisë politike shqiptare, sa që ata shpesh nuk arrijnë as të komunikojnë midis tyre për probleme thelbësore për ardhmerinë e vendit dhe shpesh ndaj të huajve paraqiten me ide dhe pikepamje që kenëqin me shumë interesat partiake se sa ato të vendit. Madje të huajt njohin shpesh më mirë se ç'mendojnë politikanet shqiptare në përgjithësi se vet politikanet shqiptare.

Por politikanet shqiptarë që nesër do të drejtojnë shtetin shqiptar, duhet të kuptojnë se vendi është i mbarsur me mijra berishe, ndaj që tani duhet të përballojnë, si mizerinë e puthadreve, ashtu dhe numrin e madh të politikanteve të të gjitha rangjeve që, të infektuar nga mentaliteti politik berishian, e shikojnë 30 Qershorin si ditën e parë që do t'i hipin kalit të pushtetit për të bërë pasuri. Po ashtu, politikanet tane, të cilët janë të detyruar, ndoshta nga situatat në vend, të adaptojnë taktikën të Berishes duke u rrethuar nga roje të shumta dhe që tani duhet të shikojnë mbi kokat e tyre realitetin dhe përzgjedhjen e intelektualëve që do të marrin persiper punët e shumta të shtetit dhe pushtetit. Kjo do të thotë se ata, që të mos perserisin fajin e Berishes, i cili për hir të një shërbimi të castit dhe në pamundësi apo nga mosdashja për të respektuar shtetin, ndau me ta pushtetin.

Nga ana tjetër mungesa e një alternative të qartë se si duhet të arrihet mohimi deri në fund i regjimit të Berishes dhe po ashtu pohimi i perspektives së shtetit të ri demokratik, si dhe manifestimi shpesh i ndjenjës së të qenit të persekutuar nga rregjimi i Berishes, (dhe për këtë duhet të trajtohen si fitimtare) i ka kthyer gjeneralet e politikës Shqiptare në një here në ushtarë të bindur të qarqeve politike perendimore. Një situatë e tillë të krijon bindjen se piruetat e vazhdueshme dhe qëndrimet shpesh kontradiktore të



institucioneve dhe vendeve perendimore per zgjidhjen e krizes Shqiptare, jane rezultat i perplasjeve te interesave te tyre globale ne Shqiperi dhe ne rajon.

Mbi kete logjike mesa duket zgjidhen dhe nerezit e politikës shqiptare qe duhet te drejtojne vendin. Tendencat italiane per te sfiduar Nanon me rihapjen, nga nje organ italian shteteror te çeshtjes se sterkonsumuar e te sterpolitizuar te ndihmave Italiane te 1991, menjehere pas nje vizite te sukseshme te tij ne Greqi, dhe dekorimi i Forestit nga Berisha si nje mirenjohje ndaj shtetit Italian, pak pas zbulimit te skandalit Foresti, (si nderhyrje ne politiken shqiptare ne favor te Berishes), eshte nje tregues i qarte per aq sa thame me larte. E keqja eshte se ne keto tavolina gjeneralet e politikës tone nuk jane te pranishem as me vendime te tyre si zote te vendit, as me propozime e as si degjues. Keshtu qe pak dite para zhvillimit te zgjedhjeve ne Shqiperi perspektiva shqiptare ka nje mbivendosje formulash e skenarësh qe po hutojne situaten tone te brendshme

Po ashtu, mungesa i nje koordinimi te mendimit politik te brendshem per te ardhmen e shtetit shqiptar, per politiken e tij te brendshem e te jashtem, i ka futur ne pasivitet te theksuar politikanet shqiptare, ne nje kohe qe politika perendimore, krejtesisht jasht natyres se vet, leviz shume ne drejtim te zhvillimeve ne Shqiperi, madje ne kundërshtim me proverbin e zgjedhur prej tyre per posterin elektoral “I zoti e nxierre gomarin nga balta”

Panajot Barka 19.06.97

# Nga Panajot Barka

## Sfidat e ringritjes se shtetit (Shqipëria në prag të një ideali të ri)

/19.08.1997

**Koha Jone** 4 Politike E Martë 19 Gusht 1997

### Shqipëria në prag të një ideali të ri

Situata në vend imponon një ndryshim epokal që lidhet me perpunimin e një ideali të lartë brenda kuadrit të angazhimit total të intelektualëve, institucioneve të kultures të arsimit të letrave dhe të shkencave, të gershetuara me kontributin e forcave politike progresiste.

### Deputetët e PBDNJ "të përmëdjekur" nga elektorati

### Kontrata e vizave kthehet në bumerang

### Raportet midis idealit dhe pragmatizmit

### Doni punë, shkoni tek partitë

### Elbasan, zyra e deputetëve mbyllur

Situata në vend imponon një ndryshim epokal që lidhet me perpunimin e një ideali të lartë brenda kuadrit të angazhimit total të intelektualëve, institucioneve të kultures të arsimit të letrave dhe të shkencave, të gershetuara me kontributin e forcave politike progresiste.

Arritja e këtij qëllimi kërkon patjetër respektimin rigoroz të disa raporteve:

### RAPORTI MIDIS IDEALIT DHE PRAGMATIZMIT

Revolucioni Frenq u bë me frymezimin e një ideali trikomponentesh, Liri, Barazi Velazerim. Kombi gjerman i rezistoi pushtimit Bonapartian duke i kundërvetur

klasicismit të kultures ushtarake të N Bonapartit, romantizmit popullor të vitatilitetit të races ariane. Vete lufta jone nacionale-Clirimtare u zhvillua në frymezimin e aspiratave për liri dhe një sistem shoqëror të emancipuar.

Ky perpunimi i idealit fillon me mbrojtjen morale të njerezve, që presupozon clirimin e tyre nga terrori psikologjik i perjashtimit nga pjesëmarrja aktive në zhvillimet në vend, nga psikoza se servilosja ndaj pushtetit dhe korupsionit janë menyrat më të mira për të jetuar dhe krijimi i bindjes së demokracia e aspiruar fillon tek individi kur ai nuk e lyp lirine dhe të drejtat e veta, kur si qytetari i thjeshtë dhe njeriu i mekanizmit shtetëror e ndjen se është i mbrojtur dhe njekohesisht i rezikuar nga ligji dhe jo nga njeriu që e ka në dorë kete ligj.

Faktoret që spikatën në levizje të tilla janë dy. Popujt si misherim i idealit dhe frymezuesit e idealeve, që janë intelektualët dhe politikanet

Mirepo në gjashtëmujorin e zhvillimeve të vrullshme në vendin tone u vu re një shtresim dhe një shkeputje e faktoreve të tilla që përbejnë bazen e ndryshimeve epokale. Në kohën e Levizjes së Madhe Popullore për Demokraci, u vu re se faktori popull veproi në pararoje. Levizja e tij karakterizohej nga pragmatizmi, (parat e humbura) dhe nga ideali i cili drejtohej kundër diktatorit Berisha. Faktori intelektual ose u vetepershtua ose ishte i dyzuar, pra pak e frymezoj apo e udhëhoqi kete Levizje për të afirmuar aspiratën e popullit të shprehur si mohim, ndersa njerezit e politikës prisnin geshenja të pjekura dhe të qeruar, duke bere që me kalimin e kohës të krijohej terreni për lulezimin e banditizmit, kriminalitetit dhe kaosit të pergjithshem.

Tani, pas zgjedhjeve, ku qellimin e vet kundër diktatorit popullit e realizoi me një votim plebishtar në favor të opozites duke e sjelle atë në pushtet, politikanet janë në qender të vemendjes. Mirepo hapat e para të perpekejeve të tyre për rifuksionimin e shtetit, karakterizohen me shume nga entuziazmi se sa nga optimizmi real. Ndersa shtresimi i vene re kohet e fundit po krijon raporte të kundërta saqë krijohet pershtypja që sakrificat

e popullit po shfrytezohen per pragmatizem politik. Keshtu raporti midis idealit dhe pragmatizmit merr formen e raportit midis:

#### MILITANTIZMIT PARTIAK DHE MERITOKRACISE E PROFESIONALIZMIT

Ftesat e perseritura te kryemnistrit te ri Fatos Nano per kontributin e te gjitha kapaciteve intelektuale e profesionale, per institucionalizimin e marredhenjeve kontraktuale mbi baza profesioniste e te meritokracise ne drejtimin e puneve te shtetit, nuk ka te beje vetem me perpjekjen e tij dhe te stafit qe drejton per te ndryshuar kete raport te qeverisjes se kalauar, ne te kunderten e vet, por ka te beje dhe me mposhtjen e presionit qe ushtrojne skalionet e militanteve partiak per zoterimin e administrates shteterore e publike e qe eshte shprehje e sundimit te pragmatizmit mbi idealizmin per berjen e se ardhmes, te nenshtrimit te shtetit nga individi, nepermjet shfrytezimit te pushtetit te fituar nga vota e popullit. Manifestimi i teseres partiake dhe aplikimi i nepotizmit shoqeror ne ngritjen e godines shteterore mbi baza interesi pragmatist apo dhe me idene e krijimit te kraheve te sigurta, krijojn sigurisht premisat per rigeryerjen e shtetit. Ne kete start te ri te shtetit, intelektualet, qe jane gjithmone transmesioni me i mire midis popullit, pushtetit dhe shtetit, duket se jane ne pritje. Arsyet kuptohet, lidhen perseri si me precedentin e krijuar nga menyra Berishiane e drejtimit te shtetit, ashtu dhe nga vet realiteti kaotik shqiptar, por dhe nga fakti se ata deri tani, para se te mundin te manifestojne nje kontribut te tille, jane te detyruar te sigurojne mbijetesen me mjete edhe vulgare per nje intelektual.

Populli, qe ne aspektin me te gjere perfaqeson anen idealiste ne raportet e zhvillimeve ne vend, perkrahjen aktive ndaj klases politike qe solli ne pushtet dalangadale po e zevendeson me nje perkrahje prove dhe pritjeje, duke vezhguar me lupe cdo veprim te qeveritareve te rinj. Pushteti tregon paaftesi per te integruar popullin ne levizjen e domosdoshme transformuese ekonomike politike shoqerore, por e le te ndjehet i perjashtuar, te mbush kafenete dhe trotuaret, me synim te mesoje se kush e ben kontrabanden, kush do te zeje filan post e vend pune, ose si do te siguroje te holla me sa me pak mund. Mirepo faktori popull ne keto momente politike zoteron te drejten e drejtperdrejte morale te reagimit ndaj cdo zvaritjeje dhe veprimi pragmatist te njerezve te pushtetit. Populli zoteron gjithashtu te fresket pervojen e efektivitetit te autoritetit te tij mbi fatet e pushtetit te administruar keq. I vetmi element i drejtperdrejte pragmatist, madje i nje pjese te popullit, mbeten parate e piramidave. Kete faktor n.q.s klasa politike ne pushtet, nuk do te mund ta integroje ne bashkesine e faktoreve qe perbejne misherimin logjik te aspirates se popullit, per nje shtet te se drejtes dhe te demokracise, mund te rifokusohet, per te kerkuar nje fillim te ri per riberjen e shtetit, ne nje kohe sa me te shkurter, pasi rruga tani me eshte e njohur.

#### RAPORTI POZITE - OPOZITE

Edhe zgjedhjet e fundit risollen ne skene “defektin” ne raportin Pozite- Opozite te demokracise shqiptare .

Ndersa Pozita ka nje natyre te gjithfuqishme, opozita esht krejt e pakonduruar. Ajo paraqitet me nje konfiguracion te grimcuar ne parti te vogla te djathta. E keqja eshte se ato nuk jane te koordinuara, as te bashkuara dhe faktikisht nuk mund te shquhen per efektivitet ne rolin e tyre opozitar. Keto parti, gjithashtu nuk mund t’i afrohen as partise kryesore te opozites,-PD-se. Prane saj mbeten ato parti opozitare qe nuk mund te mbijetojne vete. Te tjerat kerkojne te distancohen nga Partia e Berishes qe mban e vetme peshen e fajit per shkaterrimin e shtetit dhe te vlerave njerezore ne vend.

Vete PD-ja jeton periudhen e goditjejeve metasizmike te humbjes. Qe te mund te kthehet ne nje Parti vitale per politiken shqiptare, PD-ja duhet te kaloje ne filtrin e katharsis. Por me sa duket atje uniteti midis te fajshmeve dhe te pafajshmeve, midis te korruptuarve dhe te pakorruptuarve, do te ruhet duke eksportuar sulme drejt Pozites ne cdo aspekt dhe per cdo hap te saj. Nje veprim i tille i konstatuar qe ne momentin e pare, synon, te pengoje Poziten ne vepren e vet dhe ne emer te perpjekjes per ta korrigjuar ate, ta terheq ne nje beteje revanshi, ku te mund ta konsumoje, sidomos ne aspektin e efekteve shoqerore dhe te mund te krijojë imazhin tek elektorati i vet se shume shpejt do te kthehet ne pushtet. Raporti Pozite Opozite ne perpjekjet e PD-se per ta paraqitur si kontradike Jug-Veri, perben gjithashtu nje precedent potencial shume te rrezikshem.

Problemi eshte se sa do t'u shpetoje ketyre kurtheve Pozita, ne nje kohe qe asaj i duhet te veproje si ne aspektin e ngritjes se institucioneve dhe kuadrit ligjor te funksionimit te shtetit, ashtu dhe ne ate te drejtimit dhe veprimin te pushtetit brenda ketij kuadri ligjor. Pra a do t'i qendroje parimit te deklaruar per nje bashkejetese normale me opoziten, a do te mund te vetkontrollohet ajo ne pushtetin e mbi dy te tretave qe zoteron, dhe a do te krijojë mekanizma te tilla per nje efektivitet te veprimin parandalues e korrigjues te opozites.

Po ashtu nuk dihet se kur dhe si Opozita e PD-se do te braktis pozicionin e saj të vetperjashtimit nga pjesemarrja ne jeten politike te vendit me qellim qe te pengoje rreshqitjen e pozites duke shfrytezuar pikerisht domosdoshmerine e pjesemarrjes se opozites ne zhvillimet ne vend.

Pozita duhet te shmang gjithashtu frymen e revanshit qe nuk shfaqet aq i theksuar ne drejtim te opozites se sa ne nje koncept me te gjere dhe ne dem prap te te gjithe vendit, e tipit "erdhi radha jone te bejme si te duam ne, ashtu sic ben dhe ata". Po aq e rrezikshme eshte gjithashtu dhe bashkepunimi midis pozites dhe opozites sipas parimit te kthimit te borxhit. D.mth, leshimet komerciale qe ish pozita i bente dje indvidive ndoshta edhe me ofiqe te larta ne pushtetin e sotem, ose dhe pa pushtet, t' i vjel sot si perfitime politike, per te fshehur korupsionin apo padrejtesi te tjera te djeshme. Nuk duhet harruar gjithashtu se sa i forte do te jete imuniteti i pozites per te mos u kombromentuar e korruptuar nga pushteti ekonomik e i pamerituar i opozites se sotme.

#### **RAPORTI MIDIS BERJES DHE RIBERJES SHTETIT**

Presidenti i Republikee z. Rexhep Meidani theksoi ne daljen e tij te dyte publike se "perdorimi random i fatures problemore te se djeshmes thjesht per te siguruar alibine e paafetise dhe destruktivizmit, nuk i ka rezistuar kohes"

Kjo si aksiome eshte e vlefshme si per opoziten ashtu dhe per Poziten. Kryeministri Nano ne deklaratat programmatike te qeverise se tij, nen kete fryme u mundua per te shmangur aq sa ishte e mundur sulmet mbi PD-ne, duke treguar, te pakten ne deklarime, se eshte i predispozuar per te mos harxhuar shume kohe duke u marre me te kaluaren. Problemi eshte se riberja dhe berja e shtetit duhet pare si nje dimesion i vetem ku duhet percaktuar sa me qarte raporti i energjive qe duhen harxhuar per te mohuar anet e kalbezuara te shtetit, per te ribere pjeset e ndreqshme dhe sa energji duhen per te pare perspektiven. Vecse ky proces delikat dhe i veshtire duhet te jete i cliruar nga revanshi i drejtuar apo dhe spodan, por edhe nga precedenti i rrezikshem Berisha i perjashtimit nga ky proces i kundershutareve politike te trajtuar si armiq, apo dhe trajtimi i perspektives thjesht si mohim, ose e kunderta, te harrohet e kaluara ne emer te se ardhmes, apo te kompromentohet kjo e ardhme me praktika te tipit "jep doreheqjen se nuk te bejme gje"

Gjirokaster 19.08 97

PANAJOT BARKA

## **Nga Panajot Barka**

### **Precedentet “e trashëguara “ dhe reflektimi i tyre në situata aktuale**

25.08.1997

Para pak kohesh ne nje organ shtypi vihej re se, qe ne fillim te shekullit kur nisen perpjekjet per te instaluar shtetin e pavarur shqiptar, te gjithë eksponentet e politikës shqiptare jane detyruar te largohen nga vendi i tyre, kur kufijt qene te hapur dhe te kene nga nje varr ne vend te huaj. Ky fakt perben nje argument te plote te precedentit te trashëguar te intolerances dhe te inkonvergjences midis kundërshtareve politik ne jeten politike Shqiptare.

Ky precedent pati vazhdimin e vet ne periudhen e post komunizmit alla Berishe por me nje ndryshim thelbesor. Eshte e vertete qe ai perjashtoi, denoi, burgosi dhe syrgjinosi kundërshtaret e vet politike, por per vete edhe pse eshte shkaktari i nje tragjedie te vertete per popullin e vet, as u vetsyrgjynos e as u syrgjinos. Ai as ndjehet fajtor dhe pas revoltave te Jugut, duket se askush nuk do te perpiqet qe Ai te ndjehet fajtor, apo te pergjigjet per fajet e veta.

Nga ana tjeter ne Shqiperi precedenti “i trashëguar” i braktisjes se vendit kur dikush rrezikohet nga ligji apo njerezit e ligjit, ruan linjen e vet qofte ne aspektin e zyrtareve, qofte dhe te fajshmeve te rendomte. Ministra, bankierë, doganjere, drejtues te ushtrise, te policise, te SHIK-ut, dhe te korruptuar te tjere te te gjitha llojeve dhe rangjeve, pasi e perlyen vetem me faj gjejne strehim jashte vendit. Ne asnje vend te botes nuk ndodh nje fenomen i tille saqe te besh me ndergjegje faje dhe krime, madje teper te renda, ndaj shtetit dhe popullit e te behesh i pafajshem duke u larguar jashte shtetit, ose mbi kete faj te nderdosh lumturine personale diku ne nje cep te botes. Madje vet shteti i pajis ata me pasaporta diplomatike per t’u garantuar imunitetin nderkombetar.

Ne kete lloj braktisjeje konstatohet mungesa e seriozitetit persa i perket pergjegjesive individuale ndaj shtetit, dhe e kunderta mungesa e detyrimeve qe shteti duhet te instaloje ndaj individit nepunes i shtetit, apo i zakonshem kudo qofte ai.

Ky precedent rishfaq me insistim fenomenin shoqerues te kerkimit te vendeve te sigurta per parat ne formen e valutes. E ne rast se feudalet shqiptarë i fshihnin florinjte neper qypa prej balte e nen dhe, milioneret dhe miliarderet e rinj shqiptarë, kerkojne tani bankat e botes per te siguruar valutat e tyre te fituara me gjithfare menyrash. Skemat piramidale dhe ndryshimet politike ne vend si dhe burimet e ketyre parave i bejne poseduesit e tyre te ikin sa me larg Shqiperise bashke me to. Kjo do te thote se Shqiperia edhe pse e pasur ne kapital financiar te mos kete investime prodhuese dhe ne infrastrukture. Keshtu vendi yne ben edhe nje perjashtim tjeter. Eshte nje realitet i njohur qe shume nga manjatet ne bote pavaresisht se si i kane fituar parate e tyre, i kane vene ato ne sherbim te vendit te tyre duke i investuar ato. Keshtu, ky lloj kontributi, me kalimin e kohes u dha atyre nje qytetari nderi por edhe vendi i tyre eshte i fituar. Po te ndiqej e njejta rruge dhe tek ne, atehere mund te kene vlere dhe vilat shokuese dhe makinat luksoze dhe emrat e medhenj. Fatkeqesisht tek ne nuk ndodh keshtu, edhe pse dihet se zbutja e cdo lloj perplasjeje politike dhe kontrasti shoqeror vjen me perparim ekonomik.

Brenda kesaj, muajt e fundit pas sheshimit te cdo gjeje qe lidhet me egzistencen e shtetit po shfaqet nje fenomen i ri qe kerkon t’i kundervihet ketyre precedenteve te

trasheguara. Kete fenomen nje koleg para pak ditesh e quajti harrese per fajtoret. Eshte e vertete se ardheshit e rinj ne pushtet ne emer te frymes se pajtimit kombetar, te bashgezistences dhe te bashkepergjesive, kerkojne te aplikojne startim nga nivel zero duke harruar gjithcka qe lidhet me katapultzuesit e shtetit ne kete nivel.

Po te kihet parasysh egersia dhe makuteria me te cilen paraardhesit e tyre shkaterruan jete njerezish dhe vlera te tjera institucionale e materiale te individit dhe te shtetit, atehere duket qarte se kjo perben nje tendence kristjanizmi qe ia kalon dhe frymezuesit te saj, vete Krishtit Krishti si bir i Perendise kerkonte qe fajet njerezore t'i denonte Zoti, por kurre nuk thoshte te harrohen e te fillojme nga e para.

Kjo do te thote se pushtetaret e rinj ose jane idealiste te skajshem duke krijuar mundesi per nje precedent bashkefajesie, ose tolerojne fajin e djeshem ne kembim te nje tolerance te fajshme sot nga ana e opozites, pavaresisht nga verdikti e autoriteti i popullit.

Fakt eshte se nese vonesa per transparencen e skemave piramidale eshte e konsiderueshme, vonesa per te vene piken mbi i-ne persa i perket rrenimit total te vendit po merr trajtat i nje limiti te papercaktuar. Aq me keq kur ne procesin tranzitor drejt zgjedhjeve te Qershorit egzistojne skandale te tilla si ai i pasaporteve diplomatike dhe te sherbimit kur perfaqesuesit e te dyja paleve qe qeverisnin dje dhe sot gjenden pas tij dhe cudeterisht zyrtarisht sot nuk flitet per te gjetur fajtoret por “per te zvogeluar “ pasojat.

PANAJOT Per zotin BARDHI SEJDARASI BARKA Gjirokaster 25.08.97

Nga Panajot Barka

## **Çfarë synohet me harresën dhe fajesimin e Levizjes Popullore për Demokraci?**

17.09.1997

Ndersa ne shume vende, sidomos ne Lindje, perdorimi i termit “Do t’ua bejme si Vlora”, nenkupton mjetin ose menyren e permbyesjes se nje qeverie te padeshirueshme nga populli, ne Shqiperi ajo qe ndodhi nga marsi ne qershor te ketij viti, po shperfytyrohet ne permasa qe Kadareja do te thoshte, “te llahtarshme”. Ky shperfytyrim ndodh si ne aspektin studimor e historik shumeplanesh, ashtu dhe persa i perket ndikimit ne realitetin dhe zhvillimet aktuale.

Ndryshimi politik ne vend duket se perpiu gjithe rendesine e proceseve dramatike deri ne keto ndryshime, qofte dhe ne aspektin historik. Kjo ndodh per shkak se klasa qe perfitoi politikisht nga kjo Levizje, eshte distancuar edhe me shume prej saj. Kjo duket qarte, midis te tjerash, kur kjo klase politike po perpiqet t’i trajtoje perfaqesuesit e Levizjes dhe vet ate me mjete te harreses, Nje trajtim i tille ngre me lart tymnajen e ish pozites per lidhje te partive te kualicionit qeveritar me kriminele ose vet pozita krijon terren per t’u akuzuar si bashkefajtores.

Eshte e vertete se gjate periudhes se lulezimit te Levizjes Popullore per Demokraci, me dhjetra here u fol se kjo Levizje krijon ne thelb dimesioni e ri dhe real te shtetit me baza demokracine klasike Athiniote. Mirepo menjehere pas zgjedhjeve, krijimit te qeverise se re dhe fillimit te ngritjes se shtetit, asnje nga konceptet e kesaj Levizjeje nuk u perfshi ne strukturat e reja zyrtare. Perkundrazi u vu re se ne keto struktura parapelqyen nga LEVIZJA nje kategori njerezish qe e shfrytezuan praninë e tyrte në Levizje per nje karrige.

Nga ana tjeter si Komiteti Kombetar i Shpetimit Publik ne pergjithesi ose dhe Komitetet ne vecanti, pas perfundimit te rolit te tyre u shuan pa arritur te grumbullonin as dokumentacionin e veprimtarise se tyre dhe aq me keq dokumentacionin dhe faktet e tjera per shkaktores e tragjedise se rende te shtetit si institucion dhe te popullit si misherim i egzistences se tij..Perpjekja per te organizuar nje Qender te Perpunimit te Mendimit Politik dhe te Strategjise se Levizjes Popullore per Demokraci, ne funksion te nje angazhimi studies te ketyre proceseve aspak te thjeshta, nuk funksionoi, ashtu sic nuk po shkakton akoma ngacmime serioze per njerez kopetente, studiues, sociolog, politikane, ushtarake, njerez te drejtesise per t’u marre seriozisht, te pakten, si fillim, me grumbullimin e plote dhe sistemimin e fakteve. Po ashtu duhet thene se, roli i tyre nuk mbaron me zhvillimin e zgjedhjeve te Qershorit. Ai duhet te ishte kthyer ne nje organ qytetar denoncues para drejtesise te fajtoresve, rol qe nuk eshte kurre vone per ta luajtur, por duke shmangur spontanitetin, amatorizmin dhe pathosin

Po ashtu strukturat e reja shteterore nuk po krijojne akoma zyrtarisht nje organizem drejtesie te posacem ligjor per te hetuar dhe gjykuar ne gjithanashmeri fajtores e katastrofes se madhe. Heshtje per nje kohe kaq te gjate, per nje ceshtje te tille me mijra te vrare dhe shkaterrime kolosale, ne nje kohe qe jane ngritur komisione parlamantare per gjera krahasimisht te papeshe, i hap rruge te lire vetgjyqesise, heq mundesine per rivendosjen e plote te rendit dhe ringritjes se institucioneve shteterore, dhe ajo qe eshte me e keqja, krijojne precedente per zhvillime te ngjashme, per sa kohe egzistojne fenomene te ngjashme. (Le te mos harrojme se edhe komisioni i zotit Ngjela nuk ka fituar status ligjor per hetim. Ai vetem sa gezon imunitetin politik te deputetit) .

Ne kete kontekst, deklarata e Zhulalit, i sapo kthyer nga jasht ne lajmin e pare te televizionit shteteror se “Dosja e zeze e kesaj periudhe nuk do te zbardhet kurre” ishte sa provakative aq dhe domethenese. Kjo ben qe te jene te pavlefshme deklaratat sporadike ne shtyp apo dhe veprime te tjera per te denuar fajtorin kryesor apo dhe fajtoret e tjere. Nje qendrim i tille sjell gjithashtu ngaterresa shumeplanesh pers a i perket tezes se pajtimit. Shmangja e fajtoreve nga drejtësia sjell si rezultat demtimin ne menyre ciklike te pajtimit politik dhe civil.

Ne kete kuader do te ishte e pafalshme po te mos vinim re gadishmerine cuditshme te disa gazetave, madje dhe te medjes shteterore per te bere protagonist te intervistave dhe bisedave te gjata, njerez qe “kujtesa popullore “ i ka shenuar ne rreth te kuq. Duke i ndjekur me kujdes refimet e tyre vihet re stermundimi pakufi per te shtremberuar realitetin e zhvillimeve te asaj periudhe, (sidomos te pesembehjetditeshit te pare te marsit ku dhe egersia e shtetit te shprehur nepermjet tyre kunder popullit te Jugut arriti kufijt e operacioneve luftarake me perdorimin e LHL-ve) me qellim qe ata si persona dhe pushteti qe perfaqesonin te dalin te lare.

I gjithë ky shperfytyrim i Levizjes Popullore per Demokraci lidhet edhe me perpjekjen e po kesaj kategorie njeresh per ta ripagezuar ate here si ”rebelim”, here si ”trazira”, here si “kryengritje” e here si levizje te “bandave te kuqe”. Ne kete aspekt duke komentuar qendrimin pasiv te atyre qe administrojne sot zyrtarisht aspiratat e popullit per kete ceshtje, do te thoshnim se sa me gjate te vegjetoje ky pasivitet aq me i veshtire behet adresimi i fajit.

17.09.1997

Panajot Barka



31.10.1997

## PERGENJESHTRIM

Me indinjate teper te thelle jam i detyruar te pergenjeshtroj shkrimin ne gazeten "SHEKULLI" i dates 30.10.97 me tituj: " Studentet kunder Barkes", ne faqen e pare dhe "Ish deputeti Barka, kunder protestave te studenteve kosovare" dhe mbi tittull "Studentet fershellejne profesorin" ne faqen e katert te firmosur nga nje R B.

Une mora pjese ne tubimin e studenteve ne Gjirokaster te dates 29.10. 97 si gazetar dhe si pedagog dhe iu pergjigja kerkeses se drejtuesit te tubimit per nje prononcim, ne nje kohe qe pervec dy studenteve drejtues dhe dy pedagogeve te ndodhur ne salle me rreth njeqind veta, folen vetem dy studente Maqedonas. Ne prononcimin tim thash tekstualisht: " Pas shkurtit , kur ne u mplodhem ne kete salle per te ndermarre nje veprim te fuqishem politik dhe ia dolem mbane, mblidhemi perseri sot per te perkrahur nje te drejte legjitime dhe te pamohueshem, me bindje qe edhe ajo te realizohet. Kush mohon te drejten e tjetrit per arsim ne gjuhen amtare, kush mohon kulturen e tjetrit, individ apo shtet, mohon arsimin dhe kulturen e vet, pengon perparimin e tij dhe kthen shtetin e vet shekuj prapa ne Mesjete. Personalisht them se jo vetem thjesht duhen perkrahur protestat e studenteve ne Kosove, por duhet folur per realizimin e kerkesave te tyre". Kjo ishte deklarata ime e plote dhe jam krenar qe edhe nje here studentet e mi me duartrokiten. Mirepo dikush qe nuk donte qe Barka, si minoritar grek ne Shqiperi te deklaronte keshtu, dikush, me emrin R B, qe do te bej ndoshta diversion ne nje plan me te gjere i degjoi ndryshe fjalet e mia duke futur ne gracke dhe nje gazete e cila pretendon te jete serioze. Tani eshte detyre e saj dhe e drejta ime, dhe jo thjeshte si person, qe te vihet ne vend personaliteti im.

Me respekt  
Panajot Barka

## **Nga Panajot Barka**

### **Përvjetori i parë i nëntë Marsit, vërteton kompromisin politik kundër shtetit**

04.03.1998

Teksa vjen 9 marsi, nuk mund të mos veme re se platforma politike e popullit të armatosur pikerisht një vit më parë, për mënyrën e zgjidhjes së krizës së rëndë në vend, po vërtetohet kategorikisht. Intuita dhe logjika popullore e shikonte këtë zgjidhje në përjashtimin nga politika shqiptare të ish presidentit të vendit Sali Berisha, jo aq si individ se sa si fenomen i dale nga institucioni shtet të kontrolluar prej tij. Misioni i popullit mund të konsiderohej atëherë pa frikë e perfunduar. Ai de fakto e kishte shkullur Berishën nga fronti i tij dhe e kishte hedhur tej si të pavlefshëm për politikën Shqiptare, duke paguar për këtë vendi një haraç shumë të madh.

Politikanët e atëherëshëm, sot pothuaj në pushtet, të pa mesuar për të ndermarre veprime politike jashtë hijes dhe vullnetit të Berishes, e më në më ish presidentin, kështu të cmontuar dhe të braktisur, e risollen në skenë, me pretendimin e pajtimit dhe të ricmontimit të tij, por tani, pjesë-pjesë. Ndodhi e kundërta. Berisha filloi të montojë pjesët e cmontuara të tij me një temë më intensivë dhe në kahën destruktive.

Si po montohet Berisha. Së pari. Në emër të shkelejeve të parimeve të demokracisë dhe hapësirave të opozitës, të bashkejetesës dhe bashkepunimit, ai i bëri një rezistencë shumë të fortë, çdo përpjekjeje të pushtetareve të rinj në reformat legjislativë dhe administrative. Jo në pak raste Berisha ka arritur të kthejë ligje prapa apo dhe ka imponuar amendamente sipas vullnetit të tij. Në këtë mënyrë ai jo vetëm që u harxhon pozitë shumë kohë por edhe fiton të drejtën për t'i akuzuar për pa aftësi. Së dyti ka arritur të jetë i pranishëm i ditë për ditë në medjan shqiptare në përgjithësi dhe në atë shtetërore në vecanti duke përfituar me shumë terren se prania në parlament. Së treti nëpërmjet destruktivitetit të zbatuar në vijimesi, së bashku me kriminalitetin ordiner, veprimet të njëzëzve të vet në administratën shtetërore dhe kontrollit mbi pushtetin lokal, Berisha ka arritur të mbajë të ndezur tensionin dhe pasigurinë në vend për të bllokuar si rrjedhim edhe veprën e qeverisë që varet kryesisht nga ndihmat ndërkombëtare.

Një Berishë i tillë çdo ditë që po kalon duket se i duhet shumë edhe qeveritareve të koalicionit të majtë. Ata janë të ndergjegjshëm se për sa kohë nuk do të ketë një opozitë tjetër serioze dhe PD-ja do të jetë nën kontrollin e Berishes, në Shqipëri vështirë se mund të vihet në dyshë qeverisja e këtij koalicioni. Së dyti çdo pakenaqësi në çdo nivel të kampit të përkrasësve të qeverisë mund të shuhet lehtë duke servirur alternativën "Mire ikim në dhe mbani ju perseri Berishën". Së treti Berisha u duhet qeveritareve të rinj për të pasur vazhdimisht një objekt shurdh për t'i bërë thirrje për reagim, për bashkepunim e bashkejetesë, por edhe për të shkarkuar aty kur duhet gjithë fajet për shtetin që ende dërgjet i shtrirë dhe i paralizuar. Një sjellje e tillë mban ndezur konfliktin politik në vend dhe con në mbajtjen peng të politikës, drejtësinë nëpërmjet paragjykitimit të saj.

E ndërsa populli bëri aq shumë sakrifica dhe derdhi aq shumë gjak për të arritur realizimin e konceptit të vet për zgjidhjen e krizës, dmth për të detyruar Berishën të dorëzohet, ata që adaptuan politikën e pajtimit tregojnë sot se nuk janë të përgatitur për të sakrifikuar qoftë edhe pak kosto politik ose tolerancë për t'u pajtuar vërtet.

Pse ndodhi keshtu. Ndodhi se arkitektet e struktures politike te Shqiperise nuk gjeten askend tjetër me perjashtim te Berishes per rolin e opozites, se filozofia e gjithperfshirjes dhe e bashkepunimit te predikur nga pushtetaret e rinj, perben ne praktike nje adaptim i keq i parimit kristian “paqe dhe drejtesi”. Paqja u kthye shpejt ne nje predikim fals kur drejtesia krejt e paafte per te vepruar u kthye serish ne peng te politikës. Paqja e predikuar, ka ne thelb nje bashkejetese te papajtueshem per nje demokraci te vertete te aspiruar nga populli. Fjala eshte per autoresine e perbashket ne kontrabande, per shnderimin e korupsionit dhe te nepotizmit (i shprehur ky i fundit ne linjen e mirefilltë apo dhe përmes devoteshmerise partiake) ne mentalitet qeverises. Vet qeveritaret kane pranuar se kontrabanden e bejne po ata njerez qe e benin dhe dje, (kuptohet me ndryshimin se ndruan padrone), ndersa korupsioni eshte nje sekret qe nxin faqet dhe te shtypit me serioz perendimor, se ka rrenjet deri ne majen e piramides se qeverise. Riciklimi kaq I shpejtë i ketyre fenomeneve i heq te drejten morale qeveritareve te rinj per t’i dhene drejtesise fajtoret e djeshem gje qe i hap rrugen precedentit nga i cili vuajne qe pas luftes vende te tilla si Italia, apo dhe ne precedentit tjetër te tipit, Kolumbi.

Ketu i pakuptimte eshte roli I Presidentit te Republikës i cili edhe pse e di se vendit I duhet shteti, Ai shetit neper qytete e fshatra, duke predikuar ne vend te kesaj domosdoshmerie, shoqerine civile. Por shoqeria civile mund te zhvillohet kur egziston shteti. Qe te hidhen bazat e shtetit ne Shqiperi, eshte i nevojshem pajtimi politik. Dhe presidenti duhet te ndermarre inisiativa konkrete per kete, pa pritur qe t’i kerkojë dikush tjetër, apo partite politike qe t’i pajtoje. Po ashtu eshte detyre e tij te kerkoje dhe te kembengule qe te vihet ne levizje drejtesia. Pajtimi nuk arrihet duke bashkejetuar me fajtoret. Nje bashkejetese e tille e kthen Drejtesine ne shtojce te interesave te nje klani politik ne pushtet, rigjeneron krimin dhe vdekjen e shtetit. Rezultandja e gjithe ketij realiteti e ben popullin pasiv. I zhgenjyer nga fakti se rezultatet e Levizjes se tij te armatosur u keq administruan nga ish opozita, tani I duhet te preferoje edhe per pak kohe akoma, midis dy te keqijave, te keqen me te vogel.

PANAJOT BARKA

**Nga Panajot Barka**

## **Pushteti, kjo tepsi me thela mishi**

09.07.1998/ 14.07.1998

Pavarësisht nga deklaratimet e vazhdueshme për ngritjen e strukturave të shtetit, të gjitha parametrat tregojnë se ky shtet është ende viktimë e pushtetit. Ndryshimi nga një vit më parë është kahu i kundërt veprues që ka të bëjë me mungesën e gadishmerisë për ta ngritur atë. Në thelb shoqëria shqiptare vazhdon ecjen jo në bazë të ligjit por në bazë të ekulibreve të rregulluara në menyrë spontane nga vet shoqëria sipas parimit të përgjithshëm të luftës te së mirës kundër së keqës. Këto kategori të përhershme janë ravijezuar tanimë fare dukshëm dhe përfaqësohen e para nga populli dhe e dyta nga pushteti.

### **E KEQJA NJE VIJIMESI NGA PUSHTETI I BERISHES ME PAK DALLIME**

Cilat janë këto dallimet .Ndërsa PD-së iu desh një kohë relativisht e gjatë për krijimin e strukturave të korupsionit, kondrabandës dhe politizimit të shtetit, pushtetarët e rinj i gjetën këto struktura të gatshme. Ndërsa PD-ja aplikoi këto skema me synim të krijonte shtresën e vet shoqërore, pra në aparençë, kondrabanda, korrupsioni u bë fenomen masiv në të gjitha strukturat e shoqërisë dhe të shtetit, sot këto fenomene po kthehen në privilegj vetëm të segmenteve të pushtetit duke përfeksionuar kështu mafien shtetërore në ekonomi dhe politikë. Ndërsa PD-ja dje kishte një unitet në përpjekjen për të fshehur krimin ekonomik të organizuar dhe kishte kundërshtarë medjën dhe opozitën, pozita e sotmën e pranon atë hapur, por sipas aforismës, tradhetinë e duan të gjithë por tradheterët askush, ose të fajit jetim.

Ndërsa PD-ja dje sulmonte ashpër gazetarët dhe të gjithë ata që përpiqeshin të frenonin metastazat e kancerit kundër shtetit, PS-ja ndjek taktikën e heshtjes, sipas parimit qëntë lë të lehin karvani të eci përpara. Cinizmi i përseritur i Finos apo dhe i Malajt në deklarata të tipit po të jeni të zot na kapni me presh në dorë, tregojnë se pushtetarët e sotëm ndjehen të sigurt dhe se e kanë përfeksionuar sistemin dhe taktikat e korupsionit dhe të kondrabandës.

Nga ana tjetër abandonimi i praktikës së dorëheqjes, si akt civilizimi në politikë, tregon shkallën e ulët të përgjegjshmerisë kundrejt shtetit dhe shoqërisë dhe njëkohësisht shkallën e lartë të brerjes në një kohë tëpër të shkurtër të pushtetit. Pushtetarët e sotëm nuk janë të gatshëm për të dhenë dorëheqjen, por thonë se janë të hapur për t'u hetuar duke krijuar një rreth vicioz fajti, që kalon nga hallkat e mungesës së ligjit apo zbatimit të tij, tek mungesa e kontrollit dhe autokontrollit, ku qeveria i kerkon t'ia hedhi fajin drejtësisë dhe drejtësia popullit «që nuk denoncon». Në këtë kontekst, ndërsa PD-ja e shaktëroi shtetin duke kompromentuar më kontrabandën dhe korupsionin levat e tij, sidomos drejtësinë dhe rendin, pushteti I sotëm nuk po i vë në funksionim makinën e shtetit me qëllim që të kenë dorë të lirë pushtetarët.

Publikimi nga organizmat ndërkombetare i shkallës së lartë të korupsionit shtetëror dhe të kondrabandës tregon gjithashtu konceptin me të cilën drejtojnë pushtetarët e rinj. Pra ata e ndjejnë se janë të përkohshëm në atë vend dhe gjithcka që i kanë venë vetës si qëllim për të fituar duan ta fitojnë sa më shpejt që të jetë e mundur. Nga ana tjetër kjo ka ndezur më shumë përplasjet e brendshme, në Alencën për Shtetin dhe sidomos brenda PS-së ku aleancat dhe kundër aleancat kanë si bazë kryesore korupsionin dhe antikorrupsionin. Lufta e shpallur nga qeveria përbën një propagandë

për të joshur organizmat ndërkombëtar, se praktikisht kur nuk egzistojnë mjedisi i shendoshë politik, strukturat ligjore dhe steriliteti i shtetit në këtë luftë, nuk mund të luftohet as kontrabanda e as korupsioni. Ato vetëm stërhollojnë mënyra për të mbijetuar dhe për t'u bërë qëllim në vetvete dhe mentalitet qëverisës.

#### PD-ja dhe PS-ja DUHEN NË TË NJEJTËN LARTESI URREJTJEJE

Këto dallime, në mënyrën e njëjtë të qëverisuri, midis PD-së dhe pushtetarëve të rinj, ose Aleancës për Shtetin me në krye PS-në, plotësojnë më mirë idenë e të qenit dy anë të së njëjtës medaljeje. Pikërisht këtu, dhe jo tek sllogani «I gjithëpërfshirjes» për ndërtimin e shtetit dhe të vendit, duhet kërkuar arsyeja pse pushtetarët e rinj nuk dencojnë krimet e parardhësve të tyre, por kanë kthyer në peng të tyre prokurorinë, gjykatat, rendin. Kjo, kuptohet, përbën pjesën e një marrëveshjeje të heshtur midis tyre. Secila palë grumbullon fakte kundër tjetrës më qëllim që asnjëra të mos ngrihet kundër tjetrës. Kështu shpjegohet që opozita e sotme bertet pa fakte, ashtu si pozita bën propagandë me fajet e opozitës, pa asnjë veprim në emer të ligjit. Ky është I ashtuquajtura ekulibri I Asit në meng ndaj kundërshtarit. Fakt domëthenës konflikti publik Fino-Berisha. Sapo Finua, me tëpër vonesë dhe për interesa të brendshme të PS-së dhe të veta personale për t'u paraqitur si pishman hero tani që I tundin kartën e kontrabandës, e sulmoi Berishën dhe «kërkoj ndjekjen penale ndaj tij», Berisha nxorri Asin nga mënga kundër Finos. Bisedat e incizuara më të, në kohrat më të veshtira për vendin.

#### PARTIA SOCIALISTE DHE ANETARET E TJERE TE KUALICIONIT

Pas zgjedhjeve të pranueshme të qërshorit të vitit të kaluar kërkesa për një qëveri kualicioni me bazë të gjerë, ishte shprehje e formulës së servitur nga perendimi për vazhdimin e «pajtimit kombëtar» në kohë paqeje, pra si një mundësi për ndërtimin e shtetit. Kryeministri Nano e shprehu ndryshe këtë formulë me «filozofinë e gjithëpërfshirjes» Kualicioni në fakt ishte një hije e zbehtë e kesaj ideje, ku pushteti u konceptua si tepsi me thela mishi dhe meritokracia si derivat I gjithëpërfshirjes, u shndërrua në një politizim bajat I kuadrit, ose në përzgjedhje të këtij kuadri nga rrethët familjarë apo dhe në bazë të shërbimëve private ndaj pushtetarëve, duke mbajtur vazhdimisht si pikë referimi shëmbullin e PD-së.

Dy parti të këtij kualicioni, PSD-ja dhe PBDNJ-shi, po e kthejnë në profesion, të qenit kualicion, dy janë parti inegistente dhe PAD-ja u bashkua që t'i japi vlera qëverisë së re, por edhe pse nuk e duronte më gjatë rolin e opozitës, pra kërkonte me cdo kusht qoftë edhe pak pushtet. Tani që po e shikojne se anija e PS-së ka filluar në mos të fundoset, të lekundet seriozisht, sidomos PAD-ja kërkon të largohet për të bërë atë që u përpoqën, bashkë me PSD-në, në kohën e kryengritjes popullore, -të përfitojnë sa më shumë elektorat.

Nga ana e vet Partia socialiste erdhi në pushtet pa krijuar dot individualitetin e vet qëverisës. Ajo sic tha në konferencën e PS-së së Gjirokastrës një nga udheheqësit e saj të lartë, huazoi «të këqiat e Berishës dhe duam t'i imitojmë». Po ashtu, më të ardhur në pushtet, ajo pushoi të mirret me politikë dhe mirrët vetëm me pushtetin. Partia nuk mirret më me përpunimin e alternativave politike, nuk ka ideolog dhe një ideologji, por ka vetëm pushtet. Më e keqja është se përse I perket realizimit të premtimeve paraelektorale po e drejton pushtetin me mentalitetin e të qenit akoma opozitë. Ndërsa përse I perket favorëve të pushtetarëve po e drejton atë sipas huazimeve nga Berisha. Dallimi është se PS-ja zëvendësoi antikommunizmin e Berishës me

antiberishizmin. Drejtuesit e lartë të PS-së e konsiderojnë emancipim të partisë, pranimin e korupsionit, kondrabandës, rritjës së kriminalitetit, dhe I fajit në përgjithësi e kuptuar së e vë PS-në në pozita mëshire.

Metodat që përdorë ajo për të dalë nga situata , ose për të zgjatur të paktën stakuonë , janë dy. E para, tolerimi I patolerushëm, (nga halli) deri në paradoks të situatës konfliktuale në Parti. Brenda në PS, ka tani grupe e korrente që janë rrjedhojë si e përberjës së stërmadhe të partisë, ashtu edhe me qëndrimin ndaj Nanos si kryetar, por edhe me problemet e mbrehta që nxorri qëverisja e dobët e muajve të fundit, apo dhe ndërrimi drejt së djathtës, I kursit politik të partisë nga ana e qëverisë. «Unë degjojë kolegë në kryesi, tha Ruci në Gjirokastër para pak ditësh, që kritikojnë PS-në me keq se PD-ja». Kjo tregon se situata brenda në PS është më se shpërthyes dhe më sa duket pritët orientimi I shpërthimit. Praktika e deritanishme në politikën Shqiptare ka treguar se shkëputja nga Partitë e mëdha për krijimin e partive të vogla është e dështuar. Ndaj dhe mësa duket grupimet brenda në PS kanë vendosur ta sfidojnë nga brenda udhëheqjen aktuale. Këtë proces, duket se nuk e ndalë as edhe metoda e dytë që aplikon Nanua përfshirjen në pushtet të kundërshtarëve të tij.

Po ashtu nuk mund të mos vihet re qëndrimi ndryshe dhe kundër I institucionit të Presidentit ndaj qëndrimëve të qëverisë dhe vendimeve të saj dhe në përgjithësi ndaj partisë që e bëri president.

Kjo ka bërë që partitë e vogla të kualicionit, të cilat PS-ja është e ndërjegjshme se përbëjnë pasaportën e vet në Perendim për marrjen e pushtetit, të gjenden në udhëkryq. Qëndrimi më I gjatë në krahë të PS-së, tani që drejt asaj arrijnë shigjeta nga të gjitha anët, shton rreziqët e kombrometimit më fajin ose të asimilimit të vlerave të veta nga partia më e madhe ,PS-ja gjë që con në heqjen e perspektivës së tyre për t'u bërë parti me peshë në politikën shqiptare. Nga ana tjetër, embëlsia e pushtetit për anëtarët e këtyre partive në poste të ndryshme ose e bën të pamundur tërheqjen nga kualicioni, ose I rrezikon partitë e kualicionit me përcarje.

### PS-ja KËRKON ALIBI

Në kushtet pra, kur qëveria e PS-së , edhe pas një viti nuk ka arritur të vendos autoritetin e vet në të gjithë Shqipërinë, (Kryeministri, p.sh nuk shkon dot në Veri, ose edhe në Jug, si në Vlorë) , udhëheqja e lartë e PS-së për të zgjatur qëndrimin e vet në pushtet përdorë tri mjete të tjera, që janë Kosova, Berisha dhe Populli.

PS-ja po e përdorë Kosovën, krahas preokupacionit të detyruar, në dy drejtime kryesore. E para, me qenrimet e veta kërkon kredibilitet në Perenim duke iu përshtatur bindshëm skemave të tij dhe së dyti kërkon të varri xhaketën e vet në strukturat e NATO-s, sidomos përse I përket frikës së destabilizimit të situatës së brendshme. Dy herë zyrtarisht vet Fatos Nanua e deklaroi një pozicion të tillë

Faktorin Berishë udhëheqja e lartë e PS-së po e përdorë se pari, si gogol, për të trembur elektoratin të mos I iki nga ndikimi I vet .Mëse një herë në fushatë e fundit elektorale, PS-ja nuk paraqiste tek zgjedhësit alternativa politike për zgjidhjen e krizës ne vazhdim në vend , por kishte nxjerr nga xhepi I pasëm akuzat ndaj Berishës. Po s'na votuat ne , thoshte kudo dhe pa tekflif Pandi, atëherë mbajeni edhe një herë Berishën . Kjo pra tregon edhe një herë se PS-ja është në krizë alternativash dhe e mbush këtë boshllëk duke e mbajtur kokën prapa.

Së dyti Partia Socialiste e përdorë Berishën cdo herë që I duhet për të zbutur situatat shpërthyes brenda në Parti. Kur rritet ky presion nga ana e bazës, por sidomos nga ana e bllokut të madhë të deputetëve të cilët ose nuk shijojnë pushtet ose nuk mund të pajtohen sinqerisht me situatën , ose duan të provojnë egzistencën e tyre për vete dhe para elektoratit, udhëheqja e partisë u lëshon «për të shqyer Berishën» Kur ata I

nxjerrin Berishë brinjët, eksponentë të partisë dalin dhe thonë, se «Berisha nuk mund të denohet, ne jemi për pajtim ,etj etj.Thelbin e këtij mentaliteti e precizuan në Gjirokastër dy anëtarë të kryesisë së PS-së kur u thanë simpatizantëve të tyre se e patë, ne parlament ua bëjmë qejfin, e grimë Berishën , por ne do t'i bëjmë Berishës vetëm gjyqin moral(!). Ose Nanua është e vertetë se nuk do ta fusë Berishën në burg, por kryetari ynë do të fus në burg kriminelet.

Se treti, kjo taktikë perdorët se fundi për të terhequr vemendjen e opinionit publik nga skandalet e larta të pushtetarëve.

Reagimi in extremis nga ana e PD-së në diktatin e Berishës nuk ishte gjë tjetër vecse vertetim I idesë se PD-ja është ana tjetër e medaljës së PS-së. PD-ja kërkon riafirmimin real në politikën shqiptare gjë për të cilën ndergjegjësohet se nuk mund ta arrijë me udheheqës të diskrituar. Në kushtet pra të përpjekjeve të brendshme edhe në PD për riafirmimin të vertet, grupi I udheheqësve të rrezikuar për t'u shmangur nga Partia, pse jo edhe për t'u denuar , I imponon pjesës tjetër masa të tilla, si largimi nga parlamenti, për të siguruar një unitet mbi këtë bazë bojkotimi. Kjo ndodh edhe në kushtet e nxitimit nga ana e PS-së për t'i thenë PD-së «Na falni nuk iu bëjmë gjë por duhet t'i qëtesojmë këta tanët dhe të mos I lemë të shikojnë nga korupsioni». Sido që të jetë si njëra ashtu dhe tjetra , ajo që u intereson është marrja e pushtetit për ta administruar për vete duke harruar se pavarësisht nga reagimi I momentit përballë po u pozicionihet populli.

#### FAKTORI POPULL DHE LINDJA E NJE BREZI TE HUMBUR TE SHQIPTAREVE.

Nanua thotë se populli është I lodhur nga demonstratat dhe revoltat,. Ai, thotë Nanua, e provoi faturën e luftës dhe nuk është I predispozuar të ringrihet prap.. Nanua arsyeton kështu edhe pse nga ana tjetër ngul këmbë së NATO-ja duhet të vij në Shqipëri se «rrezikohet stabiliteti I brendshëm I vendit.»

Kjo ide e tij e gërshetuar më atë se populli nuk e do Berishën e ka bërë atë që të hazdiset në livadhet e pushtetit dhe ta lerë jetim shtetin. Vetkontrolli që ai dhe partia e tij kerkojnë të aplikojnë është I pamundur në kushtet e mungesës së kontrollit nga ana e opozitës,në kushtet e mos veprimit të ligjit, në kushtet e mënjanimin të shtypit qoftë edhe duke mos reagur ndaj kritikës së tij , në kushtet e inegjistencës se OJQ, mëgjithë harxhimet e Perendimit për to, në kushtet e zhgënjimit popullor si garanti kryesor I demokracisë.

Ky zhgënjim solli si pasojë që njërezit e ndërshëm dhe të gatshëm për të sakrifikuar në emer të idealit për shtetin të ndjehën të tepërt në shoqëri. Ky zhgenim shfaqet në mos besimin e popullit ndaj shtetit dhe në kërkesën e vazhdueshme të tij ose për të gjetur ekulibre të tjera, ose për t'u larguar nga vendi. «Rasti I Fundit» aq I përfolur për të ardhmën e Shqipërisë dhe pamundësia e pushtetarëve të rinj për të përpunuar një ideal mbarëpopullor për të ndërtuar shtetin , prodhon nga ana tjetër një «brez të ri të humbur në Shqipëri». Themë të ri se që në fillim të shekullit Shqipëria prodhoi disa të tillë dhe vazhdimisht në emer të idesë së një shteti që ta administrojnë njërez të aftë dhe të ndershem që nuk do ta vjedhin e shkatërrojnë atë. E përbashkëta e tyre është se me një mënyrë apo më një tjetër ata ikin nga vendi.Dallimi midis tyre është se anëtarët e brezit të humbur që po krijohet në Shqipëri nuk janë të qëndrueshëm në idealët e tyre .

Mihal Grameno është përfaqësuesi më I spikatur I brezit të humbur të shqiptarëve të fillimit të shekullit Ai u ndje I tëpërt kur pas një jetë të terë lufte me të gjitha mjetët në emer të krijimit të një shteti të përparuar, pa në drejtimin e tij «Honxo mboxhot»,. Nuk pranoi asnjë shpërblim për luftën e tij dhe vdiq kafenëve dhe rrugëve.

Idelaët në emer të shtetit të njerëzve të sotëm thyhen lehtë para tundimit të kockave që po u hedh pushteti . Dhe dihet që pushteti do të ketë aq kocka , aq sa shoqëria do t'i besojë vlerat e veta këtij pushteti. Këtë mentalitet duket se e ka kuptuar dhe Fatos Nanua I cili përpiqet që të gjithë njerëzve që kanë manifestuar qëndrueshmëri dhe vitalitet në përpjekjet për parimet demokratike të shtetit, « përfshihen « nga ai në pushtet.Kështu ai krijon për vete një etiketë mbrojtëse por nga ana tjetër shkatërron çdo bërthamë idealistësh për shtetin. Njëkohësisht ai u edukon këtyre njerëzve fatalitetin politik që midis dy sistemeve të këqija të zgjedhin atë më pak të keq dhe jo të aspirojnë për një sistem perfekt vlerash demokratike.

Në këtë prizëm Alenca për Shtetin bëri sikur nuk e kuptoi defektin e madh që I shkaktoi në një kohë kaq të shkurtër demokracisë në vend. Në analizën që I bëri fitorës së zgjedhjeve të pjesshme lokale 55% të elektoratit rezultoi se nuk ka besim më tek politika, nuk është I gatshëm për asnjë lloj sakrifice në emer të luftës politike të këtyre partive ashtu sic nuk duan t'u besojnë më që vlerat e veta t'i administrojë pushteti I këtyre politikanëve.

Analiza e metejshme thotë se 35 parti politike në vend kontrollojnë tani vetëm 45 % të elektoratit shqiptar. Më shumë se gjysma është e lirë, por jo indiferente. Kjo kategori, se bashku me ata më të durueshëm, me ata që për hir të shpresës pranojnë rritjen galopante të cmimeve,etj, do të vijë momenti që t'i kërkojnë serish hesap pushtetit për fajet e tij. Kësaj here do të kërkojnë këtë hesap përmes një udhëheqje të organizuar politike.Pra është mëse e qartë që popullido të përballët tanimë me pushtetin politik pasi të këtë krijuar një materie të re politike. Kjo materienjë forcë e re politike sipas parametrave të aspiratave demokratike të popullit,ashtu si mund të jetë produkt I procesëve afirmuese në të dy partitë kryesore të vendit e vecanarisht në PS.Nevoja për këtë formulë është pëmanente ashtu si bazat e një platforme të re politike janë tani mëse të qarta. Ristrukturimi I shtetit , rikthimi I autoritetit të drejtësisë, rivendosja e rendit shkatërrimi I strukturave që e detyrojnë shtetin të funksionojë me mentalitetin e korupsionit dhe kontrabandës

PANAJOT BARKA 09.07.98 u botua më 14.07.98



## **Nga Panajot Barka**

### **TROJKA ne Tiranë: Paqja që rrezikon perspektivën e shtetit**

20.09.1998

Vizita e Trojkës Evropiane të Shtunën në Tiranë edhe pse deshtoi tregoi se perendimi nuk është i interesuar fort që këtu të ketë një shtet dinjitoz. Duke kontribuar për institucionalizimin e këtij precedenti vet komuniteti ndërkombëtar, tregon se më shumë është i interesuar që në këtë vend të ketë qetësi, me pak demokraci, me pak shkelje të drejtash të njeriut, me pak shtet, ku politikanët e përzgjedhur prej tyre të lihen të vjedhin, të mashtrojnë e të korruptohen me qëllim që t'i heqin kur të duan, se sa është i interesuar për ngritjen e një shteti dinjitoz. Këtu nuk bëhet fjalë vetëm për faktin se nuk kishte me vete «një zgjidhje politike», porse, duke kërkuar që të respektohen propozimet e saj, cilatdo qofsin ato, pengoi edhe një herë rrjedhën logjike dhe në bazë të ligjit që kishin marrë ngjarjet në vend pas votimit në parlament për heqjen e imunitetit të Sali Berishës. Kështu përpjekjet e shtetit për t'u ngritur sadopak në kembë në atë segment që quhet drejtësi, iu nënshtruan serish formulave të pakuptimta të Perendimit për realitetin tonë. Njëshat e politikës tonë janë thjeshtë rrypa transmesioni i këtyre interesave.

Kështu deklarata e Nanos bërë në takimin me Trojkën Evropiane të shtunën, se Komuniteti Ndërkombëtar «të mos provokojë shqiptarët me formula të paqëndrueshme të cilat janë provuar se cenojnë stabilitetin dhe ardhmerine e vendit», tregon se Kryeministri shqiptar e ndjen vetën se nuk përfshihet në formulat e pritshme nga Perendimi për zgjidhjen e krizës së re shqiptare. Po ashtu tregon se qeverisja e tij e deritanishme ishte produkt i zbatimit të formulave të këtyre standartave të cilat edhe njëherë deshtuan. Ndoshta këtë Nanua e bën si një përpjekje për t'i shpetuar kërcenimit të gjithanshmë për postin e vet. Në veprimet e tij ka aq gadishmeri ndaj Perendimit sa që bëhet gati të kthejë faqën tjetër pas goditjes që Berisha i dha më 14 shtator. E keqja është se Nanua, si dhe gjithë politika shqiptare, kthen faqet dhe shuplakat i ha populli..

Kështu Kryeministri shqiptar lëshoi ultimatume të cilat, pas ndërhyrjes së Perendimit, e vune në shumë veshtiresi për të justifikuar moszbatimin e tyre. Foli për grusht shteti duke treguar dhe organizatorët dhe mënjëherë, pas zylëve të telefonave që «flasin në gjuhë të huaj», kërkoi të mos denohen fajtoret.

Perendimi gjithashtu konsideron si shenjë të çtensionimit të situatës ndryshimin e masës së sigurisë nga qelia në shtëpi edhe për katër ish drejtuesit e lartë të qeverisë së PD-së të akuzuar për krime kundër njërezimit (!) dhe njëkohësisht deklaratën e Prokurorit të Përgjithshëm se heqja e imunitetit të Sali Berishës nuk do të thotë mëdoemos arrestim të tij ... (Thjesht «do të hetohet edhe mbi Sali Berishën»), -thotë Kryeprokurori duke krijuar kështu premisa për rezimin e akuzës se të qenit Berisha organizator i kryengritjes së armatosur).

Në këtë situatë pozita, e justifikuar nga «diktati» i Perendimit bën sikur nuk kupton se ky realitet kompromenton keqazi pikësëpari çdo përpjekje për të ndërtuar shtetin ligjor dhe nga ana tjetër demoralizon ato struktura të shtetit që e garantojnë mbrojtjen e tij nga veprimi i krimit. Fenomeni është shumë herë më i dëmshëm kur është pasojë e drejtpërdrejtë e ndikimit të Perendimit, i cili me dashje apo pa dashje për tetë vjet është kthyer pothuaj në faktor aktiv e vendimmarrës për politikën e brendshme shqiptare .

Fakti që për hir të «çtensionimit të situatës» njërez të akuzuar për krime lufte pas një muaj burgimi «do të hetohen në gjendje të lirë», apo njërez të akuzuar për organizim kryengritjeje të armatosur, thjesht «do të hetohen», e nxjerr drejtësinë jasht

binareve të funksionit real brenda shtetit ligjor duke e kthyer atë në funksion të politikës.

Njëkohësisht «shqëtësimi» i Perendimit për situatën në Shqipëri dhe kohëzgjatja për të gjetur formulën e «zgjidhjes me mjete paqësore të krizës», demoralizon strukturat e policisë» Morali i tyre është e vërtetë se ndjek kurbën e veprimit të shtetit ndaj inspiruesve të krimit. Por në rruajtjen e rendit, në kushtet e funksionimit për shkak të inercisë së shtetit, më shumë ato veprojnë për hir të dinjitetit si grup, apo dhe si individ dhe për të shmangur hakmarrjen e krimit ndaj tyre, se sa si detyrim shtetëror.

Duhet theksuar gjithashtu se këto ndërhyrje e shtuan së tepërmi hutimin në kampin e socialistëve dhe të kualicionit qeveritar pas 14 shtatorit. Kryeministri shfaqet pas 48 orësh zhdukjeje misterioze në televizion, jep një konferencë shtypi provokative dhe pastaj për tre ditë të tjera nuk bëhet i gjallë për popullin. Partia Socialiste është po ashtu inegzistente duke provuar edhe ajo më mënyrën e vet paaftësinë e Kryeministrit për të drejtuar dhe partinë.

Nga ana e vet Berisha është në sulm. Po në ditën e vizitës së Trojkës në Tiranë Keshilli Kombëtar i PD-së mori vendimin e krijimit «të Frontit të refuzimit të diktaturës», të shkëputjes «se çdo lloj lidhjeje me instancat e Nanokraturës». Kjo taktikë me elementë gjithëformshe destruktive dhe jo vetëm nga pozicioni i opozitës, për Berishën mbetet me produktive për të qenë faktor në jetën politike shqiptare. Përbën njëkohësisht, mënyrën më të mirë për të ngjeshur rreth vetës atë pjesë të PD-së që kërkon ta përdorë Berishën si mburojë ndaj veprimit të drejtësisë, kontigjen ky që Berisha nga ana e vet kërkon ta përdor si çekiç për të kërcenuar «për shpërthim të një vale të re dhune në vend». Madje realiteti disa orësh i 14 shtatorit ku Berisha riprovoi fare nga afer shijen e pushtetit dhe fakti që strukturat e sigurisë së shtetit të ndërhuara nga qeveria e Nanos ishin pothuaj inegzistente, përbëjnë për Berishën një endër dalldysese.

Në raportet e treguara më lartë duket se vendi është peng i destruktivitetit të Berishës, ndërsa paaftësia e qeverisë për të dënuar dhe eliminuar këtë fenomen kërkon të justifikohet me recetat që jep perendimi, të cilat në thelb përbejnë një mburojë për Sali Berishën.

Kjo mburojë nuk lidhet, siç e thamë thjeshtë me faktorë të brendshëm. Kështu ata që në fakt përkrahin Berishën me preteksin se mund të përseritet marsi i 97-ës, gabojnë rendë ose qëllimisht abuzojnë. Marsi i vjetshëm me situatën e tanishme kanë një dallim thelbesor. Ngjarjet e vjetshme u gjeneruan nga populli dhe i administroi me vonesë opozita. Ndërsa në situatat e tanishme populli është një spektator asnjëherë që provon fatkeqësisht shijën e hidhur të krizës së gjeneruar nga politika. Popullin domosdo që nuk e ka me vete Berisha, por përkrahjen e tij nuk e ka as pozita e cila e zhgenjeu popullin në aspiratat për të cilat ai aq shumë sakrifikoi. Kështu që as përseritje të ngjarjeve të marsit nuk ka, as lufte civile s'ka, as përplasje jug - veri s'ka.

Por as vale terrori nuk mund të ketë, n,q,s shteti tregon qofte dhe në minimum forcën e vet. Në harkun kohor të disa muajve dhe vecanarisht 14 shtatori treguan se kur shteti vepron, shkelësit e ligjit futen vrimave ose zhduken jashtë shtetit. Tani para kërcenimit të shtetit se do të qellohet pa paralajmerim kundër cilitdo që do të shkel ligjin, ithtarët e Berishës midis jetës dhe premtimëve për poste e para, zgjodhën jetën duke i rralluar rradhet e tij.

### **Rreziku i vetëm mbetët terrorizmi i importuar**

Faktikisht, Fatos Nanua duhet të paguajë tani paaftësinë e manifestuar për të plotësuar angazhimet ndaj partnereve perendimorë dhe në planin e brendshëm, paaftësinë për të ngritur shtetin, për të goditur krimin e organizuar, kondrabandën dhe

korupsionin, duhet të paguajë për mungesën e seriozitetit në qeverisje, për çorientimin e Partise dhe zhgënjimin popullor.

## **Nga Panajot Barka**

### **Oktapodi i krizës shqiptare, Perendimi – rajoni dhe terrorizmi**

21.09.1998/23.09.1998

Pavarësisht se Sali Berisha kërkon t'u mbush mendjen shqiptarëve dhe botës se vetëm atij i takon ta udheheq këtë vend, të gjithë janë të bindur se kjo gjë nuk duhet toleruar më. Megjithatë midis faktorit ndërkombëtar dhe atij vendas ka një dallim. Faktori politik i brendshëm dhe vecanërisht në menyrë masive populli, kërkon mënjanimin e Berishës nga politika jo thjesht për të shmangur praktikën konfrontuese në politikën e Berishës, por edhe për t'i hapur rrugën procesëve rinovuese brenda Partisë Demokratike duke e çliruar atë sidomos nga elementët fanatikë e të inkriminuar që devotshmerinë ndaj Sali Berishës e lidhin ose me përfitime personale, ose për t'u mbrojtur nën hijen e tij. Ky proces në PD, kuptohet që do t'i hapte rrugën edhe procesëve spastruese edhe në kampin e pozitës, duke e çliruar politikën shqiptare nga protagonistë të tillë që e nënshtrojnë atë ambicjeve vetjake

Faktori ndërkombëtar tregoi dhe në rastin e 14 shtatorit se është I predispozuar për ta mbajtur Beridshën në skenën politike shqiptare, madje duke ushtruar diktat diplomatik mbi strukturat e shtetit, me pretekste të tilla «të shqëtësimit për përseritjen e marsit të 97-ës, për luftë civile, për destabilizim të vendit etj» Vetëm se kësaj here me një paralajmërim serioz se do të izolohet po të ndjek të njejtat taktika konfrontuese.

Perendimi e bën këtë edhe pse e kupton dhe e di që ngjarjet e marsit gjeneruan nga populli dhe jo nga politika, aq më keq nga politikanë të militarizuar. Mban këtë qëndrim edhe pse e njeh dhe e sheh se Berisha nuk e ka popullin me vete; edhe pse e di që njerëzit e armatosur të Berishës e braktisin atë mënjëhërë sa vepron shteti. Rreziku i vetëm egziston tek terrorizmi i importuar dhe i paguar, gjë që e ben më të domosdoshëm frenimin ligjor të Berishës. Në rast të kundërt ka rrezik që, duke qenë se konflikti kohët e fundit shfaqet në trajta krerësh e klanësh, duke qenë se populli i zhgenjyer ka hequr dorë nga përkrahja për Nanon dhe se shteti «pengohet» të veprojë, ka rrezik pra që edhe Nanua të detyrohet të përdorë të njëjta metoda për të mbrojtur postin e tij, duke vertetuar kështu teorinë se shteti në Shqipëri drejtohet nga klane dhe banda që rrenjët i kanë tek korupsioni, kontrabanda, trafiket e paligjshme.

Një gjë tjetër që vihet re në faktorin ndërkombëtar janë pozicionet pro dhe kundra faktorit Berisha. Kjo ndodh pasi Berisha arriti në karrierën e vet politike të personalizojë tek vetja, si shtetin shqiptar ashtu dhe Partinë Demokratike, kështu që edhe flijet pro dhe kundër të interesave të faktorëve ndërkombëtar në Shqipëri dhe në rajonin më të gjerë të lidhura pazgjedhshmerisht me faktorin shqiptar, të kalojnë edhe tek personi i tij.

Ky është edhe kuadri përcaktues i zhvillimeve të fundit ku deri tani duket se kapërcyem fazën e pasojave nga tensionimi i mosmarreveshjeve të faktorit ndërkombëtar që vepron në rajon. Terbimi i Berishës për pushtet përbën në fakt jo thjesht shfaqjen e tyre por edhe parametrat e këtyre pasojave

Fakt është që pas 14 muaj qeverisjeje, tolerimi i Berishës mori fund edhe për Fatos Nanon kur filluan të prekeshin në mënyrë të patolerueshme interesat e përkrahësve kryesorë të qëverisë së socialistëve, amerikanëve. Përplasja filloi pikërisht me arrëstimin e gjashtë ish funksionareve në qeverinë e Partisë Demokratike. Ata dhe sigurisht shumë të tjerë pa permendur përkatësi partiake, meritojnë bankën e të akuzuarve për ngjarjet e vjetshme, por të gjitha gjasat tregojnë se arsyet e arrëstimin janë më të thella. Arrëstimet ndodhen pikërisht atëhere ku jeta politike shqiptare, me shumë

se çdo herë tjetër tregonte shenja afiniteti dhe tolerance të admirueshme sidomos në çeshtjen e kushtetutës. Po ashtu emisarë të lartë nga SHBA dhe Gjermania vinin në Shqipëri për të ulur në takim historik dy të medhenjtë e politikës (por më të medhenj njihen si kundërshtarë),-Nanon dhe Berishën. Arrestimet gjithashtu u bënë pak orë pasi Fatos Nano foli në qeveri për situatën në Kosovë, (nëvizojmë se është momenti që UÇK-ja zgjedh për përfaqësues politik Adem Demaçin, njëriun e Berishës dhe jo Ibrahim Rugovën, njëriun e Amerikanëve), për masat për përballimin e situatës destabilizuese në vend sidomos në rajonet verilindore, dhe për luftën kundër terrorizmit. Kryeministri shqiptar ishte i vetmi nga politikanët Perendimorë që dilte hapur, me veprime konkrete në krahë të amerikanëve në këtë çeshtje, (ndërsa opozita shqiptare i konsideronte alibi të qeverisë për të terhequr vemendjen «nga kriza».) E tregojnë disa operacione të policisë së Tiranës në bashkëpunim me CIA-n kundër bazave të terroristëve islamikë në kryeqytet.

Fatos Lubonja dhe jo vetëm ai, në një analizë të po atyre diteve, mundohet të koncentrojë logjikën e gjerë të zhvillimeve të reja në vend me një fjali të vetme. Thotë ai për arrestimet. «Nuk përjashtohet mundësia që të jenë gjetur prova që kercenimet e ambasadës amerikane kanë lidhje me PD-në apo prova lidhjeje me terroristët islamikë ashtu sikurse dihet aktiviteti destabilizues edhe në qëndrimet për Kosovën»

Kjo do të thotë që pas Afganistanit ku amerikanëve iu kthye në bumerang (i shprehur në terrorizëm kundër tyre) përkrahja e talebanëve për të ardhur në pushtet, Shqipëria ishte vendi tjetër ku amerikanët duhet të paguanin tolerimin dhe përkrahjen e Sali Berishës dhe të qeverisë së PD-së në lidhjet me botën islame dhe depërtimin e terroristëve islamik në Shqipëri.

Nga ana tjetër dihet shumë qartë se Sali Berisha ka influencën e vet në një pjesë të UÇK-së por edhe është inspiruesi kryesor i radikalizimit të situatës në Kosovë, me qëllim pavarësinë e saj. Kjo situatë që përkrahej me mjete, ndoshta dhe për qëllime të ndryshme, me shumë nga bota islame se sa nga Tirana zyrtare., kuptohet që në thelb nuk u pelqen amerikanëve. Problemi nuk shtrohet se amerikanët janë kundër pavarësisë së Kosovës dhe Gjermanet apo evropianët pro saj. Qëndrimi i komunitetit ndërkombëtar në këtë çeshtje është pak a shumë i unifikuar. Çeshtja është se UÇK-ja me krahun politik të përfaqësuar nga Demaci nxjerr jashtë loje, strukturat që lidhen me Ibrahim Rugovën, pra me ndikim amerikan në Kosovë, gjë të cilën amerikanët, pas Dejtonit, nuk do ta dëshironin, ashtu si dhe «kundërshtarët» e tyre nuk do të dëshironin të kundërtën

Po ashtu Sali Berisha njihet për koncesionet ekonomike që i beri Gjermanisë pas prishjes me amerikanët me 1995-96. Burime të besueshme shtypi bëjnë të ditur se nëse gjermanët fillojnë shfrytëzimin e minierave të kromit shqiptar, atëherë industria e tyre e luftës fiton një shekull pavarësi. Kuptohet që amerikanët si përkrahesit kryesorë të koalicionit qeveritar shqiptar nuk do të praninin kurrsesi definicione të tilla për mineralin që e klasifikon Shqipërinë në vendet e para në botë.

Gjithashtu strukturat e Berishës kishin paralejmeruar se shtatori do të që muaji «i përmbysjes së qeverisë së Fatos Nanos».Kjo donte të thoshte se rrezikohej edhe influenca amerikane në Shqipëri. Njekohësisht amerikanët kishin hapur front me terrorizmin islamik.Ky terrorizëm është i pranishëm në Shqipëri, madje me një prani korelative në një rajon me të gjerë, që lidhet gjithashtu, direkt dhe indirekt, me interesat e SHBA-s .

Kështu situatën në favor të amerikanëve në rajonin kyç të pjesës jugore të Ballkanit, Kosovë, Shqipëri, Mal I Zi, Maqedoni e kishte në dorë qeveria e Tiranës. Arrestimi i të gjashteve, sipas kongluzionit të zotit Lubonja, ishte një veprim që do të mund të çonte në frenimin e Berishës në rolet e përmendura më lartë. Njekohësisht,

inisiativa nga qeveria e Tiranës, për të goditur terrorizmin Islamik (edhe pse për Shqipërinë përbente rrezikun që ta përfshinte atë në vorbullën e goditjeve nga ky terroirizëm), u jipte mundësi shërbimeve sekrete amerikane të vepronin nën një mbulesë jo kompromentuese.

Mirëpo, momenti i arrestimit u sfrytezua nga Berisha si preteks për të hapur duelin me Nanon. Që në momentin e parë u duk qart se legjitimiteti i Nanos nuk ishte i mjaftueshëm për ta mbajtur në këmbë. Strukturat e shtetit të ngritura nga Fatos Nano ishin shumë të dobëta për t'i rezistuar mllëfit për pushtet të Sali Berishës, gjersa më 14 shtator, për disa orë rresht Berisha bertiti «fitore-fitore» dhe e pa vetën, sipas shtypit, në krye të «Komitetit për Shpëtim Kombëtar».

Edhe pse grushti i deshtuar i shtetit, mund të duket në rastin më të keq, si një skenar i vetëm që të dy palët e lexuan sipas interesave të veta, edhe pse Nanua gaboi tragjikisht dhe moralisht humbet të drejtën për qeverisur, prapseprap, ai që duhet të përgjigjet para ligjit është Sali Berisha.

Por pragmatizmi amerikan dhe skematizmi diplomatik Evropian e mbajnë atë serish në këmbë. Trojka Evropiane të shtunën e kaluar në Tirane duke mos patur një formulë adekuate me natyrën e krizës Shqiptare u detyrua të përdorë skema standarte parimesh të përmbledhura në termin «dialog». Në emer të këtij skematizmi, perendimi filloi të ushtrojë presion mbi strukturat e shtetit madje deri tek organi ligjvënës duke kërkuar nga ato të mos respektojnë as logjikën e gjerave as ate të ligjit. Kështu vet ata kthehen në faktorë të krijimit të precedenteve të nënshtrimit të ligjit dhe shtetit nga politika apo interesa të tjera.

Amerikanët që këmbënguljen për rrezimin e tij nga pushteti më 1997 e kthyen në luftë të një opozite ndërkombëtare për të, nuk e mënjanuan nga politika, e para se investuan shumë dhe për vite me rradhë për Berishën politikan, dhe e dyta, partneret e rinj të Berishës pranuan atëherë humbjen e pushtetit prej tij, por jo dhe eliminimin nga politika.

Tani që Berisha tregoi se është i fortë për të përmbysur çdo gjë, por shumë i rrezikuar nga ligji, intuita e pragmatizmit amerikan duket se u dikton atyre t'i ofrojnë ndihmë Berishës, për ta shpëtuar nga veprimi i ligjit por nga ana tjetër të mund ta kenë nën kontroll për interesat e tyre në Shqipëri dhe në rajon.

Kështu në kaosin e ditëve që pasuan 14 shtatorin askush nuk vuri re se Berisha dorezoi tanket dhe hoqi dorë nga konfrontimi i metejshëm me shtetin e sapo ngritur nga dremitja, pas telefonatës së mikut të fundit amerikan të Berishës, Uiliam Perit, ish shefi i Pentagonit. Po atë ditë Berisha hoqi dorë nga rruga militare për «rrezimin e Fatos Nanos dhe që të nësërmën doli në mitingje «paqësorë» me flamuj amerikanë deri atëherë të harruara kushedi se ku. Po ashtu pothuaj e njëkohshme qe edhe deklarata, poshteruese e Dinit, ministër i jashtëm i qeverisë Italiane dhe shprehëse e politikës amerikane në Shqipëri, që thoshte pak a shumë se parlamenti shqiptar mund të humbasi legjitimitetin në rast se voton për heqjen e imunitetit të Sali Berishës. Ambasadorja amerikane Lino ishte në sallë me gazetarët kur Tiranën e vizitoi Trojka Evropiane. Kriza pas vizitës së Trojkës nuk u zgjidh, pavarësisht nga çtensionimi në dukje. Të dy kampet mbeten në pozicionet e tyre. Si zakonisht pasi ata do të lodhën dhe n.q. s drejtësia nuk do të veprojë, do të vijë amerikanët për të zgjidhur krizën, ose për ta ricikluar atë gjersa të medhenjtë të gjejnë gjuhën e përbashkët në zgjidhjen e çeshtjeve që lidhen me interesat e tyre ne rajonin më të gjerë

## **Nga Panajot Barka**

### **Riciklimi i krizës dhe nëvoja e kultivimit të shoqërisë civile**

09.10.1998/11.10.1998

Riciklimi ı shpeshhtë ı krizës politike ne vend në vitet e fundit, ndikoi dukshëm në konsolidimin e një mentaliteti mohues të çdo lloj realiteti të krijuar në favor të së ardhmës duke ı lenë gjithmonë e më pak vend afirmimit të perspektivës. Madje vihet re që një shtresë e terë intelektualësh krijuan sistemin e vlerave të tyre nën nevojën e mohimit të një regjimit neototalist.

Nevoja e egzistencës se levizjës afirmuese për shtetin dhe popullin shqiptar vazhdon të mbetet një kërkesë imedjate mos realizimi i së cilës është pasojë e drejtpërdrejtë e mungesës së një ideali shprehës i interesave të vendit dhe të popullit. Ky ideal të paktën në fazën e parë, duhet të synojë në krijimin e një shoqërie civile, e cila do të mundosonte ne vijim rikthimin e besimit të një sistem vlerash dhe tek një grupimi shprehës i këtyre vlerave.

Klasa e intelektualëve shpesh pa mjete jetese, ose e copëzuar nën trysinë e egër të politikës së kthyer në mjet përfitimi, tregon e pafuqishme të marrë përsipër një barë të tillë. Klasa politike nga pozicioni i asaj pjese të pushtetit që zoteron, ose është kthyer në pjesë përberese të atyre faktoreve që nuk duan afirmimin e shtetit dhe të vendit në përgjithësi, ose është e paaftë t'ı kundërvihet këtyre faktorëve. Kjo do të thotë se Shqipëria, për të dalë nga situatat e jashtëzakonshme i duhet gjithashtu një levizje e jashtëzakonshme.

Në një situatë të tillë e fillon startin e vet dhe qeveria e re. Ajo u përpoq të ravijëzonte imazhin e vet nën slloganin «rasti ı ri», në përshtatje të slloganit të 1997 «rasti ı fundit», të servitur nga perendimi.

I vetmi avantazh i qeveritarëve të kabinetit të ri është të qenurit të rinj. Por megjithatë edhe këtu askush nuk do të fut duart në zjarr se qeveria e re, si e terë apo në pjesë, nuk është e përfshirë, apo ka imunitet ndaj faktorit eruziv të qeverive postdiktatoriale shqiptare,- korupsionit. Arsytet e vonësës për krijimin e qeverisë së re e kompromentuan atë dhe treguan moralin e vërtetë nga i cili udhehiqen politikanët tanë. Nga ana tjetër të qenurit të rinj, pavarësisht se përben rastin e vetëm në të gjitha vendet e Lindjës në periudhën e tranzicionit, nuk duket se u jep të gjitha shanset për të përmbushur misionin e marrë përsipër.

Qeveritarët janë të rinj, por dhe të barabartë midis të barabartëve aq sa shpesh të gjithëve u duket se mund të bëhen ministra apo dhe kryeministra, mjafton që të futen në radhën e politikanëve dhe të presin momentin.

Në aspektin e brandshëm, një pjesë e politikanëve anëtarë të koalicionit edhe pse deklarojnë se do të mbeshtesin qeverinë, kanë venë veshin tek dera dhe presin që edhe këta të rinj të humbasin bastin, për të vertetuar aftësitë e tyre. Madje dy kryeministrat paraardhës të po të njejtit grupim politik nuk ndenjuan as ta mbeshtesin, të paktën me votën e tyre qeverinë e re. Po ashtu ndonese pak shurdhët, por brenda partisë më të madhe të koalicionit po degjohen zytkat e përplasjës midis partisë dhe qeverisë

Nga ana e vet populli ka lidhur duart ndën gjoks dhe deklaroi me moralin e pritjes. «Të presim çfarë do të na bëjnë edhe këta»

Opozita nuk e ndryshoi kursin e vet në qendrime ndaj pozitës dhe qeverisë së re. Ndërsa faktori ndërkombëtar, oksigjeni I çdo qeverisjeje ne vend nuk tregon ende pikësynimet e formulës së re «Miq të e Shqipërisë». Ndryshimet politike në Gjermani,

kriza e re në Itali dhe mundësitë për ndryshime në Shtëpinë e Bardhë, duhen konsideruar si shënja jo të mbara për qeverinë tonë të re

Po ashtu ceshtja e Kosovës gjithmonë e më shumë po kthehet në një kafshatë, e cila as që llogaritet se mund t'i përkasë për zgjidhje kësaj qeverie, por pasojat nga kjo krizë janë një faturë e rëndë për të në këtë prag dimri ku Kosova mund ta zerë përposht gjithë Shqipërinë.

Por veshtiresitë kryesore të qeverisë qëndrojnë në përballimin e atyre faktorëve që nuk duan egzistencën e shtetit. Këta faktorë, si mafia politike e fshehur prapa partive politike, krimi i organizuar, banditizmi, mafia ekonomike e fshehur prapa trafiqeve të ndryshme dhe faktorëve politikë që zoterojnë pushtet, janë tanimë të institucionalizuar. Menyrën e egzistencës së tyre ata e lidhin me inegzistencën e shtetit dhe për këtë kanë fituar aftësi të organizohen me ritme më të shpejta se përpjekjet për të organizuar shtetin. Ata zotërojnë mjete që nuk i ka shteti të cilat vihen në efikasitet kundër tij ose për ta kompromentuar atë. Ky mekanizëm antishtet përfshin pjesë të politikanëve dhe shtrihet në të gjithë administratën shtetërore. «Institucionët» antishtet në Shqipëri, janë më të rrezikshëm se mekanizmi i njëjtë që vepron psh në Itali, apo dhe në vende të tjera të zhvilluara, por edhe në vendet e Lindjes. Kjo për arsye se atje lufta zhvillohet midis shtetit të konsoliduar që nuk rrezikohet të shkaterrohet nga veprimi i këtij mekanizmi dhe faktorëve të organizuar të krimit që kërkojnë më shumë hapësirë veprimi.

Vet qëllimi bazë i qeverisë,- lufta kundër korupsionit, kontrabandës dhe për rivendosjen e rendit duket se përbejnë dhe sfidën më të madhe për qeverinë e re. Por qeveria e re kërkon ta realizojë këtë aksion më të njëjtën administratë të qeverive Berisha-Fino-Nano, të cilat u shquan për integritetin e tyre të korruptuar, që kursesi nuk do të pranojë të lëshojë pe, ose të ngrihen kundër vetës .

Nga ana tjetër veprimet e para të luftës kundër korupsionit dhe kontrabandës në strukturat e qeverisë dhe jasht saj misherojnë të njëjtën taktikë me atë të qeverive të mëparshme. Kështu lufta kundër korupsionit realizohet jo më zbatimin e ligjit por me lëvizje paralele të njëzëve që akuzohen për kontrabandë dhe korupsion. Doganjerë, apo komandantë policie në dogana, shefa komisariati apo dhe persona të tjerë të së njëjtës kategori, të akuzuar për kontrabandë e korupsion, hiqen nga puna me masa administrative dhe jo duke u përgjigjur para ligjit. Në vijim, ose ngrihen në përgjegjësi, ose çohen në vende të tjera pune. Një taktikë e tillë kuptohet që, jo vetëm nuk lufton korupsionin por rrit kushtet konkurrencës për vende të tilla pune. Kush nuk do të donte të punonte në një vend të tillë qoftë dhe për pak kohë (sa të sigoronte dhe stërnipërit me para dhe pastaj lë ta hiqnin) Në fund të fundit këto kushte nuk janë gjë tjetër veçse derivate korrupsioni ose treguesit e veprimeve të klanëve të kontrabandës dhe të korupsionit .

**Po ashtu** , më i riu dhe kryesuesi i stafit të ri të qeverisë, vet kryemnistri në emer të dëshirës për të bërë gjithcka vet, shpejt dhe me entuziazëm rinor, tregon se nuk është i gatshëm dhe i pjekur për të respektuar pushtetet. Dy herë brena një jave ai kompromentoi keq drejtësinë. Një herë i kërkoi policisë që të mos arrestojë gazetarë e politikanë pa dijeninë e qeverisë(!!) dhe pak ditë me vonë i kërkon përfaqësuesit të një pushteti paralel, Kryeprokurorit, në një takim më vartësit e tij, të godasi krimin, korupsionin kontrabandën.

Mëgjithatë përkrahja është e domosdoshme jo vetëm si përpjekje për afirmimin e politikës, jo vetëm për rigjallërimin e shpresës si alternativë e domosdoshme, por edhe pse duhet shpëtuar një grup politikanësh të rinj, që nëser mund të jenë shumë të dobishëm. ». PANAJOT BARKA 09.10.98 u botua dy ditë me vonë



## **Nga Panajot Barka**

### **Arsyet për të mos qenë historik takimi Majko-Berisha**

27.12.1998/29.12.1998

Në vendin tone, gjithmonë e më tepër kohët e fundit, në vend të veprimeve politike që afrojnë shpresën me realitetin, po aplikohen efekte politike që i ngjajnë tundjës së kandilit të shpresës që po i mbaron vaji, me qëllim që të rri ndezur sa të jetë e mundur me gjatë. Dy evenimentët politikë të këtij fund viti, miratimi i kushtetutës dhe takimi Majko – Berisha (pa asnjë lloj krahasimi, përse i përket rendësisë), po e vërtetojnë më së miri kongluzionin e mësipërm.

Aprovimi i kushtetutës për nga rendësia, kuptohet se përbën aktin politik më të rendësishëm të viteve të tranzicionit dhe të historisë më të re të vendit. Por rendësia më e madhe e saj qëndron në nevojën e vendit për të ngritur mbi këtë bazë shtetin. Faktikisht ndodh e kundërta. Kushtetuta po kthehet në një stoli juridike e një shtetit me struktura të gjymtuara, të cilën po fillon ta mbulojë pluhuri. Në këtë mënyrë fushata për kushtetutën shërbeu si një efekt propagandistik për të tërhequr vëmendjen pikërisht nga pamundësia e pushtetarëve të rinj për të ndërtuar shtetin dhe nga gadishmeria e tyre për ta rrëpuar edhe më. U vertetua gjithashtu se përse kohë politikanët tanë i kishin marrë nga dora organizmat ndërkombëtar, (në procesin e aprovimit të kushtetutës), ata mundën edhe ecën. Kur misioni i këtyre organizmave mbaroi, më 28 Nëntor 1998, politikanët tanë në pushtet mbetën në mes të udhës duke harruar se lufta për kushtetutën fillonte pikërisht pas aprovimit, pas 28 Nëntorit. Kushtetuta duhet të kthehet në armën kryesore për të bërë shtetin. Në vend të kësaj arme ata duket se kërkojnë shashka, tymuese e fishekë manovre.

Deshmi e këtij deduksioni është takimi Majko - Berisha. Ky takim tregon se politikanët tanë kërkojnë ta bëjnë shtetin me mjete politike dhe jo juridike, të ngatërrojnë serish partitë dhe pushtetin me shtetin. Pikërisht këtu qëndron rreziku i takimit Majko - Berisha. Ai nuk do të paraqiste një rrezik të tillë, n.q.s nuk do të konsiderohej si shpresa e zgjidhjes së lemshtit të krizës shqiptare.

Në esencë takimi Majko - Berisha është një përsëritje në situata të tjera, madje komike i marrëveshjes së nëntë marsit 1997. Atehere Berisha ishte me shpatulla në mur nga populli i armatosur. Tani nga drejtësia. Partitë sot në pushtet, e atëherë në opozitë, e kuptonin atëherë se, si pasojë e vrullit të lëvizjes popullore, mund të mbeteshin jashtë lojës për pushtet. Sot, për shkak të zhgënjimit, elektorati po i braktis. Berisha i ftoi atëherë partitë politike të opozitës në kompromisin e nëntë marsit se donte të mbetej pjesë e lojës politike në vend. Majkos i duhet sot Berisha se e di që elektorati mund të votojë prap për të dhe PS-në vetëm për inat të Berishës. Berisha nga ana e vet e do këtë gjendje të qeverisë Majko, pasi çdo ditë e më shumë kredibiliteti i saj bie. Nga kjo rrenie elektorati i PS-së po i afrohet gjithmone e me shume nivelit të elektoratit të ruajtur nga PD-ja edhe në kohët më të vështira. Vetëm kështu mund të kuptohet pse Majkua edhe pse e dinte që të gjitha topat e shkaktarit të situatës në vend po futeshin në portën e Berishës, ai i mori dhe po e rifilon lojën serrish nga mesi I fushës. Mëgjithatë të dyja palët në përgatitjet që bëjnë për një match elektoral të mundshëm harrojnë se 50 % e elektoratit kërkon alternativë politike e udheheqëse tjetër.

Por ku qëndron gjatë rreziku i trajtimit si historik të këtij takimi.

Se pari krijon trasenë e zëvendësimit të kushtetutës dhe të ligjeve kushtetuese për ngritjen e shtetit me individë «të fuqishëm» dhe nga partitë politike apo me tavolina partish. N.q.s vërtet nga ky takim, apo dhe të tjera që mund të pasojnë do të sjellin shtensionimin e vertetë të klimës politike në vend, (por shumë e vështirë në mos e pa

mundur), zhdukjen e kriminalitetit, pasigurisë, kontrabandës, korupsionit, funksionimin e gjykatave, të prokurorisë etj, kjo do të thotë se ose fajtorë janë ata të dy ose njeri prej tyre, ose, në rast të kundërt, do të duhet t'i kthejme në perendi tona dhe s' kemi më nevojë për kushtetutë apo shtet.

Se dyti. Forcon hapur precedentin e ndikimit të politikës mbi drejtësinë, që do të thotë se pavarësia e pushtetëve tek ne do të jetë vetëm pronë e pushtetit ekzekutiv. N.q.s drejtësia pushon çeshjen në ngarkim të Berishës, apo dhe ndaj personave të tjerë të marsit të 1997, kjo do të thotë se shteti ligjor jo vetëm që nuk do të mund të ndërtohet, por do të jetë vazhdimisht i rrezikuar të shembet nga presioni i vazhdueshëm i një rrethi vicioz krimi të organizuar politik e ordiner dhe kompromisesh pa parime.

Se treti. Godet ashpër konsequencën dhe rendësinë e qendrimeve të politikës dhe politikanevë shqiptarë. Lë të mos harrojmë se pak ditë pas 14 shtatorit, Nanua dhe pas tij Majkua votuan për heqjen e imunitetit parlamentar Sali Berishës që t'i hapet rruga drejtësisë. Drejtësia nuk veproi. Parlamenti dhe qeveria e pranuan sfidën e drejtësisë dhe heshtën. Dy javë më parë drejtësia u zgjua dhe shpalli akuzën e rendë kundër Berishës. Partia e Berishës e merr atë në mbrojtje duke vendosur që të mos njohë as zgjedhjet e 29 Qershorit, as institucionët që rrjedhin prej tyre e as kushtetutën. Një javë më vonë Majkua uthet me Berishën. Krerët e drejtësisë, prokurorisë, në vend që të jipnin dorëheqjen mjaftohen me një nervozizëm fals në shtyp.

Se katerti Krijon precedentin e diktatit të Berishës ndaj qeverisë dhe shtetit dhe të domosdoshmerisë së destruktivitetit të tij. Nuk besoj se duhen fakte për të vertetuar kongluzionin se Berisha diktoi dhe mori nga qeveria ato që ai desh dhe sa herë ka dashur i ka lidhur këmbët qeverisë. Edhe përfundimi i grevës së urisë së studenteve u lidh me rreshtimin para grevisteve të një të tretën e qeverisë për të pohuar se kërkesat e tyre qënë të drejta ndaj dhe do të realizohen .(!!)

Por cili ishte thelbi i këtij takimi që po na e kthejnë në historik. Çfarë u arrit aty faktikisht. Mos vallë u hodh ndonjë platformë afatshkurter, afatmesme apo afatgjatë se si pozita dhe opozita do të bashkëpunojnë për ngritjen e shtetit që do të vendos rendin qetësinë, do të zbatohen ligjet etj?! Sigurisht që jo. Të ishte arritur ta paktën një qëndrim i unifikuar dhe i deklaruar për Kosovën. Më e keqja është se për të ardhmën e këtij takim kushtet i ka në dorë përseri Berisha dhe lidhen me gjetjen e vrasësve të ndjerit Aem Hajdari. Po ashtu, tani edhe de jure qeveria nuk mund të bëjë asgjë pa i marrë dorën Berishës, ndryshe pakti prishet dhe akuzat do të bien mbi Majkon. Kjo do të thotë që edhe uniteti brenda PS-së të vihet në rrezik.

Kjo logjikë te çon në përfundimin pra se ky takim duhet përshëndetur si një tregues tolerance politike por jo të në një show politik që synon qartë t' i bëjë shqiptarët t' i kalojnë festat e vitit të ri me pak më shumë shpresa.

P Barka 27.12.98 (\*u botua dy ditë më vonë)

**Nga Panajot Barka**

## **Kuvendi Popullor viktime e falsifikatoreve të propozimeve për në keshillin kombëtar të RTV-së**

28.12.1988

Ndodh edhe kështu. Parlamenti u mashtrua, javën e kaluar kur u ftua të votojë për kandidatin për në keshillin kombëtar të RTV përfaqësuesin e minoritetit. Propozimi për këtë kandidat kuptohet që i takon organizatës OMONIA, si përfaqësuese e drejtpërdrejtë e minoritetit, por deputetet e nderuar ndoshta nuk e dinin vertet, që propozimi i ardhur nga organizata e OMONIAS ishte i falsifikuar, dhe aspak zyrtar.

Dokumenti që bën propozimin nuk është zyrtar jo vetëm se nuk ka anën formale të një dokumenti zyrtarë, por më e keqja është se ai nuk firmoset nga kryetari i përgjithshëm i OMONIAS, Vangjel Dule. Kështu Parlamenti operoi me dokumentin e njëres prej degeve të OMONIAS, asaj të Gjirokastrës me firmën e falsifikuar të kryetarit të saj NIKO PAPA.

Kryetari i Degës së OMONIAS për Gjirokastrën N. Papa, në një deklaratë publike sqaron se as ai si kryetar dhe as si kryesi e degës së OMONIA së Gjirokastrës nuk ka «lëshuar asnjë kërkesë drejtuar Kryesisë së Kuvendit Popullor e as komisionit të Medjas me propozim për kandidat për në keshillin Kombëtar të RTV-së që të përfaqësojë minoritetin grek, aq më tepër që kjo, në bazë të statutit të organizatës është kompetencë e Kryetarit të Përgjithshëm të OMONIAS»

«Shkresa e depozituar, sqaron më poshte zoti Papa,- pranë Kryesisë së Kuvendit Popullor, që mban datën 22 Dhjetor 1998, me të cilën propozohet emri i z. Arqile Pandeli Garo për anëtar në Keshillin Kombëtar të RTV-së, është e falsifikuar përsa i perket firmes dhe vulës»

Zoti Papa deklaroi gjithashtu se çeshtjen do t'ja çojë prokurorisë për të gjetur falsifikatorët dhe mashtruesit e parlamentit. Ai gjithashtu lë për të kuptuar se midis falsifikatoreve që duhet të jenë anëtarë parlamentit, Kryesisë së Kuvendit dhe grupit parlamentar të PS-së, për çeshtjen në fjalë ka egzistuar mirekuptim.

Ndërkohë Kryetari i OMONIAS Vangjel Dule deklaroi se «pas këtij skandali, do t' i kerkojë parlamentit të anulojë vendimin për anëtarin e Keshillit të Përgjithshëm të RTV-së, përfaqësues të minoritetit, të dalë pas propozimeve të falsifikuara dhe të votojë kandidaturën zyrtare të OMONIAS», për të cilën ai kishte autorizuar kryetarin e Partisë së të Drejtave të Njeriut Vasil Melo t'ia paraqiste parlamentit.

## **Nga Panajot Barka**

### **Doreheqja e Nanos nga kreu i Partisë lëvizje politike apo dalje nga politika ?!**

21.01.1999

Ne fjalën e tij të dorëheqjes nga kryetari i PS-së, me 20.01.1999, F.Nanua u përpoq ta sqaronte këtë dilemë. Tha se ai po rinis misionin e tij të emancipimit të jetës politike në Shqipëri me kërkimin e «solidaritetit të nëvojshëm» politik në masën e gjerë «të socialistëve dhe të dashamirësve të shumtë të reformave standarte të evropianizimit në gjirin e shoqërisë civile shqiptare» Sqaroi gjithashtu se nuk do të dalë nga politika deri ne frymen e fundit.

Duke e konsideruar të mirëqenë vullnetin e ri politik të Nanos, shikojmë se ky vullnet lidhet vetëm me Partinë Socialiste dhe pozicionin e tij brenda saj dhe nuk përbën një lëvizje që lidhet me situatën e rendë politike në vend dhe as duket se do të shkaktojë një tendencë emancipuese në të gjitha partitë politike të sëmura me të njetjtën diagnozë. Madje, doreheqja e Nanos po përdoret si alibi nga krerët e partive të tjera politike. Duke e cilësuar logjike, të drejtë, tregues të një kurajoje civile, ose dhe të pashmangshme levizjën e Nanos, ata nënkuptojnë hapur se situata në partite e tyre është krejt e shendoshë, ndaj edhe ata nuk po bejnë njëjtën gjë. Përkundrazi ata, ndryshe nga vet Nanua që e konsideron levizjën e tij si një perendim dielli që pret shkelqimin e tij më të fuqishëm në lindjen e re, politikanët e tjerë e shikojnë lëvizjën e Nanos si uljën finale në vijën e perendimit të yllit të tij politik.

#### **Një lëvizje jashtë skemave të përcaktuara.**

Fakti që mënjëherë pas lajmit të bujshëm shtëpia e re e Nanos «u rrethua» nga trupat e sigurimit të ambasadorëve me në zë në vendin tonë, për t'i ndihmuar këta ambasadorë për të gjetur Nanon «e zhdukur», tregon se dorëheqja e Nanos ishte jashtë projekteve të tyre për zhvillimet politike në vend. Këto zhvillime kishin hyrë në një logjikë të qartë. Thëllimi i krizës në Kosovë dhe rendimi i situatës në vend, e cila mund të rendohet «vetvetiu» edhe më në ndonjë segment jetik për vendin, siç është Tirana, po çonte pa tjetër në «nevojën» e krijimit të një qeverie ekumenike, për stabilitetin e vendit. Pas këtij momenti zhvillimet politike do të rridhnin drejt zgjedhjeve të reja, paralelisht me përpjekjet për ridimesionimin e spektrit politik shqiptar, me qëllim që të shmangeshin strukturat e instalimit të rrethit vicioz të hakmarrjes politike për interesa private e meskine në kurriz të shtetit e të Shqipërisë.

Dorëheqja e Nanos zhvendos kështu radhën e zhvillimeve duke sjell në krye zhvillimet brenda në PS, duke i rezervuar kështu partisë se vet një risk dhe një sfidë shume të madhe.

Duke qenë se PS-ja është de jure partia në pushtet, kjo nënkupton dy gjera. Ose zhvillimet politike në vend do të përcaktohen nga zhvillimet në të, ose PS e mbërthyer nga pasionet e klaneve për fronin e kryetarit, të mbetet jashtë këtyre zhvillimeve, t'i shpetojë pushteti nga dora, të perçahet, e ta shikojë pastaj pushtetin me dylibi.

#### **Nanua dha Partia Socialiste**

Levizja e Nanos duket se çbllokoi përfundimisht përpjekjen disavjeçare të ambicjeve dhe ambiciozeve politikë për kryesimin e Partisë. Mirëpo ky çbllokim mësa

duket, nuk lidhet me menjanimin e tij përfundimtar. Ai rifutet ne start me avantazhet dhe disavantazhet përkatëse. Kundërshtarët e tij brenda në parti janë të shumtë. Mirëpo këta kundërshtarë përbejnë një tufë gjeneralesh pa ushtarë, ku secili lufton për hesap te vet. Blloku i kundërshtareve të Nanos janë të bashkuar në luftën kundër tij, por të përcarë ne luftën për fronin, ndërkohë që përkrahësit e Nanos e kanë të zgjidhur këtë problem e kreut.

Duhet theksuar gjithashtu, se Partia Socialiste u rezistoi, për vite me rradhë, goditjeve përçarëse nga brenda dhe nga jasht saj, pikërishtë për shkak se kishte zgjidhur problemin ç e udheheqësit, madje në formën e mitit. Ky ishte i burgosuri Fatos Nano. Kështu rreziku potencial për përçarjen e PS-së është potent. Drejt kësaj çarjeje mund të bëhet protagonist dhe vet Nanua. Ai nuk u shpreh qart, as si mendim se çdo të bëjë (pavarësisht nga mundësitë), të emancipojë krahun e së majtës në Shqipëri, apo vet Partinë Socialiste? Fatos Nanua ndoshta e ka nuhatur se, ashtu si pas 1994, elektorati i qendrës rreth 50 përqind i të gjithë elektoratit shqiptar, është politikisht i lirë, i pa shprehur. I vetëm me barën e rendë të dështimeve dhe pa një platformë të qartë ai nuk do ta marrë mundimin. As ideja e shprehur prej tij pak kohë me parë për krijimin e socialdemokracisë së gjerë shqiptare, është e prekshme prej tij. Kjo për faktin se Nanua do te jetë gjenerali i dështuar politikisht midis gjeneraleve të tjerë, pavarësisht se të vegjel, por me grada dhe shumë ambiciozë.

### **Nanua dhe Berisha**

E çuditshme është se Berisha e priti shumë «urtë» dhe pa trimfualizma dorëheqjen e Nanos. Ai sigurisht mund të bërtiste dhe të bëntë gosti për mundjën përfundimtare të kundërshtarit politik. Kjo nuk lidhet as me mëshirën kristiane të faljës se të mundurit, që do të konsiderohej si civilizim politik të vet Berishës.

Lë të mos harrojmë se në një moment kritik të zhvillimeve politike në vend Berisha interesohet për mbijetesën e tij, ndërkohë që njeh mire se, ndryshe nga ai, Nano ka mundësi të ringrihet më mire se aid he me mjete paqësore “e demokratike

21.01.1999

## **Nga Panajot Barka**

### **Pakti për rendin Majko-Berisha, strategji e Berishes për të ardhur në pushtet**

10.02.1999

Arkimendi kerkoi dikur një pike mbështetese për levën e tij që të lëvizte tokën. Berisha gjeti një pikë për të rëzuar qeveritë e kundërshtarëve. Kjo pikë është Ministria e Rendit dhe në një kuptim më të gjerë, Rendi. Kjo pikë u përdorë nga ai edhe për të zgjatur pushtetin e tij.

#### **Pak histori**

Dy ditë pas zgjedhjeve të para pluraliste në vend, incidenti i dy prillit në Shkodër shënon pikërisht pikën e mbështetjes për politikanin Sali Berisha në lidhje me marrjen apo dhe me mbajtjen e pushtetit. Akuzat ndaj kundërshtarit për këtë ngjarje vazhduan gjatë duke përberë një armë në arsenalin e vet politik. Pak muaj me vonë dhe para se të binte qeveria e parë e socialisteve, e vetmja ministri që u dogj ishte Ministria e atëhershme e Rendit.

Pak jave para se Berisha të vinte në pushtet, më 1992, djegjet dhe shkatërrimet, që nga Fieri e Lushnja, deri në Pogradec e Fushë Arrez, u përdorën nga Berisha dhe PD-ja si mjeti më efikas për të venë nën përgjegjësi dhe akuze socialistët dhe kundërshtarët e tjerë politikë të tij, për përfitim elektoral.

Pesë vjet në pushtetin e tij ministria e rendit ishte pika me e fortë, bashkë me shërbimet sekrete, për të luftuar e trembur dhe nënshtruar kundërshtarët e tij, gazetarë, politikanë, tregëtarë etj, me pikë kulmore 26-28 majin 1996

Policia dhe ushtria u bënë armët e tij më të besuara për të shtypur revoltën popullore në vitin 1997. Po më 1997 karakteristikë është fakti që më nente mars ai pranoi tua jipte kundërshtarëve të gjitha portofolet e qeverisë por nuk leshonte me asnjë gjë Ministrinë e Brendshme atëherë, si shpresën e fundit që të mund ta sillte në pushtet apo dhe penguar zgjedhjen e tjerëve.

1998 pengua Rendi i lidhi kembët qeverisë së koalicionit. Lejoi 14 shtatorin dhe rrezoi për të tretën herë kryeministrin Nano.

1999 pakti për rendin një manover për të marrë nga deriçka pushtetin.

Pakti për rendin, i propozuar nga Berisha, po kthehet tani në gurin e provës për dialogun midis tij dhe Majkos, i shprehur ndryshe midis qeverisë dhe opozitës. Majko e konsideron këtë një fitore të qeverisë së tij dhe që të jetojë më gjatë kjo fitore, Majkua duhet të bëjë lëshime. Mirëpo, ky lloj dialogu apo dhe inisiativa e Majkos për të thirrur tavolinën e partive politike shqiptare, një e drejtë kjo e Presidentit, po çon në shkeljen e institucionëve.

Por nga ana tjetër, pakti për rendin, sipas Berishës do të thotë, që PD-ja të arrijë përfundimisht të marrë pjesë në qeveri, nëpërmjet një ministrie nevralgjike. Pra të zyrtarizojë njëkohësisht rehabilitimin e vet politik. Pas kësaj nëpërmjet një strategjie të njohur të provokojë zgjedhje për të pretenduar si i barabartë pushtetin. Momenti që zgjodhi Berisha për realizimin e strategjisë së vet është shumë i favorshëm. Ai e di se mungesa e rendit, korrupsioni dhe kontrabanda, mungesa e veprimit të institucionëve

ligjore dhe zhgënjimi popullor e kanë ulur mjaft përqindjen e përkrahësve të koalicionit dhe PD-ja do të arrijë momentin e zgjedhjeve jo nga pozicioni i opozitës, por si pjesëmarrëse në qeveri, pra siç thamë, nga pozita tejet të barabarta ku zgjedhjet të jenë kuptohet një domosdoshmeri ose alternativë e vetme.

Berisha e lidhi arritjen e këtij pakti fillimisht pas kthimit të partisë së tij në parlament. Por sapo vuri re që drita jeshile, e palës tjetër të dialogut, Majkos apo dhe faktorëve të tjerë të jashtëm që i përkedhëlin veshet atij, mbeti hapur, ndryshoi qëndrim. Tani kërkon paktin për ministrinë e rendit dhe pastaj të kthehet në parlament. Kjo përkthehet fare thjesht. Kthimin në parlament Berisha do ta lidhi pastaj me kushte të tjera në favor të tij drejt synimit për pushtetin. Dhe të gjithë ata që i kujtojnë, sa atij, aq edhe Majkos, se rendi ka lidhje me ligjin dhe drejtesinë, Berisha i konsideron armiq!

### PAKTI PER RENDIN DHE MAJKUA

Majkua në «Dritaren» televizive nuk u kuptua se çfarë tha për këtë pakt. Por morali i tij që fare i kuptueshëm. Çfarë është e moraleshmë në shoqëri është e pamoralshme në politikë dhe anasjelltas,- tha pak a shumë Majkua. Gjithashtu pas kthimit nga Amerika ai u shfaq më se optimist, gjë që do të thotë se gjithçka do të eci mbarë. Pra edhe pakti me Berishën mund të bëhet dhe gjithçka do të eci mbarë se garancitë, nga të thenat e Majkos, i jep Amerika. Por edhe ai është i gatshëm të mos e bëjë fjalën dysh Amerikës. Duke e shpallur Amerikën aleat strategjik (ku sukseset, sipas tij, janë të padiskutueshme dhe të provuara me të njëjtin strategji dhe nga PD-ja) Majkua dha të kuptohet gjithashtu se edhe Ai vet është i padiskutueshëm, por edhe Berisha i tregoi Perëndimit dhe Amerikës se, pa të asgjë nuk mund të behet në Shqipëri. Kjo lojë është me rrezik jo vetëm se reagimet si brenda PS-së, ashtu dhe nga radhet e koalicionit, në lidhje me deklaratat e Majkos, qenë shumë të ashpra, por edhe pse Berisha mund të përdoret edhe një herë nga PS-ja e parçarë në disa kampe, për të forcuar unitetin, por edhe kundërshtarët e Majkos mund ta përdorin këtë fakt si argument shumë të fuqishëm kundër tij dhe ambicjeve të tij për Kongresin e ardhshëm të partisë. Por gjithashtu, një gjë e tillë mund të çojë në një përcarje të metejshme të vet PS-së

### PAKTI DHE MINISTRI KOÇI.

I pari që rrezikohet nga pakti është ministri Koçi. Ai mori përsipër një barë të rendë për moshën dhe eksperiencën i bindur se luante me karrierën e tij politike për jetë a vdekje. Shumë shpejt ai e kuptoi se çështja e rendit nuk ishte dicka që lidhej me rendin si të tillë. Loja ishte më e gjerë kur kemi parasysh se kulisat e zhvillimeve politike filluan të mbështeshin tek gjendja e rendit. Kështu pakti i Berishës nuk presupozon atë ministër, jo vetëm se Berisha e ka shpallur atë armik, por se atje i duhet një njeri i vet. Vet fakti që qeveria e la Majkon pa përkrahjen e duhur dhe nga majat e qeverisë filluan sulmet ndaj tij, tregon se Pakti Berisha kërkon të paktën kokën e tij në sini të argjentë.

Por egziston dhe një pikë e veshitirë për pozicionin e Koçit brenda në parti. Frika se mos edhe Koçi bën ndonjë përpjekje për të kërkuar postin e kryetarit të PS-së, i ka venë ndoshta shumë klane brenda PS-së përballë sfides për menjanimin e tij me një lëvizje shume të thjeshtë. Të rrezohet nga posti i ministrit dhe si i deshtuar të mos ketë asnjë mundësi për pretendime karriere brenda në Parti. Kështu edhe Koçi digjet, edhe Berisha kënaqet edhe rruga për karrigën bosh të kryetarit të PS-së bëhet më e lehtë.

10 Shkurt 1999

## **Nga Panajot Barka**

### **Zgjedhjet lokale të 1 Tetorit treguan serish përplasje antivlerash dhe aspak ballafaqim vlerash.**

Java e parë e tetorit 2000

Raundi i parë i zgjedhjeve lokale u mbyll me një zhgënjim të plotë për të gjithë ata që parashikuan një ditë tensioni në Shqipëri. Po ashtu zhvillimi i zgjedhjeve të një Tetorit u jep të drejtën që të krenohen gjithë atyre që u përpoqën dhe kontribuan për zgjedhje të drejta, të lira, korrekte dhe demokratike. Me këto parametra u percaktuan madje edhe fitimtarët dhe humbësit. Pas kësaj duket se faktori ndërkombëtar do ta vlerësojë me notë pozitive të lartë procesin demokratik në Shqipëri, aq më tepër do ta bëjë këtë vlerësim ai segment i faktorit ndërkombëtar që u mor drejtpërdrejt me procesin elektoral në Shqipëri.

Mëgjthatë faktori i brendshëm politik në fakt nuk e kaloi këtë test më të njëjtin vlerësim.

Së pari. Gjatë fushatës elektorale partitë politike sidomos dy partitë e mëdha P.S-ja dhe P.D-ja e harruan shumë shpejt testin e perendimit që këto zgjedhje më shumë se vlerë për përcaktimin e fituesit do të shërbënin si një barometër për stabilitetin politik dhe gjenerimin e vlerave demokratike në vend.

Këto parti fitorën e kthyen në qellim në vetvete d.m.th si treguesin më të mirë për fituesin e zgjedhjeve të përgjithshme të 2001. Ky qellim në vetevete risolli tensionimin e situatave me fjalorin banal dhe akuza të rënda sa që të dukej se pas fushatës elektorale nuk do të mjaftonin të gjithë prokurorët e republikës për t'u marrë me politikanet.

Se dyti. Fushata nuk ishte një ballafaqim programesh por një ballafaqim kundërshtarësh. Ashpërsia e kësaj përplasjeje si dhe qëndrimi ndaj rezultatit nga ana e humbësit, verteton se luajaliteti dhe bashkëpunimi pozitiv – opozitë si faktorë të konstruktivitetit demokratik është veshtirë të mendohet, pa lë të arrihet. Në këtë kontekst në një përpjekje për të grumbulluar rreth vetës sa më shumë elektorat u thirr fatkeqësisht në skenë faktori Berisha aq sa mund të thuhet se ai pushtoi të dy partitë kryesore në të majtë si antiberishë dhe në të djathtë si antiPD

PS ja në këto zgjedhje vendosi veten në pozicionin real që kishte në lidhje me pushtetin lokal, në atë të opozitës. Në betejën elektorale për të fituar ajo perdori antiberishizmin madje shpesh deri në ekstreme të logjikës dhe të fjalorit banal të trotuarëve. Por lë të mos harrojmë se PS-ja e perdori këtë kartë nga pozitë e të qenit pozitiv në pushtetin qëndror dhe ky fakt është me kosto politike jo aq të ulët si brenda ashtu dhe jasht vendit. Është e vertetë se Berisha e terhoqi gjithë pozitën në logjikën e vet elektorale pavarësisht se provokonte një antiberishizëm shpesh më të skajshëm se akuzat ndaj saj nga ana e Berishës. E vertetë është gjithashtu se Berisha në formën e antiberishizmit u bë faktori për sheshimin e kontradiktave midis grupëve dhe klanëve të ndryshme brenda udheheqjes së PS-së. E thenë ndryshe. Nevoja e ruajtjes së pushtetit dhe frika se mos Berisha i bënte realitet kërcenimet e veta në rast fitoreje e kthyen atë në një faktor unitetit për udheheqjen e PS-së, pavarësisht si antiberishë. Por kjo ama nuk solli atë që i duhet PS-së,- shtimin e radhëve të votuesve të saj.

Fenomeni Berishë u kthye në një antiPD edhe në kambin e partisë së tij. Nga njëra anë ai edhe një herë barazoi në personin e tij gjithë Partinë Demokratike. Kështu pas ikje



se grupit të fundit kundërshtar nga radhet e veta, ai i reformatorëve, evidentimi i vetëm i tij në të gjitha aspektet politike të partisë asimiloi dhe zvogëloi kapacitetin intelektual e politik të PD-së dhe e denigroi atë në bertitura Ky rol i shkoi përshtat Berishës më 1997 kur Partia Demokratike u rudhos së tepërmi dhe arriti të mbijetojë në saj të energjive të tij dhe të nevojës për një opozitë në Shqipëri. Dramaciteti i atehershem tani është kthyer totalisht në komizem që një fije peri e ndan nga marrezia tragjike.

Nga ana tjetër aplikimi pikerisht si një logjistikë propagandistike, për të shtuar elektoratin e vet, të një fjalori renqethës me burgje, ruspa, gjyqe publike etj jo vetëm që i hoqi atij besueshmërinë e faktorit opozitë dhe të fakteve kompromentuese të serviuara kunder pushtetarëve, por trembi në një masë shumë të madhe pasuesit e vet dhe riktheu në kampin e socialistëve të gjithë të pakënaqurit nga qeverisja e PS-se, ose i hodhi në “partinë e intefernetëve”.

Faktori i tretë negativ i fenomenit Berishë ndaj partisë së vet është fakti se Berisha është tani humbësi i madh për partinë Demokratike. Berisha faktikisht pas zgjedhjeve të përgjithshme të 1992 ka humbur të gjitha betejat elektorale, gjithsej shtatë Mëgjithatë ai vazhdon të jetë në krye të PD-së, gjë që nuk ka ndodhur me asnjë parti në botë.

Kështu antiberishizmi i PS-së me akuza të renda penale politike e ordinere, por vetëm për konsum publik dhe jo për zbatimin e ligjit tregoi tre gjera: Alternativa e PS-së për fitore kishte sensin mohues të një realiteti të rimohuar edhe më parë. PS-ja nuk e kupton se nuk mund të ketë një opozitë konstruktive me kartën antiberishë, ndaj shtoi edhe ajo radhet e “partisë së intiferenteve”

Ndërsa antiPD-izmi i Berishës theksoi domosdoshmerinë e rimekembjës së PD-së dhe më gjerë të opozitës.

Se treti **Meritat e faktorit popull përvetësohen nga partitë politike.** Po provohet edhe një herë se partitë u nderuan me zgjedhjet për arsye se votuesi popull nuk pranoi rrugën e klimës së nxehtë politike dhe të trazirave që i imponuan gjatë fushatës elektorale partitë politike. Ai zgjodhi rrugën e qetësisë, tolerancës dhe paqës. Populli u tregua sovran i vertet me votën e tij. Por meritën për këtë arritje të tij do ta përvetësojnë partitë politike duke deklaruar “se zgjedhjet e lira korrekte e demokratike të 1 tetorit” ishin produkt i tyre. Se sa e vertet është kjo e treguan rezultatet e para dhe ato që pasuan ku humbësit ngritën krye me akuza për “manipulime totale” dhe mosnjohje të tyre duke e riacaruar situatën aq sa dhe balotazhi në një numër relativisht të lartë komunash dhe bashkish nuk do të mund të shërbejë si një amortizator kundër këtij fenomeni të origjinës politike pluraliste shqiptare.

Po ashtu popullit nuk do të vijë keq për këtë përvetësim vlerash se sa për faktin që partitë nuk marrin dot mesazhin se ai duke minimizuar shkallë shkallë pjesëmarrjen në votime u tregon se ka humbur besimin në to, se kërkon diçka të re. “Partia e intiferenteve” në këto zgjedhje po të bejmë llogari reale, del në fakt partia fituese.

Këtë në fakt e tregon edhe balotazhi në shkallë të gjerë ashtu dhe përpjekja e partive të vogla për të sfiduar dy partitë e mëdha. Por në fakt populli nuk u beson fort atyre se asnjera nga partitë e vogla nuk rezistoi në rolin e opozitës dhe të vlerave të saj për një kohë të gjatë, por në çdo rast e shfrytëzuan rolin opozitar për t’u bere pjesë përbërëse e pushtetit. Pra populli i shikon si imitime të dy të mëdhenjve, ashtu si i shikon si bashkfajtorë të gjithë individët apo grupe individesh që largohen prej këtyre partive si opozitarë .P BARKA

Nga Panajot Barka

## **Rregjistrimi i popullsisë dhe problemi historik i Minoritetit Etnik Grek**

12 prill 2001

Regjistrimi i përgjithshëm i Popullsisë dhe i Banesave në Republikën e Shqipërisë, risolli në skenë problemin e Minoritetit Etnik Grek në Shqipëri. I përceptuar në aspektin e numrit, në realitet shfaq përplasje problemore të karakterit historik, pretendime nacionaliste shpesh të sëmura, përplasje midis së drejtës së individit dhe parimeve demokratike, ligjit dhe raltitetit, ose realitetit dhe përfitemëve politike të grupeve të caktuara. Pra një problematikë që mund të ndikojë negativisht si marrëdhënjet e mira midis anëtarëve të minoritetit etnik grek me pjesën tjetër të popullsisë dhe me vet strukturat e shtetit deri edhe marrëdhënjet ndërshtetërore. Aq me keq kur egzistojnë interpretime të kundërta lidhur me qëllimin e këtij regjistrimi. Kjo do të thotë se sidoqë që të vijë puna anëtarët e Minoritetit Etnik Grek në një moment të tillë ndjehen keq dhe të zenë në një pozicion delikat.

### **REGJISTRIMI DHE SFIDA HISTORIKE E NUMRAVE.**

Minoriteti Etnik Grek në Shqipëri midis përplasje se pretendimeve ekstreme rreth numrit të tij, ka mbajtur një qëndrim mesë korrekt, të përmbledhur në deklaratën kërkesë – “të numërohem njëherë në një regjistrim në kushte të lirisë së vertet demokratike”.

Pa iu rreferuar shifrave të përdorura nga burime të tjera lë të sqarojmë pse Minoritetit Etnik grek në Shqipëri nuk ka pranuar shifrat zyrtare të shtetit monist, të cilat me aq zell përdoren shpesh në të gjitha instancat për të provokuar egzistencën reale të tij.

Kështu lë pranojmë një statistikë të kohës së mbretit Zog që thotë se numri I nështetasve të tij që I përkisnin kombësisë greke ishte rreth 37 mijë në një kohë që popullsia e Shqipërisë ishte atëhere me pak se një milion banorë. Më 1989, në krahasim me statistikën e mbretit Zog numri I popullsisë së Shqipërisë u rrit afro katër herë, ndërsa numri I nështetasve shqipatr me kombësi greke I bie të jetë rritur 1.7 herë. Pra një iracionalitet që vertetohet dhe nga rritja natyrale pothuaj e barabartë e popullsisë me kombësi shqipatre dhe greke në rrethin e Gjirokastrës. Kështu sipas vjetarit statistikor të seksionit të planit të Komitetit Ekzekutiv të Gjirokastrës I vitit 1975 del që rritja mesatare e përvithsme e popullsisë për çdo 1000 banorë në këtë rreth, nga 1955-1975 është 16.05, (aq sa është dhe mesatarja e Republikës). Ndërsa në zonat e pastra të Minoritetit të këtij rrethi rritja mesatare vjetore e popullsisë në të njejtën periudhë është 14.5 banorë për çdo 1000 banorë. Besoj se shifrat nuk kërkojnë koment, por përbejnë një fakt pse duhet respektuar kërkesa e minoritetit për të shprehur kombësinë në një regjistrim të përgjithshëm.

### **ARSYET E TJERA**

Një arsye tjetër përbën fakti se janë me qindra raste të njohura ku anëtarë të se njejtës familje të origjinës greke figurojnë me kombësi të ndryshme, ose familje të tera me kombësi të ndryshuar, pa permendur këtu familjet të prejardhura nga martesat me kombësi të ndryshme. Ky fenomen, masiviteti i të cilit konfirmohet dhe nga shembulli I mësipërm, është pasojë I arbitraritetit të shtetit monist ndaj këtij elementi personal e kolektiv të identitetit dhe i nevojës për mbijetesë të anëtarëve të minoritetit etnik grek.

Më e keqja është se gjatë këtyre viteve të tranzicionit rrugët ligjore, aq sa ato egzistojnë, për të rregulluar këto deformime, rezultojnë të bllokuara “me urdher nga lart”.

Po ashtu në kushtet e rendësisë së veçantë që organizmat ndërkombëtare u kushtojnë respektimit të drejtave të njeriut dhe pakicave, është alogjikë të mos krijohet mundësia tek anëtarët e një komuniteti të deklarojnë karakteristikën dalluese, - kombësinë, aq me tepër në kushte kur për të njejtën objekt ka abuzime të ndërsjellta shpesh me ndikime negative në ruajtjen e ekulibreve shume delikate, sidomos në rajonin tonë.

#### JO- ja NË FORMULARË PER KOMBESINE DHE QENDRIMI I OMONIAS

Në këto rrethana mëndoj se I interesuari I dytë por më kryesor për zgjidhjen e kësaj çeshtjeje duhet të ishte vet shteti. Shmangja nga formulari I një forme pyetësores që do të kenaqte pakicat e njohura etnike në vend, u krijon terrën për argumente më shumë pretendimëve për numra të hamendësuara dhe realiteteve si deri me sot.

Duket se strukturat përgjegjëse të shtetit që morën një vendim të tillë ranë ndoshta viktimë të propagandës së berë se “pozicioni ekonomik I shqiptarëve” dhe “synimet greke” do të ndryshonin në menyrë galopante këto raportë në favor të etnisë greke, apo etnive të tjera në Shqipëri. Mirëpo, për rastin kongret fakt është se qeveria Greke edhe pse financoi procesin e regjistrimit me 1.2 milion ECU, nuk pati asnjë pretendim .Deri në atë masë arriti kz qendrim I palës zyrtare greke sa që anëtarët e minoritetit grek në Shqipëri ndjen shijen e braktisjës. Ndërsa qarqet ekstremiste nuk reagues pothuajse fare, (ndoshta se kjo lloj mjegulle u intereson më shumë)

Po ashtu mëndoj se OMONOIA nuk tregoi maturinë e duhur. Bojkotimi I regjistrimit të popullsisë nuk është vendimi më I mirë që e zgjidh problemin dhe të garanton përkrahjen e organizmave ndërkombëtare. Po ashtu I krijon probleme të brendshme vet komunitetit por edhe në marrëdhënjet e tij me shoqërinë shqiptare dhe institucionet e shtetit.

Kujtojmë gjithashtu se vendimi për bojkot u mor, pasi për pesë muaj, që ligji për regjistrimin ishte në fuqi, OMONIA nuk bëri përpjekje që në pyetësor ligji të interperetohej në favor të së drejtës së Minoritetit. Aq me keq që në minoritet vendimi i motivuar patriotikisht pati trajta për përfitim politik dhe konsum të brendshëm apo të jashtëm, nga grupe të ndryshme politike që veprojnë në minoritetet

Po të na lejohet të benim një paralelizëm, to të thoshnim se vendimi i OMONIAS e vë atë në të njejta pozita me ata shqiptarë në FYROM, të cilët për të drejtat e tyre mëse të drejta, kaluan në veprime ekstreme. (Në një kohë që, mëndoj, Minoriteti Etnik Grek në Shqipëri duhej të përkrahte zyrtarisht zbatimin praktik por me mjete demokratike, të drejtave e shqiptarëve atje).

Në këto rrethana kur po behet e pamundur shpërndarja e një pyetësori shtesë për të anëtarët e minoritetit grek në të gjithë Shqipërinë, apo edhe të minoritetëve të tjera, siç është përfolur ditët e fundit, zgjidhja më e mirë do të ishte që nga njëra anë Minoritetit Etnik Grek të mos përdoret si dele e zezë. Nga ana tjetër me ndihmën e organizmave ndërkombëtare të organizohet kudri ligjor për të drejtën I identitetit dhe për garantimin e rifitimit të kombësisë në baza individuale si dhe funksionimi i strukturave përkatëse për implementimin e një ligji të tillë që do të pasqyrohet në regjistrat e gjendjës civile përkatëse.

**Panajot Barka ( u botua tek “Koha Jone” me 12 prill 2001 faqe 7)**

## **Nga Panajot Barka**

### **Paternalizmi nacionalist për të drejtat e minoriteti një rrezik për të ardhmën evropiane të Shqipërisë.**

Artikulli i përket periudhës prill 2001. Është botur dhe në gazeta të tjera

**Reagimi në vijim përbën përgjigje ndaj reagimeve shumë të ashpra tek gazeta “Koha Jonë” dhe te medjat e tjera në Shqipëri në lidhje me një deklaratë të Ministrisë së Jashtme Greke mbi respektimin e të drejtave të minoritetit etnik grek, pas mos përfshirjen në formularin (pyetësorin) e regjistrimit të popullsisë të limës për vetpërcaktimin etnik, pasi këtë proces Greqia e kishte financuar pikërisht për këtë qëllim.**

Kam përshtypjen se reagimi në publik ndaj deklaratës në fjalë nuk është orientuar në kahun e duhur. Duke u nisur pikërisht nga mënyra e reagimit dhe jo vetëm në rastin kongret, kam frikë se nuk jemi ndërgjegjësuar realisht se po nuk u respektuan të drejtat e njëriut dhe të drejtat e pakicave në veçanti, Shqipëria nuk hyn në familjën e B.E. Nuk kuptoj gjithashtu pse kur na hiqet veshi nga një institucion ndërkombëtar për këtë problem ose reagojmë pozitivisht (kryesisht për të venë me shpatulla prej muri qeverinë), ose heshtim. Ndërsa kur një vërrejtje e tillë vjen nga Greqia, qoftë edhe nga pozicioni i drejtuesit të Bashkimit Evropian, ne nxjerrim në shesh gjithë arsenalin e problematikës historike në marrëdhënjet midis dy shtetëve. Bile, nga mënyra e reagimit krijohet shija e keqe sikur gjithë parametrat e tjerë që garantojnë integrimin e Shqipërisë në BE janë të realizuara edhe respektimi i të drejtave të pakicave, sidomos ato të minoritetit etnik grek dhe se janë “pretendimet” e Greqisë për këto të drejta që e pengojnë këtë proces integrimi (!!). Jam plotësisht i bindur se e kundërta ndodh. Në çdo rast përfaqësuesit e këtij minoriteti do të ngrinin të parët flamurin që Shqipëria të mos pengohet në këtë proces, ashtu siç bëmë në 1991 për të hyrë në OSBE, siç bëmë kur Shqipëria hyri në Këshillin e Evropës, apo dhe tani së fundi për nënshkrimin e marrëveshjes për çeljen e negociatave me B.E dhe këto kurrë nuk i kemi konsideruar e as do të lejohet që të konsiderohen si veprime dobësie apo inferioriteti.

Mëgjithatë nuk mund të mos vihet re se çdo herë që ngrihen probleme të respektimit të drejtave të minoritetit etnik grek në Shqipëri reja e kundërreagimeve të ndërsjellta, sidomos nga pala shqiptare është shqëtësuese në një kohë që të mohosh faktin se egzistojnë probleme, është njësoj si këmbëngulja për të mohuar që bëhen përparime. Pa iu referuar hollësive lidhur me peshën e këtyre raportëve do të ndesha të kërkoja arsyet e realitetit të pozicionëve bardhë e zi midis palëve të interesuara.

Së pari Qendrimet të kundërta lidhur me faktorin shumëdimensional të minoritetit etnik grek në Shqipëri në historinë e marrëdhënieve midis dy vendëve.

Në Greqi egziston një spektër shumë i gjerë qendrimesh i formësuar në shtrirjen kohore që nga krijimi i këtij minoriteti si të tillë. Kjo hapësirë fillon me grupimin që i meshon idesë se problemet duhen zgjidhur në bazë të një momenti të caktuar historik (atë të vendosjes së kufijve ndërshtetërorë, apo dhe të periudhave historike që pikonin gjak nga fantazmat nacionaliste) dhe mbaron me grupimin që e shikon trajtimin e minoritetit etnik grek në Shqipëri të çliruar nga kontekste historike me ngarkesa negative dhe në kuadrin e integritit të Shqipërisë në Evropën e Bashkuar.

Në Shqipëri përkundrazi. Në të gjithë shtrirjen kohore në fjalë gjithë problematika lidhur me këtë minoritet ka formësuar idenë se trajtimi dhe respektimi i

të drejtave të tij ka qenë në mënyrë përfekte, bile më mirë se pjesa tjetër e popullit shqiptar. Madje dhe sot vazhdohet të operohet me argumenta që përpunoj për qëllime ideologjike një sistem totalitar i mohuar katërcipërisht, apo strukturat shtetërore të periudhave historike të përmenduara më lart, të veshura sot kuptohet me petkun gjasem modern të mentalitetëve kohërrënte Evropiane.

Në këtë kuadër do të ishte gabim të mos përmendej fakti që midis palëve,- Shqipërisë dhe Greqisë,- (pavarësisht nga pozicioni në spektrin e qëndrimëve në këtë të fundit), apo momentëve dhe realitetëve të marrëdhënjeve shumë të mira, ka qëndrime krejt të kundërta e shpesh të skajshme e të mbrojtura me fanatizëm, lidhur me probleme të tilla siç janë madhësia demografike, historia e origjinës etnike, trashëgimia kulturore, shtrirja gjeografike etj. Moszgjidhja e problemëve, si atyre të karakterit historik, (duke kongluduar për një histori të njëjsuar, në vend të dy historive të kundërta që kemi sot lidhur me të njëjtin realitet historik) ashtu edhe problemeve që përcaktojnë realitetin e sotëm, është e sigurt se asnjëherë nuk garanton implementimin esencial të një kuadri ligjor sado të përparuar qoftë për të drejtat e minoritetit.

Së dyti. Konflikti midis së vertetës reale dhe asaj që kërkohet subjektivisht të egzistojë apo të imponohet.

Së pari përpjekja për të parë aktualitetin dhe për trajtimin e problemëve që rrjedhin nga vizionet evropiane me syzat diakronike të së kaluarës.

Izolimi 50-vjeçar i Shqipërisë dhe pamundësia e njohjes nga afër të realitetëve dhe zhvillimëve që pesonte minoriteti etnik grek këtu, bashkë me realitetin e provuar se komunizmi si sistem është i keq dhe është i tillë në radhë të parë ndaj pakicave kombëtare, siguroi në Greqi një konservim të tezave diakronike për trajtimin dhe zgjidhjen e problemeve të këtij minoriteti në Shqipëri dhe një aktivizim të tyre kur u hapën kufinj të. Pësha e tyre në Greqi u rrit jo thjesht për shkak të trashëgimisë historike, por se në radhë të parë u krijua një vakuum njohjeje të realitetit historik 50-vjeçar lidhur me minoritetin grek në Shqipëri. Nga ana e vet ky minoritet në momentin e rivendosjes së marrëdhënjeve me shtetin am, më shumë manifastoi emocion se sa një vizion të përcaktuar qartë për të ardhmën e tij. Ndërkohë, ndërsa mohimi i shtetit totalitarist në Shqipëri u shoqërua me shkatërrimin e pothuaj të të gjitha vlerave materiale dhe mohimin e të gjitha vlerave shpirtërore e kulturore të krijuara gjatë shtetit monist, në minoritetin etnik grek ky mohim pati edhe një dimesion tjetër. Atë të largimit drejt Greqisë dhe distancimit nga çdo gjë që e lidhte me Shqipërinë. (Ndikoi shumë negativisht për këtë politika shtrenguese dhe tendencioze nacionaliste që ndoqi ndaj tij qeveria e Partise Demokratike). Gjithë kjo situatë çoi shpesh në një ballafaqim të shtrembëruar midis vizionit bashkëkohor evropian dhe kërkesave reale për respektimin e të drejtave të minoritetit etnik

Në Shqipëri pësha e realitetëve të zymta historike, nevoja për të siguruar një unitet ideologjiko-kombëtar mes një ballafaqimi të përhershëm me armiqtë e shovinist që donin të coptonin Shqipërinë, abuzimi sot me këtë nacionalizëm fals të së kaluarës për shkak të mungesës së një vizioni të ri bashkëkohor, apo si mishërim të idesë për rikuperim të historisë, ose si një mjet efikas për të kapërcyer probleme të mbrehta politike e sociale, çon në qëndrime të njëjta edhe ndaj problemëve të minoritetit etnik grek.

Kështu p.sh shpesh nga ana e Greqisë kërkohet që trajtimi i minoritetit etnik grek të bëhet në kuadrin gjeografik të termit Vorio-Epir (si nocion gjeografik të pjesës veriore të Epirit). Një kërkesë e tillë jo vetëm që shkakton re të zëza patetizmi nacionalist në Shqipëri, por janë të dukshme kundër-masat. Sikundërpeshtë minoriteti etnik grek kufizohet arbitrarisht brenda 99-100 fshatrave dhe lihet jashtë parametrave përberëse të këtij minoriteti ajo masë e madhe e pjesëtarëve të tij që gjatë sistemit

komunist kanë migruar në pjesë të ndryshme të vendit. Ose numrit 300-400 mijë grek në Shqipëri servirur nga qarqe të ndryshme në Greqi, i kundërpërgjigjet pala Shqiptare me numrin 59 mijë të regjistrimit të kohës së Enver Hoxhës dhe harrohet se në kushtet e rritjes së barabartë natyrore të popullsisë (si minoritarë grek ashtu dhe shqiptarë), popullsia shqiptare brenda 50 vjetëve u katërfishua ndërsa popullsia në minoritetin etnik grek u rrit vetëm 1.7 herë. Ndërkohë që shmanget kërkesa për regjistrimin e popullsisë ku të shenohet dhe kombësia. Ky konceptim i minoritetit bie ndesh me parimet moderne sipas të cilave respektimi i të drejtave, si të njëriut ashtu dhe ato etnike, kanë karakter individual dhe jo kolektiv apo gjeografik.

Po të shihet me kujdes do të vihet re se për çeshtjen arsimore, egziston, si më 1935, i njëjti arsenal kërkesash nga njera anë dhe masash represive nga ana tjetër dhe harrohet se po trokasin në dyert e BE-së

Minoriteti në rolin e pengut;- Midis dy shtetëve, politikanëve historianëve etj.

Raporti midis njëres palë që mohon historinë dhe tjetres që kërkon të mbeshtetet në të për përcaktuar të drejtat e minoritetit etnik, nuk konvergjon me parimet dhe vizionin evropian të pretenduar nga pala shqiptare. Për problemet egzistuese mendoj se kur strukturat zyrtare të shtetit nuk kanë ndërmarrë akoma asnjë hap për përcaktimin e kuadrit të plotë të statusit të këtij minoriteti, apo dhe të minoritetëve të tjera, në aspektin e madhësisë demografike, të historisë, të etnisë, të trashëgimisë kulturore, etj për implementimin mbi këtë bazë të kuadrit ligjor, por vazhdon të operojë, me mjete dhe metoda të historisë së tejshkuar, kjo nuk mund të krijojë bindje se në këtë drejtim mund të shkojmë përpara.

Ajo që më shqetëson më shumë është fakti se përta i përket të drejtave të minoritetit etnik grek në Shqipëri strukturat zyrtare dhe jozyrtare kanë si pikë referimi nivelin demagogjik të sistemit komunist të respektimit të tyre. Madje kjo po përcakton dhe marrëdhënjet midis njërezve të thjeshtë ku përfaqësues të shumicës nuk mund të "lejojnë" për përfaqësuesit e pakicës me shumë të drejta nga sa statusi i njohur i periudhës komuniste. Fakti bëhet më shqetësues kur vihet re se ky mentalitet po stimulon në të gjitha nivelet kontradiktën midis kuadrit ligjor që relativisht i përgjigjet standartëve ndërkombëtare dhe implementimit të tyre praktik. Po marrë një shembull fare të thjeshtë. Në Vrisera, qendër e komunës së Dropullit të Sipërm me popullsi homogjene greke egziston një klub të një të ardhuri me kombësi shqiptare, i cili i ka venë emrin "Kafe Albania". Askush nuk e ka ngacmuar atë tabelë të shkruar në shqip dhe me atë përmbajtje dhe kafja frekuentohet pa asnjë paragjykim. Tridhjet metra me tutje është një tabelë me emrat e fshatrave të një pjese të krahinës të shkruara në dy gjuhë shqip dhe greqisht. Ajo është fshirë me bojë të zezë dhe mbi të është shkruar "kufijt tanë janë deri në Prevezë" (!!)

Shkrimi në dy gjuhë i emrave të fshatrave në disa komuna me popullsi homogjene greke në përputhje me konventën kuadër, ishte një element që thyente statuskuon e të drejtave të njohura nga sistemi komunist dhe reagimi i njohur i përfaqësuesve të shumicës për zhdukjen e tyre dhe heshtja e palës zyrtare, tregon se rruga e respektimit të të drejtave të pakicave kombëtare do të jetë e gjatë dhe e veshtirë, që kuptohet çon në zgjatjen e rrugës për në Evropë.

**Nga P Barka.**

## **Deformim i paprecedent i realitetit politik në mazhorancë**

12.11.2001/17.11.2001

Shoqëria shqiptare është venë kohët e fundit përballë një realiteti politik të paparë deri më sot. Kryetari i partisë në pushtet ngrihet kundër menyrës qeverisëse të njërezve të po kësaj partie. Kështu ky realitet edhe pse i paparë në kulturën demokratike, evidenton krizën shumplanëshe të procesëve demokratike në vend dhe jo vetëm të PS-së.

Reagimet që pasuan tregojnë më së miri se shoqëria jonë diktohet nga dilemat dhe paragjykime meskine që e bëjnë të mos orientohet drejt.

Së pari Problemi trajtohet si çeshtje që u përket interesave të ngushta të grupeve të ndryshme politike qeverisëse, individëve apo PS-së si parti. Njëkohësisht pranohet nga të tërë se problemet e ngritura qendrojnë pasi çdo qytetar më një mënyrë ose me një tjetër është përballur me to dhe ka provuar pafuqishmerinë për t'u shpetuar atyre. Harrohet që një parti është produkt shoqëror dhe qeverisja prej saj produkt i votës së po kësaj shoqërie. Si pasojë kriza në një parti, aq më tepër qeverisëse u përket të gjithëve. Kjo është njësoj sikur të mos duash të pranosh zjarrin që ka rënë edhe në çatinë e shtëpisë tende dhe me këtë të justifikosh inteferencën tende për sa ndodhin përreth. Se dyti. Edhe pse nuk kemi të bejmë thjeshtë me një krizë morale por me një krizë morale të dukshme si pjesë integrale e një krize më të rëndë, proceset logjike që pasojnë një krizë të tillë janë të frenuara. Për çudinë e të gjithëve deri tani nuk çuan të paktën në një dorëheqje nëpunësi të rangut të fundit, ose në denimin, apo pushimin nga puna të ndonjë titullari. Kjo do të thotë që problemet jo vetëm qendrojnë, por janë të tilla sa mund të çojnë në zhvillime jo vetëm të padëshirueshme dhe të paevitueshme por dhe të pariparueshme, pasi dihet se vendi po mbahet nën mbikqyrjen perendimore dhe me shpresën e rastit të fundit.

Alibitë për këtë realitet politik

Qeveritarët që kritikohen mundohen që krizën ose ta quajnë krizë individit, ose ta injorojnë. Në të njëjtën kohë kur thonë se problemet duhen të zgjidhen në forumet partiake, terthorazi pranojnë egzistencën e tyre (Por sipas tyre, përderisa nuk bëhen objekt diskutimi atje, konsiderohen inegzistente).

Palët që mbrojnë grupin më të kritikueshëm në qeveri, për të shpallur objektivitetin e tyre pranojnë egzistencën e problemeve dhe të krizës. Por në vend që të mirren me to dhe menyrën e zgjidhjes së tyre mirren me retorikën e motiveve të sulmëve të ashpra të kreytarit të PS-së Fatos Nano, ndaj qeverisjes së partisë së tij. Kjo retorikë përmbledhet thjesht tek pyetjet. Pse tani dhe jo më përpara dhe a kërkon Nanua të përfitoj për vete apo të shpetojë partinë dhe vendin.

T'i marrim me radhë.

Problemet që çojnë në krizë apo individit .

Ajo gjë që duhet t'i shqetësojë të gjithë dhe veçanarisht klasën intelektuale dhe shoqërinë civile është realiteti i problemeve dhe mentaliteti apo praktika që i shkakton dhe jo individit, as si përgjegjes e as si ngrekjes ndaj tyre.

Nanua e përcolli qart mesazhin. "Nuk dua, tha, të rrezoj Metën por mentalitetin". Dhe vertet a nuk ishte mentaliteti i krijuar se politika dhe pushteti të bëjnë shumë shpejt të pasur, që krijuan fenomenin Berishë. Më këtë mentalitet nuk e rrethuan më 1997 Fatos Nanon qindrat e badigardëve dhe nuk e lanë të shikonte jashtë murrin të interesave të tyre. Zhvillimi i ngjarjeve pas 97 nuk vertetuan katërcipërisht se Berisha u rrezua që të

zëvendësueshin korupsionistët e vjetër shtetarë me të rinj, ose më sakt shkatërruesit e shtetit a nuk u rrezuan që të vinin në pushtet penguesit e ndërtimit të tij? Pra egziston një mentalitet i mbeshtetur nga një mekanizëm i ngritur mbrenda shtetit që riprodhon të njëjtin fenomen pavarësisht nga vullneti i individëve të veçantë

Kjo logjikë përjashton dhe zërat që thonë, “Të bashkohemi për të rezuar këtë qeveri të korruptuar”. Kjo nuk është zgjidhje për arsye se për katër vitët e fundit ndërruam katër qeveri . Ajo gjë që spikati ishte thëllimi i mentalitetit që, të futemi në rreshtin e politikës dha pasi të bejmë çdo lloj sakrifice të përfitojmë ndonjë post kryeministri, ministri, deputeti, prefekti, apo drejtor drejtorie, të pasurohemi deri sa të zgjidhim problemet ekonomike të katërmbëdhjetë brezave, pa le të bëhet ç’të bëhet.(!!) Zgjedhjet e fundit parlamentare e vertetojnë më së miri këtë logjikë. I njëjti kongluzion arrihet edhe për mendimin e optimit të PS-së

Pse Nanua dhe pse tani.

Theksuam se në këtë realitet të ri politik nuk ka shumë rendësi individi por situata e krizës që kërkon një zgjidhje ndryshe. Pra në kontekstin e këtij raporti nuk ka shumë rendësi emri. Në rastin kongret dhe emri Fatos Nano.

Së pari . Zgjidhja e traumave aq të renda të jetës politike të një vendi është e vertetë se kërkojnë njëzë jo vetëm vizionar por dhe me mundësi për efekte të menjëhershme, që në emer të progresit të mund të terheqin nga prapa njëzë dhe shtresa nga më të ndryshme. Por në radhë të parë duhen njëzë që të jenë të gatshëm për të marrë përsipër një barë të tillë. Fatos Nanua është një emer në politikën shqiptare me shumë peshë. Si i tillë ai ka në karrierën e tij pjesë të ndritshme ashtu si dhe njolla të zëza. Por kuptohet , kur merr përsipër një rol civilizues njollat e murme ose harrohen ose korrigjohen gjatë të njëjtit proces .

Së dyti.. Ai vet, me përvojën politike aq të gjatë dhe emrin që zotëron si investim i tij dhe i shoqërisë ndaj tij, njeh tanimë mirë jo vetëm mentalitetet politike që duhen çrrenjosur, por edhe njëzë që duan megjithmend progresin dhe civilizimin e procesit demokratik në vend. Pra ai vet duhet të ketë kurajon e pendesës së madhe t’u drejtohet këtyre njëzëve dhe t’i ftojë në procesin e nisur, i cili akoma nuk është plotësisht i qartë në objektivat e veta.

Por edhe individë të politikës, të shoqërisë civile dhe të shtresës së intelektualëve duhet të krijojnë një front unik vlerash të reja, pavarësisht nëse kanë apo jo kontakt me Nanon dhe rrethin e tij, pavarësisht se Nanua u soll brutalisht apo me mosmirënjohje ndaj tyre, pavarësisht se për shumë gjera është fajtor po ai.

Por, pas gjithë këtyre akuzave të renda edhe strukturat e tjera të shtetit duhet të veprojnë në emer të ligjit, jo për të bindur votuesin e thjeshtë por për ta inkurajuar atë për të rifituar besimin e vlerës së votës së tij. E theksojmë, momenti kërkon që shoqëria civile shqiptare, në emer të së cilës perendimi harxhoi me dhjetra miliona dollarë, të provojë efikasitetin e vet , për ardhmerinë e demokracisë dhe funksionimin e shtetit.

Në këtë kendveshtrim pra procesi i nisur nga Nanua, pavarësisht nga motivet, nuk duhet lenë që të degradojë, për të kënaqur ambicjet e një personi, kushdoqoftë ai. Kjo klimë dhe rregullat e reja që duhet të përcaktojnë morali i vertet demokratik pas kësaj do të detyrojë edhe lidhshpimin të mos gabojë si deri më sot. Pra ajo që kërkohet është vendosja e rregullave të repta dhe jo një dorë e hekurt.

Vet Nanua duket se po ndërgjegjesohet për këtë . Fillimisht u duk se çdo gjë kishte si motiv ambicjet personale të Nanos të lodhur nga politika aktive për të shkarë drejt postit të presidentit. Ngritja më lartë e flamurit kundër korupsionit , nepotizmit qeveritar, lidhjeve të pushtetit me krimin e organizuar, etj e vertetojnë se tanimë nuk do të këtë kompromise për zgjidhje të momentit apo për të kënaqur ambicjet personale. Forumet e partisë dhe kryetari



Fakti se Nanua nuk zgjodhi forumet partiake për t'i trajtuar problemet e krizës së qeverisjës por opinionin publik me strukturave partiake në bazë, kërkon të na thotë se kriza brenda në parti dhe pushteti i votave të korrptuara nuk do të japë efektin e duhur. Së dyti nënvizon idenë se bëhet fjalë për çeshtje që i përkasin gjithë shoqërisë dhe jo një grupi apëo një individ. Nga ana tjetër tregon vendosmerinë e tij për të mos bërë komromis për vete por për të ndryshuar, kësaj here rrenjësisht ato gjera në parti, në qeveri e në shtet që nuk bien erë demokracie. Çdo komromis për vete, ashtu si çdo përpjekje për t'u imponuar këtyre strukturave autoritetin e vet, nuk do të shenojnë fundin përfundimtar të Nanos por dhe thellimin e idesë së fundit të shpresës për të ndrequr shtetin dhe menyrën e qeverisjes jasht mentalitetit të derisotshëm.

Risqet kur lufton vetëm edhe kur je më të drejtën

Por dhe lufta i vetëm mbart shumë rreziqe për procesin e nisur. Nanua edhe pse përdor në këtë proces institucionin e kryetarit të partisë, edhe pse kësaj here e drejta është më të, ai duke qenë i vetëm ,duhet t'u bejë ballë edhe shumë sfidave. Shpesh, për të qenë më bindës dhe për të fituar terren ai bëhet më agresiv kur nuk dihet ku mund ta çojë vendin agresiviteti i palës tjetër. Rasti i N. Lesit është më shumë domëthnës se eksplozivi në shtepinë e Haklajt, apo dhe se urdhri për N. Brahimin për të kontrolluar lëvizjet e Nanos.

Nga ana tjetër vihet re që individë pelivan në politikë, të tradhetuar nga Meta, apo se shohin se e drejta është me Nanon, i bashkohen atij. Nanua i ndodhur në nevojën e përkrahësve, i pranon , ashtu siç pranojnë edhe ata "t'i përkushtohen prijesit" për t'i kërkuar me vonë reston. Pjesa e shendoshë e shoqërisë, ajo që quhet shoqëria civile dhe që është e interesuar në të vertet për prosperitet , nuk reagon dhe është në pritje. Nëser kur këta pelivan do të formojnë murrin e badigardeve të lidershipit të ri, do të bëhen kritizierët më të suksshëm.

Është e kuptueshme që edhe shoqëria u lodh duke investuar shpresën politike të personi i Nanos. Këtë gjë duhet ta kuptojë më mirë se kushdo vet ai. Por përderisa ai është e disajta herë që u ndodh në fund të malit me gurin e Sifizit mbi vete dhe kërkon përseri të ngjitet, kjo do të thotë se kësaj here do të mundohet të mos gabojë serishmi. Pastaj ai provon të ngjitet, kur të tjerët kërkojnë një strehë për mollët e arta që u fali politika ose një menyrë për t'i shtuar ato FUND P Barka 12.11.2001.

U botua në Koha Jonë më 17.11.2001

## **Nga Panajot Barka**

### **Nanua hedh ne KPD dorashkën, por nuk e ngre askush...**

07.12.2001

Fatos Nano hodhi serish në arenën e politikës shqiptare dorezën. Ajo, edhe pse kësaj here është mbuluar me kadifen e butë rozë, prap se prap bëri shumë zhurmë. Historia rozë e tij doli përballë krizës morale të partisë që drejton. Kjo nxiti mendimin se Nanua përdori moralin e shprishur, sipas tij, të PS-së, për të shpëtuar vetën nga një kosto të rendë politike që mund të shkaktonte në mjedisin tonë konservator mentaliteti i moralit të historisë rozë të Nanos. Mirëpo Nanua e hapi edhe më lojën me autopropozimin i tij për të qenë presidenti i ardhshëm i vendit dhe kjo çorjentoj rjedhën e politikës që impononin të huajt, jo vetëm të PS-së, por dhe të vendit.

I gjithë ky silogjizëm bëri që doreza e hedhur e Nanos të mbëtej atje, mbi tapetin arenës e kudruar nga të gjithë, por nga pika të ndryshme veshtrimi. Disa e shikojnë si dorezën e të mundurit, disa si hakmarrje për plengprishësit, disa si dorezën e vëllait të madh që nuk e degjon më njëri, disa si mënyrën më të mirë për t'u imponuar partisë për t'u çvendosur në postin Presidentit të Republikës si terheqjen më prestigjioze dhe njëkohësisht më e butë nga politika aktive. Ca të tjerë e shikojnë si aktin e fundit të ciklit të mbyllur të një politikani eksponent në politikën e dhjetëvjeçarit të fundit në Shqipëri Ka dhe nga ata që mendojnë se Fatos Nano e lëshoi dorëzën për të shpëtuar Partinë Socialiste nga katastrofa dhe për të penguar ardhjen e Berishës në Qeveri.

Fakt është që Nanua ia arriti qëllimi të parë. Çudia "Xhoana" nuk bëri përjashtim nga rregulli. Nuk zgjati më shumë se tri ditë. (Ndërsa historia "Rexhina" do të përbejë më sa duket aktin me dramatik të skenarit me tradhëti politike ndaj Nanos të kohës së Bençës që ai sigurisht do ta luaj në betejën politike branda llojit që sapo nisi).

*Realiteti i krizës në PS dhe formula e luftës politike e Nanos*

Formula e luftës politike e Fatos Nanos duket se u shpalos në Gjirokastrë. Ai tha qart aty se kriza morale çon në krizë institucionale dhe kriza institucionale në zgjedhje të parakohshme.

Nuk rendësi nëse e pranojnë apo nuk e pranojnë socialistët krizën. Përplasja e kujdoqoftë me institucionin e kryetarit të partisë reflekton krizë. Kjo krizë pavarësisht nga forma e shfaqjes ka disa shkaqe. Së pari është produkt i përplasjeve të vjetër në P.S midis grupit të nënkryetarëve dhe Nanos së burgosur që morën formën e plotë në mocionin e Nanos për kongresin dyfazor të PS-së në vitin 1996. Në rrugën e gjatë të përplasjeve Meta me taktikën sulmuese duke fshehur ambicjet e karrierës i shkepuste Nanos terren nëpërmjet postëve deri në atë të Kryministrit. Shkaku i dytë duhet kërkuar në defektet e qeverisjes. Korupsioni, trafiqet, kriza energjitike, nepotizmi klanor e krahinor përbejnë një plagë shumë të mëdha për qeverinë. Se treti, shkaqet duhen kërkuar tek dualizmi konfliktual në kreun e partisë në pushtet me një kryetar dhe një kryeministër. Kjo duhet parë jo si deshtim i formulës së njohur se sa si rishfaqja i përplasjeve të vjetër. Kryeministri ambicioz nga njëra anë ndjen vazhdimisht revanshin e kryetarit kongret të partisë dhe nga ana tjetër mendon se duke pasur në dorë edhe partinë mund të qeverisë pa problemet e tanishme të brendshme

Nanua e kuptonte se Meta po shkonte shumë larg në ambicjet e tij dhe bëhej gati për të filluar betejën kundër tij që para zgjedhjeve. Fjalimi para elektoral në Lezhë ishte sinjali i parë ku Nanua veç se pati si mbeshetje akuzat e Perendimit për qeverinë Meta, kërkoi në krah të betejës së tij edhe shtypin. Por hoqi dorë se mund të bëhej shkak që

PS-ja të humbiste zgjedhjet. Kjo përplasje u bë e pashmangshme pas humjeve të njëpasnjëshme të Nanos brenda forumëve të partisë, ku ai mbeti në minorancë, madje edhe pa bashkëpunëtorët e tij më të ngushtë që shumë herë e nxorrën nga balta.

#### *Realiteti i luftës politike të Nanos*

Po cili është qëllimi i Nanos ? Kërkon vertet shpëtimin e partisë nga kriza morale dhe të qeverisë nga deshtimi i aferm, apo kërkon që duke iu imponuar strukturave të partisë dhe instancionëve shtetërore në emër të asaj që vertet shkon keq në qeveri e parti, të reshqas në postin e presidentit, ose të paktën të rimarrë në mënyrë të përforcuar drejtimin e partisë? Mësa duket synimi kryesor është presidenca

Mjetët që zgjodhi Nanua në këtë betejë janë të thjeshta. Së pari. Ai rikerkon edhe njëherë mbeshtetjen e bazës. Për këtë ai rrembeu flamurin e rrezikut të partisë dhe humbjës se ngahërshme të pushtetit nga qeverisja e keqe. Në pari ai ka të drejtë dhe të gjithë e dinë se vetëm nevoja për një Shqipëri të stabilizuar politikisht në një rajon të trazuar, lufta kundër terrorizmit dhe faktori Berishë, përbëjnë faktorët e përkrahjes Perendimore të Metës. Por a ka të drejtën morale Fatos Nanua në këto pretendime. A mund të arrijë kryetari i një partie të shajë në publik qeverinë e partisë së tij? Kjo do të thotë se kriza e brendshme në PS dhe në qeverinë e saj kanë shkuar shumë larg dhe PS-ja humbet automatikisht të drejtën e qeverisjes. Nga ana tjetër vet Fatos Nanua nuk ka të drejtën morale të kërkoj tani llogari. Dhembët e mosmirnjohjes i tregoi ai fillimisht tek bashkëpunëtorët e tij. Rrathet e korupsionit dhe të trafikëve u trashën nën hundët e tij gjersa zunë shtetin prej fyti. Arrivizmin në parti e kultivoi po ai, ashtu siç ishte ai që lejoi të thellohej mentaliteti i kohës së Berishës se pushteti politik në Shqipëri, është biznesi më fitimprurës në botë.

Mëgjithatë, po të kemi parasysh kompromiset e deritanishme në PS, të imponuara nga nevoja e mbajtjes së pushtetit, “lufta parimore “ e Nanos, mund të çojë në rizgjedhjen e tij në krye të PS-së. Në rast se Nanua e ka ndarë mendjen për postin e Presidentit, ai në një fazë të dytë mund ta banalizojë edhe më luftën kundër Metës duke nxjerrë nga arshivat në publik ose “në vende të caktuara” gjithçka zotëron nga “bëmat” e kundërshtarëve të tij. Dhe kuptohet se ka materiale të bollshme për këto gjera.

Së dyti. Ai, duket se në shërbim të ambicijës për president, kërkon të shrytëzojë institucionin e kryetarit dhe minorancën e kontrolluar prej tij për efekte bllokuese në parti, qeveri, parlament, me kërcenimin për zgjedhje të parakohshme. Kjo kuptohet mund të japi efekte të mënjëhershme por shumë të rënda për PS-në dhe qeverisjen e saj. Brenda logjikës së politikës shqiptare pra, kjo do të thotë se midis dy të keqijave PS mund të pranojë të keqën më të vogël. D.m.th PS-ja më një kompromis të brendshëm të pranojë që 84 votat e kontrolluara prej saj në parlament të shkojnë pro Nanos kur të vijë koha e zgjedhjes së presidentit. Një lëvizje e tillë do të ishte një veprim elegant i P.S-së për të larë duart me Nanon

Mirëpo, Nanua i trembur nga pabesitë që ai edukoi në parti, kërkon garanci që tani për këtë. Mirëpo PS-ja nuk mund të japi garanci të tilla kur dihet që, sipas orientimeve të Perendimit, që për ne janë si orientimet e kahershme të Partisë së Enverit, zgjedhja e presidentit nga opozita verën e vitit 2002, përbën zgjidhjen e mundshme të krizës tjetër, asaj të bojkotimit të parlamentit nga opozita.

Eshtë kjo arsyeja që PS-ja krizën e vet qoftë edhe si përplasje me Nanon, kërkon ta paraqes si krizë personale të kryetarit. Kjo thekson mundësinë e humbjës së kontrollit nga ana e Nanos dhe çuarjen e tij në veprime nga pozitat e humbësit të madh. Një taktikë e tillë mund të çojë dhe PS-në në një pozitë humbëse të pushtetit dhe të unitetit të mbajtur, sidomos vitet e fundit, nga egzistenca e këtij pushteti.

Nga ana tjetër kalimi i Nanos në postin e presidencës zgjidh problemin e Nanos, ndërsa problemet e PS-së vetëm përkohësisht. Madje do të humbasë një pikë referimi për këtë

unitet. Ndërsa në planin e përgjithsëm rishtrohet për zgjidhje spektri i politikës shqiptare.

Një zhvillim i tillë kuptohet që do të ndryshojë madje dhe i ndryshon rjedhat edhe në PD-në e Berishës. Presioni i jashtëm dhe presioni i brendshëm në këtë parti të imponuar nga humbjet e njëpasnjëshme zgjedhore, mund të çojnë në kongresin e dhjetorit në heqjen e Berishës nga kreu i PD-së, në ristrukturimin e një të djathtë të bashkuar dhe kalimin e pushtetit tek ajo. Mirëpo zhvillimet e mundshme të përshpejtuara në PS, deri në mundësinë e provokimit të zgjedhjeve të parakohshme, mund të radikalizojë serishmi qendrimet në PD me mendimin se kësaj here edhe me Berishën mund të fitohen zgjedhjet. Një zhvillim i tillë do të sjell si pasojë domosdoshmerinë e balancimit të Berishës serishmi nga Nano. Kështu krijohen premisa që politika shqiptare mund të riblokohet serishmi në këto dy emra **FUND PANAJOT BARKA**

# KPD-ja e Partisë Socialiste, të gjithë kundër të gjithëve dhe e persia e sulmuar e NANOS (PS- një mjegull e ndriçuar)

/14.12.2001



mentaliteti i servitur nga kryetari i kësaj Partie Fatos Nano, i shprehur në parimin paksa populist, për një shtet në sherbim të qytetarëve kundër krimit të organizuar, korrupsionit, trafikëve dhe oligarkisë politike të një grupi. Të dy këto ngjarje që pasuan triditëshin e demokracisë së dyshimt të LPD-së treguan qart se tendenca e parë e ka të pamundur të gjej një rrugë tjetër në të përshtatshme përdaljen nga kriza, duke na kujtuar edhe një herë arqetipin makbethian të krimit që kërkon krim i bindur se s'kishte nga t'i vinte vdekja. Në rastin tonë se nuk kërcenohet pushteti nga zgjedhje të reja.

Në këtë kuadër demokracia e servitur në KPD, si përse i përket transparencës në komunikimin publik dhe qetësisë olimpikë për të thenë e degjuar pa kriter gjithçka, për të gjithë dhe nga kushdo, i ngjan një mjegulle të ndriçuar fort nga dielli por që nuk mbulon dot shtrembërimet e thella demokratike në mentalitetin qeverisës dhe në drejtimin e shtetit duke e rivenë atë edhe një herë në rrezik permanent. Kjo duket qartë në drejtimet e mëposhtme

## Raportë të përmbysura në problematiken reale të krizës.

Në dabinat e pashembullit treditor u ravijëzua qart se të gjitha palet e kishin kuptuar se të vetmën gjë që nuk duhet të shembnin ishte pushteti ekzekutiv. Interesat e kundërta drejt këtij qëllimi, përcakton edhe thelbin e përplasjes së madhe brenda llojit, ose krizën reale por të papohuar drejtpërdrejt nga vet PS-ja

Njëra palë ajo e Nanos, këmbëngul se mënyra e keqe e qeverisjes, si komfort i interesave personale të identifikuar në trafikë, kontrabandë, krim të organizuar që imponojnë çdo ditë e më shumë përqendrimin e pushtetëve në dorë të një grushti njërzësh çon detyrimisht në humbjen e pushtetit dhe në shkatërrim të shtetit.

Pala tjetër këmbëngul në fshehjen e ujkut për të treguar gjurmët. E shikon rrezikun e humbjes së pushtetit si pasojë të krizës së pamotivuar, sipas tyre, të shkaktuar nga kryetari Nano dhe të mungesa e efektivitetit të funksionimit të forumëve të PS. Shprehje e kësaj problematike të përmbysur është fakti që pas gjithë asaj zhurme u aprovua një rezolutë për të përkrahur qeverinë Meta me këmbënguljen për të konsideruar pozitive ato që s'u bënë apo duhet të bëhen dhe u votësua Kryesia e KPD-

Mbledhja e kryesisë së PS-së dhe takimi i Nanos në Durrës si zhvillime që pasuan KPD-në e PS-së evidentuan qart kontradiktat të qenësishme brenda PS-së midis dy mentalitetëve: I pari që kreministri Meta lejon t'i diktohet (se i shkon përshtat) dhe që synon uzurpimin e të gjitha pushtetëve, që çon në të njëjta përfundime si me pushtetin absolut të Berishës parë 1996, dhe i dyti, është

së si një instrument për të bllokuar apo demotivuar pretendimet e Nanos. (Në takimin e Durrësit Nanua edhe pse brenda linjës së partisë së vet, provoi egzystencën e së njejtës kondradiktë si më 1996-97, atë midis popullit dhe pushtetit absolut të Berishës)

Votbesimi i kryesisë në këtë kendveshtrim, përbën një përpjekje të hapur për të kaluar në duart e grupit qeverisës dhe një pushtet tjetër, atë politikë, frenat e partisë. Votimi pak ditë më vonë i ministrave të rinj në kryesi, ishte vazhdim i kësaj rruge që shenoi edhe thellimin e krizës

### **Populizmi në KPD.**

Fatos Nanua në pamundësinë për të venë në lëvizje forumet e larta partiake që shembeshin nga pesha e presionit shumëplanesh të pushtetit ekzekutivpo të partisë së tij, zgjodhi bazën e piramidës së PS-së dhe opinionin publik për të parandaluar thellimin e krizës të shkaktuar nga mënyra e qeverisjes. Për këtë ai u akuzua rend në KPD për populizëm. Mirëpo askush nuk vuri re populizmin në KPD që u shfaq.

Së pari në shpërdorimin e së drejtës së fjalës për përbaltjen e institucionëve. Tre ditë shumë prej 60 diskutantëve të lartë të PDS-së nxorrën nga skutat e errëta të shpirtit meskin apo dhe në emer të mbrojtjes së “idhullit” të tyre, (në fakt duke llogaritur interesin e tyre), gjithçka të zezë e të errët për të denigruar kundërshtarin, qoftë ky kryetari i partisë, kryesia e saj, apo dhe qeveria. Aq shumë u zhvillua kjo menyrë të argumentuari sa që u kthye në modë e imponuar edhe për ata që mendonin të argumentonin në mënyrë parimore.

Së dyti. Në barazimin e individit me institucionin. Kuptohet që të gjithë anëtarët e një forumi janë të zgjedhur. Por kryetari i partisë përbën një institucion me vete në hierarkinë e forumëve partiake dhe të zgjedhurit e tjerë janë individë. Mirëpo në KPD-në e socialistëve individë pa emer politik dhe të panjohur në jetën civile, të mbërthyer ndoshta nga vllaga e klimës së përplasjes, apo për të provuar egzistencën e tyre lëshuan nga një rreke me vogëlsira, ofendime e sharje kundër kryetarit të tyre, me idenë se kontribonin në lumin që degjuan se ishte projektuar kundër tij. Kjo nuk mund të quhet demokraci por defiçit demokratik që vjen si pasojë e keqinterpretimit të parimit demokratik të barazisë.

Së treti. Në mungesën e qellimeve parimore për morinë e faktëve të servirura. Ato janë disa herë më shumë se ato që Nanua, në emer të parandalimit të thellimit të krizës i serviri bazës së partisë dhe opinionit publik. Kësisoj populizmi i KPD-së u shndërua në rrezik real për zvogëlimin e kredibilitetit të forumëve të vet partisë socialiste dhe të qeverisë së saj. Si moralisht, ashtu dhe juridikisht PS-ja demotivoi vetën për të vazhduar për të qeverisur në këtë menyrë

### **Sentenca e Majkos.**

Pandeli Majko tha në KPD se “Ju deshët të na burrëronit shpejt mua dhe Ilirin”. Ishte një konstatim që shpreh në fakt një të vertet të madhe të kontraditave të përhershme brenda PS-së me shumë me objekt goditjesh, se sa protagonist, Fatos Nanon. Sentenca e Majkos verteton atë se grupe të caktuara brenda në PS, kur e shikonin se nuk i dilnin dot ballë për ballë Fatos Nanos vunë në majë të shigjetës së tyre kundër tij një herë Pandeli Majkon dhe tani Ilir Metën. Më këtë deklaratë Majkua pohon se entuziazmi i moshës dhe shtysa lajkatare e këtyre grupëve nuk i la hapësirë atij për të parë se po versulej kundër një simboli politik, për të cilin të gjithë kishin kontribuar dhe kësisoj fitorjsa ndaj tij ose do të ishte e pamundur ose do të ishte si Piros. Se fundi ishte kjo një këshillë për bashkëmoshatarin e tij Ilir Metën se jo vetëm nuk mund të përplasesh me simbolet, aq më tëper kur këto simbole janë shprehje e unitetit të partisë përmes të kundërtave.

### **Nano dhe Meta**

Epersia e Nanos ndaj Metës nuk qëndron vetëm tek konstatimi i Majkos. Meta është eksponent politik për shkak të pozicionit Kryeministër të fituar pse jo nga përplasjet e vazhdueshme me Fatos Nanon .Mirëpo në këtë ndeshje finale Meta erdhi duke qenë nga njëra anë mburojë e një grupi njëërëzish që e shfrytëzuan atë dhe postin e tij për të bërë pasuri duke abuzuar me pushtetin. Nga ana tjetër duke qenë shprehës i interesave antinano, ose i interesave për të shtënë në dorë dhe Partinë. Të dyja këto grupe nuk e lenë Metën të bëjë mprapa. Në ngecjen e parë Meta u detyrua të leshojë tre-katër minsitra që të mund të vazhdojë ai më tutje. (Kjo taktikë u çvlerësua mënjëherë në kryesi e pas disa ditëve)

Nanua vjen në këtë përplasje pasi u çlirua nga të njejta grupe, të cilët lëvizën drejt Metës pasi kujtuan se vapori i Nanos po mbytet. Njëkohësisht Nanua mban në dorë flamurin për sherimin e qeverisjës nga semundjet vdekjeprurëse, të cilën Meta, nën asfiksionin e grupëve që asfiksuhan dikur dhe Berishën dhe Nanon dhe Majkon, nuk e lenë t'i afrohet.

Meta duke ditur se potencialet e tij nuk mund të ballafaqohen me ato të Nanos përdori taktikën e sulmit me shumë shënues . Mirëpo përkushtimi i tyre patetik krijoi një imazh tjetër përfundimisht negativ për të.

Nanua u përball i vetëm më këtë grup të Metës duke u krijuar përkrahësve të tij terren për të folur parimisht jasht rrezës së goditjes së përkrahësve të Metës.

#### **Sfida e Nanos kryetar në minorancë**

Grupi i Metës e kuptoi se Nanua si figurë politike përbën një domosdoshmeri për qëndrueshmërinë dhe unitetin e forcës politike që përfaqësojnë të gjithë. Kështu në kushtet e pamundësisë për ta mënjeluar nga kreu i partisë ata pranuan t'i impononin një situatë tjetër. Ta mbajnë si kryetar por të demotivuar dhe në minorancë brenda partisë Kjo do të thotë që Fatos Nanua të kontribuojë për unitetin e partisë dhe garantimin e qeverisjës së re katërvjeçare dha ata të kontrollojnë si qeverinë ashtu dhe partinë.

Mirëpo Nanua duket se përfundimisht e kuptoi se baza e qëndrueshme e partisë nuk janë as ata që e duan duke bërë llogari, as militantët me vlerë të vetëm militantizmin e interesave personale, por kapitalet e verteta intelektuale e profesionale brenda dhe jasht partisë. Ai kuptoi gjithashtu se pa këto kapitale dhe ylli i tij do të perendoj shumë shpejt, dhe qeveria socialiste do të rivotohet, dhe shteti nuk do të bëhet. Kundërshtarët e tij nuk e kuptuan se ky moment përbën edhe fillimin e katharsis së vet Fatos Nanos . Duke mos e stimuluar këtë kahje, ata tregojnë se mbrojnë të kundërtën.

Një situatë e tillë motivon plotësisht këmbënguljen e Nanos së KPD-ja shenoi fillimin e zgjidhjes së krizës. Zgjidhja e saj varet nga predispozicioni i palëve.Ajo mund të jetë vertet pozitive për të gjithë ashtu si dhe dramatike po për të gjithë. Mëgjithatë bathet flasin për të dytën **FUND**

**U botua ne Koha jone, me 14 dhjetor 2001 faqe 7**

# Kundër N. Gaxojannis, apo kundër helenizmit!?

8.12.2002/15.12.2002



Përonalisht nuk më shqëtësoi aq kjo dukuri, aq sa ndërvarja e stuhisë propagandistike me komunitetin e minoritetit etnik grek në Shqipëri, ku përseri për të folën dhe gjykuan të tjerët por jo vet ai apo përfaqësuesit e tij. Ky përbën dhe motivin kryesor të këtij shkrimi dhe botimi i tij, veç të tjerash bësoj se do të mirret si shenjë respekti për pakicën. Pra mendoj se realiteti i ditëve të fundit provoi se mjaftuan deklaratimet e një eksponenti, goft edhe si individ, për të provuar falsitetin e qendrimëve Evropiane civilizuese e integruese të faktorëve të lartpërmendur shqiptarë, për të provuar gadishmerinë e tyre në efikasitetin e rindezjes së skenarëve me luftë të ftohtë.

Në një plan të përgjithshëm, kur shfaqet nga faktorë të lartpërmendur me aq peshë të botës shqiptare, sigurisht që demton aspiratën për promovim të procesëve civilizuese që do t'i hapin vendit rrugën aq të dëshirueshme drejt Evropës.

Por shumëanshmeria e reagimëve të shtyn me tutje logjikën. Flet për këtë thelbi kontradiktor në reagimet ndaj deklaratave Geixhit. Reaguesit në kor, konstatuan se Nikos Gaxojanis nuk përfaqëson as qeverinë amerikane, as qeverinë greke, as ndonjë institucion ndërkombëtar dhe se “ylli i tij ishte në të perënduar”. Atëherë pse gjithë kjo zhurmë dhe ky reagim? Pse gjithë këta faktorë potentë thirrën në ndihmë gjithë arsenalin diplomatik, historik, patriotik, madje e shkëncor për të kundërshtuar tezat e Gaxojanit?

Kuptohet, është veshtirë për ta interpretuar këtë sjellje si frikë të shumicës ndaj një individi, Po ashtu nuk mund të interpretohet ideja se reagimet ishin pjesë të një skenari për të vertetuar tezat e Gaxojanit. (bën vaki që për një pjesë kjo të jetë e vertetë). Veshtirë të pranohet se gjithë kjo zhurmë u zgjodh si një mjet efikas për të kundërshtuar instancat që mund të përfaqësojë Gaxojani sidomos në SHBA, kur dihet roli i tij në avënin politik në lidhje me pushtetin të të djathtëve dhe të majtëve në Shqipëri.

Më veshtirë është të pranohet ideja se faktorët e lartpërmendur të botës Shqiptare reagan në këtë menyrë ndaj N. Gaxojanit se nuk kishin mundësi “për të venë në

Zhurma anti-Gage që pasoi vizitën e tij javën e kaluar në Tiranë nuk mund të ketë si objekt të vetin, thjesht individin Niko Gaxojanis me shtetësi greke dhe amerikane dhe kombësi greke dhe as deklaratat e tij. Me dashje apo pa dashje segment të tilla të botës shqiptare, si medja, politikanë apo dhe ish politikanë të rangjeve nga më të larta, përfaqësues shoqatash apo dhe të lobit shqiptar në SHBA, ranë viktimë të vetvetës duke nxjerrë në pah thelbin e kompleksit konfliktual që orienton veprimtarinë e tyre në lidhje me botën Greke.



shpatulla prej muri” shefat e pozitës dhe të opozitës që ftuan dhe pritën N. Gaxojanin në Tiranë.

Mbetet që kjo zhurmë të kishte si qëllim marginalizimin dhe pengëzimin e minoritetit etnik grek në Shqipëri në kerkesat e tij për implemetimin e të drejtave të parashikuara në akte ndërkombëtare, të cilat pas ratifikimit nga parlamenti ynë kanë vlerë juridike të brendshme, ose përbëjnë një test vlerësimi për emancipimin demokratik të vendit. Kishte si qëllim trajtimin e këtyre kerkesave nga ana përfaqësuesve politik të minoritetit grek si një kontinuitet fiso midis tyre dhe ekstremizmit, sipas tyre, të nacionlizmit grek, të përfaqësuar nga Geixh.

Në këtë plan, politikanë, gazetarë, analistë eksponentë të ndryshëm duke sulmuar Gaxojanin, marrin shkas për të konturuar me argumente të njehta marrëdhënjet Shqipëri – Greqi apo fajësimin e Greqisë për një përkeqësim të mundshëm të marrëdhëneve ndërshtetërore ose pengëzimin në këtë kuadër të minoritetit etnik grek në Shqipëri. Shumica e të angazhuarve në këtë arenë propagandistike, e përdor minoritetin etnik grek për të krijuar reciprocitete dhe analogji negative, kundërpesha dhe paralelizma me faktorë pa asnjë lidhje reale dhe si pasoj u referohen të drejtave të këtij minoriteti me një status të njohur historik e etnik, për të kërkuar të drejta për faktorë të tjerë me status krejt tjetër në Shqipëri apo Greqi. Ose për veprime dhe qendrimë që i përkasin shteti Grek, kërkohet të japi llogari minoriteti etnik grek në Shqipëri.

Nuk mundëm dhe nuk më takon mua të marr në mbrojtje Niko Gaxojanin për arsyen e thjeshtë se nuk ka nevojë për mbrojtjen time. Por nuk mund të mos vihet re se pesha e emrit dhe tezat e tij që perdoren në propagandën e ditëve të fundit, ka si element të ri importimin në Shqipëri të përplasje së lobëve analogë në SHBA, fenomen që u eksportua fillimisht në Rumani në mesin e shek. të XIX dhe më pas, në fillim të shek. XX në SHBA, si konflikt interesesh midis shqiptarëve e grekeve në prag të shpërbërjes së perandorisë otomane.

Ndërkohë, përse i përket problemit të respektimit të drejtave të minoritetit etnik grek edhe në debatin e ditëve të fundit konstatohet me keqardhje se si në nivel zyrtar ashtu dhe në mentalitetin e opinionit publik shqiptar, kanë zenë rrenjë parimet e përpunuara nga rregjimi komunist. Si rezultat kongludohet se të vetmën gjë që ka bërë mirë diktatura komuniste, është respektimi i të drejtave të minoritetit grek në Shqipëri. (pavarësisht se ai përmendej thjesht me termin “minoritet” pa asnjë identitet etnik dhe, si sot, identifikohet vetëm me krahinën e Dropullit)

Në bazë të këtyre parimeve kemi edhe sot të njëjtën taktikë pavarësisht nga terminologjia perendimore e përdorur. Kështu nga njëra anë bëhen përpjekje për të krijuar një vitrinë për gjoja respektimin virtuoz të këtyre të drejtave në bazë të standartëve ndërkombëtare, nga ana tjetër konstatohen përpjekje maksimale për të mos lejuar më shumë të drejta, jashtë atyre të lejuara nga sistemi komunist ose, për t’u dhenë atyre trajta formale ashtu si në komunizëm. Kështu mund të kuptohet rezistenca e shtetit në fillim të vitëve 90’ për të mos lejuar hapjen e shkollave në gjuhën amtare edhe për femijët e anëtarëve të minoritetit grek jashtë zonave të 100 fshatrave, si dhe rezistenca për ndryshimin e raportëve të mësimëve në gjuhë amtare dhe në gjuhë zyrtare. Kështu kuptohet reagimin denigrues nga struktura të kontrolluara nga shteti për mos lëjimin e përdorimit të gjuhës amtare apo dhe të dygjuhësisë në mbishkrimet publike dhe tani se fundi reagimi po i shtetit për mos shënimin e kombësisë në regjistrimin e popullsisë.

Në këtë pikëveshtrim kemi transformimin e parimit të ideologjisë komuniste të shtetëve armiq përmanente (që i siguronin regjimit totalitar një unitet ideologjik nacionalist), në parimin e frikës nga pakica, e cila, në kushte e hapjes së vendit me

botën shikohet si një mjet në duart e shtetëve armiq përmanente dje kundra Shqipërisë sot (!!).

Lë të mos harrojmë se komuniteti i minoritetit etnik grek në Shqipëri përbën sot një faktor stabiliteti të brendshëm dhe rajonal që duhet marrë në konsideratë. Ai nuk i ka nxjerrë asnjë problem etnik shtetit shqiptar, manifeston në maksimum respektimin e ligjit dhe është egzigjent në marrëdhënjet e tij si me shtetin ashtu dhe me shoqërinë. Mëgjithatë nuk është se janë pa pasoja qendrimet e lartpërmenduar. Pasha e tyre ka ravigjësuar në gjirin e tij dy qendrimet të cilat edhe pse si shfaqje ideologjike kanë në themel përceptimin e realitetit të ri. Nga njëra anë është grupimi që ritheret në ndihmë mentalitetin e periudhës komuniste, dmth, të mohimit apo të ruajtjes formale të identitetit etnik për përfitime personale. Nga tjetër është grupimi që i mëshon idesë së theksimit dhe zhvillimit të identitetit etnik, që në rrethana të caktuara, sidomos jasht kufijve merr trajta nacionaliste deri dhe ekstremiste.

Sido që të jetë puna, frika e shfaqur serishmi ditët e fundit ndaj pakicës, apo përpjekja për të zbatuar më të praktikatat e pengut, nuk është se prishin vetëm imazhin e proceseve demokratike në vend por krijojnë dhe precedentet të veprimit “të faktorit minimal”. Kjo presupozon pengimin e faktorëve që prodhojnë situata të tilla ngado që të vijë dhe në radhë të parë frenimin e fenomenëve nacionaliste që manifestohen ose si eufori ,ose si nevojë për egzistencë.

P: BARKA 8.12.2002

U botua disa dite me vone eshte ruajtur gazeta “Koha Jone”

# Nga P Barka Pronësia mbi tokën dhe politika neotmaniste

15.01.2003/ 23.01.2003

8 8 janar, 23 janar 2003 **Rajha Janë**

## Speciale

Analiza

# Pronat dhe presionet prej saj

NGA PANAJOT BARKA

**A**jo që është e vërtetë sot ka të bëjë me faktin se prona private si shtylla themelore mbi të cilën mbështetet procesi i zhvillimit ekonomik-shoqëror dhe përkundrazi një vendi në kuadrin e parimeve të tregut të lirë, në vendin tonë është futur në një proces të veshtirë. E keqja është se problemet që kërkojnë zgjidhje bëhen në kushtet e presioneve shumëplanëshe duke mbartur kështu rrezikun e rikollimit të konfliktëve sa të vjetra, historike, astu dhe të reja.

Cilat janë çështjet e presioneve. Së pari, është presioni i ish-pronarëve cilëtdo qofshin ata. Së dyti, presioni i gjithanshëm për krijimin e garancive mbi pronësinë për stimulimin e investimeve të huaja apo vendase, së treti, kërkesat nga institucionet evropiane që zgjidhjen e problemit të pronësisë, sidomos mbi tokën, e shikojnë si garanci për proceset integruese të vendit tonë, së katërti, është presioni i pronarëve të rinj. (Pjesa që nuk është pronare e ligjshme kërkon sa më shumë mjegull për të fituar dhe kohë për të gjetur një mënyrë për ta ligjesuar atë. Pjesa që është e ligjshme për t'i shfrytëzuar në mënyrë rentabël), Së pesti ajo pjesë e popullsisë e cila për shkaqë objektive, historike, shoqërore apo demografike nuk përfshihet në rrrathet e ish pronarëve apo të trashëgimtarëve të tyre, etj. Të gjithë këta faktorë, megjithëse ushtrojnë presion për "zgjidhjen e problemit", zgjidhja që kërkojnë nuk ka një amplitudë të njehsuar, por është shprehje interesash shpesh jo thjesht të kundërta por shume të mbrehta në kontradiktën e tyre.

**PAKICA E ISH PRONARE DHE SHUMICA POPULL PA PRONË**

Për sa kohë aspirata e ish pronarëve si pakicë në minjaturë nuk është bërë realitet, do të ruhet pak a shumë njëtrajtshmeria midis rradhëve të popullsisë. Mirëpo në momentin që mund të ndodh diferencimi, kur ajo pjesë e popullsisë që sot nuk figuron si ish pronare do ta shikojë vetëm të çveshur nga prona, logjike e pritshme është që të reagojë. Por duke qenë se çdo vendim i marrë do të jetë veshtirë për t'u ndryshuar, atëherë krijohen premisa për një kontradiktë të qëndrueshme brenda kuadrin mbarë shoqëror.

Ky rrjedhim logjik buron nga disa faktorë të përbërë objektivë dhe për të shmangur kontradiktën e thella dhe të qëndrueshme ato duhen marrë seriozisht parasysh.

Dihet që forma pothuaj e vetme e pasurisë së patundshme si pronë private në vend janë format e pasurisë që lidhen me tokën. Nga ana tjetër, si e tillë toka ka qenë për shekuj me radhë objekti i vetëm i prodhimit i të mirave materiale dhe me të ishin të lidhur pazgjidhshmerisht si pronarët ashtu edhe jo pronarët. Kjo do të thotë se problemi



ligjore ekzistuese të 1990-93 për kthimin e pronave të pronarëve, dëshmimi bazë për njëqen e pronësive është një dokument antidor. Lind zyrtarisht për të bërë të mundur për pronarët Oromane, të Vidit, të Austrohungarezëve, të Francëve, për qeverinë e Kongresit të Luarmës, të Nolit, të Zogut, të Shtrëtit të qeverive Kuslinge të para dhe të gjatë Luftës së Dytë Botërore.

Nëse do të ndodh si deri tani, përveçse do të kemi problemet e lartpërmendura do të na shtojnë si pronarë mbi toka, godina, rrugë e pasuri të tjera me vlerë kombëtare përfaqësues të shtetëve që kanë marrëdhënie pastre me vendin tonë, të cilët kanë nga një akt zyrtar të shtetit shqiptar që i njëjtë ai protektor. Çfarë do të bëjë që të rritet shumë i madh ish-pronarësh shqiptar të kanë shtuar atëherë pasuritë e tyre faktoreve të lartpërmendur dhe tani i rikërkojnë këto pasuri që nuk janë nga shtetet dhe kompanitë që para shtetit vëmë dhe i shpikuar ato. Kjo-

premsa për një kontradiktë të qëndrueshme brenda kuadrin mbarë shoqëror. Ky rrjedhim logjik buron nga disa faktorë të përbërë objektivë dhe për të shmangur kontradiktën e thella dhe të qëndrueshme ato duhen marrë seriozisht parasysh. Dihet që forma pothuaj e vetme e pasurisë së patundshme si pronë private në vend janë format e pasurisë që lidhen me tokën. Nga ana tjetër, si e tillë toka ka qenë për shekuj me radhë objekti i vetëm i prodhimit i të mirave materiale dhe me të ishin të lidhur pazgjidhshmerisht si pronarët ashtu edhe jo pronarët. Kjo do të thotë se problemi

Ajo që është e vertetë sot ka të bëjë me faktin se prona private si shtylla themelore mbi të cilën mbështetet procesi i zhvillimit ekonomik-shoqëror dhe politik i një vendi në kuadrin e parimeve të tregut të lirë, në vendin tonë është futur në një proces të veshtirë. E keqja është se problemet që kërkojnë zgjidhje bëhen në kushtet e presioneve shumëplanëshe duke mbartur kështu rrezikun i riciklimit të konfliktëve sa të vjetra, - historike, - ashtu dhe të reja.

Cilat janë drejtimit e presioneve. Së pari është presioni i ish pronarëve cilëtdo qofshin ata. Se dyti presioni i gjithanshëm për krijimin e garancive mbi pronësinë për stimulimin e investimeve të huaja apo vendase, se treti kërkesat nga institucionet evropiane që zgjidhjen e problemit të pronësisë sidomos mbi tokën e shikojnë si garanci për proceset integruese të vendit tonë, së katërti, është presioni i pronarëve të rinj. (Pjesa që nuk është pronare e ligjshme kërkon sa më shumë mjegull për të fituar dhe kohë për të gjetur një mënyrë për ta ligjesuar atë. Pjesa që është e ligjshme për t'i shfrytëzuar në mënyrë rentabël), Së pesti ajo pjesë e popullsisë e cila për shkaqë objektive, historike, shoqërore apo demografike nuk përfshihet në rrrathet e ish pronarëve apo të trashëgimtarëve të tyre, etj. Të gjithë këta faktorë, megjithëse ushtrojnë presion për "zgjidhjen e problemit", zgjidhja që kërkojnë nuk ka një amplitudë të njehsuar, por është shprehje interesash shpesh jo thjesht të kundërta por shume të mbrehta në kontradiktën e tyre.

## PAKICA E ISH PRONARE DHE SHUMICA POPULL PA PRONË

Për sa kohë aspirata e ish pronarëve si pakicë në minjaturë nuk është bërë realitet, do të ruhet pak a shumë njëtrajtshmeria midis rradhëve të popullsisë. Mirëpo në momentin që mund të ndodh diferencimi, kur ajo pjesë e popullsisë që sot nuk figuron si ish pronare do ta shikojë vetëm të çveshur nga prona, logjike e pritshme është që të reagojë. Por duke qenë se çdo vendim i marrë do të jetë veshtirë për t'u ndryshuar, atëherë krijohen premisa për një kontradiktë të qëndrueshme brenda kuadrin mbarë shoqëror.

Ky rrjedhim logjik buron nga disa faktorë të përbërë objektivë dhe për të shmangur kontradiktën e thella dhe të qëndrueshme ato duhen marrë seriozisht parasysh.

Dihet që forma pothuaj e vetme e pasurisë së patundshme si pronë private në vend janë format e pasurisë që lidhen me tokën. Nga ana tjetër, si e tillë toka ka qenë për shekuj me radhë objekti i vetëm i prodhimit i të mirave materiale dhe me të ishin të lidhur pazgjidhshmerisht si pronarët ashtu edhe jo pronarët. Kjo do të thotë se problemi

ka dy anë. Nga njera duhet kërkuar origjina e pronarëve mbi tokën dhe nga ana tjetër, por në menyrë korelative, qëndron kontributi shoqëror në lidhje me tokën. Kjo e dyta kthehet edhe më në domosdoshmeri, po të kemi parasysh faktin që në 40 vjet të shtetit komunist me aktivitet të plotë centralist në ekonomi, kontributi i gjithë shoqërisë, pavarësisht ku jetonte, lidhet me tokën. Kjo për arsye se kjo ekonomi e centralizuar kishte karakter të thellë bujqësor. Madje dhe sukseset e saj më evidente lidhen me kontributin e përgjithshëm shoqëror në këtë fushë. (Në këtë kuadër ligji 7501 mbi tokën bujqësore duhet pranuar, qoftë edhe me difektet e tij, si një reformë që u mbështet mbi kontributin e shtetasve shqiptar që kishin marradhënje të drejtpërdrejta me tokën. Madje zbatimi i tij me kontradikta dhe përplasje lehtësisht të kapërcyera përbën një vertetim të drejtësisë së tij.

#### ORIGJINA E E ISH PRONARËVE DHE KONTRIBUTI SHOQËROR MBI TOKEN

Kërkësa që për të ardhmën e pronësisë mbi tokën duhet marrë parasysh kontributi i përgjithshëm shoqëror lidhet me faktorin e origjinës së pronarëve të sotshëm të tokës.

Historikisht dihet që Perandoria Otomane e përdori pasurinë e vetme të popujve nën sundimin e vet si stimul kryesor si për të realizuar shtrirjen e fesë së vet, ashtu dhe për të siguruar burime njërezore për të gjitha funksionet nga nivelet më të ulta, (ushtarë të thjeshtë) deri në me të larta (bejlerë, pashallarë e vezirë). Madje fakt është se pas rrenjës se Perandorisë Osmane, pothuaj e njejta sipërfaqe toke u trashëguar mbi këto baza nëpër të gjitha forma e qeverisjes së shtetit shqiptar deri në Luftën e Dytë Botërore. Po ashtu dhe kërkesat e ish pronarëve për formësimin e legjislacionit të ri për pronësinë mbi tokën mbështetet mbi këtë logjik. Pra n.q.s ky legjislacion dë të realizohet pa marrë parasysh faktin që origjina e pronësisë, në një aspekt shumë të gjerë, është mbështetur në qellime politike e pushtuese të Perandorisë Otomane dhe njëkohësisht po të mos mirret parasysh kontributi i shtresave të tjera të popullsisë jo pronare mbi tokën, (si ata që nuk pranuan kushte e pushtuesit Osman ashtu edhe dhjetra breza të mëpastajme që nga pikëpamja e rritjes demografike nuk mund të kishin asnjë lidhje pronësie me tokën, - por ishin të lidhur më të në prodhimin e të mirave materiale), atëhere cili do të jetë rezultati!? Shijen e hidhur të kësaj kontradikte të pritshme e provuam në marrëdhënjet që u vendosen mes banorëve të tri fshatrave në Korçë me familjet ish pronarësh të cilët me një tapi të 1431, kërkonin pronësinë mbi gjithë pyjet dhe livadhet rreth këtyre fshatrave. (!!)

#### PERANDORIA OSMANE - PRONËSIA DHE MARRËDHËNJET NDERFETARE SOT

Këtu patjetër që ka zanafillën edhe një kontradiktë tjetër e pritshme, madje akoma më e rrezikshme. Fjala është për një kontradiktë ndërftare midis të krishterëve dhe myslymanëve.

Kjo për arsye se Perandoria Otomane tokat dhe pasuritë që u jipte të krishterëve që ndërrojnë fenë dhe hynin në shërbim të të gjithë hierarkisë së Perandorisë, ua mirrte të krishterëve që në këmbim të ruajtjes së fesë së origjinës humbisnin çdo lloj pronësie. Kjo ka vlerë dhe për ata spahi që zotëronin tokë para pushtimit otoman por që i zgjeruan ato në një shumëfish të konsiderueshëm për shkak se nderuan fenë dhe se u vunë në shërbim të Perandorisë.

Problemi bëhet akoma më i mbretë po të kemi parasysh faktin historik që Kisha si institucion mbeti pothuaj e paprekur nga Perandoria Otomane dhe iu njohën të drejta edhe mbi pronësinë. Dihet gjithashtu se shumë të krishterë si individë apo si grupime fshatrash, ia kalonin pasurinë e tyre Kishës për të mos lejuar konfiskimin e saj nga ana e Perandorisë Otomane. Ky është një argument më shumë pse Kisha, dhe

sidomos ajo ortodokse figuron si një pronare e madhe tokash. Mbrehtësia e problemit buron nga fakti se sot nuk ka një predispozicion që institucionëve fetare t'u njihet e drejta mbi pronësinë e tyre. Përkundrazi kjo pronësi mund të përdoret nga shteti për kombensim të ish pronarëve që rezultojnë të një feje tjetër.

#### PROBLEMET MBI PRONËSINË NGA ORIGJINA E DOKUMENTEVE SHTETERORE

Po ashtu në spektrin e ligjeve egzistuese të 1992-93 për kthimin e pronave ish pronarëve, deshmia bazë për njohjen e pronësisë është një dokument shtetëror. Lind pyetja për cilin shtet bëhet fjalë. Për Perandorinë Otomane, të Vidit, të austrohungarezeve, të franceve, për qeverinë e Kongresit të Lushnjës, të Nolit, të Zogut, të Shtetit të qeverive Kuislinge të para dhe të gjatë Luftës së Dytë Botërore .....?.

N.q.s do të ndodh si deri tani, përveçse do të kemi problemet e lartpërmendura do të na shfaqen si pronarë mbi troje, godina, rrugë e pasuri të tjera me vlerë kombëtare përfaqësues të shtetëve që kishim marrëdhënie pushtimi me vendin tonë, të cilët kanë nga një akt zyrtar të shtetit shqiptar që i njeh si pronarë. (Është bile fakt që një numër shumë i madh ish pronarësh shqiptarë ua kanë shitur atëherë pasuritë e tyre faktorëve të lartpërmendur dhe tani i rikerkojnë këto pasuri duke nxjerrë nga syrtarët dokumentet e para shitjës ose duke i fallsifikuar ato) Madje - madje shenja të kësaj natyre, (pra të kërkesave të faktorëve të huaj në marrëdhënie të lartpërmendura me Shqipërinë, për t'u bërë pronarë), janë bërë evidente në shumë drejtime dhe megjithë hezitimin e zyrtarëve ka rrezik të kthehen në realitet.

Problemi ndërlikohet akoma më shumë po të kemi parasysh përplasjen midis ish pronarëve vërtet të ligjshëm dhe pronarëve të rinj që përfituan nga relatat të ndryshme, kryesisht korruptive, me segmentet e shtetit dhe të pushtetit.

#### SE PRAPTHI RAPORTET SHTET PRONE –SHTETARE

Tani, pavarësisht nga egzistenca e gjithë këtyre problemeve të mbrehta, shteti, nën peshën e presionit të faktorit ndërkombëtar duhet të marrë një vendim. Bile duhet ta marrë sa më shpejt për të konfirmuar angazhimin e qeverisë për reforma, por dhe për të qetësuar opozitën që po e kthen këtë problem (parimisht të drejtë) në levë të arkimentit kundër qeverisjes socialiste dhe për përfitime personale.

Por cili do të jetë realiteti pas këtij vendimi në një kohë që qeveritë e deri tanishme drejtonin me angazhimin për ta zhvatur shtetin në atë shkallë që e përfaqësonin atë dhe pasuritë e tij dhe ku toka vazhdon të mbetet pasuria kryesore e vendit?

U botua me 23.01.2003

# Nga Panajot Barka

## Përplasja quhet Rama, apo përplasja kërkon Ramën. (Prishja e marrëveshjes së 5 prillit 2002 dhe përplasja për E. RAMEN

26.01.2003/29.01.2003



Edvin Rama është emri mbi të cilin ravijëzohet përplasja e njohur e dy kambeve të mëdha të politikës shqiptare. Kjo ndodh paralelisht me prishjen e muajit të mjaltit midis tyre dhe aksesit politik të Ramës dhe të shtresës që përfaqëson sidomos në institucionet ndërkombëtare me aq peshë në konfigurimin politik të vendit tonë.

Marrëveshja pozitë-opozitë u arrit dhe funksionoi, (pavarësisht nga kualitetet e zgjidhjeve dhe respektimin e

institucionëve shtetërore apo nga arritja e objektivave), për aq kohë sa plotësonte aspiratat e dy partive të mëdha dhe e dy liderve të tyre. Pra PD-ja shprensonte në marrjen e butë dhe shkallë-shkallë të pushtetit dhe PS-ja si mënyrë më efikase për ta ruajtur pushtetin. Me angazhimin e përbashkët për reformat e imponuara jo aq nga presioni i brendshëm se se nga institucionet ndërkombëtare, lideret partiakë të dy partive kërkuan të tregonin sa të plotfuqishëm dhe të pazëvendësueshëm ishin në realitetin politikë shqiptar, kësaj here jo duke u përplasur, por duke u marrë lehtësisht vesh deri në habi.

Prishja e pritur si logjik e pashmangshme erdhi më shpejt se pritej. Mirëpo largësia e shkurtër në kohë nga relatat reabilituese të bëra reciprokisht madje jasht normave luajale të politikës dhe deri duke shtrembëruar të vertetat historike për të cilat duhet të vendoste ligji, nuk i lëjon tani ata që të ripozicionohen në llogoret e njohura të përplasjes së deridjeshme se atëherë aksionet e besueshmerisë së tyre mbetet në kuata zero.

Njëkohësisht ata e kuptojnë se e kanë konsumuar tej mase rolin e të pazëvendësueshmit. E kuptojnë gjithashtu se realitetet politike mund të imponojnë zhvillime pa qenë ata domosdoshmerisht të pazëvendësueshëm. Në të njëjtën logjik ata nuk mund të mos e shikojnë se si perendimi gjen brenda politikës shqiptare partner të rinj, të pakonsumuar dhe të besueshëm. Mirëpo realiteti politik i 12 vjetëve të fundit dhe praktika e zbritjes nga kali të udhëheqësve tanë, tregon se ata nuk janë aspak të gatshëm për të humbur këtë rol.

Prishja de facto e marrëveshjes i la ata edhe më të zbuluar dhe rrjedhimisht fryma që pasqyron kryetari i Bashkisë së Tiranës përbën tani një faktor shqetësues real për lidërshpin e vjetër. Rama dhe shtresa intelektuale e politike koherente me të dhe në korelacion me faktorin ndërkombëtar që manaxhon realisht situatën e përgjithshme në vend, mund të kthehen pra në promotor të levizjeve rievuese në spektrin kryesor politik shqiptar si shprehje të kërkesës imediate për një lidërshpi të ri politik. Aq më shqetësuese është situata për Berishën po të mendohet se një lidërshpi i ri e përjashton

atë nga marrja e pushtetit aq fort të enderruar dhe pritur deri më sot. Kjo përbën një rëndësi të thelbit të luftës së shpallur nga Berisha ndaj Edi Ramës dhe treguesin sepse ai rrembeu flamurin kunder tij

Ndërsa nga ana tjetër agresiviteti i Berishës ndaj Ramës duket se nuk ka si synim të fitojnë vertetesi dhe peshë akuzat e përsëritur të opozitës për korupsion qeveritar. Më shumë kërkon të motivojë kërkesën e Berishës për zgjedhje të parakohshme, të mohuara po nga ai vet deri para pak kohësh. Gjithashtu evidentimi i kësaj kërkesë në vetvete nuk lidhet thjesht me synimin strategjik të opozitës për marrjen e pushtetit por ngjan me servirjen e tortës së pushtetit, tortë të cilën Berisha kërkon ta përdor si karam për partitë e vogla politike të së djathtës që ato të shkrihen në një parti të vetme me atë si lider të vetëm dhe të padiskutueshëm.

Pse tani kjo logjikë përshtatet dhe shkon paralelisht me logjikën e mbrojtjes që i bën Ramës PS-ja?

Eshtë më se normale dhe morale mbrojtja e kryetarit të bashkisë së Kryeqytetit të votuar nga po kjo parti Aq më tepër kur konstatohet mbeshtetja në rritje ndaj tij e faktorit ndërkombëtar.

Së dyti ideologjia sunduese në PS për garantimin e fitorëve të para marrëveshjes me PD ishte antiberishizmi i të gjitha formave. Marrëveshja me Berishën i hoqi udhëheqjes aktuale të PS-së të drejtën morale dhe besueshmërinë në publik për të riaktivizuar antiberishizmin. Kështu që Edi Rama, me potencialin logjik dhe strukturën shprehese që zotëron dhe duke shfrytëzuar si shkak nevojën për t'u mbrojtur nga sulmet agresive të Berishës ndaj personit të tij, mund të shfrytëzohet si faktor efektiv për ngjalljen dhe udhëheqjen e antiberishizmit në PS.

Se treti Edi Rama i siguron PS-së fitorën në bashkinë e Kryeqytetit që në propagandën elektorale mund të konsiderohet si gjysma e fitorës.

Së katërti. Eshtë e vertetë se udhëheqja e PS-së në të gjitha rangjet e mbron Ramën. Mirëpo nga ana tjetër i përcakton atij kufirin deri ku duhet të arrij ai politikisht, kufi që kondurohet nga dera e Bashkisë së Tiranës. Kështu që sulmet e Berishës mund të shfrytëzohen në mënyrë efektive n.q.s Rama do të synojë të dali nga traseja e përcaktuar e të synojë për më lartë. Kjo situatë mund të bëhet gjithashtu e vlefshme po të kemi parasysh se me prishjen e marrëveshjes me PD-në, në PS dolën nga letargjia grupimet e ndryshme politike të cilat do të kerkojnë të rigrupohen rreth atyre figurave politikë që jo vetëm mund t'u sigurojnë fitorën e brendshme partiake, por edhe fitorën elektorale në zgjedhjet e pushtetit lokal apo të përgjithshme.

Se fundi pavarësisht nga fakti që e nisëm argumentimin me një emer kongret ajo që duhet thenë me këmbëngulje është se "ramat" po vijnë në skenën politike si fenomen objektiv dhe se ata nuk është se janë të rrezikuar nga qendrimi i lidershit aktual politik. Bashkë me daljen e tyre ata janë të rrezikuar edhe nga mungesa e rregullave të përcaktuara qartazi të lojës, edhe nga mungesa e kohezionit midis elementëve të këtij faktori të ri politik, por edhe nga raportet që ata do të kërkojnë dhe do të vendosin me shtresën e profesionistëve dhe elementin tjetër të aftë, me intelektualët dhe elementët e tjerë të cilët verbëria politike e lidershit të sotshëm i kishte përjashtuar nga pjesëmarrja në proceset drejtuese të shtetit. Ata duhet të shkojnë tek kjo shtresë duke kapërxyer barrierën e rëndë të servilëve, puthadorëve, korupsionistëve e trafikantëve, të cilët kanë fituar tanimë një aftësi të çuditshme që jo vetëm nuhasin që larg kush e ka rradhën për t'u ngjitur shkalleve të pushtetit e të shtetit, por edhe janë tepër efektivë në mënyrat e zbatuara për t'u përfshirë në hierarkinë e pushtetit dhe për të përfutur pastaj prej tij.

Nga P. Barka U botua tre dite me vone eshte ruajtur gazeta "Koha Jone"

## **Nga Panajot Barka**

### **Rikthimi i epokës së Migjenit dhe mungesa e revoltës!**

13.02.2003/16.02.2003

Vdekja e vogëlushit 3-vjeçar nga Kukësi nuk është se na bëri të përjetonim jashtë skenave filmike realitetin e kohës së Migjenit. Por na vjen si një realitet që sfidon në thelbin e tij atë çka më shumë tam-tame trumbetojmë se po ndërtojmë dhe aspirojmë: - standartet e një shteti civil që na siguron përditë trokitjën në dyert e Evropës.

Rasti i vogëlushit 3-vjeçar në vargun e 13 viktimave të dy-tri javëve të fundit për shkak të urisë e të ftohtit (5 të rinjtë në malin e Gramozit, katër vdekjet e tjera për shkak të ftohtit dhe urisë dhe katër vetvrasjet e fundit për shkak të pamundësisë së përballimit të jetesës), zbuluan në terë lakuriqësinë e tij shkëlqimin e rremë që krijojnë përditë deklaratat e qeveritarëve për ecje përpara, shkëlqimin e rremë të fasadave të mermerta, të makinave luksoze, të faqëve të lemuara të politikanëve .

Prapa tyre civilizimi i shoqërisë dhe i shtetit denigron në një gangrenë kërcenuese. Asnjë zyrtar i shtetit i rrangjeve të ulta apo të larta nuk doli të mbajë përgjegjesi për këtë tragjedi. Asnjë ministër nuk doli të jap dorëheqjen. Përkundrazi, me dhimbje konstatojmë se tragjedia e parametrave të fillimit të shekullit të kaluar sherben si një rast i mirë për medjat për të shtyrë disa ditë përpjekjen për të dalë nga kriza e tyre. Ndërsa ata që mbajnë përgjegjesi presin të kalojë “treditëshi i zgjatjës së jetës të çudisë më të madhe”. Presin dhe njëkohësisht ferkojnë duart për medjat që “bëjnë detyrën” duke mbajtur të palëvizshëm objektivin e kamerave mbi gishtat e shkrumbosura të Ardritit, (nuk i çon njëri kamerat mbi përgjegjesitë e pushtetarëve për to) apo se “bejnë përpjekje maksimale” për të konstatuar nëse vellezërit e tyre të tjerë duan apo jo të kthehen prap në sketërrën e Hasit.

Pas zyrtarëve të shtetit pra edhe medjat tregojnë se i kanë venë një kryq rolit të tyre të pushtetit të katërt dhe të frymës civile që duhet të kultivojnë në shoqëri. Morali i tyre i ditëve të fundit për mijrat e familjeve që mbajnë shpirtin gjallë me ushqime të marra me listë dhe me shpresën e lakrave që u bënë me bollëk për shkak të shirave, është : “ Do zoti të kem edhe unë fatin e familjës nga Hasi.....!!”. Moral ky që na çon në praktikat mesjetare të përballimit të vdekshmerisë, sipas të cilës e pranueshme dhe e dëshirueshme vdekja e njërit apo disa pjesëtarëve të familjës për të siguruar mbijetesën e të tjerëve . Ky mentalitet ndoshta pranohet si e keqja më e vogël po të kemi parasysh se në shoqërinë tonë “moderne” është shumë e njohur dhe praktika më e vjetër akoma, ajo e shtitjës se një pjesëtari të familjës për të siguruar mbijetesën e të tjerëve.....!!

Mos vallë këtu duhet të kërkojmë qëndrimin apatik dhe indiferentë të shoqërisë tonë !?. Asnjë reagim, asnjë protest, qoftë dhe e tipit “ Oh të kisha një grusht të fuqishëm t’i bija mu në zemër malit që hesht e s’bëzan”. Pas indiferencës kolektive për mungesën e dritave, të ujit, për uljen drastike të nivelit të minimumit jetik, për drejtimin e shtetit në bazë të parimeve që siguron mbijetesën e klanit drejtues, heshtja për përfshirjen në barkun e ngrirë të natës të trevjeçarit kuksian tregon se tek shoqëria jonë humbasin kuptimin nocionet e tilla si “komunitet” dhe “shoqëri civile”, se po humbet përditë shpresa. Ç’u bënë gjithë ato struktura të OJQ-ve , organizatave shoqërore, sindikatat. U bënë edhe ato pjesë e malit “që s’bëzan”?! Po! Madje me pasoja më të rënda për frymën civile të shoqërisë tonë, për arsyen e thjeshtë se ato morën përsipër këtë rol e për këtë rol mbi to rra gjithë pesha financuese e komunitetit



ndërkombëtar me para që kanë si destinacion final secilin nga ne. Kështu është e thjeshtë për të kuptuar tanimë se rruga e njëzëzve të thjeshtë të kësaj shoqërie dhe rruga e strukturave të shtetit janë si dy drejtëza paralele që reshqasin në kahje të kundërta dhe kanë si ruleta reshqitëse OJQ-të.

Por ngrirja në djep e vocarrakut trevjeçar përbën një sfidë edhe për komunitetin ndërkombëtar të angazhuar me përparimin e shoqërisë shqiptare. Para vitit 1997 ky komunitet duke zbatuar formula të gatshme në vende të tjera të lindjes, besoi se shoqëria jonë do të zhvillohej në rrugën e tregut të lirë duke financuar bizneset e vogla dhe të mesme. Me këtë argument në Shqipëri, në krahasim me vendet e tjera të Lindjes u investua përqindja më e lartë e parave për frymë të popullsisë. Më 1997 çdo gjë u shemb në kuota nden zero. Perendimi mendoi atëherë se pa ngritur më parë shoqërinë civile në vend është i pamundur si ndërtimi i shtetit ashtu dhe funksionimi tij dhe përparimi i vendit. Me këtë argument po derdhen që atëherë në Shqipëri me dhjetra milion dollarë e evro. Synimi i këtyre strukturave jo qeveritare, i fondacioneve, apo programëve, ishin dy. Së pari emancipimi i shoqërisë civile dhe së dyti përkrahja e komunitetëve në minorancë dhe e shtresave e kategorive shoqërore të pambrojtura, sidomos e femijëve, grave dhe e rinisë. Gjendja aktuale pas gati 6 vjetesh dhe problemet e këtyre kategorive shoqërore si dhe niveli i paqenë civil e emancipues i shoqërisë tonë, tregojnë se arritjet e qindra mijrave të aplikimeve dhe tavolinave të rumbullakta për këtë qëllim kanë vlerë vetëm për malin e dosjeve të përpikta në selitë e përfaqësive ndërkombëtare në vend që justifikojnë vrimat e zeza të hapura me duart tona nga perendimi.

Problemi është se faturën do ta paguajmë serish ne të gjithë. Dhe nuk bëhet fjalë për një faturë materiale se sa për kongluzionin e stërthenë nga të gjitha drejtimet se “ne nuk bëhemi”, se ne po i humbasim “rastet historike”

Nga Panajot Barka 13.02.2003.

**Nga P. Barka, për “Koha Jonë”**

**Medjat: ingranazh i makinës së pushtetit dhe ombrella mbrojtëse të korrupsionit e krimin**

**(Medjat,- mjet konfirmimi i një shoqërie që mohon vetvetën.)**

30.06.2003/02.07.2003

Zhvillimet e kohëve të fundit në lidhje me shtypin tregojnë se edhe ai nuk i shpëton ligjësisë së ecurisë së cikleve të fenomeneve shoqërore në vendin tonë. Zhvillimi i të gjitha fazave në to ndodh në një periudhë jetëgjatësie shumë të shkurtër dhe kalimi nga njëri cikël tek tjetri bëhet duke mohuar në terësi ose në përgjithësi arritjet e ciklit të mëparshëm.

Shtypi tek ne si një instrument efektiv i fjalës së lirë, pati një lulëzim shumë të shpejt. Njëkohësisht pushteti i tij fitoi shpejt një peshë shumë të madhe. Kjo ndodhi për disa arsye. Arsyeja e parë duhet kërkuar tek roli i shtypit si pushtet i katërt në demokraci. Së dyti. Duhet marrë parasysh tradita e rolit të shtypit të kohës së diktaturës komuniste që e kishte kthyer atë në një mjet për të pranuar si të verteta që nuk pranoheshin gjykim çdo fjalë të partisë – shtet. Së treti duhet kërkuar tek mosfunksionimi i institucionëve të tjera garante të sistemit të ri demokratik, siç është opozita dhe institucione të tjera kontrolluese dhe imponuese për zbatimin e ligjit. Ky realitet i siguroi një fuqi dhe rol të tillë shtypit sa që krijoi përshtypjen e një mekanizmi që të siguron gjithëçka: - pushtet, para, imunitet para ligjit, etj. Ky deformim i rolit të shtypit, ose më sakt procesi i mbylljes së ciklit të rolit të tij, u evidentua shumë shpejt. Kongresistët në periudhën 93-97 shtypi zëvendësoi pothuajë rolin e “pushtetit” të opozitës. Mirëpo me ardhjen e saj në pushtet ajo kërkoi në formë të ndryshme të “ndante” pushtetin me shtypin, jo thjesht si shpërblim, por duke u nisur nga roli dhe pesha e tij e pushtetit të katërt në administrimin e pushtetit politik. Si pasojë në një plan më të përgjithshëm këto lloj marrëdhënesh të pushtetit me shtypin kapërxyen çdo normë të lejueshme gjë që çoi në përshtypimin e mëtijshëm të procesit të mbylljes së ciklit të funksionit të shtypit si pushtet i katërt.

Raportet që u vendosen pas kësaj janë në përgjithësi raporte abuzimi të pushtetit me fuqinë e shtypit dhe anasjelltas. Lë ta shikojmë këtë në disa aspekte.

Politika e parë si “qeska me para” dhe shtypi

Në aspektin teoriko-juridik struktura medjative edhe në vendin tonë ka përberjen e njohur: -medja private, medja publike dhe partiake. Në thelb kemi dy kategori. Ajo që është e lidhur me pushtetin si realitet apo si mundësi (pjesë e medjave që përkrah opozitën në pritje të marrjes së pushtetit) dhe medjen e pavarur që realisht ndodhet në pjesën e medjës së private. Në kategorinë e parë pjesa e shtypit e lidhur me pushtetin ekzekutiv rritet vazhdimisht në kurriz të shtypit të pavarur ashtu dhe të asaj pjesë që është lidhur me opozitën. Bile ndodh që pjesë gjithnjë e më e vogël e shtypit të mbetet realisht i pavarur. Madje kjo “realisht” shkon shpesh deri atje sa të flasim për individë - gazetarë të pavarur. Ndikon këtu edhe fakti që ajo pjesë e shtypit e lidhur me opozitën nuk mund t’i besohet funksioni i pushtetit të katërt jo thjesht se është lidhur me opozitën si forcë politike porse kongresistët opozita në Shqipëri është e pabesueshme.

Deformacioni kaq i thellë dhe demsjellës për shtypin e vertet buron nga parimi i përgjithshëm tek ne se politika është mjeti më efektiv pasurimi. Dihet se veprimtaria ekonomike më fitimprurëse në Shqipëri buron nga ekonomia informale, krimi i organizuar dhe korrupsioni. Këto veprimtari zhvillohen me ndërmjetësinë direkte apo indirekte të njëjërëve të veshur me pushtet. Në kushtet kur opozita siç thamë, nuk gëzon

moralin për të qenë e besueshme në kritikën e saj dhe strukturat e tjera të shtetit dalëngadalë po shemben nën peshën e fenomenëve të krimit të organizuar, shtypi për nga vet natyra e tij kthehet automatikisht si rreziku i vetëm për to. Rrjedhimisht ai shndërrohet në objekt korruptimi. Lë të mos harrojmë se mekanizmi i shtypit përbëhet nga raporti dialektik i dy pjesëve. Biznesi i shfaqur në formën e thithjes së reklamave dhe informimit. Tek ne suksesi i biznesit të shypit nuk shfaqet si produkt i suksesit të informacionit. Ai ngarantohet nga infiltrimi i presionit politiko-ekonomik që kontrollon gjithë jetën publike të vendit që synon sigurimin e kontrollit dhe drejtimit të informacionit në favor të tij. Ky lloj presioni është i drejtpërdrejtë dhe indirektë. I drejtpërdrejtë vjen nga pushteti politik që kontrollon dhe shpërndan me logjikën e vet të brendshme paketën e parave për shtypin si në formën reklamave ashtu dhe të donacionëve të ndryshme për të. Vjen gjithashtu nga mekanizmat ekonomike të përmendura më lart të cilat një pjesë të parave të pista e përdorin ose për të krijuar medja të reja ose për të financuar grupe medjatiqe apo individë të fuqishëm medjatiqë. Në mënyrë indirekte presioni vjen nga reklamat në dukje të drejtëpërdrejta por që në kontratat përkatëse i caktojnë medjës përkatëse kushte të cilat diktohen nga faktori politik që fshihet pas shitësit të reklamës.

Këtu duhet kërkuar arsyeja që pse shteti nuk krijon një institucion të pavarur dispeçerimi të reklamës dhe marketingut. Si rezultat, pushteti duke sfrytëzuar marrëdhëniet e marketingut me medjat (si marrëdhënie në funksion të lirisë së shtypit), i ka kthyer ato në marrëdhënie në funksion të biznesit të medjave,. Kjo ka sjellë abuzimin me profesionalizmin, me parimet e gazetarisë së lirë dhe të pavarur me pasojë asfiksimin e misionit të shtypit në demokraci. Praktikisht tek ne kjo konstatohet në zvogelimin e përditshëm të medjave vertet të pavarura, në shtimin atoçensurës së fjalës së lirë, në fragmentarizmin dhe në eliminimin e kolegialitetit të komunitetit të gazetarëve me pasojë shtimin e represionit të strukturave politiko-ekonomike e kriminale mbi medjen vertet të pavarur dhe gazetarë që nuk pranojnë të shesin me asgjë lirinë e tyre.

### **Logjika e lulëzimit të medjave**

Në vitet e fundit në Shqipëri jetojmë në një situatë kontradiktore. Nga njëra anë kemi zvogëlimin e numrit të “konsumatorëve” medjatiq, nga ana tjetër kemi një shpërthim të medjave private, të shkruara apo elektronike, madje tej kufujve të vendëve me popullsi disa herë më të madhe se në vendin tonë. Realiteti i tyre duhet kërkuar përsëri tek nevoja për të abuzuar me peshën dhe forcën e shtypit. Po të vihet re me kujdes në Shqipëri është ravijëzuar tendenca e krijimit të monopolëve individuale ekonomiko-politike. Çdo grupim i tillë kërkon të krijojë garantët e tij mbrojtës. Praktika ka vertetur se mjetet më efektive janë medjat. Ato krijojnë me lehtësi obrella mbrojtëse ndaj çdo segmenti që do të tentojë të rrezikojë mënyrën dhe shkallën e tij të fitimit. Njëkohësisht është një mjet efektiv presioni për t’i saksionuar dhe ligjeruar ato. Medjat përbejnë gjithashtu një pedanë të fuqishme për të ndihmuar individë apo grupe të caktuara për të hyrë në politikë, ose për t’u ofruar qarqeve politike të caktuara shërbimet mediatike në këmbim të fitimit.

Pra një numër kaq i madhë mjetësh informimi që konkurojnë një opinion publik, degjuesish, shikuesish, apo lëxuesish në numër kaq të vogël, na zbulon se mbijetesë e tyre nuk e ka burimin tek marketingu dhe për pasojë nuk lidhet aq me dëshirën e informimit, por përfitime të formave të tjera nga poseduesit e tyre që bazohen tek pesha e fjalës së medjave dhe sidomos imuniteti që krijon medja tek ne.

Ky lulëzim nga ana tjetër është një shpresë e mirë. Pashmangëshmeria e prishjes së ekulibreve midis klanëve të ndryshme ekonomiko-politike në vend, krahas rritjes së

presionit mbi medjat, (siç po përjetojmë kohët e fundit) mund të krijojnë premisa që mbi baza të tjera të ringrihet një realitet i ri shtypi të lirë.

Panajot Barka Gjirokastër 30.06.2003 (u botua dy ditë më vonë tek Koha Jonë)

Mik i dashur,

Pas kaq kohësh thash të shkruaj përseri një diçka dhe po ta dërgojë për ta botuar tek "KOHA", por pa të venë në siklet. Dhe si zakonisht, po të lë barë titullin dhe gjykimin përfundimtar, dmth të drejtën për të venë dorë në se diçka nuk shkon. Panajoti.

### Nga Panajot Barka

## Realiteti i krizës dhe qëllimi i opozitës për të marrë pushtetin

27.02.2004/28.02.2004



Zhvillimet e fundit politike po vërtetojnë se ekuilibret e instrumentave që rregullojnë funksionimin normal të shtetit janë prishur. Vendi konsiderohet në krizë. Faktet po vërtetojnë se kriza është e mbartur. Shfaqja e saj e paradokohëshme si krizë e Partisë Socialiste në pushtet, ishte një shfaqje e genjeshtërt i shkaqëve thelbësore që e prodhojnë atë: - Etja për të venë nën kontroll të gjitha llojet e pushtetëve, për të zëvendësuar ligjin me vullnetin e individit apo përonit të ngarkuar për ta

zbatuar atë, për të kthyer politikën nga veprim në favor të shumicës, në veprim të interesave të grupëve apo individëve që e ushtrojnë politikën dhe shtetin e përfaqësuar prej tyre, nga ruajtës i vlerave të prodhuara nga qytetarët e tij në grabitës të këtyre vlerave.

Problemi themelor, pra qendron në faktin se si parti të që e ushtrojnë drejtpërdrejt pushtetin qëverisë, ashtu edhe ato që e ushrojnë atë, kanë manifestuar dhe manifestojnë pikërisht të njëjta antivlera politike. Logjika e drejtë demokratike e shikon rotacionin politik në pushtet si një domosdoshmëri të asaj që kur një grupim politik nuk mund të prodhojë më vlerat pozitive për shumicën e popullit, ia lë drejtimin e vendit, me mjete demokratike, - zgjedhje, - një grupimi tjetër.

Në vendin tonë jo vetëm këmbimi në pushtet po bëhet gjithnjë e më i vështirë, por ndërrimi bëhet "kur pilafit s'mban më ujë" dhe më e keqja, pa asnjë garanci se edhe marrësit nuk do ta përdorin atë si qëllim në vetvete.

Lë t'i marrin gjërat më kongregtisht. Evidentimi i krizës mendoj se nuk është thjesht kontrolli absolut i Nanos mbi partinë e tij (rezultatet të kujtojnë pak a shumë ato që arriti Berisha në PD para vitit 1997), as qëverisja me një rrez që i shkaktojnë Nanos konsum moral të integritetit politik, as akoma asfiksimi i veprimit politik të opozitës brenda institucionëve. Ky evidentim nuk plotësohet akoma as nga kritikata e forumëve ndërkombëtare që monitorojnë vendin.

Fytyra e krizës shfaqet më shumë tek varferia e skajshme e popullit me pasoja të renda deri në shpërbërjen e familjës, tek kërkesa permanente e shqiptarëve për t'u larguar nga vendi i tyre, tek humbja e shpresës (e cila vdes e fundit) që çon në vetvrasje masive. (A ka akuzë më të madhe për një shtet se fakti që numri i vetvrasjeje në vend për shkak të deziluzionit është në rritje?! Vetëm gjatë javëve të para të vitit në vijim numërohen 16 raste). Shfaqet gjithashtu tek mungesa e theksuar e besimit të një rrezve tek politika. (Në

një vend kaq të politizuar si Shqipëria, që njëherit konsumojnë më shumë politikë se punë, ku besojnë se politika të zgjidh çdo problem, pjesëmarrja në votim, si ushtrim individual i politikës, arrin shifrat minimale).

E mëgjitatë, opozita që kërkon pushtetin nuk artikulon gjë për të mënjanuar këtë krizë që aq barabarisht vepron mbi shoqërinë dhe kohëzisionin e vet. Përkundrazi! Shfaq me tepri gatishmerinë për të rrezuar Nanon dhe për mënyrën se si do të ndaj pushtetin e tij.

### **Berisha dhe “NANO IK”**

Dhe tek zhvillimet e fundit politike na shfaqet i njëjti binom që ka përcaktuar zikzaket politike të vitëve të fundit në vend, por edhe karakterin autokratik të demokracisë sonë e mbeshtetur tek binomi Nano - Berisha. Si njëri, ashtu dhe tjetri po shfrytëzojnë investimin politik të bërë mbi personat e tyre nga shumë faktorë, për të qënë faktorë determinantë në zhvillimet politike në vend.

Jo shumë larg në kohë, kur nën qeverisjen socialiste me Ilir Metën, amplituda e krizës impononte një shkundje dhe vendi kërkonte një mentalitet të ri politik e qeverisës, Nano, i mënjanuar atëherë vetëm në drejtimin e Partisë Socialiste, e shfrytëzoi momentin për t'u rikthyer pas një largimi relativisht të gjatë në drejtimin e qeverisë. Rrembeu flamurin e lëvizjes së “Katharsis-it”, si shprehje e domosdoshmerisë së pastrimit të drejtimit të vendit nga korrupsioni e krimi i organizuar dhe i korri për vete frytët e saj. U bë dhe kryeministër duke e thelluar zhgënjimin e atyre që besuan tek vertetësia e angazhimëve të tij për “Katharsis”. (Kjo u lëvërdisi edhe socialistëve se vaji që u derdh mbeti tek byreku i tyre. Pushteti nuk u iku nga dora)

Tani ndodhemi në një moment të rishfaqjes së krizës:- të frenimit të reformave, të mos luftimit të korrupsionit dhe krimin të organizuar, por mbi të gjitha të rritjes së varfërisë deri në skamje. Nevojën për ndryshime e inspironte dhe e administronte, me ato pak mundësi por ama në rritje, lëvizja qytetare.

Berisha, duke parë se kjo lëvizje në rritje, por edhe faktorë të tjerë brenda opozitës dhe të tjerë, mund ta linin jasht rolit që do t'i siguronte pushtetin që po bie, u rrembeu të tjerëve inisiativën dhe doli flamurtar i kësaj lëvizjeje. Dhe deri tani duket se ia doli të jetë ai shprehës i saj. Ai ka arritur të grumbullojë rreth vetës të gjithë ata opozitarë që prej kohësh duan njëkohësisht edhe shumë por edhe pak pushtet. (Opozita edhe pse kaq shumë e do pushtetin, tregonte e papërgatitur për të pasi nuk kishte zgjidhur problemin e liderit. Grupet opozitare e kuptonin se me Berishën perendimi nuk do t'u besonte pushtetin, por edhe si një opozitë e tillë mund të mos votohej nga populli. Situata jo vetëm kishte mbjellë pritjen por dhe kishte stimuluar ndjenjën se shumë syresh në vathën e opozitës ta shikonte vetën si udheheqës të saj. Kjo kishte sjellë përçarje dhe grupime të ndryshme brenda saj, por gjithmonë në heshtje dhe pa u bërë prezente para Berishës)

Nga ana e tij Berisha duket se është i ndërjegjshëm për vlerësimin e të tjerëve për personin e vet. Ndaj dhe ai duke e njohur mirë domosdoshmerinë e stabilitetit politik dhe investimin e perendimit për këtë stabilitet, po i përdorë protestat edhe si tregues i rritjes së kredibilitetit të vet, edhe si tregues i pamundësisë për të vepruar brenda institucionëve, por edhe si kërcenim, por gjithmonë me primat vetën.(!)

### **“NANO IK !” si mjet për të shpëtuar pushtetin e socialistëve (!)**

Por ç'ndodh në fakt. Revoltat e Berishës kanë në thelb parullën “Nano ik!”. Sillogani i lëvizjes së opozitës po të jetë se i drejtohet Nanos si kryetar i qeverisë me besimin e opozitës se më ikjen e tij do të hapet asaj rruga për të ardhur në pushtet, na verteton në një farë mënyre atë që thamë për binomin autokratik të demokracisë tonë. Pra opozita e sulmon Nanon si njërin pol të binomit, ashtu si dikur opozita socialiste sulmonte Berishën.

Por më shumë është evident fakti që Berisha kërkon ikjen e Nanos si përsôn. D.m.th se ai kërkon ikjen e kundërshtarit të vet antipod. Arsyet, (pas shumë marrëveshesh midis tyre, publike, të fshehta, në heshtje), mund të jenë të shumta. Por, n.q.s Nano ikën dhe ia lë vendin një kryeministri të ri socialist, atëherë çdo të bejë opozita (!).... Do të kënaqet...! ?

Me këtë kërkesë duket se pajtohet dhe ndjenja e mbajtjes së pushtetit brenda PS-së. Socialistët pra mund t'i kërkojnë Nanos, që duke imituar rastet e fundit në Greqi, Gjermani e gjetkë, të "sakrifikojë" vetën për hir të pushtetit të socialistëve. Është tjetër gjë sa do të pranojë Nano të bejë "sakrifica" të tjera për socialistet e tij dha sa do ta lenë Nanon grupet të caktuara rreth tij, (mëgjithse kjo lëvizje e imponuar mund të shfrytëzohet prej Nanos si një investim për ambicjet e ardhshme politike të tij të lëna në mes rreth dy vjet më parë).

### **Faktori ndërkombëtar i përshatet binomit tonë autarkik**

Faktin e kontrollit të demokracisë dhe të shtetit ligjor në vend nga ana e politikës dhe aq më keq nga individë të caktuar të saj, është dhe bindja e faktorit ndërkombëtar që monitoron zhvillimet politike në vend, për të zgjidhur krizat me marrëveshje bilaterale të partive politike apo më shumë të tipit Nano – Berisha. Recata aq e njohur që nga 1997, ridoli në skenë ditët e fundit nga ambasadori i OSBE-së në Tiranë. Kjo lëvizje e Liponen-it mund të këtë dhe arsye të tjera. Si paralajmerim për zgjedhje të parakohshme, (pavarësisht se koha e mbetur deri në zgjedhje të zakonshme nuk premtion përfitime të mëdha nga zgjedhjet e parakohshme), konsumim kohe deri në to, spostim të vëmendjes nga tensioni në rritje për ruajtjen e stabilitetit politik, apo përpjekje të këtij faktori që duke aplikuar serish të njëjta formula të vertetojë rentabilitetin e tyre për realitetin shqiptar e kështu ai të justifikojë vetën për rolin e tij në misionin e dhenë. Gjithçka mund të jetë. Gjithsesi gjithçka mbeshtetet tek roli e faktorit Nano- Berisha, ndaj të cilëve vet këta faktorë investojnë dhe vet duan t'i mënjanojnë nga politika shqiptare për t'i hapur rrugë politikanëve të rinj. P . Barka 27.02.2004.

U botua "Koha Jone" dt.28.02.2004 f. 13 (FORUMI i gazetes)

# Forum

Komenti

## Pse i duhet kthyer "periudhës barbare"?

*Kështu që si mjete inspiruese të demonstrimit mund të shërbejë manipulimi i klanizmit apo krahinizmit, i përfaqësuar nga grupimet politike të caktuara si diferencime jug-veri, apo nacionalizmi i shfaqur si çështje kombëtare. Këto mjete jo vetëm që kanë portën gjithmonë të hapur në ndërgjegjen e çdo shqiptari të thjeshtë, por siç thamë janë instrumenta që mitizojnë shkaqet e trazirave të 1997-ës dhe nga ana tjetër, përshkohen nga një aktualitet si çështje e shtruar për zgjidhje*

NGA PANAJOT BARKA



Nga trazirat e '97-ës në Vlorë

ne shqiptari me titullin "Kur vinin barbarët". Fabula filozofike është e thjeshtë dhe e marrë nga historia e organizimit shtetëror të periudhës romake. Pra një organizim shtetëror i asaj periudhe kishte arritur kulmin e dekadencës së vet dhe shikonte ardhjen e barbarëve si "një farë zgjidhje". Do të ishte gabim të mendohej se risjellja në kujtesën e ditës të këtyre ngjarjeve është shprehje e krizës së shtypit i cili nga që nuk ka sensacione për t'u shitur, rihap një kapitull të dridhshëm. Kjo pasi seriallet e gjata të prapaskenave të diktaturës komuniste nuk sollën ndonjë sukses, (megjithatë edhe ato seriale shpesh ishin të porositura nga ato segmente të ish-diktaturës që kërkojnë ose të rikuperojnë sadopak veten, ose t'u ndihim ripozicionimit të pasuesve të tyre në politikën e sotme. Megjithatë, qoftë si në fabulën e poezisë së Kavafit, qoftë si në proverbin popullor të kthimit të fajtorit në vendin e krimit, qoftë si porosi nga dikush, ky rikthim tek '97-ta bëhet për përfitim politik, por që mbart një rrezik të madh. Ku qëndron rreziku?

**Së pari.** Në atë që përfitimi politik kërkohet duke iu rikthyer një periudhë barbare, të errët e të pa

më fajtor, ose duke mbajtur kokën prapa dhe jo duke parë përpara. Pra pranvera e '97-ës po kthehet në sistem referimi për çdo moment që imponon ndryshime politike në vend.

Madje për të matur hapin politik duke u nisur nga kjo pikë referimi dhe jo nga problemet që koha shtron për zgjidhje për të tashmen apo për të ardhmen. Dihet që çdo shoqëri, në çdo periudhë këthese historike apo tranzicioni, për të mbështetur ecjen e saj përpara ose për të realizuar një aspiratë kolektive madhore, krijon sisteme e veta të referimit në formën e miteve, heronjve apo ideologjive, etj. Ato i përkasin kohës së vet apo periudhave të shkuara. Por shërbejnë si modele ideale imitimi që synojnë të ardhmen. Në këtë aspekt, klasa jonë e politikanëve duket se është mbërthyer tek sistemi "i vlerave" të pranverës së '97-ës. Kujtesa e tyre po harron faktet, përgjegjësitë që rrjedhin nga veprimet apo mos veprimet e tyre. Ata neutralizuan veprimin e ligjit për të gjitha këto akte dhe çdo ditë që kalon po e mitizojnë këtë pranverë të kobshme.

Pastaj, në çdo momenti që u duhet e përdorin ose për të akuzuar të tjerë dhe të lartësojnë vetveten, ose

**Së dyti.** Ndoshta ky fakt hedh sadopak dritë në arsyen se përse të dyja palët treguan të njëjtin interes e gatishmëri për të mos zbardhur 1997-ën. Dhe riaktualizimi sot ndoshta bëhet me qëllim që të tërhiqet vëmendja nga aktualiteti i rënduar ose për ta paralelizuar atë me pragpranverën e 1997-ës.

Ndoshta për të tërhequr vëmendjen nga shkaktrëtit e vertet të rrëzimit e shkatërrimit të shtetit nga njëra anë dhe nga përgjegjësit kryesorë për mos ndërtimin e tij, nga ana tjetër.

**Së treti.** Të gjithë e shohim se rikthimi tek 97-ta bëhet nga ana e politikanëve edhe për të rikuperuar sadopak imazhin e tyre politik të stërkosur gjatë kësaj periudhe nga abuzimi me pushtetin politik. Nga ana tjetër '97-ta po përdoret si mjet efikas për të zgjuar mllafet e fjetura të viktimave të piramidave. Qëllimi i vetëm i këtij zgjimi mbetet riangazhimi i popullit në lojën e tyre politike për ta shfrytëzuar atë "si vota të zjarrta" në betejën e ardhshme elektorale. Duket se braktisja e politikanëve nga ana e elektoratit i ka trembur jashtë mase politikanët. Dhe kjo tregon se dilemat, në të dy

mundësitë e marrjes së tij.

**Së katërti.** Kjo frymë mbyll shtigjet e konstruktivitetit dhe dialogut politik dhe hap rrugën e përplasjes, intolerancës dhe ballafaqimit shumëplanësh. Këtu zenë fill edhe probleme më të mëdha. Pse? Dihet se politikanët tanë duke patur si parim orientues ruajtjen e denoncuesit të së keqes dhe të fajtorit, të bëhen armiq për vdekje me kundërshtarin e tyre politik.

Mesazhi që u japin pasuesve të tyre është pikërisht intoleranca. Ndërkohë për vete ata, jashtë syve të pasuesve të tyre, ulen e pinë kafe dhe e gjejnë gjuhën e përbashkët me të njëjtin "armik". Nga ana tjetër, shkak i ballafaqimit më 1997 ishte viktimizimi ekonomik e politik i mbarë shoqërisë shqiptare në emër të mbajtjes së pushtetit të rremë. Shpesh, madje edhe sot, shkaqet e qënësishme të trazirave të 1997-ës, u interpretuan me instrumenta të përplasjes jug-veri apo të rrezikut të jashtëm. Në këto rrethana kuptohet që shkaqet e vërteta që nxitën trazirat e 1997-ës, nuk mund të rimerren si motive të të qënësishme për të nxitur lojën aktuale politike. Po ashtu lë

pushtetit në një kohë që synimi i pushtetit politik nuk përbën kauzë të njerëzve të thjeshtë. Kjo do të thotë që tani kur të dy kampet kryesore të politikës shqiptare synojnë demonstrimin e forcës të masës së mbështetësve në shesh, kuptohet që do të kërkojnë mjete të tjera për ta bërë më të qënësishëm këtë demonstrim. Kështu që si mjete inspiruese të demonstrimit mund të shërbejë manipulimi i klanizmit apo krahinizmit, i përfaqësuar nga grupimet politike të caktuara si diferencime jug-veri, apo nacionalizmi i shfaqur si çështje kombëtare. Këto mjete jo vetëm që kanë portën gjithmonë të hapur në ndërgjegjen e çdo shqiptari të thjeshtë, por siç thamë janë instrumenta që mitizojnë shkaqet e trazirave të 1997-ës dhe nga ana tjetër, përshkohen nga një aktualitet si çështje e shtruar për zgjidhje. Dhe këtu mendoj se qëndron dhe rreziku më i madh. Kjo vërteton se kriza në vend e shfaqur si krizë e pushtetit politik është më së shumti krizë idesh e vizionesh politike dhe se klasa e tanishme politike nuk mund të çlirohet nga rrethi vicioz i hakmarrjes në emër të pushtetit dhe me sistem referimi mitizimin e 1997-ës.



**Nga Panajot Barka\***

<https://www.kohajone.com/2018/11/13/panajot-barka-ne-varrimin-e-kacifas-nuk-kishte-asgje-antishqiptare-ne-bularat/>

## **Në varrimin e Kacifas nuk kishte asgjë antishqiptare në Bularat**

13 Nentor, 2018 Koha Jone



Fillimisht, falenderoj medja në Shqipëri që mirepresin shkrimet e mia. Vlerësoj qëndrimin e tyre si kontribut civilizues nëpërmjet mendimit ndryshe dhe si mundësi për ruajtjen e komunikimit ekuilibruar.

Së dyti, dua të distancohem nga ekstremizmi që cenon interesat që na bashkojnë, ashtu si edhe nga qëndrimet që shtrembërojnë të vërtetën në emër të nacionalizmit të rremë.

Së treti. Shpërthimi i furtunës së fundit në marrëdhëniet Shqipëri-Greqi kanë si pikënisje, në dukje, dy anë të kundërta të ditës së fundit të jetës së Kostandinos Kaçifës. E para, është akti i denueshëm i përdorimit prej tij të armës dhe e dyta vrasja e tij prej shtetit në kapërxim të ligjit (faktet tona këtë tregojnë), dhe për më tepër pa marrë parasysh provokimin e sensibiliteteve etnike deri në shpalljen e tij hero.

Së katërti, ndërhyrja ime në lidhje me këtë ngjarje synon një analizë më të gjerë, duke venë në qëndër të vemendjes frikën e shtuar që kaplon minoritetin etnik grek këto ditë, në raport me historinë, me realitetin dhe perspektivën e tij.

Ky minoritet përballet aktualisht nga njera anë me fashën solide dhe denuese deri në kërcënim të opinionit publik shqiptar me element të dukshëm nacionalizmin antihelen. Në anën tjetër ndodhet nacionalizmi helen i provokuar nga vrasja e 35 vjeçarit Kaçifas, nënshtetas shqiptar e grek me kombësi greke. (Vrasja ndodhi në ditën e festës kombëtare të Greqisë, në fshatin e tij, në të cilin po hidhej hapi i parë serioz në raport me të renët grekë të luftës ndaj pushtuesve fashistë në 1940-41.)

Provokimi u shtua nga politika zyrtare në Shqipëri e cila në përpjekje për të veçuar Kaçifën nga pjesa tjetër e minoritetit shpejtoi për ta karakterizuar atë terrorist dhe të fantaksur dhe përkrahësit e tij me cilesime ekstreme dhe vulgare. U ushqye nga medja të caktuara shqiptare që në menyrë të papërgjegjshme, por më shumë të qëllimshme, emetonin lajme që i shkonin përshtat nxitjes së nacionalizmit grek.

Ardhja për varrimin e K. Kaçifës, shpallja e qëndrimeve të tyre dhe ikja brenda ditës në Greqi, e bënë frikën e anëtarëve të komunitetit të etnisë greke në Shqipëri, më të frikshme. Nga njera anë se kontribuan në amplifikimin e retorikës nacionaliste antihelene të palës shqiptare. Nga ana tjetër, largimin e tyre po atë ditë dhe me peripecitë e njohuara, rriten ndjesinë e të qenurit peng të frikës tek bashkëkombësit të tyre banorë në territorin e shtetit shqiptar.

Këtë ndjesi e shton përpjekja e shtetit shqiptar për të marrë “në mbrojtje” minoritarët grekë në Shqipëri nga “ekstremistët” grekë të Greqisë, retorikë që të kujton periudhën e diktaturës komuniste.

Po e ndihmon edhe pala greke, e cila në përpjekjen e saj për të patur marrëdhënie të mira me Tiranën, harron dhe anashkalon realitetin e minoritetit të vet në Shqipëri.

Ndikojnë përvojat e hidhura të 1990, 93, 94-95, 97, 98-99, 2003 etj të cilat fituan një amplifikim të dukshëm, pasi edhe në këtë vrasje u ricikluan episode të ngjashme.

Një argument shtesë në spektrin e gjerë të frikës, përbën fakti se kësaj here i është venë më shumë syri dëmtimit të marrëdhënieve midis popujve, shtetlëve dhe krijimit të terrenit për një zinxhir hakmarrës, pjesë e të cilit mund të jetë kushdo prej nesh.

Por më shumë ndikon ndërgjegjësimi i pjesëtarëve të komunitetit të etnisë greke se shpërrthimet nacionaliste në formë mjegulle, kanë si themel mungesën e vullnetit për të thenë e zbulluar të vërtetën mbi ngjarjen, dhe krijimin në mënyrë artificiale dhe të qëllimshme të episodeve të përditshme të rënda, që të kujtojnë madje tragjeditë e lashta greke, siç ishte rasti i mbajtjes pa arsye bindese të trupit të Kaçifës për 12 ditë rresht.

Një rreth tjetër frike përbën vet ngjarja. Ditët që pasuan 28 tetorit krijuan gjithë mundësinë për të kuptuar se ngjarja ishte e parathënë. Ndoshta, nuk ishte parashikuar fundi tragjik i Kaçifës, – ashtu si me 1994 në Peshkopi. Është e vërtetë se nuk ka përgjigje për arsyet që e shtynë Kaçifën për të kryer aktin e denueshëm të përdorimit të armës, (madje dhe në drejtim të policisë, pavarësisht se nuk donte të vriste kend) në ditën e festës kombëtare të Greqisë, kontribues për të cilën ishte dhe vet ai. Por, ka një përgjigje që vjen nga rrethi i tij pjesë e të cilit abuzonte me ndjenjat dhe sinjeritetin e karakterit të tij. Nga njera duke e shtyrë dashurinë e tij për vendin dhe kombin e vet tej kufijve të normalës dhe nga ana tjetër duke e tradhëtuar si ekstremist.

Por dhe vet dinamika e ngjarjeve të asaj të dieleje shtrojnë pyetje gozhduese. Pse u vra 35 vjeçari? A u ezauruan dispozitat e ligjit për përdorimin e armës, dmth a u ezauruan të gjitha mundësitë për t'i shpetuar jetën Kaçifës? Mos vallë në gjyq ai do të fliste për gjera që nuk duhen mësuar kurrë? Nëse nuk është kështu, ku ndohet telefoni i tij, dëshmitari i fundit që mund të na tregojë shumë gjera? Trajektorja e dy plumbave që i morën jetën 35 vjeçarit tregojnë se ai u vra në këmbë. Distanca nga u qëllua, sipas një profesori mjekoligjor duhet të ishte rreth 15 metra. Persona që e panë të vdekur, thanë (pa dashje) se 35 vjeçari kishte renë me duar të hapura (!) Perse, ndryshe nga rregulli, nuk posedohet videoja për dinamikën e ngjarjes? Përse vrasja ndodhi, sapo ceremoniali ndërshtetëror për varrëzat e ushtarëve grekë kishte mbaruar? Mos vallë është vepruar me logjikën e gazetarit të njohur për investigimet e tij, se u vra për të përcjellë mesazhin se ky vend ka zot, dhe për këtë lë të qajnë nënat e tyre? Perse u hap kaq shumë loja me spiunë të shërbimeve sekrete këto ditë në minoritetin etnik grek?

Të gjitha këto pyetje dhe dyshime në subkoshienecën dhe koshienecën kolektive të minoritetit grek gjejnë përgjigje në imazhin e vrasjeve të bashkëkombasëve të tyre nga sistemi komunist për shkak të dashurisë së tyre për kombin am.

Një rreth tjetër frike përbën presioni shqiptar mbi minoritetin grek për të mohuar identitetin etnik, të drejtat dhe historinë e tij, duke përdorur si mjet paternalizmin nga njera anë dhe tejkalimin e masës, qoftë edhe në kufi të patolerueshme, për të drejta që minoritetit i takojnë nga ana tjetër. Rasti Kaçifa përbën shëmbullin më të ri dhe më tipik. Ai kishte një armë por nuk e përdori për të vrarë njeri. Donte shumë vendlindjen e vet, ndaj la Greqinë dhe erdhi për të jetuar në të, donte identitetin e vet etnik dhe e shprehte këtë me shpalosjen e flamurit (ndoshta duke tejkaluar masën e së drejtës të njohur me ligj). Çdo gjë në territorin gjeografik të fshatit të vet. Çdo gjë si veprime individuale. Asgjë në dëm të shtetit shqiptar. Por u vra për t'u shpallur ekstremist, terrorist, iredentist nga njera anë dhe hero nga ana tjetër!

Lë të zhveshim sado pak patosin grek në ditën e varrimit të K. Kaçifës. Të parin gjë që do të shohim është se, ndërsa kishte prani greke me tepicë, por nuk kishte asgjë antishqiptare. (Madje çdo përpjekje e tillë ndalohej dhe denohej nga vet të pranishmit) Tepria greke konsistonte në dy elementë bazë që në fakt nulizojnë çdo karakterizim për iredentizëm grek. Së pari u demonstuan standarte të dëgjua në çdo miting me përmbajtje kombëtare greke, apo për çdo person që humb pa të drejtë jetën. Aq më tepër që në rastin konkret Kaçifas ishte identifikuar me flamurin grek dhe vonesa me ditë të

tera të varrimit të tij nga shteti shqiptar kishte provokuar ndjenjat nacionaliste në Greqi. Së dyti në Bularat rimarrja e shabllonëve të njohura historike (dhe anakronike) pa asnjë “vizion” të ri “irredentismi kërcenues” për Shqipërinë, besoj se i la pa armë nacionalizmin ekstremist antihelen në Shqipëri.

Vet Ministri i Jashtëm Ditmir Bushati konstatoi irredentizmin tek termi “Vorioepir” (!) Mendoj se ky fakt përbën abuzimin me të keq për t’i imponuar kohës, realitetin dhe minoritetit mohimin e historisë dhe ngjarjet historike në lidhje me të. Dihet së pari që vendosja e kufijve shtetërore midis Greqisë dhe Shqipërisë ndau unitetin mijravrjeçar të Epirit në dy pjesë, në Epirin e Veriut (greqisht Vorioepir) dhe në atë të Jugut, pjesë reciprokisht të Shqipërisë dhe Greqisë. Dihet së dyti se autonomia e Vorioepirit është një fakt historik, me një protokoll të firmosur nga pala shqiptare (M. Frasheri), nga përfaqësuesit e Vorioepirit, nga fuqitë e mëdha dhe pala greke. Dihet historikisht se për autonominë e Vorioepirit ishin pro dhe luftuan bashkë popullsi të etnisë greke dhe shqiptare, myslimane dhe ortodokse në këtë territor, madje nën trysninë sabotuese të qeverisë së Athinës. Kështuqë, ta mohosh si ngjarje, apo më keq, ta identifikosh atë me minoritetin grek dhe t’ja faturosh atij sot si aktualitet irredentist, është e paprecedentë, aspak serioze dhe mjet i padenjë presioni.

Te tilla janë dhe përpjekjet për t’i imponuar këtij minoriteti historinë e stisur si i ardhur në trojet e veta diku nga shekulli i XVIII-XIX, ndaj duhet të pranojë mëshirën shqiptare. Deri na atë shkallë shkon ky presion saqë kushdo që nga ky minoritet deklaron se jemi autokton, shpallet hero.

I paprecedentë mbetet mohimni historik i faktit se tri batalionet partizane nga ky minoritet luftuan përkrah partizanëve shqiptarë në premtimin e Paktit të Atlandikut se pas luftës do të vendosnin vetë për fatin e tyre, dmth nëse donin apo jo bashkimin me Greqinë.

Po ashtu i demshëm mbetet paternalizmi shqiptar për të mohuar të gjitha figurat historike të minoritetit që nuk u bënë shërbyes të qeverive shqiptare, sidomos të Enver Hoxhës, apo për të pohuar në emrin e këtij minoriteti se ai vazhdimisht gëzonte dhe i gëzon të gjitha të drejtat, ndërkohë që nuk guxon të shkruajë emrin e vendbanimit të tij në gjuhën amtare.

Kjo do të thotë se ndërtimi i një profili bashkëjetese tradicionale si ndër shekuj nuk mund të arrihet as me kultivimin e frikës tek pakica dhe as me frikën e shumicës nga pakica. Aq më tepër kur raste të tiulla i kundërvihen totalisht historise dhe realitetit të marrëdhënieve të njerëzve të thjeshtë.

\*Shkruar për TemA